

# Bahri Myftari

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8154-32

M 99.

**ERËRAT  
SILLNIN  
NJË  
KUJTIM**

**tregime**

814-32  
NI PP.

BAHRI MYFTARI



ERËRAT SILLNIN  
NJË KUJTIM

*tregime*

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## TREGIMI I NJË SHOKUT TIM

Atëherë isha mësues në një fshat malor. Ndosh-ta në pikën më të lartë të rrethit, pasi gështenja dhe pisha vetëm aty gjeje. Vitin e fundit erdhi Berti. Unë nuk e njihja, por e dija se ai shkruante, dhe dy-tri tregime të tij i kisha lexuar në gazeta të ndryshme. Njërin ai e kishte botuar në gazetën «Drita». Pra më duhet të them se deri diku e njihja, se, si çdo autor, edhe ai do t'u kishte dhënë diçka nga vetja krijimeve të tij.

Berti lexonte shumë. Edhe atë ditë e lashë në dhomë, duke lexuar një roman. Vetë shkova te stallat e kooperativës. Ishte vjeshtë, duhet thënë vjeshtë vetëm për hir të kalendarit, sepse, po të gjykoje nga moti, ishte dimër i vërtetë. Kishte dhjetë ditë që binte borë, vërtet me ndërprerje, por kishte shkuar deri në gju. Moti i ftohtë dhe kjo bardhësi dy pëllëmbë i kishte tërbuar ujëqit, të cilët, siç i thonë në një fjale në këto anë, nuk po e vinin ngordhjen në sy. Ata kishin filluar të zbritnin deri në fshat. Një natë më parë ata kishin zbritur prej majës së Blerit, kishin rrëmbyer tri dele dhe e kishin bërë çarçaf qenin e stallës. Pllangat e gjakut dhe bishti i qenit dukeshin ende mbi borë.

— Po t'i lëmë ujqit të bredhin kështu, në fund të vitit ata do të kenë vënë nga një pëllëmbë dhjamë, — foli një fshatar.

— Me të vrrarë nuk i dilet. Pse, ç'u bë?! Duhet bërë siç bëri Halil Kuci një viti, — tha kryetari i këshillit dhe u largua me një pushkë mbi sup.

Unë, i çuditur, pyeta fshatarin se ç'kishte bërë Halili. Ai më tregoi se kishte mbytur dymbëdhjetë ujq.

U nisa për në shkollë. Pranë dhomës pashë një qen murrash me një pullë të bardhë sa një dorë fëmije midis syve.

Ishte Murroja i Halil Kucit. Halili, që kishte mbytur dymbëdhjetë ujq! Qesha. Më dukej e pabesueshme kjo, megjithatë u mundova ta mendoja atë duke u përleshur me ato kafshë të egra.

«Halili s'duhet të ketë qenë fare vetëm. Të paktën me të do të kishte qenë Murroja, dhe atëherë sikur m'u mbush mendja se me një qen të tillë mund të përleshesh pa frikë edhe me një kope arinjsh. Murroja më njohu dhe erdhi e më hodhi të dyja putrat e tij të rënda mbi gjoks, pastaj ngadalë mbështeti kryet mbi supin tim.

E krova te veshi i djathtë dhe ai më shoqëroi derisa hyra brenda. Halili ishte ulur këmbëkryq mbi krevatin tim, pranë stufës. Gishti i madh i këmbës ia kishte shqyer paksa çorapin te maja. Me të hyrë unë, ia pati me atë zërin e tij gurgullues:

— Ku je, more bir! Kam një orë që të pres, — më shkeli syrin. — Dimër jashtë dhe dimër brenda. — Unë vështrova nga Berti, i cili, sapo dëgjoji xha Halilin, u shkëput prej librit që kishte në dorë.



— Te stalla, — iu përgjigja.

— Vajte, mirë bëre, — tha ai.

— Halil, — qesha lehtë, — si i paske mbytur ti dymbëdhjetë ujç?

— Dreq, o mësues, — tha ai, — prandaj të kam qejf unë ty. Si, ore, nuk le gjë pa marrë vesh!

Vura buzën në gaz dhe i dhashë një cigare.

— Prite, — tha ai dhe më hodhi kutinë e vet.

— Shoqëria shoqëri, qesja të vejë e të vijë. Shkruaje, — thirri ai më fort, — a a... shkruaje! Ti këtë behar me fjalë të urta mbushe një libër plot.

Qeshëm të tre.

— Do ta shkruaj, — ia ktheva, — po më parë më trego për atë që të pyeta.

— Të shkuara të harruara, — tha ai.

— Mirë, edhe këtë do ta shkruaj, — i thashë.

— Ma hodhe, — bërtiti dhe qeshi, — ma hodhe, po ne jse, mend për tjetër herë. Si the ti, o mësues, si the, i mbyta! Nuk i mbyta, jo, po i helmova. Atë vit dimri sikur s'kishte të mbaruar. Harroi njeriu beharin. Ujqit i ranë këmbës nga të ftohtët, e gati u shuan, sidomos nga të pangrënët. U bënë si të tërbuar e veç t'i shihje si bridhnin kope-kope tërë natën e natës nëpër fshat. Dules, kryetarit të këshillit, i ishin ngjitur deri te shkallët, ndërsa Bimit... Bimit, ore, a e njeh?

— E njoh, — thashë unë.

— S'të pyeta ty, po këtë tjetrin.

Berti më vështroi i çuditur.

— Si, ore, s'e njihke Bimin! — tha Halili. — Bimi është me nam për këngë. Ne jse, Bimit i hapën edhe derën e shtëpisë. Fëmijët i morën vesh këto

gjëra dhe s'po na vinin gjumë në sy. Ç'të bënim? T'i vritnim? Po pse, alarme do të bënim, apo do të hapnim një vijë fronti këtu në fshat? E me kë do të ndiznim pushkë? Me ujqit. Bukur, për besë! Do të na kishte marrë historia. Dhamë e morëm derisa më në fund më shkrepri një mendje. Kisha një dele që po ia thante shpirtin gëlbara. Me sot e me nesër, ajo do t'i lante duart. Sa të ngordhte dhe të harrohej, më mirë thashë, kjo e ka nisur që e ka nisur atë rrugë, po le të mbahet mend pas kësaj. Dhe vërtet, vjen rasti dhe kujtohet. Çudi, si është kjo jetë! Edhe kafsha që është kafshë, që të mbahet mend, që të zihet në gojë, duhet të bëjë diçka të fortë, të mirë. Pra i dhashë të hajë bar të përzier me një helm që, vetëm erë po t'i merrje, të bëhej një gungë në bark. E mora dhe e shpura në majën e Blerit. E dini, besoj, prej andej na thotë dielli si u gdhitë. E lashë delen aty, ajo rrinte më këmbë, sepse e kishte ngrirë kërcu helmi. Dukej si e gjallë, e shkreta. Natën erdhën ujqit. Kushedi sa i kishin mprehur dhëmbët. U kishte vajtur mishi te goja. Nuk e dinin të zehtë se aty do t'i binin këmbës. Dhe ashtu ndodhi vërtet. E paguan paq zallamahinë që na kishin bërë, dëmin dhe gjumin e kalamajve. Dymbëdhjetë prej tyre ranë shakull mbi borë. Ja, kjo duhet bërë përsëri, — përfundoi ai, — besoj se ju kënaqa, ë?

U ngrit. Veshi çizmet e lëna përkëtej derës dhe së bashku dolëm jashtë. E përcollëm deri matanë oborrit. Aty, Berti deshi të përkëdhelte Murrin, po qeni iu hakërrua dhe për pak desh ia përfshiu dorën.

— S'të njeh, — tha Halili, — ti rri pak mënjanë, or çun. Po njeriu ka nevojë të njihet e të njohë

gjithçka. Kush pa keq prej të njohurit? Asnjë, — u përgjigj po vetë, duke na përshëndetur.

U kthjem. Vajta dhe mora një krah dru. Qielli ishte i pastër e plot yje. Bora reflektonte. Nata ishte e bardhë dhe ta kishte qejfi të rrije jashtë.

— Hajde, se ngriva, — thirri Berti, — **dera është** e hapur.

Hyra brenda. Mbusha stufën mirë, që të kërciste, siç thoshte Berti. Ai nuk mund të shtrihej në shtrat pa u skuqur stufa rreth e rreth.

— Të mos kishe ardhur ti, — tha Berti, — Halili do të kishte ikur me kohë. Pasi mbaruam ato përshëndetjet e zakonshme, s'po dinim ç'të flitnim më.

— Pas tyre vjen menjëherë çështja e motit, — thashë unë.

— Po, — u përgjigj ai me naivitet, — e biseduam edhe këtë.

— Berti, si mendon ti, mos vallë njerëzit flasin çdo ditë e çdo orë për këtë apo për atë roman? Flasin edhe për këtë, natyrisht që flasin. Por ata kanë edhe hallet dhe punët e tyre, të cilat ti, që shkruan e që do të vazhdosh të shkruash, duhet t'i njohësh, siç thonë vetë këta, me rrënjë e me degë. A e dëgjove si të tha Halili?

— Se duhet të njoh Murrin e tij, — qeshi ai.

— Mos e kthe në shaka, — i thashë.

Ai qeshi përsëri e foli:

— Në qoftë se ti pak më parë fole për njohjen e jetës e shkon deri atje, sa të marrësh në konsideratë edhe atë që tha Halili, se u dashka të njoh e të miqësohem me Murrin, kjo është për të qeshur.

— Më duket se po e teprojmë, — i thashë, — Halili nuk e pati fjalën se ti duhet të njohësh e të miqësohesh me Murron, po më tepër... Megjithatë, edhe për të ta ketë pasur, s'ka ndonjë gjë të keqe.

— Natën e mirë, — tha ai dhe u shtri në shtrat. Pas pak unë fika dritën. Në dhomë ra qetësi. Ndihehin vetëm kërcitjet e stufës.

Të nesërmen na kishin thirrur në një mbledhje në qendër të kooperativës, një orë larg fshatit tonë. Bora kishte filluar përsëri të binte. Nisi që në mesditë, kur mbërritëm ne.

Kur dolëm nga mbledhja, kishte apo s'kishte edhe një orë ditë. Tani dëbora kishte vajtur deri mbi gju. Vazhdonte të binte akoma, madje më e shpeshtë. U nisëm. Ecnim shpejt. Nata po na zinte në rrugë. Shenjat e rrugës kishin humbur, po megjithatë e kishim një orientues, përroin. Pranë tij na zuri një mjegull napë e zezë. Tani, një hop po të largoheshë nga shoku, humbisje, dhe hynte në punë vetëm e bërtitura. Urën, ose ata dy trarë lisi që të hidhnin matanë, nuk po i gjenim dot. Ç'të bënim? Vërtiteshim në, po vërtitej edhe nata. Atëherë i hymë me këmbë përroit. Uji i ftohtë brisk e kaloi mesin. Po në këto raste më mirë është të bësh përpara. Ashtu bëmë. Kur dolëm matanë, ia nisëm me të shpejtë. Në pyll ecja ishte më e vështirë. Nisëm të ndiznim ndonjë fije letër. Ecnim vetëm përpara. Të paktën kështu mendonim ne, se kishte mundësi të mos bënim gjë tjetër, veçse ecejake pa kuptim. E dëgjova frymëmarrjen e rëndë të Bertit. Diku ndalua duke shtrënguar krahun e njëri-tjetrit. Një hungërimë

ngjethëse, e shpejtë dhe e vazhdueshme u dëgjua fare pranë.

— Berti! — thirra. — Shpejt ngjitu në pishë!

— Ç'është, — tha ai dhe bëri veprimin që bëra unë, po dega që u kacavjerr u shqye dhe ai u rrokullis mbi borë. Zbrita, po s'pata kohë as t'i afrohesha atij.

Dy hapa më tutje ecte si e vënë në rresht një kope derrash të egër. Nuk na vunë re. Fatmirësisht kjo kafshë e rëndë shikon vetëm drejt dhe përleshet vetëm me atë që i pret rrugën. Ne s'kishim ndër mend ta bënim këtë, e aq më shumë Berti, që ishte mbuluar prej borës dhe i dukej vetëm koka, si një kërcu i lënë aty qysh në verë.

— Berti!

— Për herë të parë në jetën time! — tha ai duke u ngritur. Unë nuk fola. Ai seç shau me mllëf. U mbështet pas trungut sikur të mos kishte fuqi për më tutje.

— Epo mirë, hajde, — i thashë dhe i vajta pranë. Ai mezi merrte frymë.

— Si thua ti, po sikur të na kishin parë?

— Lëre fantazinë, — i thashë, — ja që s'na panë, po ec të ikim.

— Çudi me ty! — bëri ai.

— Ata nuk na u vërsulën, ngaqë më njohin mua, — bëra shaka unë.

Edhe ai qeshi lehtë dhe tha:

— S'i thonë pak, ti ke pesë vjet mëleve.

— Berti, a e di si më thotë një shoku im mekanik, — e shtyva më tutje muhabetin. — do të të bëj një thikë të madhe! Andej nga je ti mësues, rrezik të përleshesh me ariun. — Qeshëm së bashku dhe

vazhduam rrugën. Terri i natës bëhej më i rëndë, ndërsa trungjet e pishave dukeshin si ushtarë të stërvitur, kokëfortë dhe të palëvizur. Një ulërimë gjëmimtare e zgjoi pyllin prej heshtjes.

— Ujq! — tha Berti dhe përnjëherë më shtrëngoi krahum.

— Jo, — i thashë, megjithëse edhe vetë dyshova. Pas pak i thashë i sigurtë se s'ishin ujq, ishin qentë e fshatit. Me sa dukej ishim afër.

Kjo na gëzoi të dy dhe s'po shihnim më se ku i hidhnim këmbët. Qe një gëzim i parakohshëm, që u tret po aq papritur sa ç'erdhi. Qentë na rrethuan. Disa kërcenin mbi borë e disa kacafyteshin me njëri-tjetrin. Bëmë më poshtë, po përsëri ata s'na lanë të dilnim nga rrethi i tyre. Ç'do të bënim? Edhe pak po të rrinim pa lëvizur, do ta paguanim mirë. Të ftohtët po na bënte gati të rrëzoheshim dhe pas-taj, hajde ngrihu prej borës.

— Berti, më jep shkrepësen.

Nxora një letër dhe e nderza. Qentë gjëmuan së lehuri. Ata tani ishin ulur në bisht dhe po na përgjonnin: Flaka e letrës llapashitej tutje-tëhu. Njëri prej tyre u shkëput. Ishte një murrash i madh, i cili u zhduk mes errësirës.

— Tërhiqu! — i thirra Bertit.

Ndërkaq Murrashi u shfaq fluturimthi dhe erdhi e u hodh përpara këmbëve të mia. Nëpërmjet flakës së mekur, munda të shquaja një pullë të bardhë midis syve.

— Murroja, Murroja! — thirra i gëzuar. — Murroja i Halilit. — E kapa prej qafe dhe e shtrëngova fort-fort. Fryma e tij më ra në fytyrë, por unë e



afrova më pranë dhe e putha mbi pullën e bardhë. Qentë e tjerë heshtën dhe, të bindur, u vunë pas nesh. Murroja ecte para. Tani ishim të sigurt se do të arrinim. Busull më të saktë se Murron zor se mund të gjeje. Ai na çoi drejt e te shtëpia e të zotit. Unë i rashë derës dhe nga brenda dëgjova zërin e Halil Kuçit.

— Kush është?

— Miq, — i thashë.

— Hyni, — tha ai.

— Kush vjen pa ftuar, e gjen pa shtruar, — bëra shaka unë.

— Dreq, o mësues, ja, prandaj të kam qejf unë ty, — u dëgjua zëri dhe e qeshura gurgullimë e tij.

Te dera na përqafoi e, pasi na ndezi një zjarr vatre, na vuri një pjatë me fasule të ngrohta dhe djathë shakulli. Më vonë ramë për të fjetur. Në mes kishim zjarrin bubulak.

Atë natë Berti më tha se do të shkruante një tregim. Dhe e shkroi. Ky që rrëfeva unë tregimi i tij është.

## «K O D R A»<sup>1)</sup>

Dëshmorit komunist  
Adem Krasniqi

Pranvera hodhi shumë shira atë mot. Edhe pse qershori ishte në gjysmën e tij, shtrati i lumit ishte ende i verdhë dhe aty-këtu dalloheshin, në terrin e natës, kërcunj që lundronin si qenie të zeza, pa formë. Njeriu që rrinte buzë lumit kërkonte me sy vahun e dikurshëm. Ishte akoma natë dhe ai s'orientohet dot. Lumi lëpihej pas buzëve të bregut dhe herë-herë kafshonte ndonjë grusht ranishte. Matanë lumit ishte qyteti. Të vetmet shenja jete të tij ishin tek-tuk ndonjë dritë që diku ndizej e diku fikej. Ai shikonte me vëmendje, por asnjë vend nuk i shembëllente me vahun e dikurshëm. Tërë ato shira kishin bërë punën e tyre. Ç'të bënte!?... Nga ura nuk mund të dilte dot. Në dalje të saj fashistët kishin ngritur postbllokun dhe kontrollonin këdo që hynte e dilte nga qyteti.

«Ndoshta s'dyshojnë, — tha, — kështu siç jam veshur unë edhe nëna ime nuk më njeh. Po kjo...?» Revolveri i rëndoi në xhepin e xhakëtës prej shajaku. «Pastaj, duhet t'u shmangem të gjitha vendeve ku mund të grumbullohen njerëz.» Porosia e komi-

---

1) Pseudonimi i dëshmorit.

sarit kishte qenë e qartë. ««Kodra», do të hysh në qytet, kështu, i veshur si fshatar i këtyre anëve, do të veprosh me fshehtësinë më të madhe. Te dyqani të pret Polisi, ai e ka mbikëqyrur spiunin. Ki kujdes, se është spiun i rrezikshëm, ti e njeh fare mirë Xhemal Voglin. Ky ia ka bërë borxh Partisë dhe popullit. Dy nga shokët tanë ranë pre e punës së tij të ndyrë, pra... Me fshehtësinë më të madhe. Nuk do të takosh njeri, as familjen... Ç'ke? E di që ke 'kaq muaj maleve e të ka marrë malli, po dhe këtë radhë nuk do t'i takosh. S'ke ç'bën. I ka lufta këto, vëllai im. Unë jam bërë me djalë... Nuk po qesh, para disa ditësh gruaja më dërgoi një letër e më thotë t'i vete, se djali po ngrihet më këmbë dhe, kur të vish ti, më thotë ajo, nuk do të të njohë dhe do të të zërë me gurë...»

«T'i futem lumit, — tha, — lëvizjet e mëngjesit duhet të më zënë në qytet.»

Hodhi një gur në ujë. Zhurma e qullët që u dëgjua, e bëri të shtyhej më tutje. Provoi edhe një herë, por po e njëjta gjë. Atëherë ia nguli sytë një kërcuri që dukej si gjysmë gjoksi mbi ujë. U zhvesh dhe hyri. Ecte i matur. Këmbët i vriteshin nëpër gurë dhe uji i ngjitej ngadalë. Te kërcuri pushoi pak dhe u nis përsëri. Uji i ftohtë brisk i kaloi mesin. Të dyja duart i kishte të zëna... Dhjetëshja në të djathtë dhe plaçkat në të majtën. Doli në bregun tjetër dhe u vesh me të shpejtë. Dhjetëshen nuk e futi në xhep, por e ngjeshi në brez. «Eh, — bëri, — Xhemal Vogli, spiun i fëlliqur, do të të bëj të hash dhë, ashtu si atë lanxhon tjetër, mikun tënd, Shoshin. Pale, po kam dëgjuar se fryhesh si gjeldeti

nëpër pazare e kafene, duke llomotitur se komunistët të vrasin prapa shpine. Mos ki gajle, se ty tytën në bebe të syrit do të ta mbaj. «Kodra» nxitoi. Mërdhiu shumë. Kishte udhëtuar pothuajse tërë natën dhe, kur hyri në lumë, trupin e kishte ende të ngrohtë. Shumë shpejt e mposhti të ftohtin. Ishte i ri. Trupin e kishte të lidhur kulpër. Ballin të lartë dhe shpatullat të rrumbullakëta, si prej atleti. Edhe jeta në mal e kishte forcuar shumë. Rrobat e leshta e pengonin të ecte. S'kishte mbajtur kurrë shajak. Nuk mund të duronte trashësinë dhe ngushtësinë e tyre, megjithatë bënte përpjekje që ta ndiente veten lirshëm, me qëllim që, kur të hynte në qytet, të mos tërhiqte vëmendjen e të tjerëve. Në përgjithësi kësaj ia dilte, veçse me qeleshën e kishte keq. Ajo mezi i qëndronte në kokë dhe herë-herë i binte. Tani po udhëtonte pranë një are të mbjellë me grurë. Një erë e freskët shpërndante aromën e bimës dhe nga kallinjët binin pikat e vesës së mëngjesit. Agimi erdhi papritur. Dielli përshëndeti gjithësinë, nga maja e malit hija e tij u zgjat mbi arën me grurë. Hyri në një rrugicë me kalldrëm. Nga kreu i saj një kalë i kuq, i çalë, po vinte drejt tij. Ishte Kuqoja i dajë Selimit, që ishte plakur aq shumë, sa i numëroheshin brinjët së largu. «Kodra» vuri buzën në gaz, pasi iu kujtua se, kur ishte ende i vogël, ishte fat i madh për secilin nga fëmijët e lagjes t'i hipte atij kali. Sot ishte kandidateur kockë e lëkurë.

— Largohu, or bir, — dëgjoi një zë pranë një porte.

«Nënë Tina, — belbézoi, — më paska harruar? Jo, s'më ka njohur, plaka e shkretë.»

Me t'u larguar ai, plaka hodhi një legen me ujë mbi kalldrëm. Më të djathtë ngrihej shtëpia e Topçinjeve. Tri anët e mureve të saj ishin shëmbur. Fashistët i kishin vënë zjarrin, pasi djali i madh i asaj shtëpie ishte komandant çete diku në Jug. Tani zotërit e shtëpisë, tre djem të rritur, pastronin gërmadhat. «Kodra» nxitoi. Ndonjëri prej djemve mund ta njihte fare lehtë. Megjithatë, pak më tutje ktheu kokën e vështroi përsëri andej. Sa dëshironte të shkonte t'i takonte e t'u thoshte se vëllanë e madh e kishin shëndoshë e mirë dhe për shtëpinë hiç të mos bëheshin merak se do të vinte koha e do t'i ngrinin më të mëdha dhe më të mira.

Ishte në lagjen e vet. Çdo gur, pemë, pullaz shtëpie, që nga fëmijët deri te më pleqtë, sikur ishin pjesë e vetes, e gjakut dhe e dëshirave të tij. Kush nuk e donte «Kodrën», që e poqi aq shpejt vuajtja? «Kodrën» e pastër e të ndershëm, që s'qe më shumë se gjashtëmbëdhjetë vjeç kur ia ngjeshi thikën në gjoks atij fashistit që i kishte zënë rrugën vajzës së dajë Selimit? Trimëritë e tij tregoheshin në çdo vatër. Ishte pranë gardhit të shtëpisë së vet dhe ndaloi nën qershinë e madhe. Prej saj, herë pas here këputej ndonjë kokërr e pjekur. Qetësi në oborr. Heshtje e thellë në shtëpi. Dihati fort. Një tingëllimë u dëgjua në tel. «Nënë, — belbëzoi. Gjithmonë e kishte ndier mallin e saj, po atë çast kjo ndjenjë iu rrit aq shumë, sa lotët mezi i mbajti. — Nënë!» — U mundua t'i shihte fytyrën e vogël e të bardhë, sytë e vegjël e të ëmbël. Ndërkohë u dëgjua një kollë e thatë. «Tata, — tha, — Tata», — dhe atë çast u dha nga dera i ati, burrë i pashëm dhe i thinjur

borë. Menjëherë pas tij doli një djalë i vogël, i cili kapërceu dy e nga dy shkallët dhe vajti t'i ndihmonte nënës. Ai i vështronte e s'ngopej së pari. Zemra nisi t'i rrihte shpejt dhe buzët iu përthanë sikur të vuante nga një etje e madhe. U shty më pas gardhit. Dhjetëshja në brez i shtypi mishin. U tërhoq prapa dhe vuri dorën mbi hekurin e armës. Buzëqeshi lehtë. «Do të shihemi, — tha, — patjetër do të shihemi.» U hodh në rrugë. Kokrrat e qershisë iu shtypën në dorë dhe lëngu i kuq pikoi mbi kalldrëm. «I ka lufta këto, apo jo, shoku komisar», buzëqeshi dhe e ndjeu veten më të fortë. Eci me hapa të shpejtë. Qeleshja i ra mbi sy. E hoqi fare, shtroi flokët mirë e mirë dhe e vuri përsëri. Sa më thellë hynte në qytet, aq më të shumta bëheshin lëvizjet. Mori rrugën për në tregun e fshatarëve. Andej e ndiente veten më të sigurt, më të qetë. Andej kishte plot fshatarë dhe qeleshet e bardha mbi kokat e tyre dukeshin sikur notonin mbi atë lumë njerëzish. Kaloj dhe tregun dhe hyri në një rrugicë të ngushtë që të shpinte te dyqani i Polisit. Në të dy krahët e rrugës dyqane të vogla, si kuti shkrepësesh të vëna në radhë, njëra pas tjetrës, shtriheshin nga kreu deri në fund. Çatitë uleshin dhe gatit puthnin kalldrëmin. Njerëzit hynin e dilnin, sikur të hynin e të dilnin nëpër vrima. Po të mos i njihje ato ambiente, ishte e pamundur ta besoje se nëpër ato kamare lëviznin njerëz, por ja që njerëzit në to jo vetëm që lëviznin, por edhe goditnin me vare hekurin, piqnin baltën për shtëmba dhe mbushnin samarët me kashtë. Shumica e atyre që punonin në të dy krahët e asaj rruge e kishin shok «Kodrën». Ai




ishte rritur me ta dhe mund të të fliste për secilin, njësoj si për vete. Mjaftonte sikur edhe një sekondë të shkëmbente shikimin me njërin prej tyre dhe do të kalonte gojë pas goje, me shpejtësi lajmi: *Ademi, shikoni paska zbritur*. Adem Krasniqi me siguri që do të zhdukë nga faqja e dheut dhe ndonjë hale tjetër.

Shumica e dinin fare mirë se cila dorë e palosi përtokë Kolë Shoshin. Emri i «Kodrës» atë ditë shkoi gojë më gojë jo vetëm siç mund të thuash emrin e shokut, por si të dikujt që të hap sytë, të nxeh gjakun dhe të bën trim. Atë ditë u mbyllën kamaret e vogla. Nuk u ndie era thartirë e qymyrit, baltës, kashtës dhe lëkurës. Ata kishin dalë nëpër rrugët e qytetit dhe kishin kënduar deri natën vonë, këngët e luftës dhe të lirisë.

Ai do të donte t'i takonte të gjithë, sepse edhe për ata e kishte marrë malli, siç e kishte marrë malli për nënë Tinën, djemtë e Topçinjeve dhe prindërit e vet, por pesha e detyrës ishte më e rëndë, sepse vetë ajo kishte lindur nga ky mall dhe do të kryhej në emër të kësaj dashurie të madhe. Vetëm një njeri kishte të drejtë të takonte, dhe ky ishte Polisi, i cili, me sa u kuptua, e kishte vënë re dhe diçka tha me zë të lartë, duke hapur kashtën përpara dyqanit për t'ia tharë dielli. Polisi ishte samarpunues. Në të vërtetë ai mund të ishte samarpunues, ndoshta, aq sa mund të ishte Kodra mjek. Polisi dikur kishte qenë mësues, por ishte pushuar si element i dyshimtë. Nuk e mësoi e s'e mësoi dot zanatin e ri.

«Fshatarët janë merakcinj të mëdhenj, — thoshte



i qeshur, — dhe dinë ta zgjedhin ustanë. Këta samarë që bëj unë, s'janë për kurrizin e kuajve dhe të gomarëve, po për atë të bejlerëve». As bukën e gojës nuk mund të nxirrte. Por ç'të bënte? Nevojat e luftës e kishin mbërthyer aty, pasi prej dyqanit të tij dukej qartë faqja tjetër e qytetit, qendra.

Dy shokët u puthën dhe u përqaftuan në kthinën prapa dyqanit. «Kodra» hapi me kujdes kanatin. Qendra e qytetit dukej si në pëllëmbë të dorës. Burrat të veshur mirë, këmishëbardhë dhe këmishëzinj me këpucë dhe çizme lustrafine hynin në kafenetavernë.

— Ja dhe turpi, — tha. Një damar i vetëtiu në ballin e lartë. Turp quante ai kafenenë-tavernë. Aty mbledhej paria e qytetit, fashistë, oficerë të lartë që harbonin tërë natën, deri në të gdhirë. E keqja s'ishte vetëm kjo. Për një të puthur apo për një shishe shampanjë aty, digjej një shtëpi në rrugicë. Shpesh kishte ndodhur që ata kriminelë, të velur nga kënaqësitë, u vërsuleshin qejfçakërditur dhe me armë në dorë rrugicave, në emër të ruajtjes së rendit dhe qetësisë.

Që prej disa vjetësh kishin ardhur aty disa femra nga jashtë shtetit. I gjithë qyteti dridhej dhe djer-sitej si ta kishte mbërthyer malarja. «Kodra», së bashku me të rinjtë e tjerë, i kishte vënë zjarrin asaj kafeneje. Shenja e zjarrit dukej ende mbi murin e bardhë, edhe pse i zoti i saj. Qorri, ishte munduar ta fshihte, ta mbulonte, duke vënë mbi të portrete artistësh dhe reklama të huaja. Ndërkohë zbritën prej një pajtoni dy femra, njera prej të cilave ishte mjaft e shëndoshë.

— Zoti Xhemal ka hyrë brenda që në mëngjes,  
— tha Polisi.

— Paska zënë radhën, — tha Kodra.

Polisi qeshi e tha:

— S'është nevoja të zërë radhën, e quan veten prefekt. Pas vrasjes së atij qelbanikut, Shoshit, i është zgjatur llapa shumë. Ka nisur të na shajë me ç'i vjen...

— ... I ka ardhur radha të lajë krimet! — tha Kodra.

— Xhemal Vogli, sipas një informate, ka marrë përsipër që në fund të muajit të dorëzojë në kuesturë një listë me emra të shokëve tanë, — tha Polisi.

«Kodra» nuk foli. Mollëzat i digjnin zjarr. Nxori dhjetëshen nga brezi dhe pastaj e fërkoj pas faqes. Polisi qeshi. Ai e vështroi «Kodrën» me mall. Çuditëj me atë djalë, që të krijonte përshtypjen e një nxënësi të urtë, por që nga ana tjetër të befasonte me shkathtësinë e tij. Edhe vetë kishte marrë pjesë në disa atentate, madje me sukses, po për të, si edhe për të gjithë shokët e tjerë, «Kodra» ishte më ustai.

— Për hair! — tha «Kodra» buzagaz dhe futi përsëri revolverin në brez. — Te këndi, — i tha ai Polisit. — Me të dalë, unë do të vij drejt teje. Në qoftë se kanë rënë në gjurmët e mia, mos prit, por hap zjarr. Në mes të zjarrit më lehtë shpëtojmë ne, sesa ata minjtë e gjirizit.

Dolën jashtë. Qetësi. Në shesh s'kishte lëvizje. I pari u vu në udhë Polisi. Ai ecte lehtë dhe shpejt. Ndërkohë, nga kafene-taverna u dëgjua një violinë dhe pastaj një zë i hollë.

*Rri, moj, pi raki,  
Ulu, moj, në karrige,  
jam bir beu, moj goce,  
të vras, po më ike.*

*Pastaj përsëri violina. Kodra ecte pak i hutuar. Tamam si një fshatar të cilit s'i kishte zënë kurrë opinga asfalt. Qëndroi pranë dritares së madhe. Kënga dhe violina u dëgjuan më fort. Këtë radhë u acarua nga nervat, megjithatë, inatin e kaloi duke shtrënguar revolverin. Në shesh s'kishte lëvizje. Dy ushtarë dolën nga kuestura dhe kaluan kthesën. «Kodra» i dha një lëvizje me kokë Polisit dhe hyri brenda. Nuk e lanë të bënte më tutje. Përpara i doli Qorri, i zoti i kafenesë.*

— Ku vete, a e sheh ç'kafe është kjo?... Aaaa...  
derra, po derra mbetet ju, fshatarët.

«Kodra» e përmbajti veten. Syri i djathtë i Qorrit, i mbrojtur prej një mushamaje të zezë lëkure, i kujtoi atin. Atëherë ai, tata, sapo kishte ardhur nga Kosova. Mezi gjeti një strehë për të futur këmbën dhe një pranverë të tërë i ra bretku mbi bel, duke kthyer arat e Qorrit. Kur mbaroi punën, kërkoi hakun, po Qorri, për t'iu shmangur pagesës, e paditi kosovarin e pambrojtur, në gjyq, si vjedhës. Tata, që më mirë ta vritte sesa t'i thoshe vjedhës, u hakmor siç i erdhi. Ia përveshi me bishtin e belit Qorrit dhe ia rrëmbeu dritën e syrit të djathtë.

— Kërkoj zotin Xhemal, — tha i qetë «Kodra».

— Ah, zotin Xhemal, po ç'e do, apo t'i ngjitësh morrat?

«Kodrës» ia pati qejfi t'ia ngjeshte turinjve, t'ia rrëmbente edhe dritën e syrit tjetër, por...

— Unë e kam mik zotin Xhemal, — tha «Kodra» duke i hedhur një shikim të tillë, sa ai u frikësua dhe bëri mënjanë.

«Kodra» hyri brenda. Dera e lënë hapur prej tij la dritën pas. Një metër poshtë tavanit të kafenesë varej tymi. Nën këtë perde të hirtë lëviznin dhjetëra koka: tullacë, me flokë të verdhë e të zinj. Më tutje një femër, përballë atij që i binte violinës, spërdri-dhej sikur ata burrat që kishte përreth ta pickonin në vende të ndryshme njëherësh. «Kodra» vështroi sallën. Te një kënd i mbështjellë me damask vish-një shqoi Xhemal Voglin, me kokën nga ajo femra e shëndoshë.

«Kodra» kaloi një sërë tavolinash. Dikush e vështroi i habitur. Dikush e vështroi i frikësuar. Ç'kërkonte ky fshatar në këtë vend? A të ishte me të vërtetë thjesht fshatar? Po kjo mëdyshje nuk zgjati shumë. Ai që hyri brenda s'kishte nge të merrej me ta.

— Xhemal Vogli, — i thirri ai spiunit. Gjith-kush u mek dhe salla sikur ngriu. — Xhemal Vogli, ktheje kokën, na, këtë ke kërkuar ti prej komunistëve.

Tri të shtëna njëra pas tjetrës kumbuan si gjyle në kafene. Spiuni ra shakull, duke tërhequr pas vetes edhe atë femrën që ledhatonte pak më parë...

«Kodra» doli jashtë. Gryka e revolverit nxirrte akoma tym. Te këndi takoi Polisin dhe të dy morën drejt rrugicave. Zhurmë hapash dhe motocikletash u dëgjuan në shesh dhe u përhapën në të katër anët, me ndjenjën e vdekjes mbi vesh. Kërkuan ngado, por gjurmët nuk u gjetën. Po errej dhe shpresat

për të gjetur atentatorin po humbisnin. Një djalë i ri, i veshur shik, me syze, kostum të ri dhe këpuçë lustrafine, u duk në tregun e fshatarëve. Dukej bir beu apo tregtari, po më shumë të krijonte përshtypjen e një të huaji, që kishte ardhur në Shqipëri për studime etnografike. Ndryshe, ç'donte në tregun e fshatarëve?

Po ta vije re mirë, xhepi i djathtë i xhaketës i varej më poshtë. Revolveri i tij i shtrenjtë nuk ishte mësuar të fërkohej me stof të ardhur nga Anglia.

Dy pleq, që nga veshja dukeshin se ishin malësorë, bisedonin me njëri-tjetrin.

— A, ama, ë!...

— E vranë edhe atë, atë...

— Atë qenin, — ia priti «Kodra» tërë inat.

Fshatari i parë e vështroi pjerrtazi. Ç'ishte ky spurdhjak hanëmi që po fuste hundët në bisedën e tyre? «Kodra» vuri buzën në gaz, po dy fshatarët e morën për provokim dhe u larguan.

«Kodra» tundi kokën. Te qoshja takoi me Polisin. Ai i la në dorë një çantë të zezë me materiale të ndryshme partie, që do t'u shpërndareshin partizanëve në male.

I shtrënguan dorën fort njëri-tjetrit dhe u ndanë. «Kodra» priste të errej mirë dhe të dilte nga qyteti. Humbi për një kohë në fund të pazarit dhe, kur filluan të ndizeshin fenerët e rrallë, s'kishte ç'të priste më gjatë. Te kreu i rrugës së zejtarëve ngadalësoi hapin papritur dhe u mbështet pas shtyllës. U dëgjua një kollë e thatë. Drejt tij po vinte Tata,



pas Tatës, nëna me shaminë e bardhë në kokë, e pas nënës, vëllai i vogël.

Ai mbajti frymën. Zemra nisi t'i rrihte fort, fort. Ata kaluan pranë tij. I pa dhe e panë po shikimet qenë erë, përveç vëllait të vogël, që ndenji një hop duke e parë.

«S'më njohën, — tha, — ku veni, ë? — Nxori me gjysmë zëri këtë fjalë dhe u pendua menjëherë.

Ata nganë rrugën njëri pas tjetrit dhe herë pas here vëllai i vogël kthente kokën prapa.

«Ndoshta shkojnë diku për miqësi», mendoi ai pa ua ndarë sytë, derisa ata humbën në mes njerëzve të tjerë. Nata pllakosi ngado dhe ai iku. Në të gdhirë të po asaj nate u gjend pranë shokëve të tij, sipër në mal. Dy ditë më pas e thirri komisari.

— «Kodra», ç'po bën, apo zanatin?

Të gjithë shokët e dinin zellin e tij për të marrë shenjë. Ai e përdorte revolverin me të dyja duart dhe në të gjitha pozicionet. Njëri nga partizanët thoshte se «Kodra» priste perin me plumb.

—«Kodra», të ka ardhur një letër nga nëna, — i tha komisari.

— Nga nëna, — tha «Kodra», — nga nëna!?

Një tufë bilbila fluturuan mbi kokat e partizanëve dhe morën drejt qiellit.

Kodra lexonte ngadalë. Donte që ajo letër të mos mbaronte kurrë:

«Bir, — i shkruante nëna, — malli më ka marrë fort e po t'i nis dy gisht letër. Ti mund t'i fshihesh kujtdo, veçse syrit të nënës, jo. Hajt, për hair, për Shqipërinë qoftë!»

## TINGUJT E METALIT

Thonë se ofiçina jonë është nga më të mëdhatë në Shqipëri. Kjo mund të jetë e vërtetë, të paktën nga ç'kam parë unë. Tornot dhe makineritë metal-prerëse janë vendosur në krah të njëra-tjetrës, në tri radhë të gjata e të drejta, dhe të gjitha janë fjalët e fundit e teknikës. Nga jashtë sikur s'ta mbush syrin, s'është më shumë se njëqind hapa e gjatë dhe nja pesëdhjetë e gjerë. Kohët e fundit, ndoshta për këtë e ka fajin mosha, rri e mendoj vitet e kaluara, jo se i kam të mbushura me heroizëm e me çudira të tjera, po ja, ashtu si shumica. U mbush një jetë e tërë që merrem me hekura.

Më kujtohet se e kam nisur punën në këtë zana me disa torno të pasluftës. Prisnim llastik me to për një fabrikë marmelate. Më zë të qeshurit, edhe pse ato të shkreta, për kohën e tyre, na bënë goxha punë.

Ta gëzosh dhe mbaje me kujdes, më tha ustai im atë kohë.

Ç't'i mbaje me kujdes asaj!

Unë deri këtu arrita, më tha ai, ti shpjere më tutje. Kur mora këtë tornon e fundit, të them të drejtën, mendova se s'kishte ku të ventë më përsosja e kësaj makinerie.

Shkak për këtë bisedë me veten u bë tornoja e re, që sapo ka ardhur. Një alamet makinerie, që mund ta marrësh kur të duash si një uzinë më vete. Punon në të gjitha pozicionet dhe me saktësi.

Dje u shfaqën mendime të ndryshme se kush do të punonte me të. Pati një mendim që ta merrja unë, po nuk pranova dhe as do të pranoj. Jo se nuk e përballoj dot, po duhet të veproj edhe unë si veproi ustai im. Makinaria e re do gjak të ri, mendje të re dhe të fortë. Unë e dhashë mendimin tim për Yllin, atë tornitorin me kategori të lartë, që e ul kasketën mbi sy kur punon, që përqendrohet mbi detalin si një nxënës i zellshëm mbi libra.

Secili nga shokët dha mendimin e tij, por askush për vete. Vetëm njëri nuk foli fare. Ky ishte Miti. S'di se pse ky njeri më shëmbëllen me një kuzhinier. Ndoshta nga duart topolake si të një plake të shëndoshë, apo nga barku i kërcyer. Barku i madh s'i ka lezet njeriut, po sidomos atij që merret me hekura.

Së bashku me nja dy djem i bëmë nivelimin tornos së re dhe kjo ka rëndësi të madhe, si të thash, është si niveli i themelit të shtëpisë. Edhe në lëvizje, për herë të parë, po vetë e vura. Kurrë s'kish dëgjuar melodi të tillë, nuk ju besohet, unë u mahnita!

Me tingujt e metalit unë u rrita, u bëra kaq, më të ëmbël se ata nuk ka të tjerë. Zë e qesh me ndonjë që, me të hyrë në oficinë, vulos veshët...

Kur erdhi përgjegjësi i ri, më buzëqeshi miqësisht. Është i ri. Kohët e fundit e kemi zgjedhur. E shkarkuam atë të parin, nuk po na ecte puna fare.

Ndërsa me këtë të riun po bëjmë punë të mirë. Ësh-të djalë i zoti. E shoh se si i mban veshët ngritur, se si i shkëlqejnë sytë, kur dëgjon melodinë që lëshon tornoja. Ia pëlqen avazin, e pra, kjo është shenja e parë e miqësisë. Shkurt, i kemi gjetur punës nje-riun dhe jo njeriut punën.

— U vendos se kush do ta marrë? — e pyeta.

— Unë jam për ty, — më tha ai.

— E dhashë mendimin tim...

— Për Yllin...

— Po, — bëra, — pse, si...

— Të shohim, — tha ai dhe iku.

Punën e kisha vënë para dhe nisa të vështroja me vëmendje, përkarshi, çdo cep të tornos së re. Ajo vetëtinte dhe rrezet e diellit, që thyheshin mbi të, përhapeshin me bukurinë e ngjyrave të ylberit në tërë oficinën.

— Aaa... — dëgjova një të qeshur me gurgullimë nga prapa, — .., Pirro, të mbetën sytë mbi të, sikur të ishte kofshë qengji, aaa, — gurgulloi përsëri e qeshura.

Nuk ishte nevoja të ktheja kokën dhe të shihja. E dija që Miti ishte. Ai kujton se dhe vetë dielli lind prej stomakut. Njëherë vuri një bast për njëzet kokrra hurma dhe i hëngri ato pa pirë asnjë gllënjë ujë.

Nuk durova dot dhe i fola pak sert:

— Të gjithë i kërkojnë ndihmë kokës, ndërsa ti i kërkon barkut...

Deshi dhe qeshi, se mua as që më shkante ndër mend se kisha bërë shaka.

— Më çudite dje. Si propozove që tornon e re ta marrë Ylli?! Ç'ne ai këtë makineri të paparë?!

— E pse?...

— Si, ore, pse, Ylli është i ri fringo... Atij jepi një kitarë në dorë dhe... Të ishte i sërës sonë, po hajde...

— Miti, kjo e uruar mençuri nuk varet edhe shumë nga thinjat.

Buzët ma mbajtën, se desh iu derdha mirë e t'i thosha se Ylli nuk është si ti, që ke mbi dy muaj që lë çerekun e rrogës në llogari për hesap të atyre fllanxhave që nxore skarco. Përgjegjësi i ri ta luajti fenë, duke t'i bërë ngarkim, se ishe mësuar me të parin ti, që me një kafe e hidhje lumin. Ke filluar ta shohësh punën nëpërmjet xhepit dhe, kur vepron kështu, jo punën që do ta nxjerrësh skarco, po vjen një ditë nxjerr edhe mendjen.

— E ç'tha përgjegjësi? — pyeti ai.

— Të shohim, tha...

— Apo do ta marrësh ti, — më ndërpreu, — se dhe ti s'e ke keq me të, jo, grurë e ke. — Më zgjati një cigare dhe qeshi. — Atë ditë që e zgjodhëm, t'u këput dora së ngrituri përpjetë.

«Doli lepur!» — thashë me vete duke u vrenjtur.

— Tornoja nuk është kazan kuzhine, Miti.

— E ka kazanin te kutia e shpejtësisë ajo, — ma ktheu.

Nuk e mbajta dot të qeshurën dhe shkaçu s'ishte ajo që tha ai, po përfytyrimi im për Mitin, sikur kishte veshur xhaketën e bardhë të kuzhinierit dhe

vinte rreth tornos si rreth ndonjë kazani me pilaf. Dreq o punë, ç'nuk pjell mendja!

— Pirro, — ia pati ai dhe, pasi u mendua një çast, sikur kërkonte të thoshte diçka të padëgjuar, foli: — Je bërë usta edhe në fjalë. Si, bre, propozove për atë djalin dhe tak del vetë në skenë! Teatër, për kokën time, teatër...

E teproi. Po më vishte një lëkurë që s'ma duronte trupi.

— Miti, burri duhet ta matë fjalën. Ke dëgjuar kur thonë, tre vjet me gjilpërë e një vit me gërshërë? E pra edhe fjalën duhet ta kursesh dhe jo ta lëshosh si lopa...

— Pse, nuk do ta marrësh ti?! — tha ai me një fije gëzimi që iu shfaq në sy e në buzë, pasi mendonte se për të, e vetmja pengesë, për të marrë tornon e re, isha unë. Ndërsa për përgjegjësin e ri ai kishte po atë mendim që kishte për Yllin dhe për djemtë e tjerë ose, po t'ia lypte nevoja, do të përdorte po atë mjeshtëri që pati përdorur me atë të parin.

— Nuk do ta marr, — thashë, — vëri kapak kësaj, po dije, Miti, se as ti s'ke për ta marrë. Ti the qëparë se ajo na e paska kazanin te kutia e shpejtësisë! Ç'kazan, more, ç'kazan? Ajo ka brenda vetëm nder dhe djersë. More vesh, mora thuaj!

— Bëra shaka, o i uruar, — u shtir ai, — pse, a nuk e di unë këtë? Ajo është makineri e vështirë dhe ti ke hak që s'pranon ta marrësh.

— S'e bëj për këtë, — ia ktheva, — nuk trembem, por, si unë, si ti, të shfrytëzojmë mirë këto që kemi.



— E ke mirë, — më tha, — rinia, ai Ylli vërtet që është një tornitor i rrallë...

Gjykimi i tij më çuditi për një çast, por u binda shpejt se s'kishte folur me dorë në zemër. I lexova sytë dhe i pashë ecjen. A e dini ju që edhe të ecurit flet? Ai me siguri, pasi u bind që unë nuk do t'i bëhesha pengesë, e quante veten usta të tornos së re. Më erdhi keq për të.

Ecën koha, ecën njeriu, ecën dhe hekuri. Ty të pëlqen vetëm ecja e këtij të fundit, prandaj përpiqesh t'i dalësh para e t'i varësh në qafë torbën tënde, po zor se do t'ia arrish.

Më pushtoi një inat për atë njeri. Miti një është. Ja, në krahun tim kam Yllin. Ke qejf ta shohësh kur punon. Në fytyrën e tij të shëndetshme dhe të bukur, sikur të jetë faqe libri, lexon me lehtësinë më të madhe gëzimin që i fal puna. Më tutje janë dy axhustatorë të tjerë e, me radhë. Te këndi duket tornoja e re. Ajo shkëlqen e tëra. Nis e qesh me vete, pasi më kujtohet tornoja e dikurshme. E shkreta, s'dihet ku do të ketë përfunduar!

Në fund të tetorëshit erdhi përgjegjësi. M'u duk shumë i shqetësuar. Vetë e shkarkoi motokarron, të ngarkuar me nja pesë copë akse.

— Na duhen urgjent, — tha, — na i kërkojnë ata të naftës. Si do t'ia bëjmë?

— Të vazhdojmë punën, — thashë unë.

— Jo, xha Pirro, ka punë vetëm për disa të rinj.

Doli vullnetar Ylli dhe menjëherë pas tij edhe dy djem të tjerë. Do të punonin tërë pasdreken, ndoshta edhe gjatë natës. Prapa meje vura re Mitin. Po

ky, thashë, dhe nuk ia ndava sytë. Edhe ai do të punonte! Nuk ishte dalluar ndonjëherë për punë të tilla.

U takuan përsëri makineritë dhe rinisi muzika e hekurit. Veçse tingujt s'po vinin si gjithnjë. Aty, te tornoja e Mitit, diçka kuiste. Mos vallë po më bënin veshët? Dreq, o punë, Miti, si ta marr këtë vullnetarizmin tënd?

Së bashku me të tjerët u nisa për në shtëpi. T'ju them të drejtën, disa herë pasdreke më hëngri merakun për atë që bëri Miti, po dikur e preva shkurt. Përgjegjësi i ri ishte djalë i zgjuar dhe i kujdesshëm në punë.

Të nesërmen, herët në mëngjes, u nisa për në punë. Me të marrë krahun që të nxirrte në oficinë, takova Yllin. Ai më tha se kishin punuar deri në agim dhe të pesë akset i kishin nisur para një ore. Në të djathtë pashë të dilte nga klub-restoranti përgjegjësi me Mitin. Miti ishte tepër në qejf. Ndoshta ngaqë do të ishte dëndur së ngrëni, mendova, po merakun më hante për tjetër gjë. Mos përgjegjësi!... Dhe m'u kujtua ai i pari. Ndërkohë Miti turfulloi duke qeshur dhe erdhi pranë meje.

— E kam një fjalë Miti, e kam, për kokën time.

— Çfarë fjale? — më dogji mua.

— Eee, Pirro, — bëri ai. — Ti usta je, po ka usta mbi usta, hi, hiii. E sheh tornon e re, e shtiva në dorë më duket. Kot e kam marrë për ters këtë përgjegjësin e ri. Djalë për kokë të djalit është. Do të të gëzoj, më tha, do të gëzoj faqe të gjithëve... hihii ç'vete...

Fjalët e Mitit më hutuan pak, dhe një inat i

madh më kapi me përgjegjësin, vërtet t'ia jepte tonon e re Mitit?!

Hyra me shpejtësi në repart. Një grup shokësh më dolën para. Ata flitnin e qeshnin, por unë s'po kuptoja gjë. Bashkë u afruam pranë tornos së re.

Të gjithë kishin dëshirë të dëgjonin tingujt e asaj makinerie, t'i shihnin lëvizjet dhe të shijonin punën e bukur që nxirrte dhe përveç këtyre, punëtorët i hante meraku se cili do të kishte fatin të punonte me të, për kë kishte vendosur këshilli teknik nga propozimet që ishin bërë një ditë më parë. Përgjegjësi ishte i gëzuar. Aty pranë tij më kapi syri Mitin, që i vinte pas duke u përpjekur të buzëqeshte.

— Shokë, — tha përgjegjësi i ri.

Të gjithë heshtëm edhe një makineri që punonte më tutje ndaloi.

— Shokë, — përsëriti ai, — së pari duhet të falënderojmë ata që punuan tërë natën për përgatitjen e akseve dhe, ngaqë i premtova Mitit, po e falënderoj në veçanti...

Dikush qeshi. Një tjetër hodhi një fjalë që tërthorazi prekte Mitin. Ndërsa vetë përgjegjësi i futi krahun miqësisht Yllit dhe e afroi më pranë tornos së re.

— Ta gëzosh? — i tha.

— Së bashku, — tha tjetri buzgazaz.

Atëherë sikur m'u hapën sytë, po oficinën nuk po e përfshija dot. Ajo me të vërtetë është e madhe dhe nderi që i bëjnë i takon.

## KAPEDANI PA EMËR

Plaku e kishte shtëpinë në të dalë të qytetit. Qytet i vjetër, që mund të ketë qenë ndoshta qysh në Ilirinë e lashtë. Një dorë shtëpi kishte, një samarpunues, një bakërxhi, një postë me dy xhandarë, kurdoherë të bërë tapë dhe një tellall përtac që, siç thoshin, i jepte lajmet si kofini pas të vjelit. Ja këtu po e ngryste plaku i vjetër, me damarët jeshilë si fije bari të thata. Nën sqetull mbante kurdoherë një bllok në formë libri, ku kishte shënuar pjesë nga jeta e kapëdanëve shqiptarë. Ky ishte i vetmi ushqim i shpirtit për të, ndërsa, për të mbajtur gjallë frymën dhe atë pak shëndet, ushtronte profesionin e baltëpunuesit. Bënte shtamba dhe vazo. Dikush i pati thënë njëherë se atë zanat do ta kishte mësuar kur kishte qenë nizam, diku andej nga dhe-rat e Indisë apo të Arabistanit. Plaku diçka kishte mërmëritur, ose kishte sharë, ose kishte mallkuar, e në fund i kishte thënë: Balta është e vjetër sa shqiptari, ose shqiptari është i vjetër sa balta.

Pa dhe dëgjoi shumë në jetë të vet plaku, po, që do të rronte më shumë se jeta, kurrë nuk e shkoi ndër mend.



Pushtuesit erdhën gjatë natës. Ata ranë papritur, siç bie skifteri mbi zogjtë. Erdhën në qytetin e plakut duke bërtitur e gjëmuar. Në fillim ai s'po merrte vesh gjë.

— Nga vijnë, — tha, — nga vijnë këto gjëmime? Nga qielli apo nga dheu?!...

Për një çast kujtoi se asgjë s'ishte e vërtetë, tërë ai tallaz sikur shkaktohej në vetë trupin e tij tashmë të brejtur. Ndoshta kështu vjen fundi i jetës. Kujton se po ndodh katrahura për këdo, po në të vërtetë të ka rënë vetëm ty mbi kokë. Ç'të bëj, ja, edhe kështu në qoftë, unë s'kam ç'të bëj.

U shtri. Po përsëri krisma. Ato tani sikur të kërcejnin mu pranë veshit. Përtej ledheve flaka hidhej në qiell.

Ai u ngrit. Të shtëna pushkësh, sikur buruan nën këmbë, por ia dha topi vu... vu... e sakaq flaka kërceu prej ledheve e u hodh e ra mbi trupin e qytetit. Pushkët nuk u dëgjuan më, rrallë, shumë rrallë ndonjë e shtënë sikur bridhte maleve. E vjella e zjarrtë e topit u shkarkua te kasollja. Në të aguar çdo gjë u bë e qartë. Në oborr njerëz të huaj, të panjohur, me uniforma të zeza, të cilët, pikërisht ndër gropat nga nxirrte baltën plaku, po futnin shtretët e topave, municionet, thua se nuk ishin kënaqur me zjarrin që kishin vënë mbi dhe, po kërkonin të digjin edhe nëntokën.

Një grup prej tyre iu afrua shtëpisë së vogël. Ata, edhe kur ecnin, ecnin spërdredhazi, si flaka, dhe bënin zhurmë si pëlcitjet e topave. Hynë brenda. Njëri

e mbërtheu plakun për jake, e ngriti peshë, sikur donte ta kafshonte në zverk. Një tjetër rrëmbeu librin e kapedanëve, qeshi sa i kulloi pështyma mbi të dhe e shqelmoi tutje. Plaku, i mbledhur kruspull, u stërgjati dhe, si të ishte top llastiku, vajti e u hodh mbi librin e tij të shtrenjtë. Ata u larguan po me atë zallamahi. Plaku pa diellin nëpërmjet derës së hapur dhe atëherë mori me mend se ç'kishte ndodhur.

U ngrit dhe mundi të shikonte aty poshtë. Shtrëngoi librin e kapedanëve nën sqetull e mërmëriti me mlllef:

«Po futni topat, po vini zjarrin në dhe. Kanë bërë edhe të tjerë kështu si ju. Po ku janë, ku?» Shtrëngoi librin e kapedanëve dhe qëlloi dheun me këmbë. Bëri poshtë kodrës. Njëri prej armiqve i doli para, i preu rrugën. Plaku e kuptoi se ç'donte ai. Më pyet! Duhet të të pyes unë ty, o i zi. Ti ç'do këtu? Vini siç kanë ardhur edhe qindra, mijëra të tjerë, po ku, ë! Vini më këmbë, me kuaj, mbi rrota, po sikur edhe mbi krahë dallëndysheje të vini, njësoj jeni të tërë.

Tjetri e ndërpreu dhe i bëri një shenjë se, një hap po të bënte, do ta paloste përtokë.

Plaku, si për inat, bëri jo një, po dy-tre hapa, derisa një plumb i vërshëlleu sipër majës së veshit.

U kthye. Vetullat e zbardhura ranë mbi bebëzat e zeza të syve. Ndenji një hop e përsëri nisi të ecte.

— Hapni udhën, — tha plaku. — Hapni udhën, — përsëriti ai, — këtu jam unë zot! Le të vijë edhe i madhi juaj!

Njëri nga armiqtë, ai që kishte shqelmuar librin e kapedanëve, ia priti:

— Fol mirë, fol mirë, ne jemi ushtri e rregullt dhe kemi gradat tona. Ç'na pandeh ti, tufa barinjsh të vendit tënd?!

— Unë nuk i njoh gradat, — tha plaku, — vendi im ka pasur vetëm një gradë: kapedanë.

— Injorantë, barinj! — u hakërrye tjetri.

— Barinj, — tha plaku, — barinj! — dhe nxori përpara vetes dhe drejt atyre librin e kapedanëve. — Ja, këta barinj kanë mbrojtur nderin e vendit.

Armiku u hodh përpjetë i frikësuar, sikur të kishte rënë në një gropë gjarpërinjsh. Lëshoi një klithmë dhe i ra fort plakut në faqe. Plaku gati ra, po lisi, sado i vjetër të jetë, nuk e rrëzon dot era. Qëndroi, me sy të përflakur, duke duruar dhimbjen dhe turpin. Një vizë e kuqe gjaku i rrodhi nga buzët dhe u thith prej qimeve të bardha të mjekrës. Nuk e kuptoi se si u gjend përsëri në rrugë.

«Më goditi, — tha, — më ra, më... më... më mirë plumbi, sesa shuplaka e...»

Ecte, ose më mirë shtyhej. Diku u mbështet. Ai plak, kockë e lëkurë, nisi të dridhej si zogth. Të kishte ndodhur kjo e keqe disa vite më parë, në të ri të tij, do të ishte ndryshe puna. Kur kishte qenë nizam andej nga Arabia e zezë, diçka...

«Jo, nuk më goditi, vetëm një fjalë qe, një fjalë...»

Një bimbash turk po ia hante shpirtin natë e ditë e, në çdo pushim që bënin, bimbashi, aty faqe të gjithëve, mburrej se, kur kishte qenë në Shqipëri, i pati rënë të flinte çdo natë me një shqiptarkë.

— Ti gënjen, — s'kishte duruar më plaku, që atëherë të merrte gjak në vetull.

— Ti gënjen, — kishte thënë përsëri dhe atë çast kishte menduar pllakën e nxehtë, që do t'i vihej mbi gjoks menjëherë pas këtij rebelimi.

— Unë gënjej? — mezi kishte duruar turku. — Ho, edhe ti padyshim që je një nga ata djemtë e mi të lindur në ferrë.

Atëherë plaku, i ri në atë kohë, i ishte hedhur dhe i kishte ngulur thikën mu në fyt. Pastaj i kishte rënë me këmbë Azisë së Vogël, Ballkanit e kishte mbërritur në atë qytetth me një dorë shtëpi.

— Isha i ri, — tha plaku, — po tani! Tani jam sa një grusht, po turpi peshoka më shumë!

U shty përsëri. Po ku po shkonte? A kishte nder të rrinte midis njerëzve? Prej tyre i vinte zor. Ç'do t'u rrëfente sot, turpin? Megjithatë drejt tyre po shkonte. Në fund të rrugës u hap një portë dhe ai hyri. Dikush i liroi qoshen. Burrat rrinin kokulur.

— Ne jemi të humbur, — tha i zoti i shtëpisë, — si s'morëm vesh! Pushtohet vatani dhe...

— S'është për fajin tonë, — tha ai që i liroi vendin plakut, — kush kishte një pushkë, e rrëmbeu. I dëgjuat mbrëmë? Po në luftë nuk shkohet vetëm, o burra...! Ata që kishim në krye ishin për t'u vënë thikën. Mbreti, m.... thuaj.

— A doni t'ju bëj ndonjë kafe, — tha e zonja e shtëpisë.

— Ne jemi për ta pirë kafën nën gju, — tha një tjetër.

— Nuk e di mirë, — tha ai që i liroi vendin plakut, — po një kapedan deti, me një grusht burrash i prapsi tri herë këta qenër.



— Si!?! — bëri plaku.

— Po, — tha i zoti i shtëpisë, — kapedan e shkuar kapedanit paska qenë, o plak. Prandaj shkruaje në atë librin tënd, shkruaje.

— Na e bjer kafen, — tha me një fije entuziazmi ai që i liroi vendin plakut, — na e bjer, ta pimë shqiptarçe, ta pimë burrërisht.

— Po unë! — tha plaku dhe mjekra iu drodh. Koka e zbardhur, e vogël si dardhë, i ra mbi gjoks.

— Po edhe ti, o plak, — ia ktheu i zoti i shtëpisë, — ty të kemi babanë tonë, na mëson gjëra të lavdëruara e kurrë s'të kemi ndarë.

Buzët e shtrënguara nga turpi, që i kishte dhënë zjarrllëk trupit, s'e lanë ta tregonte aty faqe më të rinjve atë që i kishte ndodhur. Ndajnatë iku. Kur doli te porta, i tha përsëri të zotit të shtëpisë:

— Ai paska qenë kapedan i vërtetë.

— Cili!? — i tha tjetri, që s'e pati mendjen.

— Qysh? I prapsi tri herë... ë?

— Po, po, — shpejtoi i zoti i shtëpisë, — tri herë. Shkruaje, o plak, shkruaje, të rrijë pranë të tjerëve, se e kishte hak.

Doli në rrugë. «Po unë çfarë kam hak... — Nuk mundi t'ia tregonte askujt atë që i kishte ndodhur. — Do t'u them. Po, për sa kohë që do ta mbaj, meraku le të më brejë vetëm mua, le të ma hajë zemrën në fund të fundit.»

Hyri në shtëpi. Hapi librin e kapedanëve e di-ku, mbi një faqe të bardhë, me germa si kërrabë, shënoi ç'dëgjoi për kapedanin e ri. «Po, unë, unë

jam plak.» Në atë zë ndihej vajtimi për vetveten. U ligështua. Dremiti, u zgjua përsëri. Mori librin e kapedanëve. Donte të dinte nëse ndonjërit prej tyre i kishte ndodhur diçka e tillë. Ishte i bindur që jo, po kërshëria s'e linte. E shfletoi. Shpata, kështjella, kobure, fusha betejash shpaloseshin në përfytyrimin e tij.

«Këta e kanë ëmbëlsuar dheun, tokën nënë, ndërsa unë s'kam vend në të. Mua ajo do të më hedhë përpjetë.»

Sepse u drodh. Kishte pasur raste të shikonte njerëz të vrarë, të mbetur pa varre dhe i doli para syve rreshti i gjatë dhe i zi i korbave, që përdridheshin nëpër qiell e pastaj pingulthi u turreshin trupave të shtrirë, u thithnin gjakun ende të ngrohtë e, pasi mbushnin atë barkun e tyre sa një vezë, krra-krr... e nisinin fluturimin.

«Po as unë s'kam vend nën dhe, — tha, i mbërthyer në fyt, — as unë...» Kjo ndjenjë e ligë u bë e pushtetshme. Nuk ndërroi dot krahun. Pati frikë të kollitej. Libri i kapedanëve i rrëshqiti mbi gjoksin gungë. Vetëm kjo lëvizje, kjo peshë mbi gjoks e riktheu në mendje përsëri. E shtrëngoi fort librin dhe seç mërmëriti. Pastaj shfletoi librin dhe e gjeti faqen ku kishte shënuar kapedanin e ri.

«E ç'u bë me këtë trim, e vranë!? Të rrodhën trutë, o plak, të lanë mendtë. U lehtësua. U mundua ta rikrijonte në përfytyrim kapedanin e ri, po jepte e merrte me të dhe gjatë këtij mundimi e zuri një gjumë i lehtë, sikur të kishte bërë një banjë avulli. Gjatë gjumit se pse qeshte dhe vetëm atëherë të mbushej mendja se edhe ai dikur kishte

qenë fëmijë. Shikonte ëndërr. Kapedanët shqiptarë në dhomën e tij! Burra të lartë e të veshur të gjithë me të bardha. Ky ishte përfytyrimi i tij i zakonit për ta, po në atë bardhësi shtatlartë, tejet, shtrihej një kaltërsi deti, aq sa ai shqoi të mbështjellë me të kapedanin e ri. Kapedani i ri... i ri, i ri.

Dhe u zgjua me buzë në gaz. E harroi hidhërimin. Një çast qe ky, vetëm një hapje-mbyllje syri, sepse e liga e çau cipën e ëndrrës, zuri vend në fillim mbi faqen e goditur e pastaj mbi tërë trupin. U ngrit dhe eci anës dhe anës murit. Doli dhe u ul te pragu i derës. Dita kishte hedhur fustanin e bardhë mbi gjithësinë, dielli puthte butë-butë tokën. Afshi i ngrohtë kishte dehur zogjtë dhe gjithë natyrën.

«Ç'ëndërr që pashë, — tha duke psherëtirë, — kapedanët në shtëpinë time! — U drodh. — Turpi. turpi është këtu. Si? Po, këtu, ulur këmbëkryq...», — dhe goditi fort këmbët e mbledhura. U ngrit.

— «Jo, — tha, — jo. Unë s'jam turpi, s'jam...»

Nëpërmjet dritares gjysmë të çelur pa atje poshtë, te gropa, armikun që e goditi, i cili sapo lëshoi edhe një të qeshur si hingëllimë.

«Kujt i gëzohesh, o katran, kujt? Em... dashke të më ndash mua nga ata, o i mallkuar!»

Vajti pranë sepetes, te këndi, u kërrus mbi të, sa dhe këmbët i mbetën në hava dhe nxori prej fundit të saj një send të mbështjellë me pece të kuqe. Ishte një kobure e vjetër, ndoshta më e vjetër se vetë mosha e plakut.

«Një jetë e tërë ka kaluar që s'të kam kapur

me dorë, por unë të ruajta. Është mallkim i madh të rrijë një shtëpi pa ty, moj, bijë, — i tha kobures, — si thua, a do të ma zbardhësh fagen?» — Nga çepi i syrit të djathtë i rrodhën lot. Ç'iu kujtua? Në ato pak çaste kujtoi tërë jetën e vet.

«E, mjaft, de, mjaft. Nuk je çilimi. Dy herë bëhet njeriu çilimi...»

Hapi tejtejt derën. Libri i kapedanëve qëndronte mbi jastëk. Vajti e mori.

«S'ka turp në këtë shtëpi, — tha, — këtu është nderi, dhe nderi je ti, e ti do të jesh», — i foli librit dhe e vendosi sipër, mbi oxhak. E vështroi edhe një herë para se të mbyllte derën.

«E, — tha, — ja si ta bie jeta!... po çka, duhet mbyllur e bardhë.»

Bëri poshtë kodrës. E ngriti koburen deri te sytë. Meraku se a do ta hante armikun prej aty, e stepi, pastaj edhe një pluhur merimange i qarkoi bebëzat.

«Duhet të afrohem, — tha, — të afrohem që ta këndoј këngën tamam.»

U var tatëpjetë, gjithnjë duke u munduar të fshihej pas gjerdheve dhe ferrave. Diku ndaloi dhe koka e zbardhur, si një grusht prej bore, u duk mes gjelbërimit. Përsëri u dëgjua e qeshura. Edhe plaku pati qejf të qeshte atë çast, ose pati qejf të përqeshte, a ku i dihet.

«Qenkan shumë! — tha plaku. — Njëqind le të jenë. Pesha e turpit nuk ka kantar.» Kërceu mënjane dhe i doli ballë për ballë. Plaku tërhoqi këmbëzën, përnjëherë koburja këndoi siç ia deshë qejfi

atij. Armiku u lëkund, hapi krahët si korbat dhe pastaj u plandos sa gjatë-gjerë përmbys. Atë çast dy plumba njëherësh erdhën dhe e goditën plakun në brinjë.

«Tani, — tha ai, — tani...»

Nuk u dëgjua mirë se ç'tha më tej, po me të drejtë mund të thoshte: Do të rroj më shumë se jeta!

## NJË DITË E GORI JANKUT

Ishte një ditë e zakonshme vere. Gori Janku doli në oborrin përpara shtëpisë. E shoqja, që e fillonte punën një orë para tij, kishte ujitur lulet e oborrit. Ai, si gjithnjë, bëri për disa minuta gjimnastikë. Shtangën që përdorte i biri, e përdorte edhe vetë, po nuk e çonte lart më shumë se dhjetë herë. Kjo nuk e ligështonte.

Me të mbaruar ai ushtrimin, nisi i biri. Shtanga në duart e tij fluturonte, sikur të ishte lodër prej druri. Djali ishte mjaft i zhvilluar.

Gori po numëronte e, kur i biri i kaloi të pesëdhjetë herët, u çudit dhe qeshi, po ky qe vetëm një çast, pasi u përpoq ta fshihte kënaqësinë që ndjeu. Marrëdhëniet midis tyre ishin ftohur dhe shkak për këtë kishte qenë mesatarja e notave të djalit, më e ulët se ajo që kërkohesh për të vazhduar shkollën e lartë,

«Prandaj është hekur i fortë, — tha ai për të birin, — ia ka pakësuar hisenë kokës dhe ia ka shtuar gjoksit!... Ama dhe unë e teproj ndonjëherë, — shtoi i penduar, — po s'kam faj... Prindi ndaj fëmijës është si i urituri ndaj copës së bukës. Djalim e madh

në shkollë e kam, vajza po më ka mbaruar, ndërsa ky le të ndjekë rrugën time... Dyert të hapura i ka.»

Ndërkohë u dëgjua zëri i të birit që e thërriste për të pirë kafën.

«Dje nuk ia piva, po sot s'jam duke e bërë më atë budallallëk.» Shkoi të pinte kafën me mendimin se nuk do t'i qeshte, por as kokën mënjane nuk do t'ia mbante.

Pas pak u nis të dilte dhe po atë çast iu kujtua diçka. Dje, në punë, njëra nga vajzat, ajo me prenjka të kuqe, që punon te salla e motorëve, i kishte kërkuar një karafil nga të lulishtes.

«Do të ketë kaluar ndonjë ditë këtej kuqaloshja, — tha për vajzën, — dhe s'i paska hedhur sytë keq, dreqi, jo.» — Qeshi. Këputi karafilin, e vuri me qejf në xhepin e këmishnës dhe u nis për në punë. Pranë stacionit të autobusëve dy djem sepse qeshën.

Ndoshta prej karafilin, tha Gori buzagaz dhe, si për inat të të rinjve, i mori erë duke bërë edhe një gjest rinor që shkaktoi përsëri gaz. Qeshi dhe ai bashkë me ta.

E ndiente veten të gëzuar. Dy ditë me radhë nuk i ishte ndarë shqetësimi i të birit, por, ja, sot inati i kishte rënë dhe vendin e tij po e zinte pajtimi, kjo ndjenjë e butë, që gjendet me shumicë, si tek askush tjetër, në zemrën e prindit.

Nga larg u duk uzina, që mbante mbi vete një mjegull tymi të bardhë, në formën e një çadre plazhi. Te hyrja takoi Avramin. Ky punonte në mirëmbajtjen e uzinës. Nga mosha ishte i një sere me Gorin, po harku i kurrizit i ishte formuar para kohe dhe mjekra e zgjatur sikur i rritej me nxitim.

... — G-Gori, — tha ai, — te tubi qendror, herë pas here krijohet një unazë zjarri.

— Unazë zjarri!? — u çudit Gori.

— Po, po, — bëri tjetri duke lëvizur kot.

Gori heshti. Ç'ishte kjo unazë zjarri?!

— A lajmërove?

— Kjo që të thashë ty, ku hyn, — u përgjigj ai, — kaq pashë, kaq thashë. Jo, se pastaj ti, ti je i pari.

— Pa hajde, — i ra shkurt Gori, — hajde të vemi ta kontrollojmë...

— Është punë e tjetërkujt, — ia ktheu Avrami dhe ia nguli sytë karafililit që mbante Gori. Sepse qeshi.

«Kot e heq veten të gëzuar, — mendoi Avrami. — Kujt i shitesh ti, të njoh mirë unë ty, Gori Janku.»

— Po merresh me lulet, ë? — ironizoi ai.

— Hajde, pa lëviz, — i tha Gori, që nuk e kapi ironinë.

Ngau rrugën me mendimin se Avrami po i vente pas.

— Kur e dha shenjën?... A dëgjove? — Ktheu kokën. Avrami kishte ikur.

«Iku, — tha Gori, — iku, për nder, këtej e vë re defektin dhe këtej vë bishtin ndër shalë... Hëm, ti edhe fshesën tepër e ke! Djall!» — Shpejtoi. Defekti e vuri në merak të madh. Nëpër tubat kalonte gazoil dhe do të mjaftonte vetëm një shkrepje, që flaka të pushtonte qiellin. Ecte me hapa të shpejtë e të gjatë. Njëra nga vajzat e pa dhe u bëri shenjë shoqeve. Ç'i kishte ndodhur usta Gorit? Pse s'u foli atyre? Kuqaloshes nuk iu ndenj pa folur;



— Usta Gori, ma paske prurë karafilin?!

Ai, duke mërmëritur, vazhdoi të ngjiste shkallët. Nuk donte t'u thoshte gjë vajzave për defektin. Ato do të trembeshin, pastaj të sigurohej njëherë vetë.

«Ndoshta, ai djall Avram, e bën mizën buall», — tha.

— As nuses së djalit nuk do t'ia dhurosh, — e ngacmoi kuqaloshja. Asnjëra nga ato s'ishte nusja e djalit të tij. Kjo ishte vetëm një shaka që bënte ai me Martën, atë flokëthekrën, siç i thoshte.

U ngjit në sallë dhe i hodhi sytë rrjetit të tubave. Shenja e defektit nuk dukej. Vetëm ta mbante kokën tërë ditën përpjetë.

«E, ore Avram, — shfryu ai, — po ç'pandeh ti, mos kalon ujë nëpër ata tuba, kalon gazoil, kokë, që nga një lajthitje bëhet hataja!» — Vështroi përsëri, po asgjë s'po dukej.

«Mos bëri shaka, po ç'dreq shakaje na qenka kjo?!» — Fërkoj damarët e zverkut dhe tundi dy-tri herë kokën fort. Në çast u dha Avrami. Ai po vinte sikur të tërhiqej prej ndonjë qerreje.

— U ktheve. Ku e pe unazën e zjarrit? — pyeti Gori.

Tjetri nuk u përgjigj, por vazhdoi në qejf të vet.

— Ti je i mërzitur, Gori, të kam kuptuar. Nuk mbulohet e vërteta, po ti, si gjithnjë, kërkon të dalësh me flamur, sikur punët të shkojnë vaj. E ke dhe ti një hall, Gori Janku, e ke.

Ai nuk e kuptoi llogon e Avramit. Ku donte të dilte?!

— Unë s'kam halle. Avram, — u përgjigj, duke tundur kokën, me sytë nga tubi. Tjetri ia plasi gazit.

— Gënjeje veten me lulka, gënjeje. Po ku ka njeri pa halle në këtë dynja, ore derëzi! Po ti, ama, s'rri dot pa dhënë një çikë lustër. Unë s'them se ti ke mbetur pa bukë, po ja që tët biri s'ia dhanë të drejtën për në Universitet, mirë bënë? Ç'është ky, s'është hall? Hi... Hiii, — qeshi ai.

Plaga, që po përthahej, u ngacmua.

«Mirë të ma bëjë, — tha Gori me vete, — hakun, kur unë kokëgdhëja vë merak si i marrë. Po pse, Gori Janku, ç'të bëri djali yt, mos vallë ndonjë turp?» — Shau, po jo më të birin, por veten dhe atë që kishte përballë që, si pa gjë të keq, po i vinte shkrepësen benzinës.

— Avram, foli me ti këtë radhë Gori, — tim biri jo se nuk ia dhanë, po nuk i doli. Duhet mesatarja e lartë. Prapë, kiameti s'u bë, rrugët të tijat i ka, ngado që të shkojë... Pastaj, të gjithë Jankët s'do të bëhen me universitet, dy bukuri i ka baba...

— Mesatarja, më thotë, — ngau në të vetën për-sëri Avrami, — hi... hi... — Dy njollat e bardha si fasule te hunda iu përskuqën. — Të kam vënë re, Gori, sepse ke qejf të ngopesh me lugën boshe. Pse s'e thua troç, duhen bërryla, thuaj. E kishte mesataren im bir, që ç'ke me të, po prapë s'i doli.

— Nxirre, të shkretën, nxirre, se plase! — tha Gori me një frymë dhe shpejt hodhi sytë drejt tubit. Unaza gjarpëroi një çast dhe pastaj u zhduk. Kur kaloi rreziku, iu kthye Avramit:

— ... Pse i bije pragut, tët biri jo se nuk i doli, po s'ia dhanë. Pse dërdëllis kot, nuk ia dhanë, — për-

sëriti ai si për të nxjerrë dufin, — ë, si thua, a ia vlen ta ngasim më tutje?

— Si lart vret, po njësoj jemi të dy, punëtor ti e punëtor unë, — tha Avrami, me mendimin se i vuri kapak bisedës.

— Që s'jemi njësoj, këtë e di dhe bufi, — ia ktheu Gori, që vendosi t'i përvishej paq. — Biografinë po na bën? Biografia nis pak më tutje, Avram, dhe mos m'u hidh degë më degë, si... si, ptuu!

Avrami u ngrit. Ndjeu një zjarrllëk të madh, sikur vetë ajo unaza që shfaqej, ta kishte mbërthyer si rrip mesi. Nuk e kishte menduar se do të vinte puna deri këtu. Ai djall Gori, sikur lëshon gurë nga goja! U vrenjt në fytyrë, po forca përbrenda ishte e dobët dhe s'arrinte të shpërthente. Ndoshta ajo s'ishte e dobët, por ishte e frikësuar dhe dobësia me frikën janë si dy motra.

Edhe Gori u ngrit dhe nisi të lëvizte kot. E kishte pushtuar inati. Nuk ishte kënaqur me aq sa i kishte thënë atij, prandaj i bëhej sikur gjoksi po i mbante një peshë të tepërt. Më vonë u pendua që po merrej shumë me veten dhe po harronte defektin atje lart. U ngjit me të shpejtë dhe i kontrollloi të gjithë tubat. Nuk dyshoi për gjë, prandaj zbriti qetë-qetë.

«Njësoj jemi, — mërmëriti, — njësoj!» Pa Avramin atje, te qoshja, po kafshonte bishtin e cigares si lepuri gjethen e lakrës. «S'do ta lë me kaq, — mendoj, — jo, do ta bëj çështje faqe gjithë punëtorëve. Më barazoke me veten! Unë jam i biri i Ranxhës, ja rrënjët, or t'u mbylltë, Ranxha në luftë la krahun, kurse yt atë në atë kohë shtonte dyqanet.

Nuk i leu duart me gjak, po sehirxhiut kush ia pa hairin!? I vëmë këto në balancë e, kur të shohësh që ana ime të të hedhë përpjetë, të të hedhë! — qeshi nën zë. — Qesh. Qesh, o Gori Janku, qesh! Po si të mos qeshësh, mor vëlla! Ç'kërkon ky. Puna punë, leku lek. E ç'do?! Mos kërkon ta vëmë në udhëheqje? Na! — Dhe i ra bërrylit fort.»

Ndezi një cigare dhe e lëshoi frymën shtëllungë. Përsëri i vajti mendja tek Avrami.

«S'kam punë me të tani, jo, ke parë ti...» — E ndjeu veten më të lehtë, ndoshta ngaqë edhe ajo unaza s'po dukej shpesh. Mori karafilin në dorë e bëri tutje, pranë buzëve të bazamentit. Aty poshtë dukej salla e motorëve dhe tri vajzat që vinin rrotull tyre. I shikoi për disa çaste. Iu kujtua shakaja e kuqaloshes për karafilin dhe gati sa s'e hodhi atë mbi kokën e Martës.

«Nuk u thashë as mirëmëngjes!» — tha.

Kuqaloshja e kishte vënë re dhe thirri:

— Oo, usta Gori, po na përshëndet nga aeroplani.

«S'u paska mbetur hatri», — belbëzoi ai duke vënë buzën në gaz dhe ndërkohë hodhi mbi to karafilin.

— S'presim dhurata nga ti, — ia priti kuqaloshja, — s'kemi marrëdhënie bashkë dhe, hajde, pa ke për të gjetur nuse për djalin.

— Po ti nuk je tezja e Martës, — ia ktheu Gori i qeshur dhe të tria vajzat atje poshtë ia dhanë gazit.

Gori u largua i kënaqur dhe vetvetiu hodhi sytë drejt tubit. Lëshoi një klithmë habie dhe u dha duarve poshtë. Në tub, me shpejtësi të rrufeshme po

krijohet jo vetëm një unazë, po dhjetëra të tilla, derisa i tëri mori ngjyrën e benzinës kur digjet. Spesori ishte holluar aq shumë, sa brenda në të dukej lënda që merrte flakë. Pranë tij, duke u dridhur si në rrymë korenti, u dha Avrami.

— Të ngjitemi shpejt. Të mbyllim volantën, — tha Gori dhe nisi të ngjiste shkallët, kurse tjetri u turr drejt telefonit.

Mbi sallën ku punonin vajzat u përflak edhe një tub tjetër.

— Mjaft! — thirri Gori. — Mjaft, lëre telefonin, pa eja...

Po ngjitej këmbadorazi. Sa më larg, më vështirë ishte. Prej tubave lëshohet një nxehtësi përveluese. Ajri përçark ishte djegës dhe mushkëritë sikur po i zhuriteshin. Reflektimi ishte verbues. Ai vuri njërin dorë si strehë, po kjo nuk e lehtësoi, madje, ngaqë të parët iu mpak, desh ra pingulthi nja njëzet metra poshtë.

«Të mbyll furnizimin, volantën e madh... volanti i» ... Dhe në atë pak shikim, ajo rrotë hekuri merrte përmasa gati gjigante, edhe pse në të vërtetë ai po e shikonte fare pak, për të mos thënë se nuk e shihte fare. Gati kërceu e vajti i ngjeshi duart mbi të. Edhe ai ishte i nxehtë. Ndjeu një erë mishi të përzhitur. Hoqi këmishën dhe ia hodhi përsipër, po s'po e lëvizte dot. U mundua, po përsëri nuk e lëvizte dot.

— Alo... Alo..., — dëgjohej zëri i Avramit.

— Djalli të marrtë, — foli mbyturazi Gori. Ishte vetëm e kishte frikë se mos fuqitë e lëshonin fare. U mat t'i thërriste atij tjetrit, thirri, po zëri i doli i

mbytur. Atëherë u hodh me tërë peshën e trupit mbi volant. Këmbët, të shkëputura prej bazamentit, koloviteshin në ajër. Mblodhi gjithë forcën dhe peshoi. Rrota e madhe nisi të lëvizte. Jo djersë, por ujë i kullonte nga trupi. Ndoshta nga mungesa e ajrit e mbyti kolla. Megjithatë nuk u dha për asnjë çast, nuk i ndahej asaj që kishte mbërthyer mes duarve, se e dinte fare mirë, edhe pse ishte në një gjendje të vështirë, që prej asaj shkëputjeje varej uzina dhe jeta e tij. Vetëm prej këtij mendimi buronte ajo energji që kishte pushtuar mendjen dhe trupin e atij njeriu që, në mes asaj përflakjeje të madhe, nuk dukej si i tillë, po si një qenie e vogël dhe e çuditshme. E rrotulloi volantën, e rrotulloi derisa e mbylli. Ngjyra e zjarrtë u shndërrua në një gri të errët. Gazoili ishte ndërprerë. Prej pjesëve bashkuese shpërtheu tymi i zi, i cili mbushi uzinën përbrenda, duke fshehur makineritë, lëvizjet e shqetësuarra të njerëzve dhe vetë njerun, që pak më parë kishte mbi krye kurorën e flakës. Pas pak tymi nisi të dilte nëpërmjet dritareve. Dalngadalë, duke thithur ajrin e ftohtë dhe të pastër, Gori Jankut iu rikthye dëgjimi dhe në veshët e tij kumboi zhurma e njohur e uzinës. Qëndronte shtrirë përmbi platformë, pa e hequr njërën dorë prej volantit të madh. Kështu e gjetën shokët. Të parat që erdhën pranë tij qenë vajzat e motorëve. Ato e morën dhe e zbritën poshtë. Menjëherë e çuan në dhomën e ndihmës së shpejtë. Mjeku e kontrolloi me kujdes. S'kishte ndonjë dëmtim tjetër, veç asaj djegies së duarve, të cilat ia mjekuan shumë shpejt. Pas njëfarë kohe ai e rimori veten. Të tria vajzat i qëndronin te koka.

I vështroi me vërejtje dhe e përqendroi shikimin te Marta. Asaj i ishin përlotur sytë. Gori Janku i tundi kokën, sikur t'i hiqte vërejtje, pastaj, me një zë pak të zvargur, i tha:

— O, o, kjo! — bëri shenjë nga duart, — Për kaq? Mos, se pastaj..., — deshi të bënte shaka, qeshi dhe i mbylli përsëri sytë. Mjeku i largoi vajzat dhe nuk la njeri tjetër të hynte në dhomë. I aksidentuari flinte. Gjumin e bënte të rëndë, por fakti që flinte e qetësonte shumë mjekun. Dikur ai u përmend përsëri.

— A të dhemb gjë, Gori? — pyeti mjeku. — Rrahjet i ke për bukuri. E ke vetëm nga sforcimi, nxehtësia. Hesht...

E fërkoj te supet dhe i vuri kompresë të ftohtë mbi ballë.

Frymëmarrja iu bë më e lehtë dhe e zuri një gjumë i thellë. Ajo ngjyrë e përhimtë e fytyrës po i largohej. Mollëzat nisën t'i përskuqeshin.

Më vonë u zgjua. Tani dita ishte thyer dhe rrezet e diellit në ngjyrën e bakrit të rrahur hynin pjerretazi në dhomë. Mjeku kërceu nga karrigia.

— Mos luaj, Gori, mos luaj!

Gori mbështeti këmbët në dysheme dhe, pasi u qetësua mirë, pa pranë vetes të birin, që psherëtiu thellë.

— Gori! — u lut mjeku përsëri.

— Jam shumë mirë, doktor, — tha Gori duke u ngritur. I biri shpejtoi dhe i kapi krahun. Gori buzëqeshi.

— Më besoni që jam mirë, — tha, — kam borxh

ta ngre një shtangë pesëdhjetëkilëshe jo dhjetë herë, po njëzet, tridhjetë, ë? Si thua? — pyeti të birin.

— Po, baba, — foli djali, që përpiquej t'ia ruante duart e plagësura.

Mjeku i përcolli deri matanë lulishtes. Atë e bir dolën në rrugën e madhe. Aty ndaluan një çast. Me sa kuptohej, Gori kërkonte të kthehej përsëri në uzinë. Të shihte me sytë e tij si kishte vajtur puna. I biri nuk ia prishi. Te porta kryesore të dy u gjendën midis punëtorëve. Kaluan nëpër repartin ku pati ndodhur defekti. Shokët i kishin zëvendësuar me kohë pjesët e djegura, aty-këtu dukej ende mbi disa tuba ndonjë njollë ngjyrë kafe. Në fund të sallës pa Avramin që po shtynte një karrocë të mbushur me skoriet e shkaktuara gjatë defektit. Avrami do të donte më mirë të kthente rrugë, po karroca nuk po i bindej, s'po i bindeshin krahët. Si të vepronte?! U zu ngushtë. Ta përmendte, apo jo? Tërë atë ditë ishte penduar për bisedën që kishte bërë në mëngjes me Gorin.

«Ç'm'u desh mua», — mendoi.

Ato dy-tri ditë që Gori Janku kishte qenë i shqetësuar për punën e të birit, ato e kishin fajin. Avrami kishte menduar se ja, më në fund e pati dhe krenaria e Gori Jankut, prandaj dhe u tregua aq i guximshëm në mëngjes, se kurrë s'ishte shquar për i tillë. Tani e mundonte frika dhe i erdhi në kokë një mendim, ta përshëndeste Gorin, ta lavdëronte për atë akt që bëri, ta zbuste që ta hidhte edhe këtë radhë.

— O, Gori! — ia pati ai. — Më duket e pabesueshme se si u ngjite atje në mes të flakës, atje...

— Avram, — e ndërpreu Gori. — Atë që bëra unë



e bëjnë të gjithë këta burra që sheh ti këtu. Asgjë s'ka të pabesueshme. Vetëm një gjë nuk duhet besuar kurrë, ajo që më përrallise ti, se ne të dy qenke-mi njësoj...

Ndërkohë, i biri, që po vinte shpejt, i hodhi xhaketën krahëve dhe në xhepin e saj i vuri një karafil, Gori dhe punëtorët buzëqeshën.

— Ma dha një nga ato vajzat atje, — tha djali.

Gori Janku ktheu kokën nga e djathta dhe pa tri vajzat që po e prisnin të dilte.

## E QESHURA...

Dielli del mbi majën e malit. Rrezet e vakëta prisnin përgjumjen e natyrës dhe menjëherë pas saj nis e dëgjohet kënga e ditës së re. Horizonti duket si një gjethe trëndafili kthyer drejt diellit, një re e vogël tundet e përkundet si bishti i një kali të fshehur. Ajri është i pastër si qelqi, i freskët dhe ledhatues. Një puhi të përkëdhel faqen, gushën, gjoksin, të duket sikur diçka përbrenda do të dalë, do të fluturojë, tamam si një fije tymi, që ngrihet e ulet mbi çatitë e shtëpive që vetëtijnë nga vesa e mëngjesit. Dielli tanimë sikur sheh vetëm rrugën e tij. Hijet zgjaten e zgjaten. Prej pyllit vjen era dhe atëherë nis vallja e pemëve, shpërthen aroma jetëdhënëse e luleve dhe e gjetheve plot lëng. Qumështi i natyrës të njom buzët dhe një fije ëmbëlsie të dredh zemrën. Vesa, loti i pranverës, largohet e trembur nga rrezet e ngrohta. Një gjel pendëartë krekoset majë plehut dhe sqepin e ndritshëm si thika e fut shpesh brenda në të. Hapen dyert. Fshatari, merakçi i madh, i bie njëherë rrotull shtëpisë. Diku dëgjohet zhurma e një traktori dhe nëpër rrugët e fshatit derdhen grupe njerëzish të veshur ngjyra-ngjyra. Pak më poshtë, kalon një qerre. Balashi plak, ai kau me bri të thyer,

s'rri dot pa e ngacmuar atë më të riun, që i vetëtin qimja si gjilpërë. Tutje, në livadh, një mëz i kuq vrapon si i qmendur. Bulëzat e vesës i shkëlqejnë mbi hundë dhe ashtu, me qafën ulur, vrapon e fut kokën te gjiri i pelës së bardhë, lidhur te gardhi. Dy flutura janë vënë në garë me shoqja-shoqen.

Fli, o gjumash, fli. Si nuk e kupton se çfarë çlodhjeje, ripërritjeje dhe force të jep pranvera?! Këto i thashë për Dhimitrin, shokun tim të dhomës. Ai është gjumash i madh. Punon si ekonomist i mesëm në kooperativë. Është djalë i turpshëm dhe tepër i ndjeshëm. I pëlqen shumë muzika. Rrallë mund të ketë ndonjë të diel që në anketën muzikore të mos, dëgjosh emrin dhe mendimin e tij, për këngën që i ka pëlqyer. Qesha me vete, pasi e mendova për një çast ashtu, të shtrirë, duke u përpëlitur, se ka gjumë të rëndë. Në dimër nuk e pati këtë zakon, ndërsa tani të tërbon gjithë natën me lëvizjet dhe gërhitjet. Ndjeva pak të ftohtë dhe ia nisa përsëri vrapit. Zbri- ta kodrën ku kisha hipur dhe u gjenda në koriye. Për mendimin tim, pranvera e ka folenë në pyll. Zogjtë këtu e kalojnë natën e tani rrahin krahët degë më degë duke u turrur në hapësirën e gjerë. Vesa shkundet prej gjetheve, era e freskët i rrëmben sum- bullat e arta dhe i tret diku. Ferrat, shkurret dhe gë- mushat turfullojnë nga thëllëzat. Një lepur murrash më kërceu aty pranë. Këmba shkel butë-butë, nuk lë dot gjurmë mbi barin e ri. Mushkëritë të mbu- shen me aromën e këndshme të mbledhur gjatë natës e të çliruar tani prej rrezeve të ngrohta të diellit, i cili ka nisur të zbardhojë majat e lisave. Vërtet u lodha pak, djersita, por, po pati pyll, ka

edhe ujë. Aty matanë është burimi. Të lahesh nga mesi e lart me atë ujë, që vjen drejt nga maja e malit, është shëndet. Trupi të përskuqet, të nxehen muskujt, ke qejf të lëvizësh, dhe tërë ditën je i freskët. Ja ç'është pranvera, o gjumash, si s'e ndien hovin dhe gjallërinë e saj? Vrapova. Mbi atë shkëmbin kaltërosh, prej buzëve të të cilit buron ujë, qëndrova i befasuar dhe s'bëra as edhe një hap më tutje. Aty rrinin pranë e pranë Dhimitri me Lulen. A ishte Lulja ajo? U sigurova që ajo ishte. Para dy vjetësh e kisha pasur nxënëse. Tani ishte rritur dhe zhvilluar mjaft. Trupin e kishte të lartë e të drejtë. Herë-herë ajo qeshte. I qeshte syri, ai sy i madh e i zi, nën atë vetull të harkuar bukur e paksa të kthyer te cepat. Shkurt, ndër vajzat e moshës së saj, në atë fshat, ajo ishte më e bukura. Lulja ka qenë nxënëse e dalluar. Tani që është në punë, të gjithë flasin me respekt për punën që bën dhe me adhurim për bukurinë që ka.

«E, o Dhimitër kuqaloshi, — thashë, — (në të vërtetë, Dhimitri është pak kuqo në fytyrë, po nuk është i shëmtuar, por as edhe i bukur jo) e, or vëlla, jo po nuk ditke ti ta shijosh hovin dhe gjallërinë e pranverës! Ndërsa unë bredh si kalë, ti... ti... ».

— Dësh thirra me zë, po ndërrova mendje. Këtë e bëra për hir të Lules. Ajo edhe sot e kësaj dite më thotë shoku mësues.

I rashë nga krahu tjetër i burimit dhe shko-va në dhomë. Pas pak erdhi edhe ai.

— Ç'kemi? — e pyeta duke i shkelur syrin.

— Unë të pushë, — më tha.

— Epo mirë.

— Dëgjo, ti e di se unë nesër nisem për tre muaj në shkollën e lirë ushtarake.

— Sa kohë ke ti me atë vjazën? — e pyeta.

— Shumë, — tha ai, — po me të hyrë pranvera, kur ti shkon të bësh gjimnastikë, unë ngrihem dhe vete e takohem me të te burimi.

— Pse më fshihesh mua?

— Ti s'ke qejf të të flasin për dashurinë, — më tha ai, — ti sikur ke vendosur të mos martohesh.

— Je në vete — i thashë i prekur, — nga e nxjerr ti këtë përfundim?

Ai u ul mbi krevat dhe mbështeti kokën mbi dorën e bërë grusht në tavolinë. Dihati fort, sa dhe shpatullat i lëvizën.

— Më fal, më fal! — tha mjaft i prekur.

— Po pse s'më ke treguar? — ngula këmbë.

— Si të të them, — tha ai, — po ja, ajo s'do që ta marrë vesh njeri.

— Ju duheni dhe s'keni pse të fshiheni.

— Ajo s'do që s'do. Prit, prit, thotë.

— Po ti si ajo mendon?

— Unë, unë e dua shumë...

Vura buzën në gaz. Hapa dritaren, ajri i freskët hyri me vrull në dhomë. Dega e kumbullës, plot gjethe të reja, u lëkund. Më pushtoi një ndjenjë gëzimi. S'di nga buroi kjo, nga bukuria e pranverës, apo nga rrëfimi i Dhimitrit.

— Po mirë, — i thashë, — ç'do të bësh? Shko tako prindërit e saj. Po të erdhi, zor shkojmë bashkë.

— Tani kam një hall tjetër, — tha, — sot e dhjetë vjet të shkuar Lulja ka qenë e fejuar. E kishin fejuar këtu në fshat. Xhaxhai i saj e paska hapur

përsëri atë muhabet, por i ati i Lules nuk ka pranuar. Ai i kishte thënë se kësaj pune i është vënë kapak prej kohësh dhe s'ka pse të prishet as miqësia dhe s'ka pse të shkelet as burrëria me atë mikun. Kohë të reja...

— Shumë mirë i paska thënë, — i thashë unë, — tamam, një prind me mend, ashtu si ai do të bënte, por ama ai ka po kaq të drejtë të preket edhe me veprimin tuaj. Pse të fshiheni...

— Lulja nuk do që të hapet ky muhabet, pa u mbyllur mirë ai i vjetri... Dhe ka të drejtë, këtu i thonë fshat.

— Këtë mendim unë nuk do t'ia falja as asaj. Qenka fshat! Çudi!

— A e di, — bëri ai, e pastaj më pa në sy, — që nga ajo ditë që është hapur muhabeti i vjetër, Lulen, kur kthehet nga puna, dikush e qëllon fshehur me gurë.

— E qëllojnë me gurë!? — u habita.

— Jo për ta goditur, — tha ai, — po më shumë për ta trembur, a ku di unë...

Kjo më bëri të mendohesha pak. Si t'a qëllonin me gurë, si ta trembnin, përse?

— Dhimitër, i thashë, — këtë veprim e bën ndonjë me paragjykime, patjetër për ta trembur vajzën dhe ky mund të jetë nga familja e atij djalit me të cilin e kishin fejuar Lulen. S'dihet ç'i thotë mendja atij, por, që t'i pritet dora, je ti i pari që duhet të veprosh. Mos e fshih dashurinë... takoje Lulen dhe përcille vetë kur kthehet nga puna.

— Ashtu mendon?!

— Po.

— Nesër unë iki, — tha ai.

— Shko përcille sot, — i thashë, — po nesër e tutje mos u bëj merak, këtu jemi. . .

Buzëmbërme. Dielli kishte perënduar. Hijet e gjata të pemëve largoheshin nxitimthi dhe ngjyra e përflakur e horizontit shndërrohej e tretej njësh me kaltërsinë e thellë të qiellit. Uji i burimit kishte humbur bardhësinë dhe një gjethe e rënë mbi të kishte nisur gjumin e gjatë të natës.

Aty e priti Dhimitri Lulen. Të dy, të zënë dorë për dorë, morën korijen. Frynte një erë e lehtë dhe pak e ftohtë. Nëpër errësirë zbardhte aty-këtu shamia e vajzës. Ecnin. Tufa zogjsh, hidheshin sa në një degë në një degë, me zhurmë e duke kënduar. Po kjo nuk zgjati shumë. Në pyll ra qetësia. Dëgjohej vetëm shushurima e gjetheve. Nëpërmjet lisave të gjatë dukej qielli i mbushur plot me yje. U ngjitëm në kodër. Fytyra e vajzës sikur mori flakë. Atje, më të djathtë të tyre, lulëzonte hëna, e plotë dhe e qeshur. Aty, pak më poshtë, xixëllonin dritat e fshatit. Nga krahu tjetër i kodrës dëgjohehin zhurmat e një traktori dhe herë pas here shfaqeshin e zhdukeshin dhe dy sy të zjarritë, që vraponin nëpër arë.

— Ti nesër do të ikësh, — i tha vajza.

— Po, do të iki, — ia ktheu djali.

Heshtje. Hëna ngrihet ngadalë. Era që vjen nga pylli nis të valëzojë edhe në këtë anë. Lisi i madh hidhte hijen mbi livadhin e dallgëzuar.

— Ja, këtu m'i hedhin ata gurët, — tha dridhshëm vajza.

— Këtu!? — bëri ai.

— Këtu, — tha ajo dhe u afrua.

Djali i hodhi krahun, e tërhoqi më pranë. Ndjeu afshin e ngrohtë dhe erën e mirë të trupit të saj. Hëna spërkati, si me ujë të artë, livadhin. Lisi i madh u drodh duke u lëkundur valë-valë.

Askush nuk qëlloi me gurë atë natë. Edhe netët e tjera nuk qëlloi kush. Tashmë Lulja e ka harruar färe atë ndodhi, por ndonjëherë, kur kalon pranë atij vendi, edhe i kujtohet dhe zë e buzëqesh. Shikon livadhin e spërkatur prej hënës, lisi i madh që shushurin lehtë-lehtë dhe përmllohet për Dhimitrin, që akoma s'është kthyer.



## LEKA HYSI

Ishte ftohtë. Prej luginës së Shkumbinit përhapj mbi fushën e gjerë era e sertë brisk. Ciflat e ngrira të dheut dhe gurishtet që ngriheshin përpjetë goditnin pajisjet metalike. Ato lëshonin një tingull të thatë e me ndërprerje.

Kishim zënë vend rreth stufës-fuçi, në atë barakën prej pupuliti, përkëtej hekurudhës. Më i madhi nga ne është Leka Hysi, saldator me patentë. Tre-katër janë të tillë në të gjithë kantierin. Ai është montator i përgjithshëm, por i rrallë si saldator. Pinca në dorën e tij është aq e saktë dhe aq e shkathët, sa mund të jetë gjilpëra në dorën e një qëndistareje të talentuar. Në një moshë të afërt me të jam unë dhe i treti është Iliri, i cili këtë vit mbaroi shkollën e rezervave të punës. Akoma është nën kujtimet e saj. «Sa mirë ishte në shkollë, — thotë ai, — një javë kishim teori dhe një javë praktikë.»

— Zjarri nuk thotë kurrë ngrehu, — tha Leka.

Era fryu me tërsëllimë dhe dera u përplas lehtë.

— Hyr, — bëri shaka Iliri.

— Çohemi, — tha buzagaz Leka, — çohemi, se na zuri dreka.

— U thamë! Bën ftohtë, — foli Iliri, më pranë stufës.

— Me motin merret sinoptika, ne merremi me hekura, — foli Leka përsëri i qeshur.

Ai u ngrit dhe diçka mori mbi bangën e punës.

— Çudi, — tha Iliri duke m'u drejtuar mua, — kur ishim në shkollë, sa herë që bënte ftohtë qëllonte të kishim javë teorie, në klasë, brenda, ooo...!

Leka bëri sikur nuk dëgjoi e doli jashtë. Pas tij dola edhe unë. Era vazhdonte ulërimën. Bryma e mëngjesit mbi hekura ishte shkrirë dhe prej tyre pikonin bulëza të shndritshme uji. Konstruksione të formave dhe madhësive të ndryshme kishin zënë vend në shesh. Përballë dukej një stivë tubacionesh të diametrave të mëdhenj dhe një stivë me spesorë llamarine të trashë që na duheshin për përgatitjen e pajisjeve. Rrëzë barakës, aparatet e saldimit dhe një kalandër rrinin si të menduara. Tani po merreshim me përgatitjen e dy pajisjeve kryesore të repartit të ri të uzinës së çelikut. Njërën e kishim mbaruar, ndërsa tjetrën e kishim në përfundim e sipër. Kthimin në kalandër e bëja unë, kurse Leka saldimin, veçanërisht atë vertikal, që ishte edhe më i vështiri.

— Leka, — i thashë, — ti për këtë pajisjen e dytë po punon më me qejf. — Ai vuri buzën në gaz e tha:

— Jo, pse, edhe për të parën; po a e di ti, çfarë po mendoj? Bën mirë njeriu ta rrahë veten.

— Të rrahë veten?

— Po, — tha ai, — jo ta qëllojë me grushte, jo, por t'i vërë gishtin kokës dhe të ketë besim te vetja.

Në fund të fundit, kush i ka bërë tërë këto mreku-llira që të sheh syri? Njeriu, kush tjetër. Po ti, unë, tjetri, tjetri, ç'jemi?

— Njerëz, — pohova vetvetiu.

— E pra, sekreti i të gjitha gjërave qëndron te qëllimi dhe te djersa. Ti e di fort mirë se këto dy makineri i lanë kinezët...

— Ata menduan se ne nuk do t'i bënim.

— Kujtuan se do të ngrinin duart përpjetë. Ti nuk i arrite dhe nuk i ke dëgjuar kur flitnin për mendjen e artë, mendjen e ndritur.

— Di që kishin shumë fjalë të tilla.

— Jo vetëm fjalë, — tha ai. — S'ka mendje të artë e ku di unë, ka vetëm mendje njeriu, e ky, kudo që të jetë, në Afrikë apo Azi, është po aq i zoti sa ç'është në Evropë a gjetkë. Njëri prej tyre, një Li a Lu, nuk ia mbaj mend emrin, kur mori vesh se unë e kisha marrë patentën e saldatorit në moshën njëzetetrevjeçare, i shqeu sytë...

— I dukej e çuditshme!

— E pabesueshme thuaj. Që të kishe një patentë të tillë, duhej që patjetër të kishe mbaruar shkollë në Pekin, se gjoja atje na qenka truri i artë.

Të dy qeshëm, pastaj ai tha:

— Unë e di që ti i ke qejf këto gjëra, diçka kam lexuar edhe unë nga ato që shkruan ti...

— Lëri, ç'i zë në... — e ndërpreva.

— Më pëlqeve, — qeshi, — po këtë mendje ta kesh edhe për më tutje, ama. Fatkeqësi kur bie në dashuri me veten, po ne jse, tani kemi punën në dorë, pa do t'i vijë radha të flasim më gjërë.

— Unë s'të kam parë ndonjëherë pa punë, — i thashë.

— Shyqyr, — u gëzua ai, — mos paça kurrë të ngopur me punë! — qeshi gjithë shend dhe përveshi mëngën e xhaketës.

— Duhet ta ruash pak shëndetin, — i thashë, — ti mbrëmë...

— Ky është sentimentalizëm, — qeshi. — A e thashë mirë?

— Ti mbrëmë nuk kishe ngrënë darkë. Unë ta prura bukën në dhomë e ti s'e kishe zënë me dorë.

— Turp është, — tha, — po harrova.

— Si, ore, harrove?!

— Harrova, për kokën time, e pastaj aty nga ora tre e mëngjesit po më këndonin zorrët, po nuk u ngrita, kisha merak se mos ju prishja gjumin ty dhe Ilirit.

— Ja, me këtë nuk...

— Nuk është e përhershme, — më ndërpreu ai. — Mbrëmë lexova një libër teknik. Kryeinxhinieri ka ndër mend të bëjë zëvendësimin e kushinetës së madhe. Ti e sheh se ai nuk ka kohë, prandaj dua ta ndihmoj.

— A do t'ia dalësh?

— A do t'ia dalim, — ndreqi Leka.

Nisi të saldonte. Xixëllonjat e metalta kërcenin te syzet e tij të zeza. Unë shkova pranë kalandrës. Futa një pllakë çeliku, por s'po e mbaja dot. Forca tërheqëse e makinerisë ishte e madhe, dhe kjo më rrezikonte duart.

— Ç'u bë Iliri? — pyeti Leka.

Unë ngrita supet.

— Shko gjeje, — tha ai, — mos puno vetëm, se do të na bësh hatanë.

— Ilir, — thirra, — Ilir!

— Shko në barakë, — tha Leka, — atje do ta gjesh, e ka javë teorie këtë, — përfundoi i qeshur.

Vajta në barakë po Ilirin nuk e gjeta. Ku të kishte shkuar? Patjetër në ndonjë vend me zjarr. Era frynte dhe vërshtëllente nëpër tuba. Majat e këmbëve më ishin tharë. Thirra edhe dy-tri herë, pastaj sytë më shkuan tek ajo kova cilindrike. Në të mund të futej një buall dhe jo më Iliri. Vërtet aty e gjeta. Ishte mbledhur kulaç në fund të kovës dhe gërhiste. I bëra zë Lekës. Ai erdhi dhe filloi të qeshte.

— Të thashë që e ka javë teorie. Po qe ftohtë, ky do teori.

— Atëherë e lëmë të studiojë, — e shtyva shakanë më tutje, — i krijojme kushte. — Mora kapakun dhe e vura lehtë mbi kovë.

— Këputi nja katër pika, — i thashë Lekës.

Ai me zor po e mbante të qeshurën dhe e saldoi kapakun në katër vende. Me të mbaruar, nuk duruam dot, po ia dhamë gazit me të madhe. Iliri u përmend, e ngaqë s'po dilte dot, nisi të qëllonte me grushte anët e kovës, herë i nxehur, herë duke qeshur.

— Ilir, e ke javë teorie, a i ke marrë librat me vete? — e ngacmova.

— Hapeni, hapeni, aaa! — bërtiste ai.

Ndërkohë, ndoshta nga zhurma, apo nga e qeshura, u dha aty furnitori, Vangjeli.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti ai.

— Asgjë, — i thashë.

— Si asgjë? — u inatos ai. — Po ky që ka hyrë këtu brenda, ç'është? Ç'bëni ju... Ë? Leka Hysi, ç'bëni, estradë?

Leka buzëqeshi.

— Edhe më qesh!

— Po pse, keq e kam? — tha Leka, që u bë gati të largohej.

— Pa prit, prit, — urdhëroi Vangjeli, — edhe e paskeni salduar, pale!...

— Nuk është saldim, — i thashë unë.

— Ti mbaj vendin, — m'u kthye mua, — s'po flet kush me ty.

— Po pse nxehesh? Aty katër pika janë, — u tregova i qetë.

— Të thashë, mos u përziej, më tregoke katër pikat, po pse, pak të duken? Katër sot, katër...

— Katër mot, — ia priti Leka, që me sa u duk e humbi durimin, megjithatë toni se si u shpreh e tregonte të qetë.

— Leka Hysi! — thirri Vangjeli dhe atë çast kapi majën e hundës së tij, që nënkuptonte se Lekës i ishte rritur mendja.

Diçka tha nëpër dhëmbë dhe iku drejt e në zyrë.

— Po ky ç'pati?

Leka nuk u përgjigj, por vazhdoi të punonte. E dija që Vangjeli nuk shkante me Lekën. Dikur ai kishte bërë punën fizike në brigadën tonë e, ngaqë s'vinte rregullisht, në fund Leka i dha vetëm pesëmbëdhjetë ditë.

— Leka, inatçi i madh Vangjeli.

— Ç'ke me të, — tha me buzë në gaz Leka.

Iliri doli nga kova e nisi të qeshte.

— Fshihu edhe një herë, po ta mbajti, — i tha Leka.

Ai përsëri qeshi dhe erdhi të më ndihmonte mua. Dy faqet anësore i kthyem shpejt. Njëren prej tyre e vunë kundrejt erës. Leka mati boshtin qendror dhe nisi saldimin vertikal. Herë-herë ai shkëputej për të marrë frymë lirisht, por edhe këtë e bënte me vështirësi, pasi era e ftohtë i binte drejt e mbi fytyrë.

— Unë ngriva, — tha Iliri.

— Lekës i bie përballë e s'po qahet.

— Leka do të ketë ndonjë rezistencë nën gjoks,  
— tha Iliri duke fërkuar duart.

— Ç'thotë? — pyeti Leka.

— Ka vapë, — u përgjigja unë me shaka, — ka qejf të shkojë në Shkumbin.

— E pse, për peshk?

— Të lahet.

— Shiko, shiko, — bëri Leka buzagaz dhe shkoi të rregullonte aparatën e saldimit. U afrova dhe vështrova me kujdes punën që kishte bërë ai. Metali i shkrirë kishte marrë formën e një gërsheti. Pjesa e sipërme e pllakës llamburiste. Çudi! Ishte bërë gjithë ajo punë dhe nuk kishte rënë mbi të goftë dhe një pikë e vogël skorijeje.

— E paske qarë! — i thashë. — Duket tamam sikur të jetë presuar në fabrikë. — Ai më shkeli syrin i kënaqur e tha:

— Mirë është, po si thamë, e mira s'ka fund.

Në të mbaruar të punës erdhi kryeinxhinieri së

bashku me Vangjelin. Ai kontrolloi punën dhe i rrahë shpatullat Lekës.

— Pajisjen e parë që mbaruat e montuam. Na doli mirë, Leka. Projektin e saj ti e ke? Saktësoje dhe po ai të mbetet edhe si pasaportë për makinerinë. Futi edhe firmën tënde nën të.

— Atë makineri e nise ti, shoku kryeinxhinier, ne...

— Mirë, — e ndërpreu ai, — atëherë le të mbajë firmën e të gjithëve. Të mbarojmë sa më shpejt edhe këtë tjetrën. Na kërkojnë çelik nga të katër anët e Shqipërisë.

— Pothuajse e mbaruam, kryeinxhinier, pastaj diçka kam bërë edhe për zëvendësimin e kushinetës.

— Punove?!

— Pak, punova pak dje.

— Tërë natën, — shtova unë.

Leka tundi kokën si i turpëruar. Vangjeli shkante e vinte rreth kovës, ku kishin mbyllur Ilirin në mëngjes. Ndoshta ai e bënte këtë për t'i tërhequr vëmendjen kryeinxhinierit.

— Po ky djali ç'thotë, — tha kryeinxhinieri duke i shtrënguar damarët e qafës Ilirit. — mërdhin shumë, ë? Megjithatë mund të gjeni ca forma të tjera, — përfundoi ai i qeshur dhe iku. Pas tij shkoi edhe Vangjeli.

— Leka, Vangjeli i paska treguar kryeinxhinierit.

— Për kovën, — tha ai dhe tundi kokën.

Mblodhëm veglat. Mbyllëm barakën dhe u nisëm për në dhomë. Në kantier zhurma e punës kishte rënë. Vetëm një buldozer i madh diku hungërinte.



Me të dalë nga sheshi i hekurt, siç quhet sheshi ku punojmë ne, era u ndie më shumë. Tufa resh, si kapriata gjigante, sikur po i montoheshin qiellit. Një montator i vjetër po thërriste nga larg:

— Leka... Leka Hysi, si u bë ai djali?

— Cili?

— E, mo, ai që punon me ju. Më thanë se e kish-te marrë urgjenca!

— Je në vete? — Leka hapi krahët. — Ja ku e ke, — dhe tregoi Ilirin, që po vraponte për tek urbani.

Bëmë disa hapa në heshtje. Më vinte çudi me qetësinë e Lekës. A dinte të nxehej ky njeri? A e kuptonte se tërë këtë zhurmë e kishte bërë Vangjeli? Patjetër që ai i kishte thënë kryeinxhinierit dhe ja tani i kishte marrë tërë kantieret me radhë. Më han-te inati me veten, po të them të drejtën mora inat edhe Lekën.

— A e dëgjove, — i thashë.

— Punë e madhe, i bën Vangjeli këto, — ma ktheu qetë ai.

— Mos vallë ka ndër mend të njoftojë edhe Mi-nistrinë e Ndërtimit?..., — i thashë.

Leka qeshi me të madhe.

— Pse nxehesh, — më tha.

— A i lejohet Vangjelit të të përflasë ty lart e poshtë?

— Njerëzit kanë mendjen e tyre, pastaj ti e di mirë se Vangjeli ka një kunj të vjetër me mua.

— Që s'i firmose të plotë punën fizike, — i tha-shë.

— E pse, — tha ai i çuditur, — punën s'e bëri të plotë e këtej nga ana tjetër kërkonte hakun tamam.

— Kam qejf ta takosh, — i thashë, — dhe t'i thuash ta mbyllë gojën.

— Është i ngeshëm ai, — më tha, — e këtyre ti-pave bën mirë të mos u shkosh mbas avazit.

— E po lëre pra, lëre të të bëjë biografinë...

— Dëgjo, — më ndërpreu ai, këtë radhë rreptë, — biografinë s'ta bën Vangjeli, por puna dhe shokët e vërtetë.

Më dha dorën. Më shtrëngoi njëherë fort pas vetes dhe u langua.

Tani ndihesha më i qetë. Nuk ia ndava sytë derisa doli matanë kantierit. Trupin e mbante drejt. Shpatulla e djathtë i lëvizte paksa. Çdo lëvizje e tij fliste për qetësi dhe siguri në vetvete. Para disa ditësh kisha dëgjuar në drejtori se Leka Hysi do të ngrihej në përgjegjësi. Mundej që këtë gjë ta kishte dëgjuar edhe Vangjeli dhe ja tani për të larë «bor-xhin» e dikurshëm mundohej të përgatiste një mendim tjetër për Lekën.

Të nesërmen ishte e diel. Kur u zgjova, u ngrita me mendimin se Leka do të kishte ikur në shtëpi me trenin e mëngjesit. Në shtrat nuk ishte. Iliri, pak më tutje, mbi shtratin e tij, ishte mbledhur këmbë e kokë dhe mbi batanijet kishte hedhur edhe xhupin e Lekës.

«Sot do të kënaqet me gjumë Iliri», — thashë. U ktheva në krahun tjetër, por disa goditje sëpate nuk po më linin të qetë. Lëvizja pak perden. Bryma i kishte trashur xhamat dhe sendet matanë tyre dukeshin si hije pa formë. Ndërkohë hyri në dhomë Leka. Ai mbante në dorë një krah dru të prera.

— S'paske ikur?

— Edhe pak punë na ka mbetur, — tha ai. Pse ta lëmë për nesër, bëhet fjalë për çelik, e jo për marmelatë... Ngrihuni, po vë ibrikun të pimë edhe nga një çaj.

Iliri atë çast u përmend. Ngrihti kokën e tha:

— Booobo! Harrove që është e diel sot, usta?

— Çohu — i tha Leka. — Sot ti s'ke as teori as praktikë, po punë vullnetare. — Qeshi. Kapi Ilirin nga shpatulla, e ngrihti peshë dhe me shaka filluan të mundeshin të dy. Iliri përpiqej të mos rrëzohej, qafa e tij nuk ishte më e trashë se llëra e krahut të Lekës.

Pimë çaj dhe u nisëm. Ata të dy do të punonin te pajisja, ndërsa unë shkova në oficinë. Do të merrsha me kushinetën.

Moti sot ishte më i butë. Erë nuk frynte. Qielli ishte i qëruar. Rrezet e porsadala të diellit i ranë brymës përsipër dhe ajo nisi të tretej si sheqeri. Afër drekës pajisja e re ishte gati. Leka, së bashku me një grup shokësh po e montonin. Lajmi që reparti i ri i uzinës së çelikut do të fillonte nga prodhimi, i kishte kaluar shpejt kufijtë e kombinatit. Një gazetar u gjend aty. Ai, pasi e mbushi bllokun mirë e mirë, pyeti se kush quhej Leka Hysi.

— Unë, — iu përgjigj Leka.

Gazetari sepse qeshi.

— Leka, si është ajo historia e kovës?

Leka më hodhi sytë fluturimthi e, kur e pa se mua s'po më mbante më vendi, i futi krahun gazetarit dhe e përcolli matanë uzinës.

— Ta gëzosh, — i thashë kur u kthye, — na, të mori edhe gazeta tani.

— Gázeta ka se ç'merr, e s'merret me budalla-llëqet e Vangjelit, — u përgjigj ai, — po hajde, hajde të montojmë kushinetën.

Pak më vonë erdhën edhe dy shokë të tjerë e na ndihmuan. Isha duke vënë soportin, kur pashë kryeinxhinierin duke ardhur. Pas tij po vinte Vangjeli. Sikur m'u prenë krahët. Leka më ra me bërryl. Kryeinxhinieri ishte i gëzuar. Pas largimit të specialistëve të huaj, ai e mori vetë drejtimin e punimeve në repartin-shtesë. Tani ishte i pushtuar nga ankthi i provës së përgjithshme. A do të justifikohet gjithë ai mund, tërë ajo djersë?

— Si mendon ti, Leka? — e pyeti dhe e përqafoi faqe të gjithëve. Dy makineritë e reja filluan lëvizjen. Heshtja e dikurshme kaloi, humbi, dhe zhurma normale e makinerive i dha jetë repartit të ri të uzinës së çelikut.

Ashtu siç ishim te shkallët e hekurta, duke parë dhe dëgjuar ato lëvizje, ata zëra që kishim krijuar vetë, kryeinxhinieri na përgëzoi. Së fundi ai propozoi që Leka Hysi të kalonte me detyrën e përgjegjësit në këtë repart. Kryeinxhinieri, në një situatë tjetër, s'do të lejonte kurrë që Leka Hysi të shkëputej nga montimi, prej pincës së saldatorit, por ishte i detyruar, të paktën tani për tani. Leka shumë nga pajisjet i kishte projektuar vetë dhe po vetë i kishte montuar.

— ... për sa kohë do të rrijë Leka këtu? — iu përgjigj dikujt kryeinxhinieri, — këtë e di Leka; derisa të përgatitë një si veten.

Ne e aprovuam njëzëri, po dikush në shkallën

e fundit kërkoi të fliste. U zgjata pak dhe pashë Vangjelin.

«Po ky çfarë do të thotë?»

— Kam diçka, — tha ai, — desha të them se dikur ky Leka Hysi... — E mora me mend se ç'donte të thoshte e nuk m'u durua, po ia prita:

— Dikur ky Leka Hysi u theu turinjtë specialistëve të huaj.

— Dakord, — tha ai, — po unë s'desha të thosha këtë, po...

— Thuaj ato që duhen, Vangjel, — e ndërpreu kryeinxhinieri. Disa prej shokëve qeshën dhe nisën të uronin Lekën. Zbrita ta përgëzoja dhe aty dëgjo-va që Leka po i thoshte kryeinxhinierit:

— ... më mirë të kishim caktuar ndonjë shok tjetër.

## LINJA TË LARGËTA

Pranë stacionit të trenit ishte një shtëpi e vogël. Katër plepa të gjatë dhe të hollë e rrethonin atë. Menjëherë pas arës që mbillet gjithnjë me jonxhë, zënë fill apartamentet e reja të qytetit. Në atë shtëpi të vogël banojnë dy vëllezër së bashku me nënën. I ati i djemve, makinisti i vjetër Sandri Dilari, nuk jeton më. Sandri e kishte dashur shumë profesionin e vet, kishte bërë çmos dhe arriti derisa Nikollën, djalin e madh, e bëri makinist. Edhe për të voglin ai po këtë dëshirë kishte, por Edi atëherë s'ishte më shumë se tre vjeç, megjithatë ai lindi dhe u rrit pranë trenave. S'kishte dëshirë tjetër, veçse të bëhej sa më shpejt si i ati dhe si vëllai i madh.

Të gjithë fëmijët e lagjes, ndër lojërat e ndryshme, kanë të përzemërt edhe atë të imitimit të makinave, lëvizjeve dhe zhurmave të tyre, ndërsa i biri i makinistit të vjetër imitonte në mënyrë të habitshme zhurmën dhe fërshëllimat e sirenës së trenit. Atë pasdreke ishin mbledhur rreth tij shumë fëmijë, madje edhe të rritur dhe bënë çudi se si ai djalë i vogël, duke përplasur këmbët mbi trotuar dhe duart mbi gjoksin e tij të njomë, rikrijonte në mënyrë të shkëlqyer çastin e nisjes, apo të ndalimit të

trenit. Aty ishte ndodhur edhe një burrë i moshuar, me një kapelë trenisti në kokë. Ai s'po ia ndante sytë djalit dhe, kur ai mbaroi, i tha:

— I Sandri Dilarit je ti, mor bir?

— Po, — u përgjigj Edi, — i Sandrit jam.

Burri me kapelë trenisti iu afrua, e përqafoi fort-fort dhe e mbajti një hop pranë vetes.

— Babanë tënd e kam pasur shok, — i tha ai, — ka genë makinist i zoti. Ai i donte shumë trenat dhe kishte dëshirë të madhe t'i binte tejtejt Shqipërisë me ta.

I vogli e vështroi me kureshtje.

— Po, po, — vazhdoi burri, — dhe ai do ta arrijë këtë, posi, posi, prandaj e bëri Nikollën makinist, edhe ty makinist donte të të bënte, a ke qejf?

— Kam shumë, — tha buzagaz Edi.

— Të lumtë!

— Nikolla s'më merr asnjëherë me vete, — tha i vogli.

— Nuk të merr! Em. I thuaj të të marrë, se edhe ne ashtu e kemi marrë atë. — Ai i rrahu supet.

Edi i vogël u largua i gëzuar. Tani Nikolla s'kishte si të bënte ndryshe, s'kishte si të mos e dëgjonte fjalën e shokut të babait.

Kur hyri në shtëpi, e gjeti vëllanë e madh duke u larë e, ngaqë s'i durohej, nisi t'ia tregonte të tërë bisedën e regjistruar me aq kujdes në mendjen e vet. Më në fund i tha:

— E, a do të më marrësh me vete?

— Porositë e nënës a i kreve të gjitha, o kolo-puç? — i tha Nikolla dhe e kapi nga faqet.

I vogli ia hoqi duart me zemërim.

— Ou! — bëri Nikolla dhe iku nxitimthi jashtë. Edi e dinte fare mirë se për ku nxitonte i vëllai. Ai e dinte se Nikolla donte Elin, atë vajzën me triko të bardhë. Aty, pranë apartamentit të saj, ai e kishte parë vëllanë e madh disa herë. Edhe kur Edi shkoi të blinte bukë, e pa Nikollën po tek ai vendi ku e shihte përherë. Nuk i ra në sy. Doli në rrugën tjetër dhe erdhi në shtëpi. Nëna po merrej me përgatitjen e darkës dhe, kur erdhi Nikolla, çdo gjë ishte gati. Pas ngrënies ishin të tre në dhomë. Nëna me një punëdore ishte ulur mbi divan. Nikolla kishte zënë vend pranë televizorit. Edi, pasi pastroi tavolinën, i tregoi nënës bisedën që kishte bërë me atë burrin me kapelë trenisti e që ishte shok i vjetër i babait. Ajo buzëqeshi e i tha:

— Ti, Edi, edhe në ëndërr trena shikon, veçse jo me rrota, po sikur ecin me këmbë.

Të tre qeshën. Edi, i gëzuar siç ishte, kërceu nëpër dhomë e tha:

— Nënë, unë di një gjë.

— Çfarë, — bëri ajo me sy të gëzuar.

— Nënë, Nikolla do Elin.

Nëna vështroi e habitur, pastaj u mundua të hiqej sikur s'i dha rëndësi. Nikolla u ngrit nga karrigia.

— Të kam thënë që ti je kalama, ja ç'je!

Edi u turpërua, u skuq deri te veshët dhe i heshur shkoi në dhomën e fjetjes. Nuk ia mori mendja se ajo që tha do të merrej për ters, do ta nxehte Nikollën. Ai mendoi të kundërtën. U shtri dhe ashtu nëpër gjumë ndjeu lëvizjet e Nikollës që ra për të fjetur.



Kur u zgjua, menjëherë sytë i vajtën te shtrati i të vëllait, por ai tashmë kishte kohë që ishte ngrietur. Nikolla punonte me trenin e mallrave dhe ngrihej përherë në tre të natës. Edi lëvizi me përtim. Mëngjesi i verës ishte i pastër dhe i ngrohtë. Rrezet e diellit përshkonin degët e plepave dhe hynin pjerrtas në dhomë. U afrua pranë tavolinës. Ndërkohë u dëgjua në stacion një sirenë e zgjatur.

— Nikolla! — thirri Edi. Ai e dallonte sirenën e lokomotivës së vëllait, sikur dhjetë të atilla të kumbonin njëherësh. Shkoi te dritarja. Mbi pistën e stacionit dukej një tren i gjatë, vagonët e të cilit ishin ngarkuar me trungje, trupa të trashë dhe ata të fundit me mineral të kuq. Herë-herë lokomotiva gulçonte aq rëndë, sa dridheshin edhe xhamat e dritares.

«Ky është treni më i fuqishëm, — mendonte i vogli, — edhe Nikolla i fortë është».

Ai kishte dëgjuar se andej nga kishte ardhur Nikolla tani, kishte pyje të larta dhe male të kuqe. Sa dëshirë kishte të shikonte me sytë e vet male të kuqe! Kishte udhëtuar me tren, po s'kishte parë kurrë vende të tilla, veçse fusha të gjera dhe një kanal prej betoni që s'i ndahej rrugës së hekurt. U dëgjua përsëri sirena dhe zhurma e nisjes. Vagonët parakaluan një e nga një. Djali mbylli dritaren. Mbi tavolinë qëndronte gota me qumësht. Pasi hëngri mëngjesin, mori listën në të cilën e ëma kishte shënuar ushqimet që duheshin për atë ditë dhe u nis për në pazar. Ara me jonxhë ishte mbushur plot flutura dhe karkalecë. Ai i ra mes për mes, duke u vënë në garë me një flutur me krahë kadife. Por edhe kjo lojë nuk zgjati shumë, ngaqë flutura i humbi nga sytë.

Atje, pranë furrës së bukës, ulur mbi një stol, pa atë burrin me kasketë trenisti. Edhe ai e kishte parë, i buzëqeshi dhe e thirri:

— Ti je ai i vogli i Sandri Dilarit, ë? Sa mirë që u takuam përsëri. Të kam djalnin e shokut dhe kam qejf të flas me ty. Po, ti a ke dëshirë?

— Po, — u përgjigj Edi.

— Pra, — bëri ai dhe diçka nxori nga xhepi i brendshëm. — A e di ti, djali i Sandrit, se e kujt është kjo hartë?

— Është e Shqipërisë!, — u përgjigj Edi, — unë këtë e kam mësuar që në të parën.

— Qysh që në të parën?

— Që në klasë të parë, pra.

— Mirë e gjete, po këto vija të zeza, ja këta katrorët e vegjël, a e di ti ç'do të thonë, ë? Hekurudhë. Ja, ndiqe gishtin tim. Deri këtu babai yt me sy mbyllur e drejtonte lokomotivën. Kurse këtej, ja këtej, shkon Nikolla Dilari, yt vëlla. Ti a ke qenë ndonjëherë andej?

— Jo, — e ndërpreu i vogli, — jo, s'kam qenë, po më kanë thënë se andej ka male të kuqe.

— Aaa, — qeshi burri, — male të kuqe. Nuk të paskan gënjyer, jo. Vërtet që andej ka male të tilla, plot me mineral, po andej ka edhe bukuri të tjera: pyje, lumenj, tunele shumë dhe zogj shumë. Kur shkoi treni për herë të parë andej, zogjtë u trembën si të marrosur, kishin frikë. Po tani ata janë bërë miq me trenin.

— E, e, miq me trenin!

— Posi, miq e sidomos kur bie borë.

Edi gjithë kënaqësi i hodhi dorën mbi sup të moshuarit.

— Kurse këtej, — vazhdoi ai me kapelë trenisti, — këtej, ja, e sheh ç'lexon këtu? Bukuri! O, sa qytet i madh dhe i bukur. Ti, ke qenë? S'paske qenë. Po, sa bukuri ka rruga derisa të mbërrish atje, qytete të mëdha plot fabrika, fshatra me rrush dhe fëmijë të pastër, veshur me të bardha, si pëllumbat.

— Ti paske parë shumë gjëra të bukura! — i tha Edi.

— Po edhe sa të tjera ka, — u përgjigj ai, — kudo, kudo, në Jug e në Veri. Si e ke emrin?

— Edi.

— Mirë, ja, pra, këto vende të bukura, Jug e Veri, do t'i kalojë me trenin e vet djali i vogël i Sandri Dilarit. E, po do të bisedojmë, do të flasim.

— Po unë s'do të kem kohë, — tha Edi.

— E pse?

— Unë do të jem makinist i rrugëve të largëta.

— Kur?

— Atëherë pra...

Burri e përqafoi fort.

— Po a nuk do të më marrësh me vete?

— Do të të marr, gjithnjë do të të marr, — tha seriozisht Edi i vogël.

I dhanë dorën njëri-tjetrit. Djali mori trastën me ushqime dhe u nis për në shtëpi. E ndiente veten të gëzuar. Mundohej të sillte ndër mend të gjitha ato çka i tregoi ai burri me kapelë trenisti.

Dikush nga shokët e ftoi të luanin, por ai s'pranoi: Si mund të bridhte kot së koti ai makinist i linjave të largëta? Rruga e gjerë dhe e drejtë i du-

kej si tren i gjatë, pa mbarim, që priste të nisej nga çasti në çast nëpër ato vende ku malet mbanin mineral të kuq dhe zogjtë ishin miq të trenave, nëpër ato vende me qytete të mëdha e plot fabrika, andej nga dukeshin fëmijët si pëllumba. Aty nga fundi i rrugës, para se të dilte përballë shtëpisë së tij, gati sa nuk u përplas me dy vajza. Njërën prej tyre e njohu menjëherë, ishte Eli. Ngadalësoi hapat. Gjithmonë s'guxonte t'i dilte në sy asaj, sepse i vinte turp. Por atë ditë nuk mundi t'i shmangej, jo, s'deshi që t'i fshihej. Ai dëgjoi që Eli zuri në gojë emrin e vëllait të tij.

«Sa e bukur është Eli, por edhe Nikolla ashtu është», — tha ai duke ndjekur lehtë-lehtë vajzat. Pastaj dëgjoi që Eli i tha shoqes:

— Nikolla, moj, ai makinisti, më është qepur si ferrë.

«... Si ferrë!» — bëri Edi i shtangur. S'po mundte të kuptonte më gjatë veçse kur dëgjoi përsëri zërin eELIT.

— Ai është makinist. Në hyrjen tonë ka ardhur një inxhinier i ri. Sa i bukur që është!

Atëherë djali i vogël s'pati nevojë dhe as që donte të dëgjonte se ç'mund të thoshte ajo. Qëndroi dhe nëpër dhëmbë tha: «symace, flokëpresh, trikon e bardhë e ke pis. Nikolla nuk të do, jo, ai nuk të do ty. Nikolla është makinist. Është makinist. Ti s'je asgjë. Sa vende të bukura ka parë ai! Shkelja, Nikolla!» Dhe djali ia nisi një vrapi të shpejtë, duke imituar herë-herë sirenën, ndalesat dhe nisjet e trenit. Hyri në shtëpi. Pasi rregulloi ushqimet në bufe, iu kujtuan përsëri ato fjalët që kishte thënë Eli.

«Do t'i them Nikollës, — tha, po ai do të nxe-  
het? Nuk do të më marrë me vete. Mirë, s'po ia  
them.»

Mbylli derën e doli jashtë. Ishte vapë e madhe.  
Asnjë nga shokët e tij nuk dukej përçark. Ata kishin  
shkuar në lumë. Edi u shtri nën hijen e plepave.  
Aty ishte freskët dhe e zuri gjumi. E zgjoi zëri i Ni-  
kollës që kërkonte çelësin. U ngrit dhe vrapoi tek  
ai. Nikolla, me të hyrë brenda, nisi të lahej shpejt  
e shpejt. Vëllai i vogël i ndiqte me ankth lëvizjet  
e të madhit. Edi vendosi t'i tregonte Nikollës, nuk  
donte që ai të shkonte të priste atje, përkarshi apar-  
tamentit të saj.

— Nikolla! — tha ai.

Po tjetri bëri sikur s'dëgjoi.

— Nikolla! — thirri më fort.

— E, — iu kthye ky, — a i mbarove të gjitha po-  
rositë e nënës?

I vogli heshti. Nikolla, që donte ta zgjaste më  
tepër shakanë, mori pak ujë dhe u bë gati ta lagte,  
por pa se vëllai i vogël nuk kishte atë pezmatimin  
e zakonit, po diçka më shumë, si inat, si përbuzje.

— Edi, ç'ke? — pyeti ai duke shkundur duart  
poshtë.

— Unë do të të them një gjë ty. Nikolla, po ti  
s'duhet të inatosesh. — Tjetri qeshi dhe vazhdoi të  
fshihej.

— Nuk do të inatosesh?

— Jo, jo, po hë...

— Eli nuk të do ty, Nikolla.

Vëllai i madh e vështroi i habitur.

— Po, — tha ai, — unë e dëgjova vetë.

— Çfarë dëgjove? — foli rreptë i madhi.

I vogli u tut një çast, po pastaj s'mundi të heshte.

— Ajo tha se ti je ferrë, se ti je makinist, se në apartamentin e saj ka vajtur një inxhinier i bukur...

Nikolla flaku peshqirin mbi dysHEME. Shkonte e vinte tërë nerva. Edī e ndiqte i frikësuar, po tjetri s'kishte gjë me të.

— Ferrë, — tha, — ë, kështu, ferrë!? Unë ferrë?!

Hapi dritaren dhe vështroi andej nga ishte apartamenti i vajzës. I erdhi inat e deshi të thërriste:

«Eli, në djall të vesh ti dhe ai inxhinieri, po të ketë mendjen tënde», — përplasi dritaren dhe u largua. Përsëri nisi të ecte nëpër dhomë. Kishte marrë inat të madh.

«Makinist, — thoshte, — em, — qenkam bërë ferrë, a, a... a». U ra duarve fort dhe iu kthye të voglit:

— A, e dëgjove, ë? Ke qejf të bëhesh si... si ferrë?

— Jo, — u përgjigj Edī, pa u tutur, — jo, s'kam qejf të bëhem ferrë.

— Po ti ke qejf të bëhesh makinist?

— Shumë kam qejf, — tha i vogli, — shumë, dua të bëhem si babai, si ti. Dua të shoh ato vendet e bukura. Ajo Eli s'ka parë asgjë. Makinistët nuk e duan atë, as unë s'kam për ta hipur në trenin tim.

Nikolla u shtang një çast. Ç'po fliste ky kolopuç këtu para tij? Edī ishte, a kush? Vëllai i madh vuri buzën në gaz dhe hapi krahët. I vogli iu turr dhe e përqafoi.

— Do të bëhesh makinist, — i tha serioz Nikolla, — mirë atëherë, që nesër do të të marr me vete. Të jap fjalën si burri burrit.

## ERËRAT SILLNIN NJË KUJTIM

Tekniku i pyjeve dhe shoferi rrinin pranë dritares. Reflekset e dritës zgjateshin deri matanë, te pisha e madhe. Flokët e borës si boçe pambuku binin butë-butë mbi tokë. Neziri, një punëtor i vjetër, fshatar nga ato anë, po përpiquej të ndizte stufën. Futi një krah dru, i hodhi gati një shishe vajguri dhe, pasi shpërtheu flaka, tha gjithë gëzim:

— Bora e parë i bën të gjithë si fëmijë.

Tekniku qeshi lehtë, ndërsa shoferi, gati ëndërrimtar, shikonte borën që zbardhi shumë shpejt. Ai herë-herë mermëriste diçka.

— Besim! — i thirri Neziri shoferit. — Besim, mjaft duke u menduar, po hajde, afrohu të ngrohesh, se të është skuqur maja e hundës si lafshë gjeli. — Besimi qeshi.

— A e di, Nezir, gjithmonë bora e parë më kujton diçka, që nuk do ta harroj kurrë.

— Edhe mua, — u hodh e tha tekniku duke shkuar pranë stufës.

— Po hë?... Ç'na qenka ky kujtimi yt? — ia priti si gjithnjë Neziri, kur tekniku i pyjeve bëhej gati të rrëfente diçka për veten, ose për dikë tjetër.

Tekniku mori një afsh të ngrohtë, se pse buzëqeshi dhe ia nisi:

— Atëherë isha në vitin e fundit të shkollës së mesme. Atë mëngjes qyteti u gdhi plot borë. E, siç dihet, të gjithë dëshirojnë të...

— Bjeri shkurt, — tha Neziri, që po tymoste një cigare të trashë sa gishti.

— E pra, — tekniku i shkeli syrin Besimit, — para meje ishte një grup vajzash. Njërën prej tyre doja ta qëlloja. Dhe, kur m'u dha rasti, e godita te supi. Ajo ktheu kokën. Po ç'të shihja?! Ajo s'ishte vajza që kisha kujtuar unë, por mësuesja e letërsisë...

Besimi qeshi me të madhe, ndërsa Neziri tha seriozisht:

— Ja ç'vepër ka bërë. Sot e dy vjet të shkuar që ka mbaruar shkollën biri i botës dhe po firifiu. Ja me ç'kujtime e ushqen veten ky!

Tekniku, që tashmë ishte mësuar me Nezirin, nuk i merrte asgjë për keq atij, dhe atë çast qeshi dhe ai bashkë me Besimin.

Së fundi tekniku iu lut Besimit që të tregonte edhe ai kujtimin e vet.

— S'është kushedi çfarë, — tha Besimi.

— Vë dorën në zjarr, si i këtij nuk është, — tha Neziri.

Qeshën të tre. Pastaj Besimi filloi të tregonte:

— Atë vit unë punoja në Çermenikë. Transportim dru. Shtator ishte, fund muaji si tani. Atë ditë nuk kisha qenë mirë e sidomos në mbrëmje, kur po kthehesha për në sektor. Më kishin kapur një palë ethe që edhe dhëmbët më kërcitnin. Duart mbi timon



më rrëshqitnin sikur t'i kisha lyer me graso. S'po mendoja për gjë tjetër, veçse të arrija sa më shpejt, të rregulloja makinën dhe të shtrihesha. S'kisha fuqi fare, vëllezër! Me të mbërritur, ashtu bëra. Nëpër sheshin e sektorit, ulur grupe-grupe, rrinin punëtorët. Ishte e shtunë dhe ata, si çdo fund jave, shkonin pranë familjeve të tyre. Shumica ishin nga Gështenjasi, të tjerët nga fshatrat aty rrotull. Po prisnin makinën e mirëmbajtjes. Kot prisnin dhe këtë unë e dija fare mirë, se, poshtë në luginë, e pushë atë makinë të prishur. Porsa më panë që unë hyra në shesh sikur u gjallëruan, po kjo nuk zgjati shumë dhe mërzitja e pritjes i pushtoi përsëri. Anës barakës ku hyra unë qëndronin tre burra. Ai i shkurtri, me mushama prej lëkure, ishte Rrema. Njeri që i peshonte fjala. Thoshin se së shpejti do të bëhej përgjegjës sektori. Në krah të tij, Samiu, një fshatar i gjatë dhe shumë i fuqishëm. Me tri të rëna edhe ahun më të trashë e paloste përtokë. Ai që rrinte pak mënjane ishte Musta, hollak dhe me një hundë që i takonte te mjekra. Të gjithë e thërritnin «urithi». As nuk i përshëndeta, po nxitimthi hyra brenda. U shtriva dhe hodha mbi vete ç'kishte e ç'nuk kishte aty. Digjesha. I mbledhur kokë e këmbë, diçka më kapi veshi:

«Shko, o Rremë, shko thuaj Besimit...» — Ishte zëri i Samiut.

«Duan urdhra këto punë, e Rrema s'është bërë ende përgjegjës», — foli këtë radhë Musta.

«Hëm... — bëri Rrema, — nuk është puna për urdhër.»

«E, pra, hidhu shko», — ironizoi Musta.

Pas pak ndjeva hapjen e derës dhe hapat e Rremës. Po, me sa u duk, ai e hetoi gjendjen time dhe doli përsëri.

«Ju thashë!» — tha Musta.

«Eh..., — psherëtiu Samiu, — kam merakun e nënës, e lashë të sëmurë e...»

«Mbledhim nga dy lekë dhe...», — propozoi Musta.

Nuk munda të dëgjoja më. Kjo fjalë më erdhi plumb e rëndë e sikur m'u var në vesh. Ç'më pandehte mua urithi?! Unë i njihja fare mirë të tre, edhe Mustën e njihja, si i thonë fjalës, me dhëmbë e dhëmballë, e dija se i biri i kujt ishte, i dija edhe marrëzitë e tij fiqe për pe. Pse fliste ashtu ai? Mirë Musta, po ata dy të tjerët pse heshtnin, kur e dinin si unë me kë kishin të bënë! I mbanin iso Mustës?! Bukur, për nder. Por isha gabuar. Ngaqë ziejja i tëri nga inati, s'e kisha dëgjuar se cili prej atyre dy të tjerëve i ishte kundërvënë Mustës.

«Unë qava hallin e Samiut, ai ka merakun e nënës», — foli urithi.

«Shiko, shiko, — qesëndisi Samiu, — t'u dogj baruku ty.»

«I ka ngjarë të atit, — tha Rrema, — se edhe ai, kur hante dreka e darka me ata petullaxhinjtë e Ballit, mendjen te populli e kishte.» — Vetvetiu unë isha ngritur nga shtrati.

Do t'i shpie, thashë, deri në Gështenjas, dy orë rrugë janë. E, për kaq kohë, sikur veten me dhëmbë të ha, do të duroj. Si Samiu mund të ketë edhe ndonjë tjetër. Njerëz jemi. Kemi familje, shtëpi. Kallëpi i urithit s'e do gëzimin e shtëpisë sonë.

Hodha xhupin krahëve e dola jashtë. Zhurma e motorit të sapondezur e gjallëroi sheshin. Punëtorët

u ngritën dhe nisën të thërritnin njëri-tjetrin me zë të lartë.

«Ejani, — bëra zë unë,— oburrani.» — Ata u gëzuan dhe vrapuan gati si fëmijë. Nja pesë prej tyre, për shaka, thirrën njëzëri emrin tim. Njëpërmjet dritave dallova Rremën dhe Samiun. U bëra shenjë që të hipnin në kabinë. Rrema më përshëndeti, ndërsa Samiu, duke u kërrusur pak, tha:

«Të ramë kot më qafë, Beso.»

«E po, nga halli», — fola duke i nënqeshur Rremës.

«Ti u dridhkërke si purteka, xhan i vëllait, të paska mbërthyer keq!»

«Do të kalojë», — thashë.

«Nuk u bë kiameti, — vazhdoi Samiu, — shkonim nesër.»

«Ne u nisëm dhe tani na qoftë rruga mbarë!» — ndërhyri Rrema duke më rënë lehtë mbi shpatulla.

Shtova shpejtësinë. Filluan kthesat e para. Makina hera-herës lëkundej, po megjithatë, sa vinte e timonin po e zotëroja më mirë. Më kapte ndonjë e dridhur e fortë, po e kaloja duke u shtrënguar e duke peshuar mbi timon. Djersa edhe sytë po m'i mbulonte, vëllezër, po bëja çmos që ata të dy të mos më vinin re. Pasiguria dhe mosbesimi i udhëtarit vijnë, edhe sikur një kollë të dëgjojë prej shoferit. S'ka gjë më të rëndë për ne të timonit, sesa kur ai që kemi në krah rri si më gjemba, sikur të ketë lepurin në bark.

Herë-herë gjeja diçka për të folur. Ata mezi e prisnin këtë çast e më përgjigjeshin, madje gjerë e gjatë. E niste Rrema, pastaj e vazhdonte Samiu. Me

një fjalë, siç themi ne, s'i binin mes për mes, po rreth e rreth unazës...

...Stufa kërciste tak-tak si një sahat muri. Nezi-ri, i bërë flakë prej nxehtësisë, drodhi edhe një ci-gare tjetër, kurse tekniku, i mbështetur me të dy bërrylat mbi tavolinë, dëgjonte me sy e veshë drejt Besimit, sikur të dëgjonte një përrallë të çuditshme.

...Pra kishim dalë sipër, në Qafën e Gurprerës. Një qafë e keqe, që zor se ia gjen shoqen. Nuk e di a ju ka rastisur ta shihni. Të qëndron maja e shkëm-bit si shtizë mbi kokë, pale po të hedhësh sytë poshtë, të merren mendtë dhe të mblidhet një lëmsh mu në bark. Ja tamam aty, një perde e hirtë më mbuloi xhamin dhe s'po shihja mirë.

«Shi!» — thashë.

«Ky s'është shi, — u përgjigj Rrema, — pa shih njëherë përpara dritave.» — Jashtë vërtitëshin e hi-dhnin valle pikla të bardha bore, si cifla letre të he-dhura në ajër.

«Borë, po, kjo është borë! — u habita. — Kaq shpejt bora këtë vit!?»

«Edhe qëllon», — tha Rrema.

«Shumë rrallë», — tha Samiu.

«More, a jemi në shtator, a çfarë?!» — dhe flu-turimthi më erdhi ndër mend që duhej të kthehe-sha në sektor po atë natë. Ndërkohë makina u lë-kund para-prapa.

«Ç'ke?» — pyeti Rrema.

«Mos u mërzit, — tha Samiu, — mos u mërzit, Be-so, se në shtëpi po shkojmë.»

Duhet të kthehem patjetër, fola unë, patjetër.

Sikur edhe dy gisht të bjerë, makina këtej të blloko-  
het dy muaj...

M'u kujtua përsëri kthimi, Gurprera, të cilën ta-  
ni sa po e zbritja. Po kur të kthehesha, aa, tjetër  
hall. Në ngjitje, aq më shumë që, po të kishte zënë  
pak borë, vështirësia rritej edhe dy herë. Ndjeva përsëri  
shtrëngesë në gjoks dhe një gogësimë ma mbushi  
gojën me një lëng në shije të bakrit.

Ndërkohë burrat, që kishin hipur në karroceri,  
ia nisën një kënge. Dhe sa u ka lezet kënga atyre  
fshatarëve! Bora binte shtruar dhe ata këndonin. Kë-  
nga sikur mblidhej dalngadalë me atë bardhësinë që  
rrekej me terrin pis të natës. Kur e këndonin të gjit-  
htë burrat, të dukej sikur frynte shtrëngata. Lëkun-  
deshin pishat, kërciste pylli dhe honet thika e rrë-  
pira e zgjatnin ison maleve. Po refreni?! Ç't'ju them,  
vëllezër. Kënga sikur vinte e bënte vend në zemër.  
Të pushtonte një mall i madh dhe sikur nga çdo qe-  
lizë të buronte dashuria për jetën. Nuk e dija atë  
këngë. Por refrenin e mësova shumë shpejt.

*Çermenika ka lëshu kushtrimin,  
nji ne jemi me Partinë,  
Enver Hoxhës i kemi dhanë besën,  
lejmë e vdesim për Shqipninë.*

As nuk di të këndo, por, t'ju them të drejtën,  
atë natë zëri im po më pëlqente tepër.

Nuk i hoqa nga goja ato vargje. Qofsha i ga-  
buar, por kënga nuk ka dalë për t'u kënduar vetëm  
ndër dasma. Ja, unë këndoja, këndonin edhe ata bu-  
rrat e tjerë, dhe e ndieja veten të fortë. Ç'u bëne

ato të dridhura, kur iku tërë ajo djersë?! Dhimbja po matej me forcën. S'ka më mirë kur vepron kësh-tu. Ndryshe, pak ta lëshosh veten, vjen e qullësh si brumi.

Të dhënë pas këngës, e kaluam Gurprerën për bukuri. Po gjatë kthimit?

«Do ta kaloj patjetër,» — fola me zë.

«Si the?» — pyeti Rrema.

«Ju, çermenikasit, keni këngë të bukura,» — ndër-rova bisedë. Kjo u pëlqeu atyre të dyve. Më vësh-truan me dashuri mua e pastaj njëri-tjetrin.

«Ilaç i kemi,» — tha Rrema.

Unë e kapa domethënien e asaj fjale dhe qesha.

«Tani ti, Beso, e ndien veten mirë, pa shih, pa shih, po të përskuqen faqet,» — foli Samiu.

Lehtë mora kthesën e fundit dhe makina mori udhën e përroit. Një çift lepujsh, i befasuar nga dri-tat, ia dha vrapit duke lënë gjurmë të vogla, të çrregullta mbi shtresën e bardhë e të butë, që sapo kishte nisur të pushtonte tokën. U dëgjuan të lehura qensh me shakullimë. Njëri syresh vinte e zgërdhin-te dhëmbët e bardhë e të mëdhenj si çataj, gati mu pranë rrotës së parë në krahun e majtë. Pas pak u dukën dritat e fshatit, të cilat ngjanin si pishtarë të vegjël, të ndezur aty, në atë faqe mali. Pranë një sheshi ndaluam. Të gjithë filluan të kërcenin në tokë.

«Shiko, shiko, Mustë urithi po ikën brinjazi! — tha Samiu. — E bëri hak këtë panxhën time ai... po ç'e do, nuk ia...»

«E qëlloi Besimi, — e ndërpreu Rrema. Si thua, Sami, a s'është goditje e fortë kjo që bëri Besimi?

Unë isha hedhur në tokë dhe po tërhiqja zin-

xhirët nga karrocëria. Tani, pa ta nuk mund të bëje një rrotë më tutje.

«Ç'bën?!» — tha njëri nga punëtorët, ndërsa një tjetër m'i hoqi zinxhirët nga dora.

«S'ke ku të shkosh tani natën, — tha ai i pari, — ç'kujton ti, se ne nuk kemi shtëpi këtu, po hajde... O Rremë, a e sheh», — ngriti zërin ai.

«E bëmë njëherë atë bisedë, — tha Rrema, — është e pamundur të rrijë, në qoftë se s'duam ta izolojmë makinën këtu.»

«Mirë, xhanëm, po si? Beso, po qysh?» — ia bëri Samiu.

Punëtorët u tërhoqën dhe nisën të më ndihmonin. Shumë shpejt i vendosëm zinxhirët. Unë hipa dhe ndeza motorin.

«Prit, prit, të shkretën, do të vij edhe unë me ty», — tha Samiu.

«Ku, në sektor?!»

«Po, natë është... Rruga...»

«Jo, — e ndërpreva, — s'ke pse të vish. Makina një timon ka. Ti s'ke besim tek unë? — e ngrita zërin. — Po ju, shokë, s'keni besim?»

«S'është fjala aty», — tha Rrema.

«Epo... atëherë... natën...»

I rashë borisë. Makina mori më të djathtë. Bora binte qetë-qetë. Hyra në përrua. Nata këtej ishte pus. Qetësi e madhe, qetësi e shurdhët. Asgjë s'pipërinte. Ndoshta këtë e shtonte më shumë ajo rënia e borës me copa të mëdha, gati sa një pëllëmbë fëmije. I bija borisë shpesh. Jehona e atij tingulli të gjatë e thyente atë heshtje të mörzishme e më shndërrohej në zëra njerëzish. Kurrë s'kam pasur qejf të

udhëtoj vetëm. Prania e një njeriu aty në kabinë, sikur i jep një kuptim më të madh punës sonë.

Para se të filloja ngjijtjen e Gurprerës, ndalova dhe fillova të kërkoja me sy majën e saj. Po çne. Ishte njësoj sikur të kërkoje një gjilpërë në kashtë. Vetvetiu nëpër mend e pastaj me një zë të ëmbël, nisa të këndoja. Dalngadalë m'u bë sikur njerëz të tjerë po më shoqëronin mua. Erdhi e u bë një kor i vërtetë. Më kishte fluturuar mendja dhe kjo më bëri të qeshja, më bëri me humor. Në të tilla raste është i domosdoshëm guximi. Me këtë ndjenjë të re lëvizja shpejt, ndërrova marshin dhe i dhashë gaz makinës.

«Hajde, nuse, para!» — thirra.

Ajo u lëkund paksa dhe u nis. Vështirësitë le të jenë çfarëdo, po ato do të kalohen. Mjafton t'i shikosh drejt e në sy, t'u kthesh gjoksin dhe shpatën e mendjes ta mprehësh në të dyja anët.

Ngjitesha. «Kujdes, kujdes», si përgjigje më vinte uturima e ëmbël e motorit. «Djathtas... gremina... një pus skëterrë, i pafund! Mjaft... S'duhet folur më shumë, por duhet vepruar». Ndërrova marshin. Bora po shtohet. Përpara kishte një rrëke të madhe, tanimë të zhdukur krejtësisht nga ajo bardhësi e padurueshme. U ndie vetëm një sforcim kur kalova mbi të. Zinxhirët e lehtësuan kalimin. Mbi gjysmën e së përpjetës fillonte një pjesë rruge e përbërë prej shtresash të holla shkëmbi. Ja, aty makina rënkoj fort dhe mua m'u ngjeth mishi. Tronditjet u ndien edhe mbi timon. Shtova gazin, po u shtuan edhe rënkimet. Bëra një lojë dritash fare kot. Copat e borës zinin vend lehtë mbi xham. Natá zmadhonte kufijtë e vet. I dhashë përsëri makinës, por ajo



s'po shkulej nga vendi. Xhironte. Vetëm xhironte. Herën tjetër u dëgjua qartë vërshëllima e gomave. Pastaj ajo klithje e tmerrshme zbriti dhe humbi në humnerë. U ngatërrova pak si tepër. Edhe një herë bëra përçapje. Gomat kishin larguar borën dhe nën to ishte formuar një shtresë e lëngëzuar dhe e rrëshqitshme. Po zinxhirët?! Atë çast zhurma e tyre më rrëqethi. U këputën! Kjo s'duhej të ndodhte. I rashë fort timonit. Ç'të bëja? Të frenoja e të shikoja ç'kishte ndodhur? Kjo s'do të më falej. Frenimi në borë e sidomos në atë vend, ishte vetë vdekja. T'i jepja pak prapa? Dy pëllëmbë nga rrota e prapme fillonte gremina... rrokullisja... Si të veproja?! Duhet vepruar shpejt. prandaj, i qetë dhe i saktë në lëvizje, vendosa ta ngjitja me marsh tjetër të përpjetën. Po në ndërrim e sipër makina m'u fik. Nisi të rrëshqiste. Ç'të bëja... ç'të bëja? Të hidhesha? Po makina!? Unë mund ta shpëtoja kokën ndërsa asaj... as nam as nishan s'do t'i gjendej. E, kjo ishte e rëndë, vëllezër. Ju betohem, për kokën e djalit të vetëm, vetëm për fatin e saj mendova, kjo më shtyu të hapja derën e të kërceja fluturimthi mbi tokë. Mbështeta duart mbi një gur. që në ndonjë rast tjetër zor se do ta luanin tre burra. I dhashë fort. e lëviza, po më mori me vete, më rrokullisi. Duart m'u copëtuan, po s'po i ndahesha. E lëviza paksa, me mendimin se rrota e djathtë do të shkiste e do të ndalonte mbi të. Shikimi m'u turbullua. Makina i shëmbëllente një maceje të zezë, të lëvizshme. Me shpejtësi i vura shpatullat gurit, por atë çast ndjeva mbi kurriz një tronditje tërmeti. «Ndaloi?! Ndaloi!» — thirra me sa më hante zëri.

U hodha përperjetë. S'më mbante vendi. Një gjë më kërkonte zemra atë çast, vëllezër, të kisha njerëz pranë, t'i puthja, t'i përqafoja. E sa rritet pesha e jetës, vëllezërit e mi, kur rrezikut i ke dhënë shkelmin! Makinën e kisha pranë. Zgjata krahët drejt saj dhe aty mbi motor mbështeta gjoksin, ndërsa buzët i vura mbi xhamin e akullt. E putha, e putha, vëllezër. I kisha shpëtuar jetën asaj, kisha shpëtuar nderin tim, jetën time. Gjykojeni si të doni, vëllezër, po dy pika lot më rrodhën nëpër faqe në ato çaste.

Besimi heshti... e pastaj Neziri tha:

— Ja, këtij i them kujtim unë...

— Zjarri qenka fikur fare, — tha Besimi.

Pas pak ata ranë të flinin. Jashtë binte borë dhe frynin erëra të ftohta.

## B E L T A R E T

Me nisjen e dimrit fillonte dhe shtegtimi. Nuk ishte shtegtim zogjsh, me një fije bari në sqep, drejt vendeve të ngrohta. Ishte shtegtim njerëzish, me një fjalë mallkimi në gojë dhe me zemrën e çarë më dysh.

— Si mos më keq, — foli i pari Ago Tafili. Kjo fjalë thuhej çdo vit, aty nga fundi i vjeshtës së tretë, kur ata fillonin nisjen. Mund të ndryshonin gojë të që e flitnin, se njerëzit, derisa lindin, edhe vdesin, por ajo fjalë që mbaronte me psherëtimë nuk ndryshoi. Brodhi si e hazdisur nga viti në vit dhe erdhi pa u ndryshuar aspak edhe në fundin e vjeshtës së tretë të 1938-s.

Ata ishin të tre fshatarë. Më i madhi ishte Agoja. Më i vogli ishte Nuriu. Në torbat e dhirta kishin futur belat e rëndë e nga një copë bukë misri, që ishte bërë gur nga të ftohtët e egër. Shkonin për të punuar larg, shumë larg. Kur në malet e tyre çelte lule kumbulla, atje ku venin ata niste të vilej rrushi.

Kishin një ditë dhe një natë që ishin larguar nga shtëpitë e tyre, po malli po i zhuriste sikur të kishin një mot të tërë.

«I rëndë është fillimi, — mendoi Ago Tafili e

vazhdoi: — Po, e gjithë koha larg shtëpisë është po aq e rëndë.»

Agoja dhe ai që vinte pas tij me moshë, Selami, e dinin ç'i priste. Do të zbritnin në qytet. Aty do të takonin Meliha hanëmin e Idriz beut. Vetë beu e kishte lënë tregtinë e argatëve e kishte filluar një më me leverdi, atë të duhanit. Hanëmi i kishte kaluar edhe dy gurë më tej beut. Në qoftë se ai të shikonte nga shpatullat dhe pulpët e këmbëve, kjo femër-pelë, siç e quante Ago Tafili, të shikonte më tej, deri te dhëmbët. Të shënonte emrin në listë e të niste për te pronari i gjoleve të Marinës, i cili për çdo trup të shëndoshë i dërgonte hanëmit një shpërblim plus.

Ago Tafili u drodh, u frikësua. Mos vallë këtë vit ishte dobësuar dhe hanëmi e kthente prapë? E, atëherë!..

Të kthehej në malet e tij. Ç'të bënte? Të ngrinte duart drejt qiellit? Apo të bënte si atë vit që e pagoi me të rrahura, kur i dërgoi «falë me shëndet» nënës së mbretit dhe soj e sorollopit të saj?

Dy burrat s'e kishin të vështirë t'i shkonin me hamendje deri në fund rrugës së saponisur, kurse Nuriu, ai e bënte për herë të parë këtë udhë dhe s'dinte ç'e priste. Agoja dhe Selami ishin brazduar nga rrudhat deri te cepat e buzëve. Nuriu vetëtinte. Flokët të verdhë, kurse sytë të gjelbër e të ndritshëm ngjanin si një livadh në mes të borës. Fytyra e bukur e djalit dhe trupi i tij plot gjallëri, ishin për dy më të vjetrit si një pranverëz në atë dimër të keq. Prania e Nuriut s'ishte vetëm prania e bashkëfshatarit, por edhe e rinisë së tyre, e vetë jetës në fillimin e

saj të bukur. Te Nuriu ata shikonin djalin, vajzën, për të cilët kishin marrë këtë rrugë të mundimshme, që po ua brente jetën keqas, si krimbi mollën. Nuriu heshtte. S'ishte vetëm e panjohura që e priste. Shpesh i kujtohej i ati, Aliu, i cili u nis një vit më parë e s'u kthye më. Tani djalit i rëndonte në shpirt porosia e s'ëmës, që të gjente patjetër varrin.

Nata e dytë e zuri në qytet. Qyteti natën i ngjante një bualli të zi, të shtrirë përtokë, mbi trupin e të cilit, tek-tuk, kishin vënë ndonjë qiri të ndezur. Ato pika verdhacuke dritash ngjallnin trishtim. Hynë në rrugën e zejtarëve dhe u drejtuan në strehën e tyre, pranë mureve të ngrohta të punishteve. Aty do ta gdhinin derisa të vinte Meliha hanëmi. Ishte ftohtë. Era rrihte krahët si e tërbuar dhe kokat e selive përqaseshin mbi cipën sterrë të natës. Të tre, nëpër terr, kërkonin me duar murin e ngrohtë të ndonjë kovaçhane, që ishte shuar vonë.

— E gjeta, — tha Selami, — e gjeta! — dhe papritur u këput e ra. Dy të tjerët e kapën dhe e mbështetën pas murit.

— Ago, — pëshpëriti Selami, — zor se e nxjerr këtë vit!

— Selam, — thirri Agoja.

Por tjetri, edhe pse e kapi tonin qortues, vazhdoi të tijën:

— Gjithë verës në shtëpi veshkat më pikuan gjak, ndërsa në gjëlet e Marinës gjaku nuk do të pikojë, nuk do të pikojë, Ago, por do të rrjedhë, dhe atëherë... — Selami heshti. Vështroi Agon e pastaj Nuriun. Pikëllimi në fytyrën e djalit e mundi. U

pendua që foli aq gjatë. Burri duhet ta burrërojë më të riun e jo...

— Qetësohu, Selam, qetësohu, — i foli Agoja. Selami vuri lehtë buzën në gaz. Ajo s'ishte e qeshur, por një përqeshje, njëfarë mallkimi për fatin e tij të keq. Nuk u ndie më.

— Xha Ago, — e pyeti Nuriu, — a ka shumë kohë që bredh njeriu me torbën në krah për bukën e gojës?

— Po, bir, shumë.

— Po gjithmonë kështu do të bredhim ne? Gjithmonë me copën e hekurit në torbë? — Ai nxori nga torba belin, të vetmen pasuri të trashëguar nga i ati i vdekur, dhe e hodhi përpara këmbëve.

— Merre, Nuri, — tha Agoja.

— Gjithmonë me këtë? — përsëriti djali duke e futur hekurin në torbë.

— Këtë nuk e di, — tha Agoja. — Një moti i bëmë letër qeverisë, e vuri edhe yt atë gishtin në të, por qeveria tha se s'ka punë. Djalli ta marrë, biri im, a hahesh dot me të?!

Sytë e bukur të djalit u bënë si dy gjole të errëta të vogla. Balli i lartë iu preh nga viza të imta. I ishte kujtuar i ati, dhe ai po këtë fjalë thoshte, bile shtonte edhe diçka më shumë: të mos hahesh me qeverinë, se pastaj, të kafshon mbreti. Në përfytyrimin e Nuriut të vogël mbreti ngrihej me trajtat e qenit. Po me rritjen e tij përfytyrimet bëheshin më reale. Vetëm se një vit më parë, kur mori vesh vdekjen e të atit, mbreti iu shfaq, çuditërisht, përsëri në trajtat e qenit.

— A s'është më mirë të vdesim ndër shtëpitë tona? — tha djali.

— Jo, bir, jo vdekje!...

Ago Tafili e mbajti frymën. Ta thoshte vetë atë fjalë, do t'i dukej shumë e zakonitë por, kur e dëgjoi nga goja e të riut, i erdhi plumb e rëndë. Nuk i foli djalit, por e mendoi se shumë shpejt rinia dhe bukuria e tij do të thyhej më dysh, ashtu si ajo e Agos, e Selamit dhe e shumë bëltarëve të tjerë.

«Ja si prishet njeriu nga kjo jetë endacake, — mendoi Ago Tafili dhe solli ndër mend rininë e tij, kur ishte vetë djalë i shëndetshëm dhe i pashëm. Në atë kohë pronari i Marinës i kishte matur shpatullat dhe i kishte rënë tejtejt krahinës për të gjetur edhe një tjetër si ai, ndërsa Meliha hanëmi ishte tundur deri në lajthitje para forcës së atij mashkulli. — Unë ika, — tha trishtueshëm Agoja, — kurse ata qenër mbetën! Rrezik të varrose unë tri herë, ndërsa ajo mandallja Meliha të mbetet po ajo pelë e hasdisur. E pse të mos tërbohen, rrojnë mirë.»

— Në djall! — shfryu Ago Tafili dhe mbylli sytë.

Të nesërmen qyteti u zgjua me një cipë të bardhë bore. Ata të tre, të mbështetur pas murit, dukeshin si tri statuja të vendosura prej kohësh. Lagështia e natës i kishte mpirë, nuk lëviznin, sikur të ishin ulokë. Nga kreu i rrugës erdhi një thirrje shumëzërashe, që i bëri të hidheshin përperjetë.

— Ç'qe kjo?! — pyeti Nuriu.

Thirrja u dëgjua qartë: «Duam bukë. Duam punë!...» Pastaj, nëpërmjet mjegullës së atij mëngjesi, ata shquan fytyrat thatanike dhe gjokset e zhveshura të njerëzve. Turma i ngrinte grushtet lart e pas-

taj i ulte me forcë, sikur të godiste një kokë të padukshme.

— Ç'janë këta? — pyeti përsëri Nuriu.

— Janë punëtorë, — iu përgjigj Agoja. — Këta janë më keq se ne.

Mjegulla u largua si me fshesë, dhe djali pa se pranë mureve të punishteve qëndronin edhe burra të tjerë, me supet e thyera nga pesha e rëndë e torbave.

— Po këta?

— Kanë ardhur gjatë natës, janë si ne. Edhe këta presin hanëmin.

Ndërkohë para punëtorëve vërshuan xhandarët dhe po atë çast ndaloi edhe një kaloshinë blu. Prej saj zbriti një oficer dhe hanëm Melihaja. Ajo po vinte drejt fshatarëve. E nxituar e me flokë të shkoko-lisur, dukej sikur kishte ardhur drejt nga shtrati. Takoi fshatarët e parë.

— Ata e vunë emrin në listë, — tha Selami.

— Në atë listë e vuri emrin edhe im atë, — mër-mëriti Nuriu. Tiparet e bukura erdhën e iu bënë më burrërore. Mbi atë fytyrë gjeje edhe bukurinë, edhe forcën. Ago Tafilit i pëlqeu kjo. Iu kujtua rinia. Ndërkohë pranë tyre erdhi hanëmi.

— Shtyhuni dhe ju, më tutje, — foli ajo. — Bëni mënjanë e mos u përziëni me ata që çirren e që ulë-rijnë. Ata janë gati të hanë mish njeriu.

— Ata kërkojnë bukë dhe jo...

— Ago Tafili, — e ndërpreu hanëmi, — ma more të keqen. Në mykët ke shkuar. Shtyhu, të thashë, në mos... — Ajo e preu fjalën. U drejtua nga Nuriu.



— Po ky ylber nga na doli këtu? — Gusha e hanëmit u drodh...

«Ujkonja do të përpiqet të duket si dele», — mendoi Agoja dhe u bë gati të ndërhynte, për ta shpëtuar djalin nga thonjtë e saj.

— Ti, pëllumbth, nuk do të shkosh, — vazhdoi Meliha hanëmi, — do të rrish këtu.

— Jo, — e ndërpreu Nuriu, — jam nisur për në rrugë tjetër.

— Do të bësh si them unë, — nguli këmbë ajo.

— Jo, — tha prerë djali.

Një hije e zezë i kaloi hanëmit në fytyrë dhe sytë iu egërsuan.

— Shko, — tha, — shko, desha të mbeteshe pëllumb, — i shfryu pas pak. Buzët iu përdrodhën si të nëpërkës, i shtyu fshatarët deri matanë qoshes. Nga qendra erdhën më me forcë thirrjet: «Duam bukë. Duam punë!»

— Doni vdekjen, — iu kanos Melihaja.

— Vdekjen tënde, — iu përgjigj nëpër dhëmbë Ago Tafili. Nuriu i dëgjoi fjalët e Agos. Vështroi pjerrtas hanëmin. Sytë e saj të thellë iu dukën djalit si dy zgavra që dalngadalë po mbusheshin me gjak.

Melihaja bëri më tutje e s'u pa më.

«Të lumtë, djalë, — nisi të thotë me vete Agoja, — shpëtove nga ajo baltovinë.»

— Shiko, xha Ago, shiko, a i bihet njeriut ashtu? — iu drejtua papritur Nuriu.

Atje në qendër kishte filluar një përleshje e vërtetë. Xhandarët, si viça qafëtrashë, me një shirit të kuq rreth gushës, qëllonin me kondakët e pushkëve dhe me grushte mbi kokat dhe gjokset e punë-

torëve. Dy nga ata gushëkuqët e ngjeshën një djalë të ri me kasketë pas murit dhe e qëllonin me kondak, herë njëri, herë tjetri. Nuriu kërceu përpjetë dhe deshi t'u afrohej.

— Nuri! — i thirri Selami dhe e kapi nga bërryli. — Tërhiqu mënjane. A nuk e sheh? Ky është sherr me mbretin!

— Mbreti të kafshon, — tha Nuriu, duke e shtrënguar dhe tundur Selamin prej supesh. — E more vesh, të kafshon, kështu thoshte im atë dhe paska pasur njëqind herë të drejtë.

Në ato çaste djali me kasketë u iku xhandarëve nga duart. Ai hyri në mes shokëve e doli fare pranë fshatarëve. Mbi murin përballë ai shkroi me germa të mëdha: *Poshtë mbreti*. Tre xhandarë, që e vunë re, u sulën mbi djalin, e goditën dhe e shembën përdhe. Fshatarët e panë qartë atë sulm. Të tërë u rrëqethën dhe u bënë dyllë të verdhë.

— Nuri! — thirri Agoja. Kjo thirrje sikur e riktheu në radhët e tyre përsëri jetën. — Nuri, shkruaj edhe ti diçka nga ana jonë!

Nuriu rrëmbeu një tullë të kuqe, e theu atë përgjysmë e mbi fasadën e murit shkroi atë që i qe mbledhur në gjoks: *Të rëntë mishi copë-copë, Ahmet Zogu, siç po na bie neve!...* Nuk e mbaroi atë që kishte ndër mend. Një plumb, nga diku, erdhi e mori prapa kokës. Djali ra me fytyrë nga qielli...

— Nuri! — thirri Ago Tafili dhe u hodh mbi trupin e djalit. Ashtu bëri edhe Selami. Fshatarët e tjerë erdhën dhe i ngritën më këmbë.

Ago Tafili, me sytë e mbushur me lot, vështroi përçark. Përmes lotëve të nxehtë shqoi oficerin e

xhandarmërisë dhe pranë tij hanëmin me dorën e nderur nga fshatarët. Shau dhe mallkoi ashtu siç i deshi zemra. Nuk i la lotët t'i binin poshtë, por i ngriu te cepat e syve. U ul mbi djalin dhe e puthi në ballë.

— Nuri, Nuri, o bir!...

Djali heshte. Buzët i kishin mbetur të hapura sikur do të vazhdonte të fliste. Bukuria i ishte shtuar edhe dy herë, ndërsa sytë e bukur i shikonin larg. Ago Tafili e ngriti djalin ndër duar, e vuri pranë gjoksit dhe eci. Pas tij vinte Selami e pas Selamit beltarët e tjerë. Ecnin me hapa të sertë, të rëndë, drejt punëtorëve, për të vazhduar betejën...

## DIMRI QË SHKOI

Ajo erdhi në fillim të dimrit. Vinte nga një qytet jugor, ku bëhen shumë limonët. Kishte kryer një shkollë profesionale dhe do të fillonte punë në brigadën e Simonit. Shokët e vështruan me kureshtje. S'ishte ngjarje e re ardhja e një vajze në brigadë, por ajo iu duk atyre krejt ndryshe, ndoshta nga butësia e tepërt gati fëmijore dhe nga flokët e gjatë e të verdhë. Simoni e caktoi Shpresën, kështu e quanin vajzën, të punonte në tokë dhe jo në lartësi. Këtë ai e bënte për të gjithë ata që sapo nisnin punën e montatorit. Ishte si stazh për t'u përgatitur, që më vonë të punoje ngjitur në skela e kapriata. Vajza merrej me punë të thjeshta, punonte pa u ndier, me kujdes të madh dhe me një qetësi të çuditshme... «Ajo sillet me hekurat ashtu siç është sjellë në shkollë me librat», — thoshte Likja, vincieri i gjatë, i cili pëlqente shumë këngët me iso. Edhe kur dikush prej shokëve bënte ndonjë shaka, vajza tërhiqej mënjanë. Ngadalë nisi të afrohej, të vinte buzën në gaz dhe atë që e ngacmonte me shaka nuk e vështronte më vëngër. Pastaj ajo hyri e tëra në jetën e tyre. Tanimë askush nuk thoshte ndonjë gjë enkas për të. U

miqësua shumë me Dolin, por gjatë punës ndahe-  
shin, ngaqë e para ishte një montatore e zonja, linte  
pas edhe djemtë, kurse Shpresa akoma vazhdonte  
«kurën» që i kishte caktuar Simoni, siç thoshte Bash-  
kimi me shaka. Pasdite, me të lënë punën, të dyja  
vajzat ktheheshin bashkë. Banonin në hotelin nr. 7.  
Pasi laheshin dhe pastroheshin, Shpresa niste e për-  
gatiste darkën. Këtë ajo e bënte më shpesh, sepse  
tjetrën, gati çdo natë vinte dhe e merrte një djalë.  
Ajo e donte Dolin dhe ikjet e saj me atë djalin i shi-  
konte me frikë. Matej ta pyeste, po këtë s'e bëri dot,  
derisa një natë Doli ia tregoi vetë. Ai ishte një mon-  
tator nga Tirana, me të cilin Doli ishte fejuar dhe  
tani priste të merrte shtëpi e të martohej.

Që prej asaj nate Shpresa, nëpërmjet dritares,  
i kundronte dhe i ndiqte me sy ata të dy derisa  
humbisnin në rrugën e gjerë, plot lëvizje.

«Sa e lumtur është Doli», mendonte vajza duke  
mbështetur kokën mbi xhamin e ftohtë.

«Ku të kenë shkuar? Ku venë ata të dy natë për  
natë?!» — Qeshte lehtë dhe vetvetiu e përfytyronte  
edhe veten duke shëtitur diku, aty pranë tyre. Për-  
sëri rikthehej në gjendjen e vet dhe largohej nga  
dritarja me dhimbje. Kjo s'kishte lidhje me Dolin  
dhe lumturinë e saj. Për të Doli le të ishte edhe më  
e gëzuar, më e lumtur. Po atëherë ç'kishte vajza?  
Shpresa ishte e fejuar. Shoqet e saj u nisën, sipas  
emërimeve që kishin marrë, qysh në shtator, kurse  
ajo... Një ditë e ëma e mori në punën e vet. Kuj-  
hyri në zyrë, Shpresa pa te tavolina përkarshi një  
djalë me mollëza si gungë e me një lëkurë të bar-  
dhë, të pakapur nga dielli. Ai u ngrit me kujdes nga

karrigia dhe po me aq kujdes i zgjati dorën vajzës. Edhe kur i foli, ai sikur përdori po atë kujdes. Me të dalë nga zyra, e ëma i tha:

— Si t'u duk ai djali, Shpresa? Është i zoti, tërë peshën e llogarisë së ndërmarrjes ai e mban. Apo s'ka një familje, i ati...

— E pse m'i thua gjithë këto, — e kishte ndërprerë e bija.

— Ti s'je e vogël.

— E pastaj?!

— Le të të emërojnë, jo në Elbasan, por edhe në Shkodër; Shpresa, tani ti na ke ne këtu, ke edhe të ardhmen tënde. Po le të bëjmë njëherë fejesën...

— Fejesën?

Kur u kthye... Doli e gjeti Shpresën shtrirë mbi shtrat të veshur. Doli u çudit. Ajo e dinte fare mirë se sa e rregullt ishte tjetra. Iu afrua, i vuri dorën mbi ballë e pastaj e tundi lehtë.

— Shpresa, Shpresa!

Vajza kërceu e trembur.

— Ç'ke? — pyeti Doli. — Ç'ke, pse të janë enjtur sytë?

Shpresa s'foli, po një ngashërim i thellë iu çli-rua prej gjoksit.

— Të pyeta, — këmbënguli Doli, — hapja zemrën shoqërisë, — shtoi me shaka, — punë e re, njerëz të rinj. Ti, po, vajzë e...

Shpresa u kthye mënjanë.

— Nuk të bëj qejfin, — vazhdoi Doli, — kjo duket. Pastaj, ç'kujton ti, se s'ka djem...

— Këtu? — tha tjetra.

— Këtu, jo këtu, — shtoi e qeshur Doli, — këtu

jam unë, e ti s'mund të biesh në dashuri me mua...

Shpresa vuri buzën në gaz dhe atë çast e ndjeu më të nevojshme se kurrë t'ia tregonte Dolit atë që i kishte fshehur deri atëherë. Dhe ia nisi ngadalë. Ia tregoi. Kur fliste, lehtësohej.

— Mirë prindërit e tu, po ti, po ai? — pyeti Doli.

— Unë. Ç'pyet për mua. Ata më mbajtën katër vjet në shkollë dhe nuk ua prishja dot. Shoqet ikën që në shtator, kurse unë...

— Ti prite të fejojesh, — i tha Doli.

— Unë e di që ti s'më fal, — tha Shpresa. — Po ja, besoj se edhe ti... ç'do të bëje ndryshe... Ti më pyete për atë. Uf.. kujton ti se ai është si ky yti, që të vjen e të thërret nga dritarja? Ai, ai kurrë s'më thërriste, kurrë s'më mori me vete... Vinte vetëm në shtëpi. Kur hynte brenda, më dukej sikur në dhomë çdo gjë ngrinte, edhe perdja s'lëvizte më. Jo sepse ai kishte hije të rëndë, përkundrazi. Po si të të them, ja, mendo, ai më dukej sikur, çdo herë që vinte, bënte të njëjtën rrugë, shkelte po në të njëjtat gjurmë. Bisedonte me mamanë të njëjtat gjëra, për punën e tyre. Unë rrija e heshtur, s'merrja dot pjesë në diskutimet e tyre tërë llogari. Mbjaj mend pak më qartë nga ai litar diskutimesh vetëm këtë, që ai ishte nxehur në kulm, pasi shefi e kishte kritikuar në një ambient të hapur dhe jo sipas rregullit, dhe për këtë ishte shqetësuar, kishte ditë që po bënte çmos të provokonte mbledhje. — Doli e dëgjoji me vëmendje, ndërroi krahun e tha: :

— Çudi, mua më duken të çuditshme!

— Ndoshta ty s'të ka ndodhur kështu.

— Jo ndoshta, po s'më ka ndodhur, — tha Doli,

— Unë e njoha këtu. Dikur kemi punuar bashkë me montatorët e Tiranës. Kaq, ç'të të them. S'kam ndër mend të të tregoj gjithë historinë e dashurisë, — shtoi ajo duke qeshur. — Ti je në fillim e s'më ke thënë gjë.

— Unë! — u çudit Shpresa. — Unë, ç'të të them unë, pse, dashuri është ajo imja?

— Kjo që ke filluar tani, — e ngacmoi Doli. — Kam vënë ré se sikur s'para ke qejf të kthehesh më me mua në qytet. Cili e pret shokun, ti Bashkimin, apo ai të pret ty?

Shpresa heshti. Vuri shuplakat në faqe dhe vështrimi i saj i ëmbël u përqëndrua diku larg. Iu kujtua fytyra e pastër e Bashkimit, flokët e verdhë, pak a shumë si të sajët, sytë në të kaltër dhe ai purpur i lehtë që i kishte rënë djalit atë çast kur i tha se e donte, se mendonte. . . Ndërsa ajo s'i kishte kthyer përgjigje. A do të mundte vallë... Hapi krahët e lehtësuar. Doli, që flinte poshtë saj, i shtrëngoi dorën.

— Kur do ta bëni dasmën? — pyeti Shpresa.

— Shpejt, shumë shpejt, — iu përgjigj Doli.

Të hënën Simoni bëri rindarjen e punës. Grupi që do të kryesonte Bashkimi do të punonte pranë atij objektit të ri. Punëtorët e ndërtimit e kishin mbaruar muraturën, i kishin ngritur edhe kolonat e larta prej betoni, e tani ajo ndërtesë i ngjante një pallati shumë të madh, pa dritare, pa çati. Dritaret dhe çatia për të janë kapriatat metalike dhe konstruksionet prej çeliku gri.

— Bashkim, — i tha Simoni, — ti do të marrësh



edhe Shpresën me vete, mjaft e lamë aty. Me këtë tip që ka ajo, ka rrezik ta harrojmë fare. Kështu s'bëjmë gjë tjetër veçse e lëmë në vend. Merre, le të punojë me ju, se, sa më e vështirë të jetë puna, aq më i fortë bëhet njeriu.

Shpresa uli kokën.

— Më merr vesh, — tha Simoni, — ti, moj vajzë, s'je më ajo që ishe në fillim, por unë dua të bëhesh edhe më e zonja.

Bashkimi ishte ndër specialistët më të mirë të brigadës. Simoni ishte i bindur se ai do të bënte çmos për aftësimin e vajzës, gjithashtu kishte edhe një parandjenjë se ata mund të kuptoheshin fare mirë midis tyre.

— Shpresa! — i tha Bashkimi.

Ajo nuk e ngriti kokën, sepse ishte e sigurt se ai po e vështronte. Ishin para objektit të ri. Një masë e madhe e hekurt, e heshtur shtrihej përdhe. Të tëra ato duhej të mbërtheheshin mbi shpatullat e mureve dhe të shtyllave prej betoni që ngriheshin tridhjetë metra nga toka. Vajza i vështroi nga poshtë-lart. Kjo ishte detyra. Lartësia e katit të parë s'ishte e re për të. Vinçi buçiti fuqishëm. Likja, me anë të ganxhës, mbërtheu një kapriatë, lëshoi një «oo» të gjatë dhe ia nisi i kënaqur njëres prej atyre këngëve të tij me iso.

Kapriata kolovitej në ajër dhe pastaj përfundonte në duart e tyre. E para e niste montimin Shpresa. Bashkimi mbante aksin qëndror e, me të mbaruar ajo, niste edhe ai.

Puna e montatorit ka nevojë për forcë, shkathësi e vëmendje, por mbi të gjitha për guxim. Vajza

bënte përpjekje, po pas çdo ngjitjeje të re i merreshin mendtë dhe shihte turbull. Dimri ishte i fortë, me erë, si zakonisht, dhe, atje ku punonte Bashkimi, të ftohtët ishte edhe më i sertë.

Vajza e vështronte pjerrtazi. Po sikur të kishte edhe ajo guxim e të ngjitej deri atje? Puna do të bëhej më shpejt dhe djali lart s'kishte pse të priste mbi gjoks vrullin e erës. Puna në katin e parë eci mirë. Vajza lodhej, sidomos kyçet e duarve i këputeshin, por edhe ndiente një gëzim që s'e pati provuar deri atëherë. Ajo shikonte se përpara saj ngrihej një mur i vërtetë prej hekuri, mbi të cilin kishte derdhur edhe ajo djersën e vet. Në katin e mësipërm Shpresa fitoi shprehitë.

Një ditë, kur erdhi Simoni, Bashkimi i tha atij në sy të vajzës:

— Shpresa ka bërë përparime... shoku brigadier.

— Po, patjetër, — tha Simoni buzagaz.

— Shoku Simon, — thirri Likja nga dritarja e vinqit. — Shpresa na u duk pak, po na doli shumë, ajo po ia kalon edhe Bashkimit.

Shokët qeshën, ndërsa ajo, fluturimthi, këmbëu shikimin me Bashkimin. Tërë pasdreken e rijeit disa herë atë çast. Sytë e bukur të djalit i rrinin pranë. Kur mbaroi puna, ai i tha që ta priste, por ajo iku. I hipi urbanit. «Ai kërkon përgjigjen, — mendoi vajza, — po ç't'i them unë? Jam e fejuar?» Një ndjenjë ftohtësie ia pushtoi gjoksin.

«Por unë e dua, e dua», pohoi ajo me këmbëngulje.

Urbani ndaloi dhe ajo zbriti. Kur u largua autobusi, ajo vështroi e habitur. Kishte zbritur një sta-

cion më poshtë. Qeshi lehtë. Futi duart në xhepat e xhaketës blu dhe shpejtoi. Ndihej e gëzuar. Të krijonte përshtypjen sikur fliste me vetveten. Nën dritat e neonëve flokët e verdhë i vetëtinin si drita e hënës.

Pranë hotelit dy të rinj bisedonin. Vajza iu duk si Doli dhe, kur u afrua pranë tyre, gati i përshëndeti.

«Ç'kam sot!» — Qeshi dhe ngjiti shkallët. Hyri në dhomë. Mbi tavolinë qëndronte një fletë fletoreje me këtë shënim:

*Shpresa, mora shtëpi të re, do të rregulloj plaçkat, Doli.*

Shpresa e ngriti fletën lart, e shtrëngoi fort, sikur të shtrëngonte dorën e shoqes e ta uronte.

«Sa e gëzuar është Doli! Ajo është e lumtur! Sa mirë, ata e duan njëri-tjetrin! Çfarë fati paskam pasur unë! Vetëm unë kështu, vetëm unë!» E kapi një trishtim i madh dhe vajti e ra në shtrat. «Si mund të jetë i fejuari im ai! Unë s'e dua. Le të jetë i fejuar për ata që e duan, për ata!... — Një të nxehtë djegës i rrethoi sytë. — Si veproi ashtu mamaja?»

Ajo kishte disa muaj që nuk i kishte parë prindërit, malli e kishte marrë, por veprimi i tyre, ajo fejesë e kurdisur e bëri të derdhte lot të nxehtë mbi jastëk. Iu kujtuan vitet e shkollës. Letrat plot mall që merrte. Pastaj kthimi nga shkolla për pushime.

«Do t'u shkruaj një letër, — tha ajo, — po, po, do t'u them se nuk e dua atë. I fejuari im do të jetë ai që do të dua dhe unë. Dua Bashkimin! Ata do ta pëlqejnë. Ne ngajmë shumë të dy, edhe Doli

ngjan me të fejuarin e saj. Bashkimi i ka flokët si të mitë, vetullat, buzët, veçse sytë jo. Ua! Sa shumë fola! Mos vallë të gjithë vajzat, kur dashurojnë, flasin shumë!?»

Buzëqeshi. Tani e ndiente veten më të lehtësuar. U shtri dhe shpejt e zuri gjumi.

Dy ditë më pas ra shi i shpeshtë dhe i ftohtë. Kapriatat dhe konstruksionet nuk kapeshin dot me dorë. Ajo masë e hekurt, e akullt, me ftohtësinë e saj i jepte kantierit një pamje të zymtë, të shurdhët. Pellgjet me ujë të turbullt, si gjole të vogla, mbanin mbi vete ndonjë copë dërrasë, si urë lidhëse midis dy brigjeve. Punëtorët merreshin me përgatitjen e pajisjeve nëpër baraka, ku një stufë-fuçi plot me ziarr shpërndante afshin e ngrohtë. Por, përderisa shqetësimi më i madh ishte për punën jashtë, atyre nuk u hynte në sy as baraka, as zjarri, prandaj dilnin dhe hynin duke mallkuar motin e keq që po e tepronte. Shpresa përgatiste disa copa spesorësh. Ajo punonte me zell, e përqendruar dhe çdo detal e nxirrte të saktë.

— Shpresa! — i tha Bashkimi, — ti duhet të keshqenë nxënëse e mirë.

— Ashtu mendon ti? — i tha ajo.

Ai u largua dhe vajza u bë flakë nga turpi për përgjigjen që i dha.

Në drekë, si zakonisht, erdhi dhe e mori Doli. Ngaqë ishte kohë me shi, punëtorët u derdhën në mensë. Avulli që dilte nga sporteli dhe nga rrobat e lagura të tyre krijonte një mjegull. Bashkimi, me pjatat në duar, s'po gjente vend për t'u ulur. Shpresa e pa dhe i tha Dolit:

— Thirre Bashkimin.

Tjetra, sikur ta kishte pritur këtë, ia pati:

— Bashkim, hajde ulu këtu, se kështu tha...

Shpresa i shtrëngoi dorën.

— Ti s'ke turp, — i tha.

Doli qeshi.

— Turp është të gënjesh.

Bashkimi erdhi dhe u ul.

— E, t'i them... — e ngacmoi Doli. Shpresës iu përflakën faqet. Djali vuri buzën në gaz. Nisi të hante i qetë e me kënaqësi

— Sot në darkë ju pres të gjithë, — tha Doli, — shtëpinë e re e kam rregulluar për bukuri. Do t'ju luaj mendja e kokës, — qeshi, — pastaj dy ditë te vjehrra në Tiranë, e pastaj...

— Ku? — pyeti Bashkimi.

— Në kamp.

— Në mes të dimrit?

— Unë jam nga qyteti i diellit, — tha ajo e qeshur. — Unë dua borë. Pritmë, Voskopoje, se po të vij!

Ata qeshën të tre me zë dhe u ngritën.

Para se të mbaronte puna, Simoni nisi dy veta për të blerë dhuratën që do t'i shpinin Dolit. Më vonë ata u takuan së bashku pranë teatrit. Lanë rrugën kryesore e morën atë që të nxirrte te lagjja ku ngriheshin apartamentet e reja. Do të shkonin vetëm për urim. Dasma do të bëhej në Tiranë.

— Kujdes, — thirri Likja, — se është e pamundur që komunalja të mos ketë lënë ndonjë gropë hapur.

— Dil në krye, — tha Bashkimi.

— Rinia, — tha ai dhe i liroi vendin Shpresës, që mbante dhuratën e shoqes.

— Like, po na plak me zor, — tha Simoni. Ai sikur mori inat e doli vetë në krye.

Të tjerët qeshën. Pas një kthese u duk apartamenti. Ngjitën shkallët. Te dera, buzagaz, i priti i fejuari i Dolit. Vetë ajo kishte veshur një fustan vishnjë dhe flokët i kishte rregulluar bukur. Ishte shumë e emocionuar. Shërbimet i kreu Shpresa. Ata kishin zënë vend rreth tavolinës së lustruar. U krijua një çast qetësie dhe këtë e prishi shpejt i fejuari i Dolit.

— Epo, shoku Simon...

Simoni u ngrit në këmbë e me buzë në gaz tha:

— Në këto raste sikur të lidhet goja... Jam... jam shumë i gëzuar, ta ngremë për çiftin, të tjerat...

Tringu i lehtë i gotave brodhi nëpër dhomën erëmirë. Në mes të bisedave të zakonshme, ngriti një gotë i fejuari i Dolit.

— Për kombinatin tonë, shokë, për kombinatin, ai na bashkoi.

— Bashkime të tilla pastë me qindra! — tha Likja.

Shpresës iu bë sikur shikimet e tyre ranë mbi të. Vështroi Dolin. «Sa e mirë! Çdo gjë e ka rregulluar për mrekulli.» Dhomës së fjetjes nuk i mungonte asgjë. Në dhomën ku ishin ata, ishte vendosur një divan, një komplet karrigesh ngjyrë arre dhe një stufë e emaluar. Përballë një bufe me rimeso, e njëjtë me karriget. Aty ku ishte vendi për të vendosur televizorin, ata kishin vënë një radio «Iliria».

— Shtëpia e re, — tha Doli.

— Ngadalë, ngadalë, — tha Simoni.

— Mund të blinim edhe diçka tjetër, — tha i fejuari i Dolit, — po e kishim bërë mend me kohë që do të shkonim në kamp.

— Fora ta bëni, — u hodh e tha Likja, — kur jam martuar unë, sot e dhjetë a dymbëdhjetë vjet para, i thashë vetes: o kabinë, o s'ka dhe e gjeta, po nga hundët më doli, plazh nuk bëra unë po gruaja.

— E pse? — pyeti Bashkimi.

— Ti gjej nuse, pastaj pyet, — ndërhyri Doli.

— Ta ngremë për Liken, — tha dikush, — që i ka shërbyer nuses...

— Prit, — tha Likja i rrëmbyer, — prit ta ngremë për tavolinën. S'ka gjë se është kaq e thjeshtë, aq më mirë, gëzimi më i madh nuk është ai që vjen nga stomaku, por ai që buron nga zemra.

Vonë u larguam të gëzuar. E fundit që u përshëndet me ta qe Shpresa.

— Doli! Unë tani do të mbetem vetëm.

Ajo e pushtoi.

— Ti vetëm! Çfarë të kam thënë?...

Vajza e përqafoi fort dhe zbriti shkallët. Atë e përcollën të gjithë së bashku deri në hotel. Ajo u uroi natën e mirë dhe dy e nga dy ngjiti shkallët. I kishte lënë mbresa ajo darkë e thjeshtë, pranë atyre njerëzve të çiltër dhe me humor. Hyri në dhomë. Sepse e ndjeu veten pak të lodhur dhe u ul një çast. Pastaj, me një qeshje të ëmbël në buzë iu afrua dritares. Në rrugë s'kishte njerëz. Pa atë vendin pranë shtyllës, ku priste çdo natë i fejuari i Dolit. U mbush me frymë. Ajri i freskët i natës

e çlodhi. Shi nuk binte më, në qiell dukeshin grupe yjesh. Horizonti ishte me një ngjyrë të kaltër të tejdukshme. Këtë mrekulli tani natën e krijonin dritat e forta dhe ndriçimet e zjarrrta të kombinatit... «Për kombinatin! Ai na bashkoi!» Ajo nisi të këndonte lehtë një këngë. I vajtën sytë te pasqyra. Atje kishte vënë letrën që i kishte dërguar i ati dhe që ajo ende s'i kishte kthyer përgjigje. Vendosi t'i shkruante dhe, ashtu e gëzuar, siç ishte, ia nisi:

*Të dashur prindër! Baba, më fal për vonesën e e përgjigjes. Jam mirë. Po ju? A është afruar shumë deti pranë shtëpisë? Këtu fryn erë vazhdimisht. Baba, porosinë që më dhe ta kreuva. E hapa librezën e kursimit. Baba, ajo vajza nga Fieri, Doli, iku nga dhoma sepse u martua me një djalë nga Tirana. Sa shumë shkojnë ata të dy! Morën edhe shtëpi të re. E tërë ajo lagje është bërë për punëtorët e kombinatit, për çiftet e reja. Ndoshta nga kjo, një shoku im thotë me shaka, se Elbasani është qytet i çelikut dhe i dashurisë. Më thoshe se e kishe parë kombinatin, po ti e ke parë shumë vjet para dhe ajo uzina që ke parë ti është njësoj si të shikosh fabrikën e verës që keni aty. Tani që po të shkruaj këtë letër është natë, po a e di si duket kur hedh sytë nga kombinati? Të duket sikur është agim dhe dielli sapo ka lindur. Unë akoma s'e kam parë plotësisht, këtë fat e kanë vetëm ata që punojnë në lartësi të mëdha, si Doli. Shpresoj se edhe unë do të ngjitem...*

Ju puth me mall, bija juaj, Shpresa



E mbylli letrën. Vajti pranë shtratit dhe u shtri. Kishte qenë një ditë e gjatë... e mbushur me mbresa.

Mëngjesi erdhi i pastër. Shiu i natës e kishte larë qiellin. Ullishta përreth vetëtinte sikur mbi të të ishin hedhur cifla xhamash. Autobusi rrëshqiste mbi rrugën e gjerë. Bënte pak ftohtë. Punëtorët ndalonin pranë objekteve të tyre dhe shpejtonin. Në këto ditë zjarrin më të ngrohtë e ka vetë puna. Barakat nuk tymosnin më. Zhurma e bisedave dhe e makinerive, kjo këngë e punës, kishte pushtuar tërë kantieret. Montimi i kapriatave mbaroi në fund të javës. Shpresa ndihej e ngazëllyer. A nuk ishte ajo, që disa kohë më parë nuk shkëputej dot nga toka? Ndërsa tani vajza qëndronte për orë të tëra duke punuar mbi një hekur U. Kishin mbetur pa montuar vetëm konstruksionet. Këto përbënin çatinë e asaj ndërtese të madhe. Bashkimi i tha asaj:

— Shpresa, atje në majë nuk ka shumë punë, prandaj s'është nevoja të ngutesh e të vish.

Po vajza e dinte fare mirë se pikërisht në majë, atje ku po ngjitej ai, ishte vështirësia më e madhe. Ajo e vështroi, ashtu siç bënte gjithnjë, vetëm kur ai u largua.

«Atje në majë s'ka punë fare!» Ai po punonte atje, në një pozicion tepër të vështirë. Pak t'i lëvizte këmba... Ajo e vështroi përsëri dhe ndjeu për të një drithmë të ngrohtë, të ëmbël, që i mbërtheu gjoksin. Kjo s'ishte gjë tjetër veçse dashuria e saj e madhe për të. U desh një largim i Bashkimit disa ditë nga puna, që ata të kuptonin e të ndienin se sa të afërt ishin për njëri-tjetrin.

Bashkimi u kthye dhe i shtrëngoi dorën. Dora

e butë e vajzës bëri po të njëjtën gjë dhe atë çast, ajo për herë të parë nuk i largoi sytë, po e pa me buzë në gaz derisa ia tha të gjitha ato që kishte mbledhur për të në zemër.

U bë vonë dhe Bashkimi nuk po zbriste. Aty-këtu filluan të ndizeshin dritat. Vajza nuk duroi më gjatë dhe i thirri.

— Mbarova, gati jam, — tha ai. — Shpresa, a e di ç'po bëja tani? Po mundohesha të dalloja objektet ku kam punuar më parë, por është e pamundur, dritat nuk kanë kufi. Çudi! Më duket vetja sikur s'jam unë që kam vjet që punoj këtu!

Vajza u përpoq të ngjitej, por u tremb dhe fajin ua hodhi natës dhe lodhjes së ditës. Sa dëshironte të ishte atje lart, të vazhdonte tërë atë vepër gjigante, hekur e tëra, që uturinte, zhurmonte e që s'mbyllte sy kurrë.

Kur zbriti ai, Shpresa i kishte mbledhur veglat e punës.

— Shpresa, ti vë merak shumë. Po shumë shpejt dhe...

Vajza i buzëqeshi.

— Montatori e do nusen të guximshme, — tha ai.

Vështruan njëri-tjetrin dhe qeshën. Ai i hodhi dorën mbi sup. Ndërkohë Likja i ra borisë së vinçit dhe i tha Bashkimit se po e prisnin në mbledhje.

Vajza i hipi urbanit dhe kur zbriti në qytet shë-titorja ishte mbushur plot me njerëz. Moti ishte zbutur e të kujtonte një mbrëmje pranvere. S'pati qejf të shkonte në dhomë, kishte nevojë të shëtiste. Pa njëherë tejtejet bulevardit. Hyri edhe në mapon qendrore. «Si e do nusen montatori?» — pyeste ve-

ten dhe po vetë përgjigjej, duke vënë lehtë buzën në gaz. Ah, sikur të ishte Doli! Do t'ia tregonte të gjitha. Mori rrugën në të majtë dhe doli pranë apartamentit të saj. Dritat e rrugës depërtonin matanë perdeve të holla. Nga dritarja fqinje u dëgjua një këngë. «Përsëri ndonjë çift i ri», — tha ajo dhe iu bë sikur në të gjitha dritaret kishin dalë njerëz. Aty pranë ishte një apartament në mbarim dhe ajo caktoi një dritare për veten e saj, pastaj sikur s'i pëlqeu ajo dhe u shty më tutje. Zgjodhi një tjetër, pikërisht atë që ishte përkarshi kombinatit dhe e përfytyroi veten së bashku me Bashkimin, të mbështetur mbi parvazin e saj.

Autobusi i ndaloi pranë këmbëve. Ajo hipi. Një fëmijë ngulmonte të shikonte nga dritarja. Vajza i liroi vendin dhe filloi të luante me të.

Kur ndaloi, e puthi fëmijën, i uroi natën e mirë së ëmës dhe iku. Hyri në dhomë. Një letër qëndronte poshtë derës. E kishte nga i ati. Pa u ulur mirë e hapi dhe nisi ta lexonte. Ndali njëherë se sikur s'kuptoi gjë dhe pjesë-pjesë e lexoi me zë.

*Ajo shoqja të trashëgohet, po ti mos rri vetëm në dhomë, na dërgo adresën e drejtorit... dhe dëgjo, moj bijë, ai përshkrimi që kishe bërë për kombinatin na pëlqeu, mamaja mbushi sytë me lot dhe më porositi të të them se s'është nevoja të synosh të ngjitesh lart, kur po ata hekura, po ato fabrika e uzina që sheh në tokë, po ato janë kur i sheh edhe nga lart. Ndërsa për librezën, mirë ke bërë që e ke hapur, po mos mendo as për një vit, as për dhjetë vjet, po deri në qershor. Atëherë do ta bëjmë dasmën...*

Asaj i ra letra nga dora. Tërë atë gëzim dhe lumturi sikur ia hoqën nga vetja. «Me kë do ta bëj dasmën? Me kë do të martohem? Me atë?!» U mundua ta përfytyronte, por s'ishte e mundur. Në kujtesën e saj asgjë s'kishte mbetur, veçse ai shqetësimi i tij për të provokuar mbledhje.

Ndjeu nevojë të fliste, t'i thoshte të gjitha ato që i takonin asaj së kaluare, të cilën ajo tani e konceptonte si dhjetëravjeçare. Muret e dhomës sikur ngushtoheshin dhe ajri iu duk i pamjaftueshëm. Shkoi pranë dritares dhe e hapi. Qielli ishte plot yje dhe me hënë. Ajo vështroi tutje, iu duk sikur në dhomë vërshuan uturimat dhe zhurmat e kombinatit.

Në mëngjes mendimet e letrës së të atit filluan ta mundonin përsëri. Nuk ndihej mirë.

«Si t'ia bëj, — tha, — sa do të vazhdojë kjo gjendje? Më duket se vetë e kam fajin. Do t'i nis një letër babait dhe do t'ia them hapur. Prishe atë fejesë. Ajo s'ka qenë kurrë fejesë... — Heshti një çast. — Unë dua Bashkimin.,, po, po... ata janë prindërit e mi, dhe është mirë që ta dinë edhe këtë!»

Vendosi dhe shkroi shumë shpejt letrën. E kish-te pushtuar një ndjenjë mërzie. Sillte ndër mend çastin kur prindërit do të lexonin letrën. Ç'do të bënin ata, atë natë? Do të mendonin keq për të.

— Shpresa, mirëmëngjes. — përshëndeti dikush.

Ajo, as kokën nuk lëvizi. Shikimin e kishte hedhur matanë xhamave. Urbani ndaloi dhe punëtorët zbritën. Ajo zbriti e nisi të ecte vetëm.

«Ah, sa mirë do të ishte të kisha Dolin!» — tha duke psherëtirë. Njëherë mendoi të priste Bashkimin

dhe të bisedonte me të. «Montatori e do nusen të guximshme», përsëriti fjalët që i kishte thënë ai.

«Dhe unë, jam shumë e guximshme», ironizoi ajo veten.

Pa e kuptuar as vetë ngadalësoi hapat. Në krah të djathtë ishte vendi i punës. Ja, atje lart montoheshin konstruksionet. Edhe sot aty do të punonin. Ajo hodhi sytë drejt majës. Bashkimi nuk do ta linte më vetëm të punonte atje lart. Donte të ishte krah tij.

«Do të ngjitem deri lart, — tha, — sikur ta di që të bëhem copë-copë.»

Filloi të ngjitej. Metrat e parë i bëri me lehtësi. U afrua pranë lartësisë ku kishte punuar Bashkimi një ditë më parë. Ja, aty dy-tre metra duheshin dhe kërcente mbi platformë, po nuk mundi. Shtrëngoi duart pas hekurave të ftohtë, i shtrëngoi jashtë mase dhe ky qe gabimi i parë, sepse iu kontraktuan edhe këmbët. Megjithatë bëri edhe një hap. Era i vërshëllente në veshë. Poshtë, rreth njëzet e ca metra, gropat e thella nxinin. Tashmë çdo përpjekje ishte e kotë.

«S'mundem më, — belbëzoi, — s'mundem. S'jam e zónja për asgjë.»

Ndërsa e pikëlluar, siç ishte, u bë gati të zbriste, një zë që erdhi nga poshtë e ndaloi.

— Ngjitu, Shpresa, ngjitu...

Ishte zëri i Bashkimit, e pas pak, ai u dha pranë saj. Ai zë i dashur e ngrohu dhe ajo ndjeu t'i lëvrinte gjaku nëpër muskuj. Hodhi këmbën e djathtë para, të majtën, dhe me radhë derisa u gjend mbi platformë. Fshiu djersët dhe para syve të saj u shpa-

los mëngjesi më i bukur që kishte parë. Kombinati dukej si në pëllëmbë të dorës, ndërsa mbi Shkumbin sikur notonte një mjegull e bardhë.

— Puna mbarë! — thirri Simoni nga poshtë.

Vajzës i kishte rënë një i kuq si i shegës. Gjoksi i rrihte, hapi krahët e përmalluar, sikur të pushtonte atë që i kapte syri. Befas, dora e saj kapi dorën e Bashkimit dhe pastaj e lëshoi në çast.

— Po unë....

— Çfarë?

— S'të kam treguar...

— Nuk është nevoja, — i tha ai duke psherëtirë dhe, sikur të ishte penduar për dobësinë që tregoi, e pushtoi vajzën, — nuk është nevoja. Doli m'i ka thënë të gjitha.

— Po atëherë, ti...

— Unë s'vij nga epoka e gurit, — tha ai duke bërë shaka, pasi vajza ishte tronditur mjaft dhe rreth buzës së sipërme iu dukën kokrra të arta djerse.

Ajo e mbështeti kokën mbi gjoksin e tij. Zemra i rrihte shpejt dhe buzët i dridheshin... Kombinati këndonte këngën e punës, ndërsa tutje, flaka e furrnaltës, si shpatë gjigante, i ra qiellit në mes, duke krijuar një horizont të përskuqur.

\* \* \*

Likja kishte disa ditë që e kishte vënë re atë djalin të vërtitej rreth objektit të tyre. Djali ishte i gjatë, i pashëm, me mollëzat pak të kërcyera. Ai ndoshta do ta kishte harruar, sikur atë mëngjes të mos e kishte parë Shpresën me të. Shpresa me një

djalë. Ajo mund të kishte edhe shokë të tjerë përveç atyre të brigadës. Po, që të kishte shoqëri midis tyre, Likja nuk mund ta pranonte. Djali i fliste, ndër-sa ajo e mbante kokën mënjanë. Kur vajza hyri në objekt, djali u largua. Likja mendoi ta pyeste vajzën po ndërroi mendje.

«Këto punët e rinisë duan kujdes të madh, — tha, — duhet të jesh marrë me to. Ngadonjëherë hyn pa ftesë në valle dhe zë belanë kot së koti.»

Në pushimin e drekës e pa përsëri atë djalin t'i vihej pas vajzës. Si po vepronte ai, të acaronte nervat. Likja nuk duroi dot, dhe, ngaqë ishte në vinq e s'mund të zbriste shpejt, i dha një sinjal Bashkimit, i cili ktheu menjëherë kokën andej nga e orientoi shoku. Me të vërtetë diçka kishte midis tyre. Vajza përplasi derën e barakës pas vetes, ndër-sa djali, po aq vrullshëm, e hapi dhe hyri brenda.

— Të të vijë turp, nga prindërit e tu, nga miqtë, — i tha ai vajzës.

— Ik, — i tha rreptë Shpresa.

— Ti nuk do që ta...

— As që kam dashur ndonjëherë, — ia preu ajo.

— Jam i fejuari yt..., — dhe i vuri dorën te supi.

Ndërkohë hyri Bashkimi. Vajza sikur ngriu në vend.

— Ç'është, ç'po ndodh këtu? — tha ai.

Shpresa nisi të merrte frymë me nxitim.

— Shpresa! — tha Bashkimi.

— Ky është ai, — mundi të shqiptonte shpejt vajza.

— I fejuari i saj, — tha tjetri.

— Ajo s'ka qenë asnjëherë e fejuar, — tha Bashkimi, — more vesh, asnjëherë, prandaj...

Atë çast hynë brenda Simoni dhe Likja.

— Ka qenë e fejuar me mua, — këmbënguli tjetri.

— Unë të thashë jo, — iu përgjigj Bashkimi sert.

— Po, natyrisht, — vazhdoi tjetri, — dalin rrugës ca birko si ti dhe u prishin mendjen vajzave.

— Ore, bandill, kujt i thua birko ti, — u hodh e tha Likja, që bëri të afrohej, po Simoni ia preu rrugën.

— Po më frikësoni, — tha ai me kryeneçësi dhe kapi dorën e vajzës. Shpresa u shkëput prej tij. Ai u nis t'i vente pas, po Bashkimi i doli para dhe ai u pengua.

— Ngadalë, — ndërhyri Simoni dhe i zgjati dorën të rrëzuarit.

Ai s'pranoi e, pasi u ngrit, tha:

— Dua të shikohet sjellja e këtij, — tregoi Bashkimin me gisht, — po, po, se jam mirëinformuar edhe për disa veprime të tjera.

— Pa qetësohu, — tha Simoni.

— Të falem nderit, po s'është nevoja, — ia ktheu ai, — dua të mblidhet kolektivi për këtë, po, po, të bëhet mbledhja dhe....

— Do ta shohim, — tha Simoni, — po të jetë nevoja, do ta bëjmë, po ti qetësohu, — dhe e shoqëroi djalin matanë objektit.

Pas pushimit ata filluan përsëri punën. Simoni ishte i shqetësuar dhe vendosi të punonte edhe vetë sipër, te konstruksionet, ku punonin Bashkimi me Shpresën. Ai i donte të dy dhe e respektonte shumë dashurinë e tyre, pasi tek ata ai shihte njeriun e



ri dhe ndjenjat e pastra të tij. U ngjit lart dhe u kënaq kur vuri re se midis dy të rinjve s'kishte asgjë që të trishtonte, përkundrazi, ata dukeshin më të lirshëm e sidomos vajza dukej më e freskët, më e bukur. Flokët e verdhë ia rrëmbente era, kurse sytë pak të përlotur vështronin pjerrtas brigadierin, i cili, atë që ndodhi pak më parë, mundahej ta kalonte fare natyrshëm. Simoni punoi tërë pasdreken me ta. Në të mbaruar të punës, ai i përshëndeti dhe u largua. Me të vënë këmbën në tokë, u dha ai djali.

— Shoku Simon, — i tha ai — ju jeni edhe komunist.

Simoni e vështroi pak i habitur e, gjithmonë brenda natyrës së tij, i tha:

— Po, jam! Po ç'do të thuash ti me këtë, ë? Epo mirë, mirë, po kur ti bëre fejesën, a pyete ndonjë komunist?

— S'është e arsyeshme të bëjmë llogari të tilla, — tha ai, — po unë të propozova që të mbliidhet kolektivi, të bëhet mbledhje...

— Mbledhje, — e vështroi Simoni, — po e bëmë mbledhjen, e bëmë, ja, atje lart, — dhe tregoi Shpresën e Bashkimin si të tregonte një çift pëllumbash.

## DJËRSA DHE GJAKU

Të parët që erdhën dhe u ngulën në fshatin Mali i Egër do të kenë pasur si udhërrëfyes ndonjë tuftë dhish, se vetëm ato mund të ngjiten nëpër ato gërxhe, thika e rrëpira. Në atë dy pëllëmbë shesh, njerëzit kishin ngritur fshatin e tyre me shtëpi të vogla e të dendura.

Burrat rrinin para shtëpisë së Uranit. Ishte natë prilli dhe kumbulla aty pranë sapo kishte çelur. Në ato anë tani fillonte pranvera. Era që vërshëllente nëpër gjerdhe vinte tek ata si një këngë vajtimi. Burrat flitnin për dimrin që iku, për gëlbasën e deleve dhe për mbjelljen me misër të atyre gurishteve që gjysmën e farës e kalbnin nën vete.

Kur e mori fjalën Mali, Urani i vuri shpatullat tokës dhe hodhi vështrimin nga qielli.

— Urani po numëron yjet, — tha njëri.

— I duken, të ziut, si zile, — tha Mali.

— S'kam ndër mend të dëgjoj ato lajthitjet e tua, — ia ktheu Urani pa lëvizur nga vendi.

Mali një vit më parë ishte nisur për në kurbet. Bejlerët e Kodrasit, që kishin filluar t'i pinin gjakun që kur ishte fëmijë, kur e panë se Malit s'i bënin më gjunjët për të ndjekur kopetë e tyre, i dhanë

duart, e përzunë. Me kumbullat dhe me gorricat e Malit të Egër, nuk mbaheshin dot gjallë dhjetë shpirt. Vendosi të merrte rrugën e kurbetit. Buzë detit, nën diellin zhuritës të asaj vere të nxehtë; priti për ditë me radhë vaporin që do të vinte t'i merrte atë së bashku me shumë të tjerë.

Dhe ai erdhi më në fund. Ishte një vapor i kuqërremtë, me pjesën e prapme blözë të zezë. Të kallte tmerrin kur e shihje. Mali s'kishte parë kurrë vapor mbi ujë. Ndërsa ishte i pushtuar prej tmerrit dhe çudisë, plasi gjëma e njerëzve buzë detit. Ndashaj prindi nga fëmijët, burri nga gruaja, motra nga vëllai. Këtë s'e duroi dot fshatari i zbritur nga Mali i Egër. Kjo i shëmbëlleu me vdekjen, prandaj aty për aty vendosi menjëherë: më mirë të vdiste pranë njerëzve dhe fëmijëve të vet. Malli i vendlindjes e tërhoqi. Pasi u end tërë verën anës deti duke kërkuar punë, u kthye në Malin e Egër dy herë më shumë i brengosur. Që atëherë seç tregonte ca gjëra të çuditshme, me të cilat në fillim Urani qeshte shumë, por, kur e pa se Mali po e tepronte, nuk qeshi më, se e quante gjynah të madh të qeshësh me budallanë.

— Uran, — tha Mali i prekur nga qëndrimi i tjetrit, — Uran, e di që ti nuk më beson. Po dëgjo ama, kam thënë e ç'nuk kam thënë, po i tërheq të gjitha. Po këtë a e beson ti, Uran, se kripa nxirret nga deti?

— Urani u ngrit i befasuar.

— Ore, — tha me një frymë, — ore, — dhe iu drejtua të tjerëve, — duhet bërë një gjë për këtë njeri!

Të tjerët ia dhanë gazit me të madhe. Nën ndri-

çimin e hënës, llamburinte një kuti duhani e lënë në shesh.

— Aman! — tha Mali. — Po këtë nuk e besoni? Mirë, mirë, mos besoni, por unë do t'ju tregoj edhe një gjë tjetër. Në qoftë se s'besoni përsëri, s'kam për ta hapur gojën më, deri mot në këtë vakt. Derisa dola në det, kalova mbi male, dhe rripa si këto tonat. Po kalova edhe mbi fusha, fusha them, po ju mos sillni ndër mend gurishtet tona, as livadhet e bejlerëve të Kodrasit se dhe atyre me një vrap pele u bie tejtejt, por mendoni qiellin e madh ta keni ndër këmbë. Kjo ishte Fusha e Muzakës, e atëherë m'u kujtuan këto selishtat tona që s'e bënë misrin kurrë më lart se një gju hajvani, m'u kujtua Mali i Egër me dy hostenë diell. Ndërsa atje, oo, oo, fushë dhe diell, aty-këtu ndonjë bregore e vogël që me një shqelm e bëje përshesh. Tokë-djerr, e harruar në ditë të hallit. E, ç'thua, Uran?

As Urani dhe as të tjerët s'u ndien. Këtë radhë rrëfimi i Malit i kishte bërë të gjithë të urtë dhe u kishte ndezur fantazinë. Secili përfytyronte atë fushë të pamatë, atë tokë djerr që e digjte dielli dhe e ngrinte acari i dimrit.

— Çudi, — bëri së fundi Urani, — çudi! — Ishte në mëdyshje. Asaj që dëgjoi edhe s'i besonte, por nga ana tjetër qejfi ia kishte të ishte vërtet ashtu.

— S'ka asgjë për t'u çuditur, — tha më i vjetri ndër ta, duke u zgjatur paksa e duke i dhënë secilit kutinë e duhanit. Atë e trembi qëndrimi i të tjerëve. Heshtja që ra menjëherë pas tregimit të Malit s'i pëlqeu. Ata s'po i dukeshin më si burra, por si fëmijë.

— S'ka asgjë për t'u çuditur, burra, as për të vrarë mendjen. Më ka qëlluar dhe mua të shtyhem tutje Malit të Egër. I kam parë ato që thotë Mali, ashtu është.

— Ne jemi budallallepsur fare, — u hodh Urani, — hamë veten me dhëmbë për një pëllëmbë tokë dhe nuk shtyhem tutje. Bota as fillon këtu dhe as mbaron këtu. Andej poshtë digjet e zhuritet toka, kurse...

— Ç'kujton ti, o i uruar, — ia ktheu më i vjetri, — mos vallë atë tokë e kanë lënë për të qarë hallin ty? Ç'është ajo, bakllava që ta kanë nxjerrë ty përpara? — përfundoi ai me shaka.

— Unë s'jam mësuar me bakllava, — ia ktheu Urani i prekur, — unë jam mësuar me pikën e djersës. Gjithçka që të sheh syri e të kap mendja këtu e kudo, djersa e ka bërë. Si lihet toka djerr?!

— Ne të dy dhe gjithë fshati ynë s'e lë dot, — tha më i vjetri, — por ai që ka edhe e lë, zaten ai që ka i bie së mirës me shkelm.

— Ai që i bie tokës me shkelm i ka rënë nënës së vet, — tha Urani, — dhe ai s'është më njeri.

Nisi erë më e ftohtë. Hëna u fsheh mbas një reje. Herë-herë dëgjohej ndonjë e qarë fëmije. Burrat u ngritën dhe pas pak sheshi mbeti i shkretë.

\* \* \*

Pranvera në Malin e Egër, edhe pse vjen pak vonë, e sjell bukurinë e vet. Burrat varin gunat dhe përveshin llërët. Gratë heqin tërkuzat nga shpina e lyejnë shtëpitë. Pranverën e ndiejnë më shumë lulet dhe fëmijët. Lulet harlisen prej motit të

ngrohtë, ndërsa fëmijët zbathin çorapet e grisura e të rënda të leshit, bredhin me këmbët e trëndafilta nëpër shkurre duke imituar blegërimën e qengjave.

Fshatarët, në gjysmë të prillit, nisën të mbillnin selishtat. Duke hedhur farën, u dridheshin duart, pasi e dinin se gjysma e saj do të shkonte dëm, do ta kalbte dheu. Ajo që do të mbetej do të bënte pak përpyetë dhe do të jepte një kalli me pesë-gjashhtë kokrra në majë.

Urani sikur s'kishte ndër mend të mbillte. Kishte disa ditë që mendja i bridhte lart.

Kurrë s'u kishte besuar atyre që tregonte Mali, i quante pallavra, por historinë e tokës s'po e kalonte dot lehtë. Iu shfaq edhe në gjumë. Tokë, tokë e pakufi. Disa net u gdhi qull në djersë. Rrinte mënjane i heshtur. Po bëhej i çuditshëm, madje disa filluan të thoshin se e kishin parë të fliste me veten. Fushë, fushë, këtë mendonte e, ngaqë s'mundta krahasonte me diçka tjetër, i hidhte sytë drejt qiellit. Një dëshirë i vlonte në zemër. Vendosi të shkonte në ato vende që tregonte Mali. Disa prej fshatarëve i kishin folur rëndë. Atë tokë, nëse nuk e ka ndonjë si bejlerët e Kodrasit, patjetër që e ka vetë mbreti. Ai nuk e pranonte një gjykim të tillë. Për të s'mund të kishte zot një gjë e braktisur e aq më shumë toka.

Unë do të zë një pjesë sa për vete, nuk i hyj në hak njeriu. Do t'i jap djersën dheut dhe prej tij do të marr bukën. Këtu po e mbjellim misrin mbi gurë, kurse atje tej, tokën e kanë lënë shterpë, të zhuritur, as që duan t'ia dinë. Unë s'jam me këtë mendje. Vetëm do të shkoj. S'kam frikë, po të isha i tillë do të kisha vdekur njëqind herë deri sot.

Një natë e porositi të shoqen se, po të pyetnin për të, t'u thoshte se kishte shkuar për miqësi.

— Pse, ku do të shkosh? — e pyeti ajo.

— Tek ëndrra, — tha ai pa e menduar atë që nxori.

E shoqja e vështroi e habitur dhe ia nisi nga shërimit. Edhe ajo diçka kishte dëgjuar nga të tjerët për gjendjen e re të burrit të saj. S'kishte dashur t'u besonte, po ja që ata paskëshin pasur të drejtë.

— Si të thashë, — tha ai që e kapi fillin, — si të thashë. oh, unë jam i luajtur, i luajtur, për kokën e djalit!

Ata nuk kishin as djalë, as çupë.

— Ç'djalë!? — bëri e shoqja akoma më e habitur.

— A nuk të kam thënë. Hënë. ti je grua e rëndë tani e së shpejti do të lindësh djalë!

Ajo e vështroi dhe në fvtyrën e saj të skuqur svtë qeshën dhe prej tyre rrodhën dy pika lot që morën tatëpjetë e qëndruan te buzët paksa të hapura. ku dukeshin dhëmbët e bardhë e të ndritshëm si guralecët nën rrezet e hënës.

Natën doli nga shtëpia me qëllim që njerëzit të mos e shihnin, se ruhej mos i ndodhte si Malit, që u nis për kurbet dhe u kthye përsëri në fshat dy herë më i pikëlluar seç ishte.

— Uran! Uran! — bëri e shoqja. Ai i shtrëngoi duart dhe ato iu dukën tepër të dashura e të ngroh-ta. Iku. Mori me vete Ziganin, qenin e tij, më trimin ndër sojin e vet në Malin e Egër, i cili natën nuk dukej, se ishte në ngjyrë të zezë, ndërsa ditën,

të çudiste me atë trupin e tij sa një dem. Fshati flinte nën hijen e natës e të maleve. Të dy udhëtarët agu i zuri në qafë. Ai hodhi sytë për qark. Male la prapa, male kishte përpara. Atje ku takohej mali me qiellin, duhej të ishte fundi. Ndoshta aty fillonin ato fusha të gjera, që s'mund t'u vinte kufi syri. E, atje do të ngulej, të ikte nga Mali i Egër, që s'kishte vend për varret e të vdekurve e jo të mbante të gjallët që lëvizin e duan të hanë.

Zigani i madh ecte rëndë-rëndë, pa u lodhur.

Në mesditën e ditës tjetër Urani arriti atje ku takonte mali me qiellin. Përpara s'kishte më male, por...

— Tokë! Tokë! — thirri njeriu, sikur vetë të mos kishte udhëtuar mbi të po mbi një oqean të pafund.

Gëzimi i madh ta rrëmben mendjen dhe ai njeri, i lodhur dhe i drobitur nga tërë kjo rrugë, hidhej përpjetë, rrokullisej e klithte si shqiponjë.

— Zigan, tokë, o i uruar, tokë, pa tokë edhe ti vdes!

Mori përroin në të djathtë, që varej rrëmbyeshëm tatëpjetë e që shtrohej duke gjarpëruar në fushën e blertë.

Kur shkeli mbi hapësirën e sheshtë, fryu një erë e lehtë, e freskët, jetëdhënëse. Bari i ri, i gjelbër e plot çumësht u përkul deri në tokë. sikur t'i uronte mirëseardhjen njeriut. U ul në gjunjë, iu fal asaj bukurie dehëse. Zemra e fshatarit, e përveçuar nga malli i tokës, u mbush tërë kënaqësi dhe kjo e bëri si të shushatur.

U shtri mbi dyshekun e gjelbër. U zgjua vonë. tamam si një njeri që i kishte vënë punët në vijë.



E ndjeu veten të shpirë, të çlodhur dhe ia kishte ënda të këmbente dy fjalë me dikë. Zigani flinte e ai i foli tokës: «Një pëllëmbë tokë ka çdo shtëpi në Malin e Egër, s'ka ku të vejë më rëndë. Ti këtu qenke mashallah, të ngopke zemrën dhe syrin. Të kanë braktisur. Mallkuar qofshin ata! Do t'u them njerëzve të mi të vijnë këtu. Po s'erdhën, do të marr gruan time, Hënën dhe djalin. Djali s'ka lindur akoma, më mirë, le të lindë këtu dhe të të dojë ty siç do të dojë nënën e vet.»

U ngrit. Nën dritën e dobët të hënës dhe të yjeve, punoi derisa ngriti një kasolle të thjeshtë. Tërhoqi lesën që shërbente si derë dhe thirri qenin pranë vetes.

— Zigan, — i tha, — hëpërhë, ja shtëpia jonë. Edhe kjo, është toka jonë, ende jo tamam, po me të filluar ta ujisim me djersën tonë, s'ka zot tjetër më ajo veçse ne. Ai që e ka pasur këtë tokë e ka braktisur, ti e sheh vetë, e pse...

Qeni ngriti kokën dhe i nguli sytë Uranit.

— Të gjeça shëndoshë, — tha njeriu me dhimbje.

Zigani e përcolli deri aty ku fillonte mali e, pasi lehu fort-fort dy-tri herë, u kthye për në kasolle.

Kur ishte në ngjitje, e dëgjoi edhe një herë të lehurën e qenit. Ajo ishte gjëmimtare e mbaronte vajtueshëm. Ai u rrëqeth dhe mallkoi veten për atë mendim që i ndolli mendja.

Dy ditë më pas, Urani dhe e shoqja, e rënduar, kishin vënë para një gomar, mbi të cilin kishin ngarkuar tërë pasurinë e tyre, duke futur këtu edhe dy pulat dhe një gjel. I gjithë fshati kishte dalë për t'i përcjellë. Është zakon në ato anë që nje-

rëzit, bashkë me përcjelljen bien edhe ndonjë dhuratë: një dorë fasule, një kurorë qepë apo një grusht trahana. U përcoll me të gjithë e tani i kishin mbe-tur disa pleq të moçëm, që ishin zënë ulokë. I takoi të gjithë pranë sofatit të shtëpisë. I fundit, që kishite dalë me mudim të madh deri te rruga, i tha:

— Ti po ikën, Uran, jo se nuk e deshe Malin e Egër, jo se nuk na do ne mbi dhe e ata nën dhe, jo se nuk do pyllin dhe gurët. Unë jam plak e s'dua të marr gjynahe me vete...

Urani u mat të fliste.

— E di pse ikën, e di, — i tha plaku. — Ti u ke thënë njerëzve se atje misri bëhet me tre kallinj. ti u ke thënë se gruri atje e bën kallirin të rëndë sa një kokërr ftua. Dhe njerëzit të zënë besë, se ti vetë ke qenë nga ata që s'ke besuar kurrë. Po ti u ke thënë se atje ka fusha të tëra djerr, pa zot. Kjo mua më plak edhe një herë kaq. O është toka e mallkuar, o janë njerëzit.

Urani dhe gjindja aty përreth ngrinë. Të gjithë po vritnin mendjen të gjenin fillin e fjalës së plakut. E të gjithëve u shkante mendja për keq.

— Kam dhe një, — tha plaku.

Një parandienjë edhe më tronditëse pushtoi gjindjen. Në këto raste vetëm urimi «udha mbarë», i vjetër sa vetë njeriu, i thuhet atij që largohet.

... — Pra dhe një kam, — vazhdoi plaku, — nusja ishallah një djalë!

Njerëzia mori frymë e lehtësuar, sikur u rikthve në ietë. Të gjithë filluan të putheshin e të përsofoheshin me Uranin dhe nusen.

Karvani mori rrugën. Hënës s'i reshtnin lotët,

por edhe Urani, pak po ta lëshonte veten, do të qante dy herë më shunë se e shoqja. Kafsha para mezi ecte. Hëna mbeti prapa.

Me këtë të ecur, ai mund të arrinte atje ku kishte lënë Ziganin vetëm, në fund të muajit.

Kafsha kishte mbi vete pasurinë e shtëpisë dhe e shoqja atë të gjakut, të shpirtit. Ç'të bënte? Liroi ngarkesën e hajvanit dhe e hodhi mbi kurriz ndërsa mbi kafshën e urtë hipi Hënën. Ritmi i ecjes u shtua, po njeriu i ngarkuar gulçonte dhe avullonte djersë. Ecnin pa folur. Dëgjoheshin vetëm trokëllimat e gurëve nëpër këmbë dhe herë-herë kakarisja e pulave, që Urani i mbante në një torbë mbi supin e majtë. Ndaluan për një kafe. Pas dite, kur u largua vapa, u nisën. Ecnin andej nga shkante edhe dielli. Por, ndërsa ky e kishte shesh përpara, karvani i gjorë shfaqej dhe zhdukej me orë të tëra, pa i shkëputur lidhjet me diellin. Nata i zuri në majën e malit. Aty ata dukeshin sikur kishin shkuar mysafirë në qiell. Në të aguar u nisën. Qielli nuk u zbardh më, sepse diellin e ndiqnin, çap pas çapi ca re si shtëllunga të zeza. Kjo e lehtësonte udhëtimin, po merak u se mund të binte shi e shqetësote Uranin. Tani ai vinte pas, edhe pse ishte balli i atij karvani. Këmbët i hidhte zvarrë nga pesha që kishte mbi kurriz. Opingat i ishin holluar si lëvozhgë, ndërsa sytë i ishin veshur me një cipë si ajo e qepës. Nuk shihte ku e hidhte këmbën. U pengua pas një rrënje e u rrokullis me gjithë ngarkesë deri në fund të rrëpirës. Nga goja dhe hunda e sakatosur i kullonte një gjak i kuq, i trashë e djegës. Po njeriu i rrëzuar u ngrit. Hodhi përsëri ngarkesën mbi shpinë. Kur mori torbën, pa se njëra nga

pulat gjatë rrokullisjes, kishte cofur. E nxori dhe e vendosi lehtë mbi një gur. Tjetra kakarisi nja dy herë. Urani u ngjit. E shoqja, që e priste buzë greminës, rrinte si në ethe.

— Kthehemi, Uran, kthehemi.

Ai e mbështeti ngarkesën mbi një gur të madh e tha:

— Atje ku do të vemi ne, toka është e sheshtë, dhe të duash të rrëzohesh nuk rrëzohesh dot. — I hodhi sytë së shoqes. Ajo ishte zverdhur e bërë meit. Në fytyrën e saj dukeshin damarët jeshilë.

— Si të mos vemi, Hënë. Atje na pret Zigani, toka dhe shtëpia jonë. Shtëpi, thashë! Po do të bëjmë një më të mirë dhe djali në dyshemenë e saj do të bjerë...

E ndërpreu fjalën, se gjaku i buçiti përsëri dhe e shoqja i vuri shaminë e kokës në gojë.

Një bubullimë gjëmoi nëpër qiell. Nga diku larg vinte një zhurmë sikur rrokulliseshin gurë.

— Do të bjerë shi, — tha ajo.

— Ne duhet të mbjellim sa më shpejt misrin, — tha ai dhe humbi në gjumin e rëndë të lodhjes. Nata zbriti në tokë shumë shpejt. Pus nga të katër anët. Nisën pikat e para të shiut.

Urani u zgjua. U vunë përsëri në udhë. Ecën derisa toka nën këmbë u bë e rrëshqitshme. Shiu ia dha me gjym e ata hynë në një guvë. Një shigjetë e zjarrtë u përdrodh si nepërkë dhe goditi lisin aty përballë. Karvani u drodh, u verbua, ndërsa lisi mori zjarr. Ai mbështolli të shoqen pas vetes dhe ajo, e lagur, zuri të ngrohej dhe të hapte sytë nën gjoksin e tij. Ai e përkëdheli. E afroi më pranë dhe të dy u ngrohën pranë njëri-tjetrit.

Lisi e humbi flakën, lëshonte vetëm tym, që nxinte më shumë se terri i natës.

Mbas largimit nga fshati, ky ishte pushimi më i gjatë që bënë. I zgjoi përroi aty pranë, që binte gur nga mali.

— Ky përrua kalon pranë arës sonë, më duket, — tha ai.

— Duhet nxituar, — tha Hëna, — se Zigani s'ka ç'të hajë.

— Zigani është i mençëm, — tha ai, — e në tërë atë fushë do të dijë të gjejë ushqim.

— Qeni nuk ha bar, — tha ajo.

— Atje bari është gjithë qumësht, — tha ai. Hëna qeshi..

— Në duhet të qeshim, — tha Urani, — se mbas kësaj së keqeje do të gjejmë një të mirë. — Dhe qeshi edhe vetë.

Dielli në qiell dukej sikur luante me retë. Një avull i ndritshëm çlirohej nga toka e përgjumej një metër mbi të. Mbi karvanin ngrihej tani ai mali ku Urani kishte thirrur: Tokë, Tokë. Ja dhe ajo maja si dhëmballë. Po ta vështroje, ajo dukej sikur do të të sulej mbi kokë. Mbasdite arritën atje. Dielli shndriste hapsirën dhe fushën. Përroi që zbriste nga mali, si i hazdisur, shtrihej mbi fushë si një shirit i kafenjtë. Një erë e lehtë frynte e sillte aromën e tokës së panjohur. Hëna ishte mbështetur pranë një gëmushë. Shikonte si e trembur atë që shtrihej para saj. Kurrë s'kishte parë kaq hapësirë. Ajo, bijë dhe nuse, ishte nga Mali i Egër. Mbuloi këmbët lakuriqe me fustanin e leshtë dhe pshe-rëtiu.

— Ç'ke, pse mendohesh? — pyeti Urani.

- M'u kujtua fshati. — tha ajo:
- Kujtimi është një gjë e mirë, — i tha ai.
- Është zahire për shpirtin.
- Paskemi dhe lumë pranë! — tha ajo.
- S'është lumë, por përrua. Ka rënë shi. Po sidoqoftë ky është fat tjetër për ne. Se toka, do ujë, Hënë, toka pa ujë është si gruaja shterpë. Po ngrihu, ngrihu të vemi e të çlodhemi në shtëpinë tonë.
- Pse, erdhëm? — pyeti ajo.
- Erdhëm, — tha ai.
- Nuk kam frikë nga rruga, — u përgjigj Hëna, — mos më gënje, se, po të kishim ardhur, Zigani do të na e kishte ndier erën.
- Vërtet! — bëri ai dhe pastaj shtoi: — Eh, ç'është ai, ç'është, kushedi ç'i ka thënë mendja.
- Ai e ngriti hopa të shoqen, por ajo s'deshi të hipte mbi kafshën.
- Epo unë s'të mbaj dot në krahë, — i tha ai dhe qeshi.
- Ajo iu var në qafë, e shtrëngoi fort-fort dhe i tha:
- Jo, jo, do të eci vetë. Dua të vete me këmbët e mia në shtëpinë e re.
- Perëndimi që i trëndafilte. Hijet e muzgut ranë në fushë. Hija e karvanit shkoi deri buzë përroit. Ai vështroi me mëdyshje. Para disa ditësh po në këtë rrugë kishte kaluar, po përroi s'ishte kaq afër! Po shkelte mbi një ledh të kuq. Përroi kishte dalë nga shtrati. Vende-vende kishte hedhur gurë e vende-vende trugje e shkarpa. Kasollja s'po dukej. Ai shpejtoi. Diku, jo shumë larg, pa vetëm katër hunj. Po Zigani?! Mos vallë!?...

I krisi diçka në gjoks. Ecte dhe sytë s'ia ndante kasolles, që i ngjante një kali të ngordhur.

— Zigan! — thirri, — Zigan, — e ndërkohë, mu pranë kasolles, pikërisht aty ku kishte qenë ajo lesa e derës, i zuri këmba diçka të butë. Njeriu vështroi me sy të tmerruar.

— Zigan! — thirri Urani dhe futi thellë krahun në flum për të nxjerrë atë gjënë e butë që kishte nën këmbë. Dhe e nxori. Ishte koka e madhe e Ziganit e pak më tutje bohçja e plaçkave. Përroi, që kishte ardhur natën e kaluar, e kishte gjetur qenin brenda në kasolle. Në çastin që ai kishte bërë përpjekje për të dalë jashtë, një kërcu i kishte zënë derën dhe ndoshta e kishte goditur fuqishëm në kokë. Po plaçkat kush i kishte prurë aty! Ai, kur iku, i la te këndi matanë. Me sa u kuptua, Zigani i kishte rrëmbyer ato dhe kishte bërë të dilte jashtë. E ngriti pranë gjoksit trupin e qenit. Ai ishte shumë i rëndë. Qeni deri në çastin e fundit i kishte ndenjor besnik të zotit. Gruaja dhe burri rrinin pranë Ziganit të shtrirë. Ishin të pikëlluar sikur të kishin aty para ndonjë të vdekur të afërt.

— Zigani ka lindur në mal. Dhe ne atje duhet ta varrosim, — tha Hëna e përlotur.

— Si, të shkojmë!?!...

Një mendim ogurzi i vërvitej asaj në kokë. Ia shkrepri një së qare me ngashërim, gati me kujë dhe u shemb mbi thesin e plaçkave.

— Këto janë punë të rënda për gratë, — tha ai.

Mori Ziganin në krahë dhe pak më tutje e varrosi.

Kur u kthye, e shoqja flinte rëndë dhe ai i ho-

dhi një velencë të dhirtë. Trupi ia donte që të shtrihej edhe vetë se ishte i lodhur, madje i rraskapitur, por e kishte vendosur që të nesërmen do të fillonte patjetër mbjelljen e misrit. Pranvera, sa ç'është e bukur, është edhe e pabesë. Disa punë duheshin bërë, dhe ai filloi sipas rradhës. Shkarkoi parmen dën. Nxori nga torba pulën dhe gjelin e i la mbi bar duke u hedhur ca kokrra misri. E pastaj shkuli katër hunjtë e kasolles së vjetër dhe i nguli larg përroit, larg kasolles së parë. Donte që e nesërmja të mos e zinte pa çati. Vajti në shelgjishtë e bëri lesat anësore. I mori dhe i vendosi duke e krijuar përsëri shtëpizën e tij të vogël. Mbasi mendoi se s'kishte gjë tjetër të ngutshme për të bërë, vajti e u shtri pranë së shoqes. Hëna rrëshqiti në qiell. Qetësi. Dëgjoheshin herë-herë shfryrjet e gomarit dhe çukitjet e pulës e të gjelit. Nga shelgjet vinte kënga e përroit dhe e zogut të natës.

Dielli i mëngjesit në pranverë ka forcë dehëse. Por një forcë më të madhe ka toka që ngacmohet nga ato rreze. Aroma e dheut, e përzier me atë të barit dhe të luleve të fshehura, e bën shpirtin të këndojë. Ai u shtriq dhe u shtri njësh me tokën e pastaj, sikur të kishte marrë forcë prej saj, u hodh përpjetë e, kur qëndroi më këmbë, qeshi gjithë gëzim.

Gomarit, që kishte kullotur gjithë natën, tani i vetëtinte qimja. Ndërsa pula, pak më tutje, çukiste majën e barit plot sqimë. Aty pranë, e shoqja qeshte me diellin. Një flutur, me të gjitha ngjyrat e ylberit mbi krahë, i vinte përreth fytyrës së Hënës dhe lehtë e prekte te mollëza e djathtë. Ky ngacmim e bënte atë të qeshte.



— Ngrihu, nuse, — tha i gëzuar Ūrani. I pëlqeu që e thirri ashtu. Dhe ajo vërtet nuse ishte. E kishte barrën e parë, të parënë shumë në sy, por jo për të shoqin, i cili në atë çast përfytyroi edhe djalin.

Gruaja nuk po ndihej. Flokët e zinj të lidhur gërshet i kishin rënë mbi barin e vesuar. Pushi i lehtë përreth buzëve i vetëtinte si gjilpërë. Ai u ul më gjunjë dhe e puthi aq lehtë, sa e puthte flutura te mollëzat.

Nga fundi i hejbeve nxori belin, i futi një bisht të latuar për merak dhe doli jashtë. Qielli ishte i pastër e vetëtinte si shpina e përroit aty matanë. Vetëm një re e bardhë, e hollë si bisht kali, davaritej në horizont. Rrezet e diellit e ngrohën sikur të ishte larë me ujë të vakët. Hodhi sytë në kufirin më të largët të arës që kishte menduar për të mbjellë. «Plot, shyqyr», — tha. Pastaj e tërhoqi shikimin më pranë e u përqendrua mbi një varg të zi mizash përdhese që i kalonin te këmbët. Njëra prej tyre kishte rrëmbyer një majë bari të thatë dhe e tërhiqte, duke u rrokullisur keqas së bashku me të.

«Shiko si qepet! Punëtore të mëdha janë, s'ua gjen shoqen, veç njeriut. Ai është më i forti. Unë s'u kam besuar kurrë përrallave. Ndoshta do t'u besoja, por unë s'kam dëgjuar shumë nga ato. Gjyshërit s'i gëzova dot. E shkreta nënë, më la fëmijë, kurse im atë, nuk ishte qejfli përrallash. Unë them se është njeriu dhe jam i sigurt, sepse kështu më përgjigjet vetja ime. Mjafton me ato që kam hequr.»

Shtrëngoi belin fort e bëri disa hapa më tutje kasolles. Tokën që kishte menduar për të mbjellë do ta kthente njëherë më bel, sepse nga vitet ajo qe

bërë jo vetëm shterpë, por edhe ploçë. Ndihej i gëzuar. Kur i dha me këmbë fort dhe e nguli belin, shpëtoi nga një dridhmë shpirtërore që po ndiente. E ktheu plisin dhe tërë kënaqësi, si të kishte para një bukë ponicë të rrumbullakët, e ndau thela-thela. Përsëri një valë tronditëse, po kësaj radhe e kaloi duke thënë: «Për hair! Do të të dua siç kam dashur nënën time.»

Nga zemra e plisit, e ndarë në pjesë, gufoi aroma jetëdhënëse e dheut. Nisi të punonte me nxitim. E ngulte thellë veglën dhe me lehtësi të madhe, sikur ta kishte mbushur me shkumë, e kthente mbrapsht. Herë-herë ngrinte kokën. Fshinte ballin e larë në djersë duke lënë mbi të gjurmët e dheut dhe pluhurin që lëshohej nga lëvizjet. E shoqja kishte dalë nga kasollja. Ishte ulur në krye të arës dhe kundronte të shoqin. Bukurinë e tij, shtatin e gjatë e të fortë për të cilin ajo krenohej heshtazi. Shtriu këmbët. Afshi i tokës së punuar e ngrohu. Mbushi duart me dheun e ngrohtë dhe fërkoji pulpët e saj të bardha. Urani e vuri re dhe ia bëri me dorë. Ajo, duke u hedhur plis më plis, i vajti pranë.

— Hënë, a e shikon ç'tokë, sterrë e zezë, — vuri buzën në gaz, — dy gjëra duhet të jenë në ngjyrë të zezë, toka dhe kokrra e fikut, — qeshi, — kurse gruaja duhet bardhoshkë, si ti!

Ajo e vështroi me mall e me sy të përlotur.

— A të kujtohet si ishte toka në Malin e Egër? Gur, gur, që të binte bretku tërë ditën, ndërsa këtu të zë malli të shohësh një të tillë.

Hëna qeshi. Buzët e saj të holla u drodhën.

— Të zë malli? — tha ajo. — Por unë e kam një të tillë këtu në grusht.

— Gur, — bëri ai, — gur, ja, na, më qëllo, — dhe zgjati kokën. Ajo e qëlloi. Plisi i vogël që i kishte mbetur në dorë. me të rënë mbi kokën e Uranit, u shkërmoq. Ai qeshi me zë dhe. duke e kapur për mesi, më vrull e afroi pranë gjoksit të vet.

Ai e dinte fort mirë se ç'mbante trupi i saj, që kishte nisur të rrumbullakosej. Ngrihej dhe, pasi i mbushte mendjen asaj që ose të pushonte, ose të shkonte në kasolle, e riniste punën i qetë e akoma më me forca. Në atë kohë që u largua Hëna, dielli ishte në të perënduar. Afshi që çlirohej nga toka e punuar, ngrihej dy pëllëmbë përprjetë nga toka. Nga përroi vinte një erë e lehtë që të thante djersën në ballë. Tashmë horizonti u përflak, shenjë kjo që linte të kuptohej se edhe dita e nesërme do të ishte e pastër. Kjo e gëzoi Uranin, i cili ktheu plisin e fundit dhe me kujdesin e ushtarit për armën, e pastroi belin dhe u largua me mendimin se të nesërmen do t'i jepte fund punës. Hëna, me t'u kthyer, kishte nisur të punonte pranë kasolles dhe kishte bërë goxha punë. Së pari një kotec për pulën dhe gjelin, të cilët me siguri dremitnin tani. Pastaj kishte zënë baltë e kishte mballosur lesat anësore, ku dukeshin ende gjurmët e gishtërinjve të saj. Te këndi kishte sajuar një shtroje prej bari e fieri, të mbuluar me velenxë. Në mes të kasolles kishte vënë vërbën me fasule që ia kishte nisur këngës me kohë.

Burri, pasi rregulloi kafshën, hyri në kasolle dhe e vuri re dorën prej nikoqireje të gruas. Qeshi e tha:

— Hënë, mos je lodhur shumë?

— Jo më shumë se ti, — iu përgjigj ajo.

— Ti je vetë e dytë.

Ajo i foli me sy dhe shtroi për të ngrënë.

Më vonë ranë të flinin. Burri vuri kokën e ftoh-të e të lagur nga djersa mbi krahun e bardhë të së shoqes.

— Nuk duhet të lodhesh, Hënë, — qeshi. Donte të thoshte diçka tjetër, se e ndiente veten të lumtur atë çast.

— Ti, pse flet me vete, Uran? Ti gjithmonë kë-shtu bën.

— Ky është një zakon i vjetër. Të flasësh me vete, me aq sa di unë, është një gjë e mirë, pastaj dhe një fjalë e urtë thotë: Mat shtatë herë e prit një herë. Ti mos ki gajle, Hënë, se unë gjithmonë flas e mendoj për gjëra të mira, se atëherë; ç'u kuptua? Për shembull, tani desha të thosha se tokë kemi plot, kemi tokën tonë. Ajo ka nevojë për krahë. Të kishim... çfarë?

— Djalë, — tha ajo duke buzëqeshur.

— Pesë të tillë, — tha ai me gëzim. Përfytyroi sikur i kishte aty pranë. Qeshi përsëri. — Do të... — e këputi gjumi e as nuk foli e as nuk mendoi më.

E shoqja liroi krahun. U ngrit. Ushqeu zjarrin me qëllim që balta e lesave të thahej më shpejt e vajti ra përsëri. Nga përroi vinte kënga e njohur e shelgjishtavë. Bulkthi cicëronte përçark. Yjet në qiell ndritnin, por zjarri aty në mes të kasolles, që dukej nëpërmjet lesës, ishte më i madh dhe më i shndritshëm.

Të nesërmen në të errur e mbaroi pjesën që i kishte mbetur e nuk ndihej shumë i lodhur. prandaj pati qejf dhe u shtri brinjazi ndanë arës. Një cast u ngrit si i frikësuar. Vështroi, por nuk mundohej të shquante ndonjë gjë, sepse në kokë po i lindte një

mendim i keq: «Si! Kjo është toka ime!» Një ndjenjë pasigurie dhe frike e pushtoi. «Mos vallë jam në ëndërr?» Edhe atëherë kur futi këmbët në dheun e ngrohtë, edhe atëherë kur u shtri i tëri barkas mbi të, vazhonte të ishte po në atë gjendjen e fillimit. Po sikur e mblodhi veten. Sytë iu pastruan dhe ai pa qartë ngjyrën e zezë të arës, e cila, nën muzg, ishte kthyer në të kadifenjtë. Kërceu përpjetë duke thënë:

«Kjo është toka ime.» I vuri kapak atij shqetësimi. U sigurua se toka i përkiste atij dhe kjo nuk ishte ëndërr, ashtu siç nuk ishte ëndërr që ai ishte Urani nga Mali i Egër.

Qetë-qetë, duke iu gëzuar tokës që ishte ujitur nga djersa e tij, hyri në kasolle. Shpresonte të kishte prodhim të mbarë. «Këtu s'mund të ndodhë ndryshe, — tha ai duke fërkuar në mes dy duarve copën e plisit, sikur të ishte sapun, — këtu jo. Kjo është tokë e shëndoshë. Një nënë e shëndetshme edhe fëmijët të tillë i lind, ndërsa kur është si ajo e Malit të Egër, — e ai, ashtu sipas zakonit, e përfytyroi atë si një grua eshkë, me gjoksin pllakë, — ç'do të presësh nga ajo, — tha, — ajo s'ka pështymë dhe jo qumësht.»

Mbërtheu parmendën pranë kafshës, së cilës po i varej koka nga pesha e kularit. E kontrolloi mirë e mirë, i kroi dy-tri herë kurrizin dhe i kapi veshët e gjatë duke i thënë edhe një fjalë me të qeshur.

Hëna kishte hedhur farën në një tas të madh e po vinte drejt tij.

— A, a, kështu nuk më ndjek dot. — i tha ai. — po hidhe farën këtu, këtu, — dhe i ngriti cepat

e përparëses. Kur gishtërinjtë i kapën barkun e së shoqes, u drodh dhe belbëzoi: — Po na vjen, po na vjen djali!

Ajo u skuq deri në majë të veshit nga turpi dhe kënaqësia. Hodhi farën e misrit në përparëse dhe i vajti pas. Parmenda çau para dhe ai i hoqi opingat, duke shkelur kështu zbathur mbi tokën pambuk.

— Kujdes, Hënë, dy e nga dy, që të marrë frymë fara, që të mos na dalë bima verdhacuke, por e jeshiltë e me lëng.

Ajo ndihej e lumtur dhe merakun e të shoqit i jepte gaz. I dolën në krye arës e, kur filluan vijën e kthimit, parmenda i ngulte dhëmbët dheut dhe e lëshonte butë-butë mbi kokrrat e farës. Uranin e ngacmonin mendimet. Jo pse dyshonte për rehatinë dhe ngrohtësinë që do të gjente kokrra e misrit nën atë dhe plot jetë, por sepse herë pas here i shfaqej era e Malit të Egër, e cila e gllabëronte farën.

«Si mund të rritet misri atje?! Atje farës i bie guri mbi vete. Po guri, edhe njeriut, që është i forti i të fortëve, po t'i bjerë, i...»

— E, mój Hënë, a e di ç'po mendoja?

— Edhe unë po mendoja, — i tha ajo.

— Çfarë?

— Se do të kemi misër shumë.

— Të dy në një mendje paskemi qenë, — tha ai dhe ngau kafshën. Kafsha çapitej me vështirësi, me zor po hynte në brazdë. Por ai nuk i vinte faj. Ajo s'është nga ai fis kafshësh që e ka për zanat këtë punë. Urani e dinte këtë. Nga një grusht deri në gusht, se pastaj do të blinte dy qe, që, kur të shfrynin, të bëhej mjegull.

Vonë mbaruan së mbjelli. Urani s'do t'ia falte kurrë vetes lodhjen e Hënës, por edhe ajo e fortë qëllloi, për asnjë çast nuk e lëshoi veten, veçse këtëj nga fundi këmbët po i merreshin dhe fytyra i ishte bërë si ftua i verdhë.

Pasi iku e shoqja, Urani vajti i dha ujë hajvanit dhe e lidhi te livadhi, ku bari gëlonte dhe ishte i ëmbël si ujë përroi.

Kur vajti në kasolle, nuk e gjeti brenda të shoqen. U tremb shumë dhe i vajti mendja për keq. Mos vallë nga lodhja ishte pulitur diku? I ra me pëllëmbë arës, po s'pa gjë.

— Hënë! — thirri, — Hënë!

Pak më vonë u dëgjua zëri i saj i hollë.

Ai shpejtoi.

— Ku ishe? Ku?

— Te Zigani, — u përgjigj ajo.

— Ti je e lodhur, Hënë, — i tha ai. I kapi dorën e së bashku hynë në kasolle.

Tani punët ishin lehtësuar ose, të paktën, disa prej tyre ishin në vijë, po më kryesorja për të qe meraku i mbjelljes, të cilën kishte ditë që e kishte mbaruar. Duke pasur parasysh se mbi çfarë toke ra fara, ishte shpresëplotë për bereqetin që do të merrte. Ai, nga përvoja, e dinte më mirë se kushdo se ç'do të thoshte mungesë buke.

Tani për tani ajo i mungonte, por ai jetonte me shpresën e së ardhmes. Uria e përditshme, e shkaktuar nga lodhja e mosngrënia, nuk kishte fuqi ta mundte, sepse tek ai ndjenja e shpresës ishte më e fuqishmja. Ai i ishte qepur jetës, edhe pse ajo e

kishte goditur disa herë, por kurrë s'kishte mundur ta rrëzonte. Dikur, qysh në vogëlinë e tij të hershme, e kishte për zakon t'u largohej njerëzve, jo sepse nuk i donte ata, por sepse edhe natyra i pëlqente shumë. Kur ishte duke bredhur pyjeve e livadheve të malit të lartë, e ndiente veten të gëzuar dhe harrohej fare. Ky zakon i mbeti menjëherë pas vdekjes së nënës, e cila e la, ashtu siç thoshte dhe vetë ai, një pëllëmbë. Bukuria që i kapte syri, era e malit, kërkëllima e pyjeve malore, krahërrahjet e shqiponjave, ia largonin zemrës së vogël mërzinë dhe i mbushte mendjen vetes se nëna akoma jetonte, por, me t'u kthyer në shtëpi, shikonte vetëm vatrën e mbushur me hi, dhe mbi kokë trarët e zinj që kapërtheheshin me njëri-tjetrin, atëherë e pushtonte llahtaria e gdhiehej me lot në sy. Austriakët, që hapën për dy muaj rresht një vijë fronti në Malin e Egër, i dogjën shtëpinë dhe ia morën të atin me vete. S'dihet ç'ndodhi me të, po, derisa nuk u bë i gjallë për kaq vjet, s'është vështirë ta kuptosh. Urani i parritur mbeti vetëm. Portat e mjera të fshatarëve u gjendën të hapura. Ku shtrohen shtatë lugë, nuk ka as ç'të shtojë, as ç'të pakësojë e teta. Askush nuk e përbuzi dhe ai gjeti qetësinë pranë tyre, gjeti fjalën e ëmbël, këshillën dhe kurajën, por, nga ana tjetër, ai e ndiente se i mungonte diçka e madhe, prandaj shkëputej për ditë me radhë e bridhte pyjeve duke thënë se unë jam si pylli, pylli s'ka nën e babë, pylli s'ka çati. Këto përpjekje, qysh në vogëli poqën shpejt tek ai gjykimin dhe përfytyrimin e krahas tyre zemërgjerësinë, e cila gjeti vend në tërë qenien e tij, formuan atë ka-



rakter tek i cili gjeje dy kulme, pathyeshmërinë e, nga ana tjetër, mallin me përmasë të madhe.

U rrit shpejt, dhe bëri siç bëjnë të gjithë, u martua. Hëna i qëlloi e mirë. Tek ajo gjeti kujdesin dhe dashurinë, që s'i kishte ndier pas vdekjes së nënës. Së shpejti priste djalë dhe kot ai nuk kërkonte që gruaja t'i lindte djalë. Kjo dëshirë kishte hedhur rrënjë në mendjen e tij. Edhe tani, shtrirë nën atë lisin, gjethemadh, djem po shihte në ëndërr. Jo një, po pesë të tillë, burra të shëndoshë, që rrinin kokulur para të atit, i cili, i lumtur, sa s'bëhet, po u ndante punët, dy për ta korrur misrin dhe dy për ta mbledhur, ndërsa i vogli i rrinte si oqiç nga prapa.

Me këtë ndjenjë u përmend. U ngrit, hapi krahet në një mënyrë të tillë, sikur ata që kishte parë në ëndërr t'i kishte pranë dhe po i pushtonte.

«Do ta mbush shtëpinë plot, — tha, — im atë s'pati fat, ndërsa unë!!!» — qeshi. I ra pyllit qark, për të parë nëse baqinat që kishte ngritur kishin zënë ndonjë zog; njëra prej tyre kishte nën vete dy të atillë. I mori dhe, duke vajtur në kasolle, shikonte, pa i hequr sytë, bimën e re, që tashmë kishte jeshiluar arën.

— Thëllëza! — i tha Hënës.

Po kur i pa, ajo tha duke nënqeshur:

— Dy zogj rrjepacakë!

— Pse, me të vërtetë kujtove se janë thëllëza?! — tha ai. — Që të gjuash ato, duhet të jesh i ngeshëm, e unë s'kam kohë të rri me ty dhe jo të bredh pas atyre. — Ajo i hodhi duart në qafë. Burri kishte filluar të gjallërohej. Ajo e ndjeu forcën e tij edhe në frymëmarrje.

— Unë kam parë një ëndërr të bukur, — i tha ai kur ranë për të fjetur dhe nisi t'ia tregonte.

Natën ra shi. Ajri i mëngjesit ishte i freskët dhe me cikla të shkëlqyera. Ngjyra e jeshiltë e bimës ishte bërë më e thekshme. Urani i ra rreth e rreth arës dhe vaji qëndroi buzë përroit. Uji kishte kërcyer, kishte lëvizur nga shtrati.

— Ky është përrua mali, — tha, — e nis rrugën si ujk, po këtu në fushë bëhet i butë si dele. Kjo është gënjeshtër se, pak po të tërbohët, s'e ka të vështirë të ngjitet po aq lart, sa ç'është vendi nga rrjedh. Kësaj së keqeje i duhet dalë përpara, ndryshe llumi... — Dhe atij iu drodh zemra, sepse iu kujtua Zigani i gjorë dhe po atë çast e përfytyroi misrin në arë të mbytur nga llumi. Ç'të bënte? Të ngrinte një mur? Aty pranë s'kishte gurë. Ranishtja është e pabesë. U tërhoq tutje e atje, ku fillofte toka e shëndoshë, vendosi të hapte një gropë të madhe. Atë ditë me atë u mor. Dy ditët e mëpastajme, dheun që kishte futur në të e përzjeu me ujë dhe bar. U përvesh deri mbi gjunjë, e nga mesi e lart u zhvesh lakuriq. Me këmbë e me duar nisi të përziente baltën me barin. Pastaj rrokulliste një masë të madhe balte, e mbështeste mbi gjoksin e tij dhe me tërë forcën e vet e përplaste tutje, midis përroit dhe arës.

Sa mund kërkonte kjo punë! Mjaftonte të shikoje trupin e tij, që dukej sikur kishte dalë nga uji. Mbasdite punoi përsëri dhe u lodh aq shumë, sa as zogun s'mund të mbante mbi shpinë. Mendoj ta linte e, kur kapi masën e fundit prej balte, s'pati fuqi ta hidhte, po u rrokullis në të, duke rënë hundazi në gropë.

— O! O! — thirri nja dy herë e, ndërsa sforcohej të bënte përpjetë. duart i shkonin thellë e më thellë dhe balta i erdhi deri te gusha. Pati frikë të bënte edhe lëvizjen më të vogël. Balta mund ta mbulonte të tërin.

«Si! Ky qe fundi?! I bëra gropën vetes». — tha.  
— U përpoq të lëvizte, por balta e thithi përsëri.

«Kjo do të më hajë». — tha. Përsëri nisi të lëvizte po këtë radhë mundi të kthehej brinjazi. Bënte c'ishte e mundur që kokën ta mbante lart, merrte frymë, por edhe pas kësaj përpjekjeje balta veçse e thithte. Më mirë të mos lëvizte fare. Po sa mund të qëndronte kështu? Dielli po perëndonte e, kur të errej, as anët e gropës, ku kishte rënë, nuk mund të shikonte. Dy pëllëmbë larg, anës ledhit ishte, oo frika se mos zhytej fare s'e linte të shtrinte krahët dhe të kapej atje. Balta gati po i pllakoste gojën, i dha trupit lart, shtriu të dy krahët para, duke i ngulur ata si kthetra mbi tokën e fortë dhe po aq shpejt, duke peshuar mbi ta, u ngjit i mbytur në baltë, por i gëzuar, se ia kishte hedhur edhe këtë radhë. U la i tëri në përrua. Ujij ishte brisk i ftohtë, brandaj, me të dalë, u vesh nxitimthi dhe ia nisi një vrapi qark e qark arës.

Këtë punë e vazhdoi për ditë me radhë. Ngri-ti një mur të vërtetë midis arës e përroit.

«Tani, sado inat të marrë përroi i malit, s'ka c'më bën, s'ka ku të vejë. Veçse në u bëftë me krahë», — përfundoi i qeshur.

Behari erdhi dhe u ul këmbëkrav në fushë. Plasi gjinkalla buzë përroit. Moti po bënte si ia deshi zemra. Natën binte shi i qetë, kurse ditën rrezet e diellit ngrohnin tokën, bima fuqizohej, kërcelli i saj

po ia kalonte llërës së njeriut, filloi të dilte dhe kalliri. Tani atë gropën e kobshme e përdorte si topil, ku grumbullonte ujin që merrte nga përroi dhe me të ujiste misrin... Urani ishte ngritur pa gdhirë. I lëshoi ujin arës, duke e ndjekur atë çap pas çapi. Aty nga fundi s'duroi pa e zhveshur një kalli. Ç'të shikonte? Plot me kokrra, plot me bukë! E shtrydhi paksa, dhe qumështi i bardhë i ra fytyrës e gjoksit të zbuluar.

«Mjaltë — tha, — mjaltë. Hënë, Hënë!» — thirri. Gruaja e dëgjoi, por s'doli dot shpejt te dera. Tashmë ajo ishte rënduar e me zor lëvizte.

Ai shpejtoi e hyri brenda. Mbi sofër pa gjellë të reja: qepë, hudhra, të cilat Hëna i kishte rritur me kujdes, por që vetë s'po vinte gjë në gojë.

— Uran, — i tha ajo, — kur të vëmë draprin, neve do të na vijë fëmija.

Kasollja ra në qetësi dhe atë natë ai ëndërroi. Burri shihte zotin e tokës, ndërse gruaja gazin e shtëpisë. Të nesërmen ai shkoi larg, brodhi nëpër koriye dhe u kthye me gjirin plot me kumbulla e mollë të egra.

Tërë ditën koha kishte qenë e vrenjtur. Mbasdite retë ishin nxirë e ishin afruar pranë njëra-tjetrës. Mund të binte shi, se kishte kohë që s'kishte rënë. E la hapur grykën e tonilit, me qëllim që uji të mos mblidhej po të zbriste drejt përroi. Aty pranë qëndronte një njeri. Një njeri!

— Puna mbarë! — tha ai.

— Mbarë paç e mirë se erdhe, — iu përgjigj Urani.

— A të freskohem pak, — tha i porsaardhuri, — kam bërë shumë rrugë e kam akoma për të bërë.

Futi kokën në vijë, e lloçoçiti nja dy-tri herë dhe pastaj i dha një të fshirë me dorë. Ishte një burrë kallam i gjatë, thatim, i vrarë në fytyrë, por syëmbël.

— Jam nga këto anë, — tha burri, — po punoj larg, shumë larg.

— S'ke tokë? — e pyeti Urani.

— As morra, — tha tjetri, — po kjo fusha këtu, e jotja është?

— Jo, — tha Urani, — unë kam vetëm këtë që sheh të mbjellë me misër, dhe, shyqyr, misrin s'e kam të keq. — I erdhi një mendim i tillë Uranit: Mos vallë edhe i porsaardhuri kishte po atë hall që pati ai vetë tre muaj më parë, prandaj i tha:

— Këtë tjetrën këtu, or mik vëllai, s'e ka njeri.

— Si nuk e ka njeri? Kjo është e Tokëliut! — u habit tjetri.

— Unë të thashë se kjo s'është e askujt. Unë s'kam parë njeri këtu. Për këtë dëshmitar jam unë dhe gruaja ime. — Sytë e vegjël të tjetrit u zmadhuan.

— Hiç mos u çudit, — vazhdoi Urani, — por besoji kësaj që po të them unë. Si mund të ketë zot një tokë që lihet në këtë ditë, — dhe tregoi fushën djerr. — Në qoftë se dikush e ka pasur dhe e ka braktisur, ai është i mallkuar, e s'mund ta quajmë zot. Në në Malin e Egër kështu i themi.

Ndërsa tjetri heshte, Uranit iu kujtua fjala e atij plakut, ditën e përcjelljes, se, o është toka e mallkuar, o është njeriu.

«Po që toka nuk është e mallkuar, kjo duket sheshit, — tha me vete, — misri është bërë sa një bojë njeriu dhe kalliri sa krahu».

— Hëm... — bëri tjetri, pasi e mblodhi veten,  
— po ti e di se cili është Tokëliu?

— Cili Tokëli?! Ç'është ky?!

— Gjykoje nga emri, — i tha ai.

— Unë s'kam si e gjykoj nga emri. Emri s'thotë gjë. Emri është kapistall.

Tjetrin e habiti përgjigjja. U mek një çast e pastaj ia ktheu:

— Ky emër do të thotë shumë. Atij i është harruar emri dhe ka marrë emrin e pasurisë. Tokëli, që do të thotë..., — ai nisi të shqiptonte ngadalë: — To-kë-li, pra nga pasuria. Neve fshatarëve, që jemi nga këto anë, na i dha thonjtë, sepse nuk mundëm ta hidhnim këmbën sipas dauilës së tij. Ai e helmon bujkun, është gati t'i vërë zjarrin dheut e të mos lëshojë një pëllëmbë. Dhe kujdes, o njeri i mirë, — tha urtë-urtë burri thatim, — kujdes, se ai ka miq shumë, edhe vetë mbretin e ka. — Urani, që e dëgjoi me vëmendje, tha:

— Ai le të ketë miq, edhe të gjithë mbretërit e botës le të ketë, prapë i poshtër është. Këtë e them tani dhe njëqind vjet rresht. Ne në Malin e Egër e mbjellim misrin mbi gur. Një grusht dhe është barabar me një frymë njeriu. Se, a e di ti, mik vëllai, se cili është shpirti i tokës? Njeriu është, njeriu, — e pastaj iu lut të porsaardhurit se ia donte zemra t'i shkonte atë natë në kasolle.

— Ndoshta do të më bëhet mbarë ndonjëherë tjetër, — i tha ai, — sot më duhet të iki, se edhe koha u bë gati për shi. — Urani e përcolli atë deri në fund të arës dhe u kthye. U dëgjua nga larg një gjëmim. Reja e madhe, e zezë, mbi krye, e shqyer e me cepa të mprehtë, u përhap në tërë qiellin. Zu-

në pikat e para në fillim e pastaj fije-fije të holla, pa mbarim, që thureshin midis tyre.

Hyri në kasolle. Ç'bisedoi me mikun i vërtitej ende në kokë. Puna e parë që bëri i ndërroi vendin sëpatës. E hoqi nga këndi dhe e vari diku pranë derës. Heshti një çast. Ç'kishte dëgjuar prej mikut iu dukën të njëjta me këshillat dhe fjalët e urta që i kishin thënë edhe bashkëfshatarët.

«Ç'bëjnë ata!» — mendoi, dhe për herë të parë, pas kaq muajsh, i solli ndër mend të gjithë. Sa mirë do të qe t'i kishte pranë, t'u kërkonte një mendim.

«Të thamë se e ka një zot ajo tokë. Edhe pse ai nuk duket, prapë zot mbetet...»

U ligështua sa s'bëhet më dhe të gjithë burrat e Malit të Egër i shau. Burrecë, u tha, frikacakë!

«Mua e keqja gjithmonë mbi kokë më ka ndenjtur, por s'më ka ngrënë dot, përkundrazi, unë e kam përzënë atë. Edhe këtë radhë copë-copë kam për ta bërë. Kjo tokë më njeh mua për zot, pyeteni, në s'besofshi».

Hëna, e shtrirë te këndi i kasolles, lëvizi. Urani nuk i tha gjë asaj, se nuk ndihej mirë. Kishte ditë që dridhej si në ethe.

Shiu ia dha me të madhe. Nga përroi dëgjohej zhurma e gurëve që vinin nga mali. Por ai s'e kishte më merakun e arës. Muri prej ledhi që kishte ngritur, ishte tharë dhe kishte zënë vend përballë përroit, si një gërmadhë kështielle.

Një vetëtimë cau qiellin me shi të natës dhe erdhi e u përdrodh brenda në kasolle. Shiu ia dha rreptë dhe mbulesa prej balte e kasolles u cull, filloi të cante, po, pastaj nisi të pikonte në çdo vend.

— Ngrihu, Hënë!

Po e sëmura nuk mundte. Atij iu lagën këmbët. Edhe nga lesat anësore po hynte ujë.

— Ngrihu, moj! — thirri Urani. E ngriti të shoqen peshë. Gjoksin e vet ia vuri asaj si mburojë mbi bark, sikur të ruante dritën e një qiriri që të mos e shuante shiu dhe era.

Iu mpinë duart, herë-herë i merreshin mendtë nga lodhja e lagështia. Nga gjunjët e poshtë këmbët s'i ndiente si të tijat, por së shoqes nuk iu ankua, duroi në heshtje dhe e mbajti pranë gjoksit deri në të aguar.

Në orët e para të mëngjesit retë morën vrapin sikur t'i shtynte dikush. Velloja gri e natës ia la vendin faqes së kaltër të qiellit. Një vlber vezullues ishte harkuar mbi fushën e gjerë. Bukuria e ditëve të verës u rikthye përsëri. Ai doli jashtë e vajti drejt e te pengesa e përroit. Ajo i kishte qëndruar tërbimit.

— E paske pasur hak tërë atë djersë që më more. — tha Urani e vazhdoi: — Tani më duhet të bëj edhe dicka tjetër. Më duhet shtëpia e gurtë. Po gurët? — Kaloi matanë përruan dhe u nis të kërkonte.

Pas një kohe gjeti një bregore nga ato që thoshte Mali se me një shqelm i bëje përshesh.

Ai s'kishte ndër mend të bënte këtë, por t'i mbartte gurët.

Të ngrinte një palë shtëpi të forta. Kush është zot toke, i takon të jetë dhe zot shtëpie. «Toka, — thoshte ai, — nga kjo e uruar vijnë të gjitha të mirat



e kësaj bote, nga janë e nga s'janë. Unë e kam, edhe djalin e kam. Po sa të tjerë do të kem, sa!...»

Tokë kishte aty sa për një fshat të tërë. Djemtë e tij do të rriteshin, do të martoheshin, do të shtoheshin dhe do të krijohej prej tyre një lagje me njerëz, e cila do të kishte për dru të parë ata dy njerëz të urtë e të varfër, që zbritën nga Mali i Egër: Uranin dhe Hënën.

«Po Tokëliu, unë duhet të bëj shtëpi të re, — tha, — e s'kam punë me të. Ai qenka haram, ai qenka i ligu i të ligjve, ka shumë kësisoj, që e braktisin nënën tokë e harrojnë. Ai që sillet me nënën kështu, iu ktheftë jeta përmbys e mos i mbiftë fara askund!»

Themelet po i hapte vetë. Hëna mæzi lëvizte, ishte rënduar shumë dhe ai nuk e urdhëronte as për brokën e ujit. Dielli i verës digjte tërë ditën e dheu i nxjerrë nga themelet, me të rënë në kontakt me të, bëhej kockë. Arës iu ndërrua ngjyra për herë të tretë. Misri kishte marrë një të verdhë të celur; pak të frynte dhe fërfërinte i tëri si pylli në vjeshtë. Kokrrat e kallirit e kishin pirë qumështin, kurse mustaqet po i binin përtokë. Me sot e me nesër duhej të hynte drapri. Punonte pareshtur e kur s'mundej më, vinte e shtrihej ndanë arës, nën hijen e misrave dhe, sipas zakonit, niste e bisedonte me veten. Që kur kishte shtënë në dorë atë tokë pjellore, mendonte i kënaqur, qysh nga dita ku kishte folur me atë njeriun që erdhi e iku si era, përfundimet e këtyre bisedave ishin të rënda, të këqija. Ai e kishte jetuar deri në atë moshë vetëm me djersën e vet, prandaj për të ishte e zorshme që njëfarë Tokëliu ta quante zot veten ndaj një toke të lënë në atë

ditë, të lënë djerr, të braktisur. Madje ai ishte be-tuar në heshtje se s'do të linte kurrëkënd t'i hynte në hak. Nuk i binte në qafë kujt, këtë kërkonte edhe nga të tjerët.

Tokëliu s'i doli kurrë në përfytyrim si njeri, po si nepërkë, që i turret këmba-këmbës fshatarit, një kokë e futur në tokë, nga një vrimë e së cilës dilte vetëm zjarr.

Ilaci më i mirë për harrimin e së keqes është puna dhe tek ai njeri, i cili tërë ditën e ditës ndodhej në lëvizje, u rikthyen përsëri përfytyrimet e mëparshme: të gëzuara dhe të lumtura.

Ai kishte qeshur me mall për Malin dhe për të gjithë ata burrat e urtë e zemërmirë, që mblidheshin ndajnatë dhe flitnin për gurët e arave, për motin, për bagëtinë e pastaj ngacmonin Malin për të dë-gjuar rrëfimet e tij.

Themelet e hapura i la disa ditë që të përthahe-shin e t'i piqte dielli. ndërsa vetë u nis drejt përroit për të gjetur gurë. Udhëtoi deri në mesditë e diku, aty ku fillonte buza e malit, gjeti gurë të bardhë të futur keqas në dhé.

«Gurë, tamam gurë për shtëpi. — tha, — më të bardhë se dielli.» Gërmoi për ditë me radhë e nxori shumë prej tyre: «Mjaft nxora. mjaft. Nuk do t'i bëj si ato të Malit të Egër. të rënda e të errëta, jo. E ç'më duhen të rënda. Në Malin e Egër, shtëpitë janë të rënda. hambarët janë të lehtë, kur-se këtu. hambarët duhen të rëndë...a!» — oeshi gjithë shend. Nisi të mbartte gurët. Një ngarkesë ia vinte kafshës që kishte filluar të shëndoshej e të trashej. Vetë ai po bënte noshtë e më noshtë. Puna nuk e linte të merrte frymë një ditë. Mishi i ishte

nxirë dhe pjekur nga dielli, kurse flokët, që i rrinin dikur gardh mbi ballë, i kishin rënë dhe ajo pjesë i shkëlqente si dru i lustruar.

Nga bukuria e dikurshme s'i kishte mbetur më asgjë, me përjashtim të dëshirës që i ziente në zemër.

Kafsha ecte para e njeriu pas. Herë-herë njeriu, nga lodhja e peshës së rëndë, ulej përtokë. Me vështirësi ngrihej paksa, mbështetej me gjithë ngarkesën mbi shpinë, qëndronte një hop, mbushej me frymë dhe riniste rrugën e rëndë.

«Vete e çlodhem, — thoshte, — pastaj, kur të kthehem përsëri, jam i lirë. Po, përsëri, përsëri. Epo, kur t'i bëj shtëpitë, flasim bashkë!»

Kur u kthye një pasdite nga bregorja, pa pranë kasolles dy njerëz, njëri hipur mbi një kalë të ri, ndërsa tjetri mbi një të bardhë. Ç'ishin ata?! Po ja, vetëtimthi iu shfaq nepërka, e menjëherë pas saj gryka plot flakë.

«Të jetë...! — Lëvizi shpinën e kërrusur nga pesha e gurëve. — Po Hëna?»

Ai lëshoi një kollë të thatë, i ra lehtë kafshës te vithet dhe ngau udhën. Edhe tre hapa dhe ai do të ishte përballë tyre. Ç'ishin këta njerëz që rrinin kaluar para shtëpisë së tjetrit?! Po ajo është kasolle! Sido që të jetë, përderisa ajo ka njerëz brenda, për hir të tyre njeriu i mirë zbret nga kali. Por ata s'kishin ndër mend ta bënë këtë. Me sa dukej, atyre s'u hynte në sy as kasollja, as njerëzit. Uranit iu mblodh një lëmsh në fyt dhe u kapërdi me zor. Kaloi pranë tyre dhe i përshëndeti sa për të kaluar radhën.

— Ta kemi ndier zërin që ditën që ke ardhur!

Urani, që ndërkohë po shkarkonte gurët nga shpina, nuk e pa se cili foli, por iu drejtua të dyve:

— Kjo s'është e vërtetë, — u tha, — askush s'ma ka dëgjuar zërin, as mua, dhe as sime shoqeje, Hënës.

Ata vështruan njëri-tjetrin. Ai mbi kalin e zi tha:

— ... E patëm fjalën se e kemi ditur që ti ke ardhur në këto dhera. Dhe paske bërë goxha punë të madhe.

— Më duhet të bëj edhe shtëpi të gurtë, — tha Urani.

— Prandaj kemi ardhur, — vazhdoi kalorësi, — që të të urojmë në emër të zotit tonë dhe të zotit të kësaj toke, Tokëliut.

Urani ndenji një hop fare pa lëvizur. Buzët e rreshkura e të plasaritura i shtrëngoi pas njëra-tjetrës. Lëshoi një «hëm» me hundë, kaloi dorën mbi ballin e djersitur dhe e shkundi. Bëri më tutje e shkarkoi gomarin. Pastaj u kthye e tha:

— Çfarë thashë?

— S'the gjë, — tha njëri nga ata.

— Jo, — tha Urani, — thashë se zot i kësaj toke është djersja, — dhe tregoi me dorë pikat e djersës që i thithte toka si e babëzitur.

— Zot i kësaj toke është Tokëliu, — tha ai që rrinte mbi kalin e zi, — por ai ta ka dhënë tokën, punoje. Ndaje në tri pjesë dhe ç'jep njëra, është jotja.

— Unë aq kisha në Malin e Egër, — tha Urani, — por ne s'po flasim për këtë, unë di një gjë, se s'ka zot për gjërat e braktisura. Ai e ka braktisur tokën dhe është i mallkuar.

— Tokëliu ka qenë dhe do të jetë zot i tokës,  
— tha kalorësi si për inat. — Vare vath në vesh këtë,  
Tokëliu është pushteti, është zoti...

— Zot është djersa, — ia ktheu Urani.

— Tokëliu!

— Djersa!

— Provo e fut vetëm një rën këmbë në atë arë,  
— tha ai që kishte hipur mbi kalin e zi.

— Menjëherë, — tha Urani dhe bëri nja dy hapja.

Kalorësi hoqi pushkën nga krahët dhe ia drejtoi. Ai u kthye ballë për ballë kalorësit. Me një lëvizje vetëtimë ia tërhoqi pushkën nga dora, duke e hedhur edhe atë shakull mbi dhe. E në çast, sikur gjatë gjithë asaj kohe të mos kishte bërë gjë tjetër po vetëm të kishte mbledhur fuqi, lëshoi një sokëllimë ngjethëse. Ia drejtoi pushkën tjetrit, që rrinte mbi kalin e bardhë. Ai, i lemerisur, ngau tutje, e tjetri, më keq se ai, i vajti pas.

Hëna kishte dalë dhe rrinte para derës. Ai e mori për dore dhe e futi brenda.

— Hajde, — i tha, — hajde, nesër do të korrin.

Ajo u drodh dhe po ajo dridhmë përshkoi edhe atë.

— Ata do të vijnë prapë? — pyeti ajo.

— Ti, Hënë, s'është të lëvizësh, — i tha ai, — po shtrihu.

— Ha bukë, — i tha ajo.

— Do ha, — tha ai, mirëpo veza dhe qepa aty mbetën.

Pushkën nuk e vari atje ku vari sëpatën, por e hodhi mbi sup. Tani duhej të pengjonte të shoqen,

por edhe arën. Herë-herë dilte jashtë. Zogu i natës këndonte rrallë, ndërsa përroi flinte.

Njeriu me pushkë doli në krye të arës. Në ecjen e tij kishte diçka të frikshme. E kishte hapin të rëndë, sikur të dyshonte për fortësinë e asaj mbi të cilën i shkelte këmba. Era frynte dhe në mes të arës me misër dukej sikur mbyteshin qentë.

«Ndaje tokën në tri pjesë dhe njëra është jotja, — tha njeriu me pushkë, ulur në krye të arës. — Po mbi dy të tjerat djersa e kujt është derdhur? E kujt, e kujt?»

U ngrit me vrull dhe po ashtu bëri poshtë, sikur aty e priste dikush, të cilin do ta mbërthente për fyti e do t'i thoshte se të tria pjesët i kishte larë me djersën e vet, jo njërën, po të tria. Dhe të tria i takonin djersës, pra atij.

Në mes të arës kishte mbërthyer misrin te kalliri dhe po e tundte. Krahu i djathtë u sforcua më shumë dhe tyta e pushkës e goditi prapa kokës. U largua me një qetësi të mërzitshme, si vetë ajo natë e gjatë. Hyri në kasolle. Ai e bëri shumë herë këtë veprim, hynte në kasolle e dilte në arë.

Agoi, dhe nata iku pa u ndier. Ranë rrezet e pjerrëta të mëngjesit.

— Çohu, Hënë, çohu, — i tha, — të vëmë draprin pa na zënë vapa. — Kishte qejf ta kishte të shoqen pranë atë çast.

— Na duhet djali tani, djali!

— Ata nuk erdhën? — pyeti ajo e frikësuar.

— Hënë! — tha ai. Në atë thirrje kishte dashuri dhe qortim.

Gruaja s'donte ta rëndonte më gjendjen e të shoqit.

— Uran, do të kemi djalë, — tha, — djalë, — dhe e përqafoi.

Dolën te dera. Po aty... Qëndronin, si të dalë befasisht nga dheu, tre njerëz të armatosur, hipur mbi kuaj. Dy ishin ata të djeshmit. Po ai, hipur mbi kalin çil?!

Tokëliu! Ishte fytyrëmadh dhe i ndriste lëkura si vithet e kalit. Fytyrëmadhi i tha diçka atij që kishte në të djathtë e sakaq kali i zi nisi një vrap të harbuar nëpër arën e mbjellë me misër. Misri u thye, kërciti e ra poshtë. Dy kalorësit ruanin derën e kasolles. Herën e dytë u nis kali i bardhë. Misri kërciti dhe u thye përsëri. Herën e tretë u nis fytyrëmadhi.

— Ah! — ia bëri Hëna dhe ra në gjunjë.

Urani s'duroi dot më. U hodh jashtë duke u rrokullisur. Ndërkohë dy të shtëna shpërthyen njëherësh. Ai shpëtoi, por kasollja mori flakë. U mbështet pas ledhit.

Para tij çdo gjë e ngritur me djersë e gjak, kishte rënë përdhe. Mbi to shkelte pa mëshirë fytyrëmadhi, hipur mbi kalë.

Urani i shënoi ballin atij dhe ia dogji me një plumb. Fytyrëmadhi ra dhe kali e tërhoqi zvarrë. Dy të tjerët qëlluan mbi Uranin. Ai këmbën e djathtë e tërhoqte zvarrë. Hëna e arriti dhe e tërhoqi deri te kasollja e vjetër. Më tutje nuk mundi Hëna. Një plumb erdhi dhe e mori Uranin në supin e djathtë.

— Hënë, — tha Urani, ndërsa dhimbja e plumbit të mbetur në mish e therte. Ajo u mundua ta ndihmonte, por ai i bëri shenjë:

— Hënë, vuajta për mirë, vuajta..., — i ra koka përdhe, por e ngriti prapë dhe tha: — Shko, Hënë, shko. Kujdes djalin dhe i thuaj se zot i tokës është kjo, — dhe mbështeti kokën mbi hekurin e nxehur të të pushkës.



## NËN QIELLIN E FURNALTAVE

### Novelë

#### I

Dy uzinat aty pranë zhurmojnë ditë e natë. Motorët elektrikë, zemra të pandalshme, derdhin nëpër arterie gjak të ri, të freskët. Prej oxhaqeve të larta ngjitet nëpër qiell tymi i bardhë, i cili pas pak shkrihet dhe humbet në gjithësi. Ndërsa midis tyre uzina e pastrimit të mineralit gulçon e përpëlitet. Lëvizjet i ka të ngathëta. Vjen një çast dhe zëri i jetës i meket. S'ka gjë më të rëndë sesa një uzinë mecece. Ajo masë e madhe hekurash dhe muresh duket sikur ha vetveten.

Peshën e kësaj fatkeqësie më shumë se kushdo e ndiejnë punëtorët. Humbet gëzimi dhe qetësia e zakonë. Shqetësimi i lindur papritur është i madh dhe për të gjithë.

Një tabelë e thjeshtë dërrase e lyer me bojë të kuqe, e vendosur më njëfarë shkujdesjeje, si me inat e ngutje, kishte të shkruara shifrat e realizimit të planit për atë muaj dhe për trimujorin para tij.

Grupe punëtorësh, nga ata që sapo e linin punën, ose nga ata që e fillonin, afroheshin pranë saj. qëndronin një hop sa i hidhnin një sy e pas pak largoheshin duke marrë me vete shenjën e merakut, që u dukej qartë mbi ballë dhe në sy.

Inxhinier Gjergji qëndroi tek ajo tabelë më gjatë. Uzina ku punonte ai kishte hedhur vetëm një hap mbi zero. Njëra këmbë ishte ngulur mbi një pikë dhe kishte kohë që s'po shkëputej dot prej saj. Në përfytyrimin e tij uzina mori trajtat e një njeriu superënë dhe kokëvarur. U përpoq ta largonte këtë ndjenjë të keqe, por e kishte tepër të vështirë. Rezultatet e uzinave të tjera ishin mbi njëqind për qind.

Ndërsa jona, mendoi ai. mbeti në vend. Hedh një hap para, vetëm një hap. pastaj hesht. Deri kur do të vazhdojë kjo gjendje?! Uzinë pa gojë, uzinë gjuhëprerë...

Tej u dëgjua sirena e furnnaltës dhe Gjergjit iu bë sikur e tundi dikush nga supet. Vështroi andej për disa caste dhe kur pa flakën, që dukej sikur nxitonte t'i jepte edhe vetë kupolës së qiellit ngjyrën e kuqe. e ndjeu veten të qetë e të gëzuar.

«Ajo flakë nuk duhet të shuhet kurrë, — tha ai me vete. — ne u mësuam me të dhe jo vetëm ne, por dhe qielli vetë».

## II

Makineritë ishin vendosur në dy salla, në katin e parë e të dytë, dhe mbi to ngriheshin dy vinçaurë, në kabinën e njërit prej të cilëve ishte ve-

ndosur portreti i një këngëtareje të njohur. Në të djathtë ventilatorët e mëdhenj, gojëhapur sa mund të futej në të tërësisht trupi i njeriut, mezi prisnin të fillonin punën. Menjëherë pas tyre niste rrethi i makinerive. Të vogla e të shndritshme, ato të kujtonin një rresht fëmijësh të veshur me përparëse të bardha dhe në qëndrim gatitu. Diku aty pranë kishte zënë goxha vend barabani i madh, i mbështjellë me një fletë të shkëlqyer çeliku, që krijonte një pasqyrë ovale me përmasa gjigante, në të cilën pasqyroheshin makineritë dhe herë-herë ndonjë punëtor që kalonte rastësisht pranë saj. Përshtypja e pastërtisë dhe e rregullit përfitohej qysh nga takimi i parë me këtë ambient, por tashmë kjo i binte në sy vetëm vizitorit. Punëtorët e krahasonin këtë ambient me një mollë të kuqe, që të merr më qafë nga bukuria, por që përbrenda krimbi zë valle. Pikërisht tek ai barabani që të rrëmbente sytë prej shkëlqimit, kishte zënë vend e keqja. Aty ishte zemra dhe aty krimbi kishte ngritur folenë. Trupi i asaj makinerie ishte holluar mjaft dhe herë pas here (kohët e fundit gjithnjë e më shpesh) vendë-vendë çahet e krijoheshin ca vrima, sa një grusht. Nga këto vrima shpërthente minerali i tretur aty brenda. Makineritë e tjera, që prisnin të përtyreshin, por që nuk kishin çfarë, vazhdonin të rrinin të heshtura, me nofulla shtrënguar. Këtu shuhej zëri i fabrikës dhe niste belbëzimi, kurse oxhaku atje lart kollitte frymën e kuqërremtë, që s'ishte gjë tjetër, veçse brengë dhe vuajtje prej kësaj urie makinash.

Barabani i madh ndaloi, ngaqë trupi i tij u çapërsëri.

Mekaniku i turnit, Viktori, një djalë rreth 27

vjeç, i gjatë dhe me shpatulla të rrumbullakëta, me një gojë të vogël, si të një fëmije, kërcëu dy-tre hapra prapa. Pranë këmbëve të tij vërshoi lëngu i zjarrtë. Ai u largua shpejt, duke lënë mbi pllakat e shkëlqyera gjurmët e këpucëve. Diku ndaloi dhe vështroi përsëri makinerinë. Nuk guxonte t'i afrohej. Ja dhe t'i afrohej, ç'do të bënte?! Disa herë rresht, ditë të tëra, ishte marrë me të, por gjendja veçse keqësohej. Makinaria e heshtur i ngjante një kafshe të therur, prej trupit të së cilës vërshonin currila gjaku.

— Unë nuk vë dorë më mbi të, — tha ai, — le të vijë inxhinieri.

Ndërkohë inxhinier Gjergji, që e kishte dëgjuar shuarjen e zërit të makinerisë, qëndronte i mbërthyer te shkallët e hekurta. Ai shikonte sikur të kishte përpara ndonjë të sëmurë në gjendje të rëndë. Nuk lëvizte... Frymëmarrja e rëndë ia ngrinte supet përpjetë. Kohët e fundit ishte hequr mjaft. Mollëzat i dukeshin si dy kokrra arra dhe sytë e thellë e të mëdhenj e kishin mpakur shkëlqimin e zakonshëm. Në fytyrë i vihej re pagjumësia dhe merak.

Viktori shpejtoi t'i vente pranë, por inxhinieri i bëri një lëvizje me dorë. Punëtori ndaloi dhe hapi krahët.

— Të saldohet përsëri, — i tha Gjergji me zë të ngadaltë, të lodhur.

— Të saldohet! — u çudit Viktori duke e parë drejt në sy.

Inxhinieri vazhdonte të qëndronte si më parë. Dukej sikur me mendje nuk ishte aty. Dhe në të vërtetë ai diçka po mendonte. Si do t'i vente halli

kësaj makinerie? Kështu do ta vazhdonte punën ajo!  
Deri kur?!...

— Viktor, a dëgjove ç'të thashë? — foli inxhinieri.

Viktori iu përgjigj me një frymë:

— Nuk kam ç'ti bëj më! Spesori i është bërë si letër cigareje.

— Çudi! Mos më trego gjëra që i di! — u përgjigj sertë Gjergji.

— Epo edhe kështu nuk shtyhet! — tha tjetri.

— Po si t'ia bëjmë?!

— Kërko, kërko të vijë makineri e re.

— Kujt t'ia kërkojmë? — tha Gjergji duke zbritur shkallët.

— Kujt... drejtorisë, ministrisë...

Gjergji u afrua pranë makinerisë Nr. 1. Sytë i kishte të përgjumur dhe mbi të dyja vetullat i ishte harkuar një vijë e kuqe. Gjithë natën nuk kishte fjetur. Madje kjo gjendje ishte përsëritur disa net rresht. Hamendjet dhe meditimet e ditës mblidheshin në darkë sikur t'i ruheshin errësirës dhe zinin vend në mendjen e tij. Makineria Nr. 1 ishte makineria-zemër e uzinës. Ajo nuk po punonte normalisht. E keqja që vinte prej saj, merrte arratinë në shumë drejtime, po më shumë binte në sy në furrnaltë. Ajo gatuante bukën e saj dhe, të mendosh se furrnalta punon pa mineral, është njësoj sikur të besosh se njeriu rron pa ajër.

Zbriti me kujdes shkallët dhe nisi të kontrollonte motorët. Disa prej tyre nxeheshin si në flakë. Pak të vije dorën mbi mbulesën e tyre bojë hiri, të përzhitej lëkura. Pësja e lëndës gjatë përzierjes e çekuilibronte makinerinë. Pastaj metali kafshonte

keqas, duke nxjerrë vende-vende tym dhe shkëndija.

«Kjo duhet hequr, duhet qëruar prej këtej. S'kemi ç'të presim», — tha ai për makinerinë Nr. 1.

Të zëvendësohej makineria një? Ta krijonin vetë... Dukej si aventurë!... Ajo ishte një makineri krejt e panjohur për të dhe, siç thoshin specialistët e huaj. «ishte fjala e fundit e teknikës».

«Si do t'ia bëjmë? Ata thonë se do të sjellin një të re. Po kur? Të presim... të presim», — përsëriti ai nervoz. Po deri kur!» Koha e pritjes ishte bërë gungë. Kishte që në fillim të vitit që thuheshin këto fjalë.

«Nuk duhet të presim më, — vendosi ai. — në asnjë mënyrë! Në qoftë se nuk duam që nesër, pasnesër të gjendemi para një fatkeqësie që s'do ta kalojmë dot lehtë, furrnalta s'duhet ta ndërpresë punën. Këtë askush të mos e shkojë ndër mend. Dhe të nisim ta bëjmë vetë...»

Po ç'do të thoshin specialistët e huaj? Ata premtorin se makineria e re do të vinte.

— Mjaft, mjaft, — tha ai nervoz, sikur t'i drejtohej tjetërkujt, — kemi që në fillim të vitit që dëgjojmë po këtë avaz.

Disa skica i kishte bërë gati dhe së shpejti mendonte t'ua paraqiste shokëve të byrosë teknike. I kishte kërkuar specialistit të huaj pasaportën e origjinalit, dhe ai i kishte thënë se s'po e gjente dot, por, me ta gjetur...

Raste si ky ishin dëgjuar dhe në uzinat e tjera, edhe në kantieret e ndërtimit bishtra të tilla hasje me dhjetëra.

«Ç'dreq miqësie na qenka kjo!? — tha ai. —

Kujt do t'ia shesin ata këtë «miqësi»? Dikush mund të thotë se s'mbeti te ti për të dhënë gjykime të tilla! Ti do të shpërndash dritë! Ç'e di veten?! Je inxhinier dhe asgjë tjetër. Ç'të duan le të mendojnë, — u nervozua ai, pa ia ndarë sytë makinerisë. E ç'ara, nga rridhte minerali i tretur, i shëmbëlëu me një plagë që rridhte gjak. — Po, — tha ai, — jam inxhinier, kam përgjegjësinë time. Mos vallë ka ndonjë që mendon se jam këtu vetëm për të shtrënguar vidha? Për të shtyrë mushkën? Mendimin tim do ta them këtu dhe kudo që të jetë nevoja, edhe në organizatë. Ndryshe, do të isha një mizë, një frikacak dhe atëherë do të meritoja patjetër dënimin më të rëndë. Kujt t'i fshihemi? Em... Ç'poshtërsi dhe ta mendosh një gjë të tillë! Këtu s'ka miqësi. Ata po na sabotojnë. Vetëm një miop, një fyryfyl nuk sheh përçark,», — përfundoi ai, duke nderur dorën drejt Njëshit të prishur.

U ngjit përsëri me të shpejtë.

— Viktor, — i tërhoqi vëmendjen mekanikut, që rrinte dy hapa larg, i mërzhitur dhe me një pakënaqësi gati në shpërthim.

— Kjo makineri na plasi shpirtin! — tha Viktori, që shau nëpër dhëmbë e, po duke sharë e mallkuar, nisi të rregullonte defektin.

Ç'faj kishte makina? Inxhinieri e dinte me kë kishte të bënte. Në qoftë se Viktori shau e mallkoi, e kishte me të drejtë. Ai s'kishte kursyer asgjë për ta mbajtur gjallë makinerinë. Prej fillimit të vitit e deri tani ajo u kishte rënë si një sëmundje e rëndë uzinës dhe punëtorëve.

Dikush po vinte nga krahu tjetër. Gjergji ktheu kokën. Po vinte specialisti i huaj. Qeshte, apo ashtu

lu duk Gjergjit? Specialisti ishte i gjatë, flokët i kishte të zez, të ngritur përpjetë, si një tufë gjembash të hedhur mbi kokë dhe ecte me hapa të çrregullt.

— Inshinier! — i thirri ai Gjergjit. — Ç'pati ai punëtori?

Mbi buzët e tij të holla e të hirta vetëm sa u duk një nënqeshje tinzare. Gjergjit kjo nuk i shpëtoi. Specialisti i huaj foli përsëri:

— Nuk kuptohesh dot me të...

— Unë kuptohem mirë, — tha Gjergji.

— Unë jo, — tha tjetri. — Ky punëtor sesë flet...

— Nuk ka rëndësi, — e ndërpreu Gjergji, — nuk ka aspak...

— Si, si? — këmbënguli përsëri ai.

— Nuk të intereson, desha të them. Pse, pse mërzitësh kot...

— Ashtuuu! Po ai e ka me mua.

— Asgjë s'ka me ty, — tha qetë Gjergji, — po e ka me defektin. Kemi që në fillim të vitit, me t'u dukur shenjat e para, që ju kemi bërë kërkesën për makinerinë e re, po as sot e gjithë ditën ajo nuk ka ardhur. Çudi, punoi uzina vetëm tre muaj dhe tani... Një defekt që mund të kishte ndodhur të paktën pas dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjetësh...

— Nga e dini ju që mund të ndodhte mbas kaq kohësh?

— Diçka di edhe unë, — tha Gjergji.

— Kjo është makineri e re, e panjohur për ty, Si flet ti, apo me hamendje? Lërini parashikimet, inxhinier.

— Ky është konkluzioni juaj? — ia ktheu Gjergji po me atë ton.



— Konkluzioni ynë! Me mua e keni drejtpërdrejt?

— Me ju, — tha Gjergji, — me specialistin që zëvendësuat ju...

— Ah!... — shpërtheu ai. — Mos u besoni të ikurve, inxhinier. Të ikurit janë si të vdekurit. Përpiqen të lënë diçka të mirë nga pas, por shpesh nuk e arrijnë këtë... Lërinia ata t'i mbulojë pluhuri i harrësës. Ju më dukeni i lodhur, inxhinier, dhe kohët e fundit jeni dobësuar shumë. Jam dakord me shqetësimin tuaj, por, kur ky e kalon masën, na ha kohën. Uzina juaj ushqen furrnaltën, por edhe furrnalta, pa ju, s'mund të jetojë. Ju këshilloj miqësisht; ruajeni shëndetin. — Ai u ngrit dhe nisi të ecte nëpër dhomë. — Merruni edhe me diçka tjetër. A nuk e ndieni të nevojshme të argëtoheni? — Mori prej raftit një libër, e, pasi lexoi emrin e autorit, tha:

— Ah, po pse, duke lexuar Balzakun argëtoheni ju?! E, pra, emrat e Balzakut, Dikensit, Tolstoit... këtu pata rastin t'i mësoj. Këta mysafirë borgjezë nuk e kanë nderin të hyjnë në vendin tim.

Gjergji, që mezi priti sa mbaroi tjetri, ia ktheu:

— Unë s'di ta kem tepruar me shqetësimin që kam. Pastaj, as ty dhe askujt nuk i jam ankuar. Ju falem nderit për interesimin që tregoni! Ndërsa, për këshillën që më jepni, s'është nevoja. Kam shumë mundësi për t'u argëtuar, veçse, duke lexuar Balzakun, jo.

— Atëherë pse e lexoni? — u hodh tjetri.

— Mos u ngutni, — iu përgjigj Gjergji. — Balzaku, apo edhe dy shkrimtarët e tjerë që mëdhenj që përmendët, nuk i takojnë borgjezisë. Mjerë ajo, po të kishte shumë të tillë! T'ia mohosh një populli

të drejtën për të mos u njohur me veprën e tyre është marrëzi, për të mos thënë diçka tjetër.

— Populli ynë është i madh, ka kulturën e vet të madhe dhe mijëravjeçare, — u mbrojti specialisti.

— Qoftë i madh, apo i vogël, populli është popull, — tha Gjergji, duke mos ia ndarë sytë. — Një popull e bën të madh vepra e tij, historia.

Specialisti i huaj, që u mat të ulej, përsëri mbeti me dorën varur mbi shpinoren e karriges.

— E shoh, — tha ai. — e shoh se leximi i tyre jo vetëm që nuk ju argëton, po...

— Më mëson, — e ndërpreu Gjergji.

— S'desha të them këtë, — tha ai.

— Tjetër gjë do të ishte e panevojshme, — tha Gjergji.

Specialisti ndërroi mendje për t'u ulur dhe u bë gati të largohej.

— Ju kam kërkuar pasaportën e Njëshit, nuk ma keni dhënë.

— Prisni, prisni, do t'jua sjell, — tha ai nëpër dhëmbë e doli jashtë.

Gjergji u ngrit dhe mbylli derën gjysmë të hapur.

«Pak, — tha, — pak t'u flasësh për punën, i vënë menjëherë kyçin gojës. Ndërsa, nga ana tjetër, vjen e të dërdëllis një orë të tërë. I kemi kërkuar makinerinë e re, ai hesht. I kam kërkuar pasaportën, ai prapë hesht. Prit, më thotë, prit!»

Gjergji hyri në sallën e makinerive. Punëtorët ishin pranë Njëshit. Viktori bëri mënjanë, sikur s'kishte të bënte me inxhinierin. Nazmiu hodhi cigaren tutje dhe me ashklën që mbante në dorën tjetër, goditi makinerinë e dëmtuar, ndërsa Frida, si-

për në kabinën e vinçit, ia kishte ngulur sytë fotografisë së këngëtares. Vera dhe Drita po punonin pak më tutje. Herë pas here Vera fshinte djersën dhe shfrynte si të ishte kthyer nga një rrugë e largët.

Ngurrimi i tyre, heshtja dhe një mërzi e hapur krijuan një gjendje të rëndë për inxhinierin. Iu duk sikur shkaktari i saj ishte ai vetë.

«Mos po merrem shumë me llafe, — tha, — dreqi ta marrë, po më bëhet mani, tërë ditën flas me vete».

Në fund të sallës u kthye djathtas dhe hyri në zyrë, që ishte edhe dhomë për të. Sytë i vajtën te pasqyra përballë. U çudit me ndryshimet në fytyrë dhe u afrua edhe më. Vërtet mollëzat i kishin kërcyer jashtë mase dhe një ngjyrë e hirtë shpërndahej poshtë tyre. Kishte mbi një javë që punonte pa orar. Pagjumësia i kishte brejtur shëndetin. U largua e vajti pranë tryezës. Nxori disa shënime që kishte mbajtur gjatë një diskutimi me disa shokë inxhinierë. Ideja e ngritjes së makinerisë së re i buçiste brenda në kokë dhe kërkonte të dilte, si uji prej një shpërthimi të papritur.

Për një çast i mendoi të gjitha pengesat e kapërcyera dhe qeshi.

«Fundi gjithmonë duhet menduar, — tha, — por jo ama përpara fillimit. Pa ta nisim njëherë. Duhet të dal para shokëve me fakte dhe argumente. Ta lëmë dëshirën mënjanë... nganjëherë kjo e uruar të bën të marrësh derën në krahë. T'i bëjmë llogaritë mirë. Ta peshojmë çdo mendim. Makinaria nr. 1 është krejt e re për ne. Po do të na ndihmojë pasaporta e Njëshit të vjetër, ama... Po a do të na e japin?! Të vejë puna deri atje, sa të mos na e ja-

pin? Hëm... Çdo gjë mund të presësh prej tyre! Prandaj them që ta peshojmë çdo mendim».

Mbi një fletë të bardhë bëri disa prerje të vështira dhe llogaritje të gjata.

Vonë u ngrit nga karrigia. Koka i zhurmonte, por thellë qenies së tij ndiente një kënaqësi të ëmbël, që s'ishte gjë tjetër, veçse gëzimi i fitores që parandjeu atë çast.

### III

Atë ditë dielli u duk vetëm mbasdreke vonë. Gati tërë ditën ra pandërprerë një shi i imët, por, me të nisur një erë e fortë, që mbiu papritur tej luginës së Shkumbinut, qielli u pastrua vende-vende. Urbanët e linjës rrëshqitnin mbi asfaltin e lagur dhe po aq lehtë merrnin edhe kthesën e fundit.

Frida qëndronte mbështetur mbi parmakun e urës, te dalja kryesore. Punëtorët shpejtonin për në stacion. Vajza nuk lëvizte. Pastaj ajo e humbi durimin dhe u kthye me shikim nga uji, që rridhte poshtë. Pas pak dikush i ra miqësisht te shpatullat. Ajo u kthye shpejt dhe pa Gjergjin. Buzëqeshi, po vetëm kaq, se, kur vuri re mirë që ai s'kishte hequr as çizmet, as xhupin, ajo gati sa s'ia dha vrapit.

— Si kështu! — tha ajo. — As sot nuk do të vish në qytet?

— Frida, — tha Gjergji. — Nesër do të bëjmë mbledhjen e byrosë teknike. Më duhet të përgatit një material të plotë. Mendoj ta fillojmë vetë punën për zëvendësimin e Njëshit. Besoj se mund t'ia dalim.

— U bë një javë, plot një javë që ti po aty e mban mendjen. Po pse, vetëm ti je këtu?!

— Frida... — tha përsëri ai, këtë radhë pak me habi.

Kishin marrë vetvetiu krahun e djathtë të stationit. Lëvizjet andej ishin të rralla. E vetmja zhurmë ishte shushurima e plepave.

Ai i kapi lehtë dorën, por ajo e hoqi nxitimthi dhe fare papritur u kthye andej nga erdhën. Kjo e rëndoi Gjergjin, po nuk e dha veten. Këtë ftohtësi ai e kishte ndier shpesh kohët e fundit. Ishte munduar të gjente arsyen, po tani për tani s'mund të thoshte asgjë.

— Ç'ke kështu? — e pyeti ai.

— Bëjmë mirë, ose bën mirë të marrësh edhe një shtëpi këtu, — tha ajo. — Po, po, pse qesh? Kujton se kam nevojë për shaka!

— Po ti për të qeshur po flet, — tha Gjergji. — Si mendon ti, të mos merremi me defektin, ta lëmë uzinën të...

— Mos e lër, mos e lër, — e ndërpreu ajo, po me tonin e mëparshëm dhe shpejtoi të arrinte urbanin që sapo mbërriti.

— Natën e mirë, — thirri Gjergji, por ajo nuk u përgjigj. «Ndoshta nuk dëgjoji! Po mbase edhe ka dëgjuar...», mendoi ai.

Nga larg u dëgjua sirena e furnnaltës. Atij i shëmbëlleu me një zë të afërt, që e thërriste t'i shkonte sa më pranë.

Nxitoi. Kaloi njëherë nëpër sallën e makinerive. Njëshi, me çrregullime, po megjithatë ishte në punë. Hyri në dhomë dhe, si zakonisht, punoi gjer vonë. Atë natë studioi disa tipe makinerish të për-

afërta me Njëshin. Në njërin nga materialet që po lexonte, i tërhoqi vëmendjen një shënim i shkurtër. Tipe si makineria një kishin filluar të viheshin në përdorim vitet e fundit dhe deri tani i gjeje vetëm në pak shtete të botës. Ky njoftim e bëri të mendohej dhe nisi t'i rishikonte edhe një herë të gjitha shënimet, skicat, prerjet që do të paraqiste në byronë teknike. Kjo punë e lodhi mjaft. Ora tregonte dy pas mesnate dhe koka i peshoi mbi tryezë. Pas pak u ngrit ngadalë, sikur të ruhej se mos i trembej gjumi dhe, sa të numëroje deri në tre, filloi të dihas-te shpejt dhe lodhshëm.

Ai kishte besim se shokët do ta përkrahnin. Mendimi do të rrihej e do të bëhej më i pjekur. Të gjithë ishin të shqetësuar për fatin e uzinës. Memcëria e saj vinte e bëhej më e padurueshme. Shënjat ishin që shumë shpejt, ndoshta për pak ditë a javë dhe makineria Një të ndalonte në vend, dhe heshtjen e saj t'ia përcillte edhe furnaltës. Njëshi ishte zemra e uzinës, po furnalta ishte zemra e kombinatit.

Ja, me këtë ndjenjë u ngrit dhe nisi të vishej shpejt. Doli në platformën e sipërme dhe, kur pa flakën e furnaltës të përkëdhelej pas faqes së kaltër të agimit, u qetësua dhe e pushtoi një ndenjë e ngrohtë gëzimi. Tutje dukeshin të shkonin e të vinin urbanët e linjës. Ishte freskët dhe punëtorët nxitonin. Disa e linin turnin e disa sapo e merrnin. Gjithnjë i kishte pëlqyer ky çast i ndërrimit të turneve.

Në lëvizjet e punëtorëve, në përshëndetjet e tyre, me një përgëndrim sado të vogël, zbuloje merakun dhe gëzimin e punës. «Mëngjeset e uzinave ndryshojnë nga të shkollave, — mendoi ai buzagaz,

— jo vetëm nga uniforma e nga mosha, po sikur kanë diçka më serioze, më të përgjithshme. Apo kështu më duket mua?» — përfundoi ai.

Ndërkohë diçka krisi. Makineria Një kishte ndaluar përsëri papritur.

«Pa filluar mirë puna», — tha ai dhe shpejtoi.

Viktori kishte marrë pincën dhe i bënte zë Nazmiut, po ai e bënte veshin shurdh. Inxhinieri i vështroi. Me siguri diçka kishte ndodhur midis tyre. Ndoshta do të ishin grindur. Atij nuk i pëlqeu as toni i Viktorit, as qëndrimi i Nazmiut.

«Kjo djall makinerie po na i prish njerëzit, po na prish shokët,» — tha ai dhe u vajti pranë.

— Ç'keni? — pyeti.

— Nazmiu nuk do të punojë, kërkon të ikë nga uzina, — u përgjigj Viktori.

— Unë kam kërkuar lejen, — tha ftohtë Nazmiu, — dhe do ta filloj.

— Ky është preteksti, — ia ktheu Viktori. — Kujt ia shet ti këto?! A s'të pashë dje te zyra e kuadrit? Pse s'thua të vërtetën?

— Të vërtetën thashë, — u hakërrua Nazmiu.

— Jo, ti e merr lejen që gjatë kësaj kohe të gjesh ndonjë punë tjetër, — tha Viktori.

Gjergji, që gjatë kësaj kohe kishte heshtur, i hodhi një sy hetues Nazmiut.

— Si, ti dashke të largohesh ng uzina?! — i tha.

— Unë jam mekanik, — tha Nazmiu, — e jo punëtor komunaleje, që të rri gjithë ditën rreth Njëshit, me fshesë në dorë. Prishu, ndreq, prishu, djallosu!

— S'erdhi, — tha Vera. — Erdhi deri tek autobusi dhe u kthye, ishte e sëmurë.

— Si, e sëmurë dhe erdhi deri...

— Kështu më tha, kështu të thashë, — e ndërpreu vajza. Pastaj, duke i dhënë zërit një notë ironie, vazhdoi: — Sot është e shtunë, s'është keq kur e fillon pushimin një ditë më parë.

— Kështu mendon ti?

— Kështu mendon ajo, — ia ktheu Vera, që, si gjithnjë, dhe sidomos kohët e fundit, kur bisedonte me Gjergjin për Fridën, qëndronte ftohtë.

Vera e kishte shok të ngushtë Gjergjin dhe dashurinë e tij me Fridën, qysh kur nisi, e pa me frikë. Për të Frida ishte vajzë e bukur, atëherë edhe e urtë, por shumë shpejt cilësia e dytë ishte zëvendësuar nga një kryelartësi e kotë.

Afër drekës, kur Njëshi u vu përsëri në punë, Gjergji u largua. Me të dalë nga salla, u ndesh me specialistin e huaj. Ai po qeshte. Gjergjit ia pati qejfi të ndërronte udhë. «Gjithnjë qeshin kot», — tha.

Kinezi vazhdonte të qeshte, sikur të kishte dëgjuar shakanë më të bukur të botës.

— Gati rashë në kanal, — tha ai.

— E ç'ka këtu për të qeshur?! — tha Gjergji më shumë me vete. Ngriti paksa dorën dhe hyri në zyrë.

Punoi tërë mbaşdreken. Doli prej andej vetëm kur shkoi të hante darkë.

#### IV

Të dielën paradite ai kontrolloi materialin që do t'u paraqiste shokëve të byrosë teknike. Mbledh-



ja mund të bëhej të nesërmen. Shkoi të bënte edhe një banjë me ujë të ngrohtë te kaldaja e furnaltës. E pushtoi një kapitje, por pas banjës kjo i kaloi shpejt. Pastaj nisi të rruhej. Në cep të pasqyrës kishte vënë një fotografi që kishte dalë me Viktorin tre vjet më parë. Shkumonte faqet dhe shtë s'po i hiqte që andej. Qeshi.

«Sepse u rritëm shpejt, — mendoi, ë?... — U përpoq të shkulte një fije floku të zbardhur para kohe, por ajo i shpëtoi dhe humbi në masën e flokëve gështenjë. — Ndërsa Viktori mbahet mirë, — tha me vete. — Vetëm shpatullat, shpatullat po i zgjerohen, por ama ata kaçurelat e tij po ma marrin të keqen. Plugu i ka hyrë gjer në gjysmë të kokës.» Qeshi përsëri. Ndërkohë ra zilja e telefonit. Frida po e merrte për herë të dytë.

— Do të vij, — tha ai, — do të vij patjetër.

Ai hëngri drekë me nxitim dhe nga mëraku hyri edhe një herë në uzinë. Kujtoi se aty do të rrinte pak, po kjo i kushtoi gati dy orë.

Vera, që kishte radhën e gatishmërisë atë ditë, e siguroi se do ta lajmëronte, kudo që të ishte, po të ndodhte ndonjë avari serioze. Ajo e nërcolli deri te dalja dhe aty i pastroi me përkujdesje supet e pluhurosura.

— Është ditë pushimi, — i tha ajo buzagaz, — dhe Frida do të të kritikojë, po të mos jesh i rregullt.

— Kritikën së pari do t'ia bëj unë asaj, — tha ai.

— E pse?

— Sepse dje s'erdhi në punë.

— Kujdes, kritika jashtë orarit të punës s'është

të fort e këndshme, — i tha me të qeshur ajo. —  
Fshiji pak këpucët.

Ai u bind si një nxënës i urtë. Sepse i dukej  
tjetër njeri vetja. «Ndoshta kam kaq kohë që s'kam  
dalë në qytet, — tha, — u bë puna me liralalje më  
duket».

— Më i qeshur, — bëri shaka Vera.

Ai i tërhoqi lehtë flokët dhe buzagaz u largua.  
Një shofer, shok i tij, për të mos ngritur pluhurin  
e rrugës, ngadalësoi shpejtësinë e makinës dhe i fo-  
li duke qeshur:

— Më erdhi keq për kostumin që ke veshur,  
inxhinier, se, sa për ty... ty pluhuri të duket pudër.

Gjergji e përshëndeti po ashtu, duke qeshur. Kur  
doli në krah të portës së jashtme të uzinës, dëgjoi  
që e thirrën. Ishte Metani, mjeshtri i uzinës.

— Inxhinier, na paske tharë sytë, or i uruar,  
për nder! S'kam parë djalë më të pashëm!

Gjergji tundi kokën si i turpëruar dhe nxitoi të  
arrinte urbanin. Kur zbriti në qytet, e pushtoi një  
gëzim i lehtë. Ishte fund pranvere. Mbrëmja ishte  
e freskët, e bukur. Veshjet e errëta të dimrit qenë  
hequr dhe tani, në rrugën kryesore, e sidomos te  
Sheshi i Dëshmorëve, lëviznin ngjyra të shumta.  
Përballë teatrit pa Fridën. Ajo kishte veshur një  
fund ngjyrë speci dhe një triko bojë hiri me jakë  
të hapur. Varësja e vogël, kur ajo lëvizte, shfaqej si  
një xixëllonjë. Frida i kishte prerë flokët dhe atij iu  
duk shumë më e bukur. Ndoshta, ky ishte shkaku  
që dy djem më këtej kërkonin t'i tërhiqnin vëmend-  
jen, por ajo, me qëndrimin që mbante, përhapte ve-  
tëm mospërfillje. Gjergji ndjeu dëshirë të ishte sa  
më parë pranë saj dhe, po të premtonte koha, kishte

qejf të bënte edhe një shëtitje me të, para se të fillonte shfaqja.

I dha dorën. Edhe ajo ia zgjati të sajën tërë ëmbëlsi. Njëri nga djemtë lëshoi një kollë të thatë, ndër-sa tjetri tundi kokën, sikur të thoshte: paske lindur me këmishë, vëlla!

Pas shfaqjes Gjergji e pyeti Fridën:

— A të pëlqeu drama?

— Gjithë ajo dashuri dhe s'pamë një... të paktën një përqafim, — tha Frida, që peshoi fort mbi krahun e tij.

— Kishte nevojë, në tërësi, për më shumë realizëm, — tha Gjergji.

— Deshe të thoshe se kërkonte përplasje, ndeshje?... Sa të pëlqen kjo e shkretë ashpërsi! — tha ajo.

— S'është e vërtetë, — iu përgjigj Gjergji. — Po të ishte më shumë realiste, edhe vërejtjen tënde do ta shihja të realizuar. Si ka mundësi që një njeriu të ashpër t'i pëlqejnë përqafimet, — bëri shaka ai dhe i hodhi dorën mbi sup. Trupi i saj u drodh lehtë. Ai e afroi më pranë. Hera-herës, për shaka, i mbyllte sytë dhe ajo peshonte kokën mbi gjoksin e tij. Prej saj çlirohej një erë e këndshme. Ecën një copë rrugë pa folur.

«Do t'i them, — mendoi Frida, — do t'i them». Megjithatë po ngurronte. Largoi paksa trupin prej tij dhe të dy u kapën për dore. Diku Gjergji i shtrëngoi dorën me përkëdheli dhe e ktheu nga vetja. Vështroi me ëmbëlsi fytyrën e bukur të saj, sytë e mëdhenj e të qeshur. E puthi. Po aq e singertë dhe e dëlirë u tregua edhe ajo.

Pa e kuptuar, kishin hyrë në një lulishte dhe

qëndruan tek ai stoli i bardhë nën dritën vezulluese. Ndenjën për një kohë aty.

— Frida, — tha Gjergji, — nuk e kuptoj ngurrimin e prindërve të tu. — U ngritën dhe u vunë në rrugë. Gjergji vazhdoi: — Ata janë edhe të rinj. Po të sillej nëna ime kështu, i falej.

— Pse mërzitësh, çdo gjë do të bëhet si më mirë, — e qetësoi ajo dhe mendoi se kishte ardhur çasti që t'ia thoshte atë që e mundonte. Ajo e parandiente që Gjergji s'kishte për ta pritur mirë. Megjithatë, kur vajtën pranë shtëpisë së saj, ajo ia tha:

— Gjergji... është krijuar një rast i mirë... dua të shkoj në laborator.

Ai nuk foli.

— A më dëgjove? — pyeti ajo.

— Nuk po të kuptoj, — iu përgjigj ai qetë.

— E pra, dua të shkoj në laborator. A nuk është më mirë si për ty, edhe për mua. Ç'të bëj në uzinë, vinçiere?

— Seriozisht e ke? — tha ai që s'dinte, ta besonte, apo jo.— Nga të lindi kjo dëshirë? — pyeti dhe, duke vështruar atë, pa në fytyrën e saj shenjat e ftohtësisë që ishin shfaqur dhe herë të tjera.

— Ti mos u përziej, — tha vajza, — e di se mund të përflasin. Mund të thonë që ja, «e paska rregulluar inxhinieri». Më ka premtuar... — Ajo përmendi teknologun e laboratorit, Pandin.

— Ç'hyn ai këtu!? — pyeti Gjergji.

— U bëre xheloz? — tha ajo, që u përpoq ta lehtësonte bisedën, — ti mos ki merak, me ty...

— Frida!

— Gjergji, të lutem ma plotëso dëshirën.

— Pse, moj, dëshirë na qenka kjo?! — tha ai.  
— Të ikësh nga uzina, e kur... ne tani kemi nevojë për punëtorë të tjerë. Pastaj uzina jonë...

— «Uzina, uzina!», na plase! — e ndërpreu ajo. — Unë s'rri më aty. E çfarë? Vinçiere!

— Po pse, unë pianos i bie? — tha ai. — Apo kërkon të bësh lojë me mua? — u përpoq të bënte shaka, duke i marrë dorën asaj.

— Unë e kam vendosur, — u revoltua ajo. — Kam biseduar edhe me mamanë e më tha se është dakord. Gjithmonë kam menduar se ti nuk do të më lejoje.

— Dhe as nuk të lë, — tha ai, — pastaj, ti për këto gjëra s'ke psë të pyesësh mamanë. Ti e di fare mirë gjendjen në uzinë.

— Thashë që e kam vendosur, — tha ajo.

Ai ndjeu përpjekjen e dorës së saj për t'u shkëputur nga e tij.

— Bisedojmë nesër.

— Natën e mirë, — tha ajo dhe iku nxitimthi. Ai priti një çast të shkurtër. Ndjeu zagushi të madhe. Në dhomën e saj u ndez drita, Gjergji priti të merrte sinjalin e zakonshëm, shuarjen e dritës dy herë, por ajo u fik dhe ai më kot priti që ajo të ndizej prapë.

## V

Mbledhja e byrosë teknike u bë dy ditë më pas. U prit të vinte drejtori, por ai ishte nisur për në Fierzë dhe ende s'ishte kthyer. Kështu që atë e drejtoi Metani, një mjeshtër me përvojë. Ai i ra shkurt, ashtu si zakonisht; nuk i pëlqenin zgjatjet, stërho-

llimet. Kapja mbas thelbit të gjërave ishte një nga cilësitë e tij dhe, kur shtinte në dorë këtë, të tjerët çuditeshin me sigurinë dhe humorin e tij.

— Atëherë s'na mbetet gjë tjetër, — tha ai, — kjo le të mbetet mbledhja më e shkurtër në botë. Me ç'pamë, në teori gjërat ishin të qarta dhe shtruar drejt. Gjendja e krijuar në uzinë të na nxitë të gjithë për ta realizuar. I urojmë Gjergjit sukses!

Të gjithë u ngritën. Gjergji e priti Metanin te dera. Ky i futi krahun miqësisht, si ta kishte birin e vet.

— Përveç shqetësimit që na paraqite ti, i dashur Gjergj, — tha ai, — të kuptova mirë, kishe edhe diçka tjetër për të thënë. Mos vallë për specialistin e huaj? Mos m'u përgjigj. Nuk është nevoja. Ata kanë punën e tyre, ne kemi tonën. Me të nisur ndërtimin e makinerisë së re, emri yt do të vejë deri në ambasadë, e pastaj... ku i dihet...

— Siç të ndodhi ty, — ia ktheu Gjergji, — kur nise të ndërtoje sferat e mëdha.

— Po ai avaz, — tha Metani.

Gjergji ngurroi një çast, pastaj tha:

— Partia duhet t'i dijë...

— Ti je komunist, — i tha Metani, — unë po ashtu, ja pra që i ditka për bukuri Partia.

: Gjergji i shtrëngoi dorën, ai e përqafoi po aq miqësisht dhe u ndanë. Përfundimet e mbledhjes u përhapën në tërë uzinën para se të vente aty vetë Gjergji. Punëtorët e shfrytëzimit, mbi të cilët binte pesha më e rëndë e kësaj fatkeqësie që kishte pllakosur uzinën, po i vështronin me një interes të veçantë ata të mekanikës, që do të ishin këtej e tutje,

s'dihej për sa kohë, kirurgë për plagën që kishte marrë uzina.

Grupi i mekanikës me Viktorin në krye prisnin të vinte inxhinieri, por edhe këta nuk ishin të gjithë. Nazmiu kishte ikur, po në vend të tij kishte ardhur një punëtor i shfrytëzimit. Ndërsa Frida...

Në zyrën e kuadrit që paraqitur një vajzë rreth njëzet vjeç, me pantallona bojë hiri dhe një triko të ngushtë vishnje. Fytyra e saj me sy të mëdhenj përfundonte me një mjekër të prerë bukur. Flokët mjaft të zeza, i kishte prerë shkurt dhe poshtë tyre, rreth qafës, dukej jaka e trikos vishnje, mbi të cilën fërkohej herë-herë ajo mjekër e bukur, pak sqimatave. Në gishtin e dorës së djathtë ajo mbante një unazë me gur të gjelbër, që i kishte tërhequr vëmendjen nëpunësit të kuadrit, i cili të kujtonte ata njerëz që habiten për hijgje. Më në fund ai tha:

— Dikur ju na nxorët veshët... s'them për ty, — e zbuti tonin ai, — por edhe për të tjerë, bile pati disa që s'lanë gur pa lëvizur vetëm e vetëm që të punonin në këtë fabrikë, ndërsa tani, hëm, kërkoni largimin.

Ai hoqi shikimin prej dorës së vajzës e nisi të kërkonte nxitimthi diçka nëpër sirtar. Përsëri foli, po me atë ton.

— Teknologu Pandi ia bëri mirë një punëtori që kishte një kërkesë po si kjo jotja. Edhe ai donte të largohej. Për këtë ka ligje dhe nuk ju mban njeri me zor. Po nuk është mirë.

Vajza mblodhi vetullat dhe prej çantës nxori një letër, që e la mbi tryezë. Ai e vështroi me vëmendje, pastaj nënqeshi sa edhe rrudhat e ballit iu dështuan.

— A, po pse më lodhe! Ti je Frida...

— Duka, — plotësoi mbiemrin vajza, duke fërkuar buzët me njëra-tjetrën dhe duke lënë mbi to një shkëlqim të këndshëm.

— Po pse më lodhe, — përsëriti ai, — pse më lodhe kot. Fare kot. E kemi biseduar me teknologun punën tënde. Ti ke punuar vinqiere, tani do të punosh në laborator. Bukuri!

Vajza u lehtësua dhe fërkoj shkujdesshëm mjekrën pas jakës së trikos.

Tjetri plotësoi disa formalitete dhe ajo qeshi, pastaj lexoi me vëmendje atë që ishte shkruar në letër.

E kënaqur, doli jashtë. Një erë e lehtë pranvere, që vinte prej luginës, ngrinte një re pluhuri, e cila po aq shpejt fashitej e humbiste, duke lënë pas vetes një copë rrugë të pastër. Frida shtrëngoi çantën e vogël varur mbi sup dhe bëri më tutje për t'iu ruajtur pluhurit. Me njërën dorë shkundi me përkujdesje të madhe fundet e pantallonave. Kur ngriti kokën, qëndroi e befasuar. Ja dhe ndërtesa e lartë e laboratorit. Përpara kishte një lulishtë, prej lulëve të freskëta e plot ngjyra të së cilës të dukej sikur vetë pranvera prej andej merrte krahë e shpërndahej mbi tërë gjithësinë. Frida, me një drithmë të ëmbël, u ul në stolin e parë. Ja puna e re, mendoi ajo. Kënaqësia që e madhe, dhe njëherësh me të edhe rëndësia që i dha pas kësaj vetes. Çfarë kishte biseduar të dielën me Gjergjin? Tani ai ishte inxhinier dhe ajo laborante. Më mirë kështu! Po... çudi, pse të mos pranonte Gjergji që ajo të largohej nga fabrika? Derisa ai e donte, patjetër që kënaqej që ajo të ishte mirë e më mirë. Ndërkohë, një laborante e ve-



shur me përparëse të bardhë, po zbriste mengadalë shkallët.

«E ç'ka më shumë se unë kjo», mendoi dhe e përfytyroi veten të veshur po si ajo, me përparësen e bardhë dhe me flokët e zinj që do të binin mbi të.

Tani flokët i kishte të shkurtër, por do t'i linte të zgjateshin deri poshtë supeve. Kjo kishte qenë një dëshirë e vjetër. Po ku t'i mbante, sipër në vinç!? Qeshi. Solli ndër mend vitet e shkollës. Sa binte në sy midis shoqeve! Një shok i klasës bile kishte thurur dhe një vjershë për flokët e saj. Qeshi përsëri dhe, ashtu e gëzuar prej këtij kujtimi të largët, u ngrit. Hyri në sheshin e uzinës. Po gëzimi që e kishite pushtuar, u struk, u tremb si zogu prej ngricës së dimrit. Dritaret e mëdha, pjesët e rënda metalike dhe vinçi-urë mbi kokë lëshuan hijen e rëndë mbi supet e saj të vogla. Atë çast riprodhoi me mend bisedën që kishte bërë me Gjergjin të dielën. Ai e donte dhe ajo ishte e sigurt për këtë. Kjo e bënte të besonte se Gjergji do të ndërronte mendim dhe do të yente ta kërkonte.

Kaloi me mospërfillje pranë Verës dhe Dritës. Ngjiti shkallët me të shpejtë dhe hyri në kabinën e vinçit.

— Po kjo si e ka hallin? Tri ditë që s'ka ardhur në punë, — i tha Drita Verës, që po kontrollonte kushinetën e montuar rishtas.

— Kërkon të shkojë në laborator, — tha Vera.

— Si!? — u habit Drita. — Po kjo këtu...

— Këtu ka Gjergjin, deshe të thuash. Hëm... kështu si e ka zënë kjo... Gjergji i ka thënë jo, ndërsa zonjusha... Fola pak ashpër, po kështu e meriton ajo.

Unë Gjergjin e kam shok, jemi rritur bashkë dhe më vjen keq për të. Ç'kërkon kjo... për një vajzë me mend në kokë do të ishte fat një djalë si ai.

Ndërkaq Frida po zbriste nga kabina. Kishte mbledhur diçka në një pako, ndoshta rrobat e punës, kishte hequr prej dritares edhe fotografinë e këngëtares. Ecte pa zhurmë dhe shpejt, thujse po e ndiqte dikush nga pas. Siç duket atë nxitim ia shkaktonte ajo qetësi deri në shurdhim që kishte përçark.

— Frida, — i thirri Vera, — Frida, — i thirri për herë të dytë, por ajo nuk ndaloi.

## VI

Pas mbledhjes së byrosë teknike Gjergji nuk shkoi në uzinë. Ai kishte vendosur që, para se të vinte në dijani shokët e vet për vendimin, ta shohiste edhe një herë më qetë në mendjen e tij. Shokët e repartit mekanik nuk ishin të gjithë mjeshtër me përvojë dhe inxhinierë si ata të byrosë. Aty duhej folur shumë më qartë dhe sa më thjesht. Po saldimin e barabanit kush do ta bëjë? Viktori? Jo. E pra, prandaj s'duhet ngutur. Viktori është mekanik. I shkoi mendja te dy-tre saldatorë të tjerë, pastaj përfundoi te «qëndistari i madh», siç i thoshin shpesh Metanit. Vërtet që ai ishte mjeshtër i përgjithshëm, por si saldator, tre-katër veta kishte si veten, bile dhe këta i vinin anës.

«Metanin, atë do ta marr, — vendosi. — Aq më mirë që edhe kam biseduar disa herë me të për këtë punë.»

Ky përfundim e lehtësoi dhe u gëzua. Fërkoj duart i kënaqur.

«Tani të gjej edhe materialet». Iu kujtua punëtori i vjetër i magazinës, Daja, siç i thoshin. «Zor se do t'ia mbush mendjen lehtë. Ai s'të jep një bulon dhe jo pllaka çeliku... Po do të më japë se s'bën. Pastaj shkoj në repart dhe ulemi këmbëkryq». Magazina e madhe shtrihej prej anës së prapme të uzinës nr. 7 e mbaronte aty ku zinte fill kantieri. Punëtori i vjetër i magazinës dikur kishte qenë punëtor bujqësie po në këto toka, ku tani ngrihej pjesa jugore e kombinatit. Prej fshatit të dikurshëm s'kishte mbetur asgjë, veç asaj kumbullës në mes të sheshit, me katër degë të mëdha, dy prej të cilave ishin tharë.

Gjergji shtyu derën, hyri brenda e, pasi vështrroi njëherë përçark, u drejtua te pllakat e çelikut. Aty mund të gjente spesorin që i duhej.

Punëtori i vjetër i magazinës e pa nga larg.

— Përsëri vijnë të nxjerrin! — tha ai trishtueshëm.

Kohët e fundit tërheqja e materialeve ishte shtuar. Anka të tëra, të stampuara në të katër anët, tërhiqeshin prej traktorëve, ose ngriheshin peshë prej vinçave. Nisnin rrugën tutje dhe linin pas gjurmët të mbushura me bar verdhacuk.

— Nxirrni, nxirrni! — thirri ai gati me një zë vajtues dhe i erdhi ndër mend një urdhër i dikurshëm, i lëshuar prej sekretarit të Komitetit të Partisë, për të mos u tërhequr asnjë material nga magazina, veçse në raste të jashtëzakonshme. Raste të tilla, ama! Dhe për të këto raste ishin për-

mbytja, zjarri... lufta. Po nga këto asgjë s'kishte ndodhur. Atëherë ç'po ndodhte?

«Na duhet filan material. Do të marrim këtë pajisje», dhe i linin në dorë një copë letër. Pastaj dëgjohej hungërima e vinçit apo zhurma shurdhuese e traktorit. Pastaj... Çdo gjë shkonte jashtë magazinës, duke lënë në shesh boshllëk dhe habi në mendjen e punëtorit të vjetër, i cili çakërdiste sytë, se si këta njerëz nuk i vinin njëherë gishtin kokës.

Më vonë vinin të tjerë. Na duhet, s'mund të rrimë pa vazhduar punë. Po si? E kemi bërë kërkesën... ka defekt teknologjik. Dy muaj punë?! Epo, s'bëhen bulonat prej brumi! U dogj kushineta. Prej druri ishte?! Kemi bërë kërkesë për sferat e mëdha. Ato s'po vijnë. E pse? Ka dallgë Oqcani Indian! — i kishte thënë mjeshtri i vjetër, Metani.

— Shiko, shiko, — kishte thënë punëtori i vjetër i magazinës.

Ndërkaq Gjergji e kishte gjetur spesorin që kërkonte. Vajti nën hijen e kumbullës dhe i thirri punëtorit, por ai nuk lëvizi nga vendi, rrinte si i ngrirë, ulur mbi stol.

Gjergji buzëqeshi dhe u mbështet pas trungut të pemës. Një dorë lule të bardha u shkëputën prej saj e u shpërndanë për qark. Ngriti sytë lart. Lulet e bardha po rralloheshin. Ai dihati thellë, nxori një bllok të vogël e nisi të shënonte në të. Ky ishte hapi i parë që po bënte për përgatitjen e makinerisë së re. Në qoftë se spesori i gjetur do të ishte i një marke me atë të barabanit, fillonte

shkalla e dytë. Sikur të kishte pasaportën e makinerisë, do të ishte më lehtë. Specialisti i huaj i kishte premtuar se po e kërkonte dhe, me ta gjetur, do t'ia jepte. Gjendja ishte bërë e padurueshme. S'dalim dot para shokëve, mendoj ai. Plani s'po realizohet dhe, jo vetëm kaq, por po bëhemi pengesë edhe për të tjerët.

U bë nervoz dhe e la bllokun mënjanë. Iu kujtua kërkesa e Nazmiut: «Largohem për shtrëngesë ekonomike.» Shtrëngesë ekonomike, qeshi ai hidhur, shtrëngesë për birrë, për... në djall!

— Po ti, hajde! — i thirri ai punëtorit të magazinës, që vazhdonte të rrinte si më parë, — hajde, ç'ke që më përgjon. Unë s'po jap shpirt, nuk po vdes!

Punëtori i magazinës qëndroi edhe një hop ashtu dhe pastaj sikur u pendua dhe erdhi pranë tij.

— Ç'ke, — i tha, — më dukesh shumë i lodhur.

Gjergji nuk foli, po shfryu me mlllef.

— E pse e nxjerr këtë? — e pyeti ai për pllakën metalike që ishte pranë këmbëve të Gjergjit. Ai i rrëfeu se ç'kishte ndër mend të bënte.

— Uzina juaj s'ka tre-katër muaj që ka filluar punë dhe u prish. Ma merr mendja që për kaq kohë, edhe unë po të rrotullohem, nuk kam për të vdekur, — tha punëtori. Midis tyre ra heshtja. Punëtori, kur vështroi inxhinierin, me sy të mënduar e të lodhur, tha:

— Bëji sytë katër, çun. Dy muaj punë fabrika e të ngel në dorë. Sheshin që dikur ishte plot, ju

e bëtë rrafsh. Qofsha i gabuar, por në kokë më vijnë shumë gjëra...

Përsëri ra midis tyre një heshtje. Gjergji rrinte mendueshëm. Ato që dëgjoji prej punëtorit, vërtiteshin edhe në mendjen e tij dhe vetëtimthi e pushtoi një dëshirë e madhe për t'ia shprehur edhe atij.

— Ja, po vjen një vinç për t'u ngarkuar, — tha punëtori, — kushedi sa të gjatë do ta ketë listën. Ika, po dëgjo, inxhinier, atë punën që ke menduar, nise. Ajo pllaka që ke marrë, është tamam për atë që të duhet. Çoje në laborator, po deshe, po të jesh i sigurt...

Punëtori u ngrit dhe, me një hap të shpejtë bëri drejt vinçit që sapo futi kokën në shesh.

«Duhet të filloj menjëherë», — tha me vete Gjergji dhe ndër mend i erdhi makineria e dëmtuar.

Kapërceu hendekun dhe u hodh në rrugën e gjerë. Në të dyja anët e saj shtriheshin tuba të trashë. Nëpër ta zhurmonte me rrapëllimë gazi, që mundahej të gjente një të çarë për të vërshëllyer jashtë. Hija e uzinës së gizës thyhej përpara këmbëve të tij. Më poshtë, një mori tubash të hollë e të ndritshëm thureshin me njëri-tjetrin, duke krijuar mbi të një rrjetë të imët, nëpërmjet së cilës mund të shihje vetëm një pëllëmbë qiell. Mori në të majtë. U mbështet për një hop mbi listelën e gardhit duke mos i ndarë sytë nga një flutur që bridhte si e dehur, lule më lule. Se pse qenkam lodhur shumë, mendoi. Vuri buzën në gaz dhe ndjeu një fillad të freskët në fytyrë.

Nxitoi dhe pas pak ngjiti shkallët e laboratorit. Në fund të korridorit, përballë një dore të lyer me bojë gri, qëndroi. Aty ishte zyra e Pandit. Trokiti, po nga brenda nuk u dëgjua zë. Trokiti përsëri, e përsëri heshtje. Shtyu derën ngadalë dhe ndjeu t'i binte mbi fytyrë një afsh i ngrohtë që të rëndonte frymëmarrjen. Brenda nuk kishte njeri. Nën tryezën kryesore përhapej një ndriçim përflakës. Gjergji u afrua dhe pa një furnelë të kuqëluar. S'i mjaftojnë kaloriferët, tha ai me vete dhe hoqi spinën nga priza.

Ndërkohë hyri teknologu. Me të parë Gjergjin, fytyra e tij mori një shprehje pakënaqësie. Kur vuri re furnaltën që ishte fikur, tha:

— Ju të bazës jeni të hekurt, ndërsa ne, ne jemi si zogjtë. Mërdhijmë shumë.

— Jashtë është më ngrohtë se brenda, si duket, muret kanë akoma lagështi, — tha Gjergji dhe lëshoi mostrën mbi tryezë. — Të analizohet përqindja e të gjitha komponenteve.

— Pse?

— Na duhet për makinerinë numër një.

— Ndonjë aventurë kështu? — tha tjetri.

Gjergji e vështroi vëngër.

— Jo për aventurë, — tha shkurt, — por do ta bëjmë vetë Njëshin.

— Si vetë!?

— Është vendim i byrosë teknike.

Tjetri, që po përgatitej t'i kundërvihet paq, ngaqë atë që dëgjoi e quajti si një veprim për t'u dukur, kur mori vesh se ishte vendim i byrosë teknike, e mpaku sulmin dhe e nisi në një krah tjetër:

— Po, po, mirë bëni, — tha ai, — kam dëgjuar për Njëshin. Fatkeqësi e madhe. Po ti je inxhinier i zoti, kështu flasin... S'thonë kot, më mirë të të dalë syri se nami...

Gjergji mendoi ta shpërblente po me atë monedhë, por ndërroi mendje.

— Veçse kujdes, — tha teknologu, — Nazmiu të kishte ikur nga uzina. Mos të të ikë edhe ndonjë tjetër...

Kjo e tronditi me të vërtetë Gjergjin. Ç'ishte e nevojshme të përmendej Nazmiu?

— Nazmiu iku dhe udha mbarë i qoftë! — tha Gjergji. — Ndërsa të tjerët janë të gjithë në uzinë. Nga të erdhi ty ky mendim?

— Mos u rrëmbe, — tha tjetri. — Mos u rrëmbe, se do të nxehesh dhe pa dashje do të fyesh ndonjë tjetër, që për ty s'do të ishte mirë.

Gjergjit fluturimthi i shkoi mendja te Frida.

— Kushdo që të jetë, — tha ai më në fund.

— Ashtu! — bëri Pandi gjoja i prekur.

— Po, po, — vazhdoi Gjergji, — kushdo që do të vepronte si ai, do të meritonte më tepër se një fyerje.

— Po shkak, — tha ai që mendoi se e shtiu gurin në dorë, — shkak i këtyre gjërave cili është? Ti je inxhinier, inxhinieri i uzinës... po kot s'thonë që faji u bë qyrk dhe s'e veshi njeri.

— Nuk erdha këtu për të zbërthyer proverbat, — i ra shkurt Gjergji, për t'i dhënë fund këtij lumi fjalësh. — Më kthe sa më shpejt përgjigjen!

Tërhoqi derën dhe doli. Nxitoi dhe shumë shpejt u gjend në uzinë. Ngriti kokën dhe vështroi



kabinën e vinçit. Fotografia e këngëtares ishte hequr. «Paska ikur, — mendoi, — qenka e vërtetë.»

Iu bë sikur dëgjoi zhurmë, po gabohej. Sallën e makinerive e kishte mbytur shurdhimi. Pranë mjeshtrit, që ishte shtrirë, rrinin Viktori, e të tjerët. Sa vunë re inxhinierin, e kuptuan gjendjen e tij, u bënë më të heshtur dhe vështronin njëri-tjetrin, duke pritur se kush prej tyre do ta thyente akullin.

— Viktor, po ju pres, të lajmërohen të gjithë, — foli vetë inxhinieri.

Ata vrapuan pas tij. Fjala e inxhinierit u ktheu gjallërinë dhe shqetësimit të tyre i dha një kuptim të ri. Gatishmërinë e tyre ai e ndjeu, dhe kjo e kënaqi. Iu duk vetja më i qetë, më i qartë. Ai u foli shokëve për mendimin e byrosë edhe të vetin. Dikush kërkoi sqarim: përse nuk po vinte makineria e re? Një tjetër kërkonte që, para se të fillonte puna, t'u merrej specialistëve të huaj pasaporta e origjinalit. Gjergji i dëgjoi me vëmendje. Si t'u përgjigjej?

— Shokë, fakti është që ne s'e kemi makinerinë e re, tani për tani nuk kemi as pasaportën. Gjendjen në uzinë e dimë të gjithë. Si do të bëjmë? Këtej të nisë gjykimi dhe mendimi ynë. Për të tjerat Komiteti i Partisë...

— Ndihma që vjen prej mijëra kilometrash... — ironizoi Viktori.

— Viktor, — i tërhoqi vëmendjen Gjergji, — unë propozova që diskutimin ta nisim nga një pikë tjetër.

U krijua një gjendje e nderë. Gjergji u ngrit më këmbë. Heshtja ia uli supet. Ajo ishte si një cipë e hollë që me zor të madh përpiqej të përmbante shpërthimin.

— Makinaria një duhet të ngrihet patjetër me forcat tona. Do të duhet mund, djersë... — nisi të fliste i pari Gjergji dhe shpejt e shpejt vuri skicat mbi tryezë. Pastaj diskutuan të gjithë. Mbaruan shumë vonë.

## VII

Specialisti i huaj kishte mbi tri ditë që nuk ishte dukur fare nga reparti i mekanikës. Ai e kishte marrë vesh se punëtorët kishin vendosur ta bënë vetë makinë nr. 1, dhe kjo e tmerronte. Megjithëse thellë-thellë ndiente njëfarë sigurie se ata s'kishin për ta bërë dot, prapëseprapë frikën ua kishte. S'ishte rasti i parë ky.

«Dhe kanë një këmbëngulje të çuditshme, — mendonte ai, — një guxim të marrë». Aty për aty iu kujtua urdhri i shefit të tij. Të bëhej çmos që makinaria të mos ngrihej. «Po sikur...», nuk guxoi ta çonte mendimin më tej dhe një frikë e bëri të dridhej e të tulatej.

Ai u largua me të shpejtë, kur pa të vinte drejt tij Viktori me një ingranazh në dorë. I ruhej shumë atij, sidomos këto ditë, menjëherë pas fillimit të detyrës së re; ai i ishte qepur dhe me këmbëngulje i kërkonte pasaportën e origjinalit.

«Ndoshta ai e di që s'ka për ta marrë kurrë

atë, — mendoj specialisti, — por tregohet kokëfortë që të më diskreditojë. Ai është djall, ai sikur i di të gjitha ato që kam unë në mend, dhe jo vetëm të miat, por të të tërëve, edhe të shefit vetë.»

Bëri më tutje dhe aty u ndesh me Verën. Vajza diçka zbërthente mbi një skicë të hapur në shesh.

— Humbe fare, — i tha ajo.

— Sëmure, — u përgjigj ai.

— Ruh, si shpesh po sëmuresh, — i tha vajza me qesëndi.

— Vera vajzë e mirë, — tha ai.

— Të gjithë të mirë janë, — u përgjigj Vera sa për të kaluar radhën.

— Jo, jo, — bëri ai. — Viktori bë... koka vogël, po...

— Koka vogël, po punë shumë, — e ndërpreu Vera, — ndërsa ti koka madhe, punë hiç... — i tha si me të qeshur ajo.

Ai u mundua ta kalonte romuzin duke qeshur.

— Po Nazmiun?... Nuk e pashë Nazmiun, — tha ai. Pyetja e tij shprehte më shumë se aq. Qëllimin e vërtetë e zbuloi toni i egër dhe gjithë kënaqësi.

Vera heshti një çast, pastaj e vështroi vëngër.

— Nazmiu, — tha ajo, — nuk sheh ç'bëhet për-qark, nuk sheh më larg se hunda e vet.

Specialisti tha diçka të pakuptueshme në gjuhën e vet dhe u largua, pa e hequr mendjen nga Vera. «Këta janë të gjithë si Viktori, veçse me atë mund të kapesh kur të duash dhe t'ia lësh

barrën mbi kurriz, kurse këta, — dhe solli ndër mend edhe inxhinierin, — këta të djegin...»

Kaq shumë e kishte humbur, saqë vetëm kur doli në rrugën e gjerë, në të djathtë të uzinës së pastrimit të mineralit, e kuptoi se po bëhej natë. Atë rrugë e bënte ditë flaka e furrnaltës, ndriçimin e së cilës ai nuk po e duronte dot, prandaj u hodh më tutje. Kishte ardhur që në fillim të vitit dhe ja, po mbusheshin pesë muaj dhe s'po mësohej dot me të. Pamja e saj i ngjallte një ndjenjë të keqe, të frikshme.

«Ja, ajo furrnaltë që kërkon të hajë mineral, po më ha jetën», — thoshte me vete. Ai kishte urdhër që të shuhej ajo flakë dhe këtë detyrë e kishte marrë prej shefit të vet qysh ditën e parë të ardhjes në uzinë. Të shuhej patjetër flaka e saj, që i shëmbëllente, sipas tij, një plage në qiell.

Shpresat kishin qenë të mëdha, por, kur nisi ndërtimi i makinerisë së re, ato erdhën e u tretën. Prandaj i ruhej dritës dhe ishte gati që më mirë të zhytej në fundin e një pusi, sesa të duronte ndriçimin e saj. Por edhe pse u fsheh nën kapriatat aty pranë, flaka e furrnaltës nuk i ndahej, dhe ai mori inat hijen e vet, që i shfaqej herë djathtas, herë majtas. Shpejtoi dhe hyri në dhomën e shefit. Ai ishte një burrë i shkurtër me ballë të kërcyer si pjepër. Mbante veshur një xhaketë bojë hiri dhe në xhepin e djathtë të saj tre stilografë me ngjyra të ndryshme. «Me cilin prej tyre, vallë, u shkruan emrat e atyre që u kthyen në fund të dhjetorit, — mendoj specialisti, — emrat e të ikurve, siç i quante ai, të të rebeluarve.» Dhe atë çast iu shfaq Tibeti. Nuk kishte qenë asnjëherë atje, e kishte parë ve-

tëm nga lart, kur kishte kaluar mbi të me avion. Atëherë i qe dukur si shkretëtirë, pa fund e pa anë, mbushur plot me skelete, me ca skelete që, për çudi, qëndronin më këmbë e lëkundeshin vazhdimisht, natën dhe ditën, prej erës së marrë që vinte nga thellësitë e Kinës.

«Unë s'jam mirë, — tha ai me vete, — më dhemb koka, duart... trupi...»

Shefi ngriti sytë e përgjumur prej një libri me citate dhe pyeti duke lëvizur paksa buzët.

— Ata e kanë nisur makinerinë, — u përgjigj specialisti me një frymë, në qëndrim gatitu, derisa shefi nxori njërin prej stilografëve nga xhepi.

— Na injoruan, — shtoi specialisti, duke u dridhur, — tani kërkojnë edhe pasaportën.

Shefi e dëgjoi me vëmendje, pastaj me zë të mbytur, duke trokitur stilografin mbi librin e citateve, i tha:

— Pa ne këta nuk bëjnë dot një hap. Ti nuk do t'i ndihmosh.

— Unë t'i ndihmoj! — tha tjetri i lehtësuar, edhe pse iu rishfaqën skeletet e Tibetit.

— As pasaportën nuk do t'ua japësh. Do ta biesh këtu dhe prej këtej del vetëm tymi i saj.

— Kërkojnë të na injorojnë, të na hedhin balte. Nuk na pyetën...

— Gjithnjë kanë qenë kokëshkretë, — tha shefi, — po këtë radhë nuk do t'u ecë. A e dëgjove ç'thashë?

Tjetri pohoi i qetë. Vetvetiu sytë i vajtën nga dritarja. U tremb. Flaka e furrnaltës e verboi. Ndërrroi vend dhe tha:

— Kanë shpurë në laborator një spesor për zëvendësimin e barabanit.

— Aty kemi shokun Li, — tha shefi. — Shoku Li është kuadër i zoti, udhëheqës në revolucionin kulturor... Si? Mos ke ndonjë mendim tjetër për të?

— Jo, — u përgjigj specialisti, — unë s'kam asnjë mendim.

— Shumë bukur, — tha shefi, — tani ngjitu në dhomën tënde.

## VIII

Gjendja e uzinës po bëhej çdo ditë e më e rëndë. Puna për makinerinë e re kishte nisur, po përfundimi ishte ende larg. Veç këtij meraku, punëtorët kishin edhe hallin e makinerisë së vjetër. Duhej mbajtur gjallë edhe ajo, që me zor të madh nuk punonte më shumë se tri-katër orë në ditë dhe që edhe atëherë, siç thoshte punëtori që kishte zëvendësuar Nazmiun, me shpirt në dhëmbë punonte. Shigjetat e realizimit në tabelë vinin e uleshin rëndë-rëndë. Ajo tabelë e detyroi Gjergjin të ndërronte rrugë. Ato shigjeta të vizatuara në të iu dukën sikur nga çasti në çast prisnin të lëshoheshin prej harkut të tendosur.

Herët në mëngjes e kishin njoftuar se furrnalta po harxhonte rezervat e fundit të mineralit. Parandjenja që e kishte pushtuar tani, i kishte krijuar një gjendje nervoze. Përgjigjja për spesorin akoma nuk kishte ardhur nga laboratorit. Atij iu kujtua Daja, këmbëngulja e tij dhe kjo e qetësoi deri-diku. Në repartin mekanik shokët punonin

bashkërisht, veçse Viktori, që ngriti kokën për ta përshëndetur, tregonte në fytyrë i lodhur dhe i pagjumë. Kishte punuar njëzet e katër orë rresht, duke bërë vetëm disa pushime të vogla.

Ai që kishte zëvendësuar Nazmiun dukej më i freskët, ndoshta ngaqë ishte rruar në mëngjes, edhe pse natën e kishte gdhirë në punë.

Shumë nga pjesët e makinerisë së re ishin mbaruar, ose ishin në përfundim. Vera po i tregonte për një pajisje të re.

— Kaq e lodhur qenke? Ti mezi flet, — i tha ai.

— Qaji hallin asaj, — ia priti Viktori, — ajo ka rezerva, a nuk e sheh si është?

— Ndërsa ty s'të lë macja që ke në bark, — ia ktheu vajza me shaka.

— Edhe ti paske punuar natën? — e pyeti Gjergji Verën.

— Të gjithë, — tha ajo, — po na shqetësoi Drita.

— Nuk ka ardhur?

— Është në dhomë, shkoi të qetësohet pak. Mbrëmë punoi me vinçin dhe për një çast e humbi dhe u përplas pas panelave.

— Po pse, atë dërguat ju?!

— Kë të dërgonim? Sikur s'e di ti... zonjusha Frida na la shëndetin, na iku nga uzina.

Ai heshti.

— Nuk e ke takuar? — pyeti Vera.

— As që kam për ta takuar, — tha ai i vendosur.

— Jo që ta përkëdhelësh, — shtoi vajza, — por dua që ty mos të të brejë ndërgegjja nesër.

Heshtën të dy. Pastaj Gjergji tha:

— A është vrrarë shumë Drita?

— Jo, vetëm se u trondit mjaft. Ç'i bëra që të shkonte në shtëpi, dhe s'deshi.

Ndërkohë u afrua Viktori.

— A erdhi përgjigjja prej laboratorit? — pyeti ai.

— Jo akoma, — tha Gjergji. — Unë ia dhashë teknologut vetë.

— Në dorë të sigurt e paske lënë! — ironizoi Viktori.

— Të kam thënë unë ty, — e ngau Vera, — s'të lë macja.

— Po mirë e kam, — tha ai, — dje Daja më tha se e kishte parë të krihej një orë të tërë pas xhamave të dritares.

— E pastaj?... — tha Vera.

— Për mua, një njeri që i kushton kaq rëndësi pamjes së jashtme, lë mangët shumë gjëra të tjera. Këta lloj në përgjithësi nuk janë të hairit për punë.

Gjergji dhe Vera qeshën, ndërsa ai që kishte zëvendësuar Nazmiun, e vështronte Viktorin si nxënësi mësuesin. Ky vetë ishte i vjetër, por i pëlqeu shumë fjala e Viktorit dhe i rrahu shpatullat miqësisht.

— Me pjesët hidraulike ku jemi? — pyeti Gjergji.

— Gati janë, — tha Viktori, — tani s'mbetet gjë tjetër, veçse të thërresim Qëndistarin. A do ta bëjë ai saldimin?

— Po, Metani, — tha Gjergji, — kam biseduar me të, gati është por, derisa s'kemi ende spesorin, s'kemi pse ta largojmë nga puna.

— A e mbarove projektin — bazë? — pyeti Viktori.



— Duke punuar jam, — tha ai, — por, po të kisha origjinalin... të paktën sa për ballafaqim.

— Paskan vendosur të mos na e japin, ë? — tha Viktori.

Gjergji heshti.

— Viktor, — tha pastaj ai miqësisht, — nuk thashë se s'do të na e japin.

Pak më tutje u duk specialisti i huaj.

— Do të vij përsëri, — tha Gjergji dhe bëri të ikte, që specialisti të mos gjente rast e të kthehej aty. Por tani ata kishin filluar të kontrollonin e të dyshonin edhe kur ndokush prej nesh u thoshte «mirëmëngjes.»

Gjergji bëri mënjanë.

— Inxhinier, — thirri ai, — jam tepër i gëzuar. Porsa u ndava nga një grup studentësh kinezë. Njëri prej tyre ishte nga krahina ime. A e di si i quajnë ullinjtë tuaj atje? — Ai e ngriti zërin me qëllim që ta dëgjonin edhe të tjerët. — Pema e miqësisë.

— Miqësi agrumesh, — ia priti Viktori.

— Çfarë tha ai? — i tha specialisti Gjergjit.

— Asgjë, — tha Gjergji.

— Çudi! Me atë punëtor nuk jam marrë vesh kurrë, — tha tjetri dhe i futi krahun Gjergjit.

— Më premtuat se do të më binit pasaportën... — i tha Gjergji.

— Kush tha se nuk do t'jua sjell.

— Bjere, de, të shkretën, — tha përsëri Viktori me zë të lartë.

— Po e kërkoj. S'lashë vend pa e kërkuar, por s'po e gjej.

— Po pse, ç'u bë ajo, zog?! — tha Viktori.

Gjergji e vështroi, por nuk pati ndër mend të ndërronte bisedë.

«Në fund të fundit po i kërkojmë diçka që na takon.»

— Thashë që nuk po e gjej, nuk po e gjej... —  
iu mor goja specialistit.

— Mos e hëngri miu... — e shtyu më tutje Viktori.

— Po, miu, miu, — u hutua ai.

— E shikon, inxhinier, e paska ngrënë miu!

— Kush tha se e ka ngrënë miu?! — u nxeh specialisti.

— Ti the, — ia priti Viktori.

— S'është e vërtetë, ti the i pari, — tha specialisti.

Gjergji tundi kokën me përcmim. Si të vepron-te. Si mund ta frenonte Viktorin, kur ai tjetri s'dinte ç'thoshte. Ai ishte i detyruar ta zbuste gjendjen. Edhe pse ata i thoshin sherrit lepe, duhej të largohej me durim dhe takt. Gjuha e përgjigjes s'duhej të ishte e njëjtë me të atyre, prandaj i futi krahun dhe u largua së bashku me të.

— Punëtor i çuditshëm, — turfulloi specialisti, — dhe ju mendoni që ta ndërtoni vetë Njëshin. Me tipa si ai do ta ndërtoni?!

— Atë e kemi mjeshtër, — tha Gjergji.

— Për opinga, — foli tjetri.

— Thashë mjeshtër në teknikë, — u përgjigj Gjergji, që liroi krahun prej tij.

— Mos harro, inxhinier, se puna që ke nisur, s'është punë artizanësh.

— E dimë, — tha Gjergji.

— Por duhet të këshilloheshit, duhet të pyetnit...

— Pse të përsëritim po të njëjtat gjëra, — tha Gjergji pak më butë, edhe pse tjetri po i acaronte nervat.

— Makinaria një do të vijë. Vërtet është një makineri e rrallë, po në Shangai si ajo prodhohen dhjetë në ditë.

— Furrnalta po harxhon rezervat e fundit të mineralit, — tha Gjergji dhe nuk ia ndau sytë.

«Furrnalta, — mendoi specialisti, — furrnalta. A do të mund të shuhej fare ajo!»

— Këtu është vapë, — tha ai dhe shkopsiti jakën e mbyllur, — vapë. Verë e tmerrshme, verë e nxehtë...

— E shëndetshme, — e ndërpreu Gjergji.

— Ju dhe kohës i jepni kuptim...

— Thashë të vërtetën, — e ndërpreu përsëri Gjergji.

— Ju kam dëgjuar edhe herë të tjera, — tha ai, — flitni ashpër dhe me kuptime shumë. Më kujtoni komisarët e Stalinit. Çudi, ju jeni edhe i ri!

— Hëm! — bëri Gjergji. Kjo gjuhë s'ishte e re për të. Edhe herë të tjera i kishte dëgjuar se si përpiqeshin ta çonin ujin në mullirin e tyre, kërkonin sherr dhe, kur s'e arrinin këtë, kënaqeshin edhe me acarimin më të vogël, pastaj ndodhte si në atë lojën e kalamajve: «ta lashë», dhe nisnin të ankoheshin për mungesën e konsideratës për ta.

— Komisarët e vërtetë, kudo që të jenë, janë të gjithë njësoj.

— Çdo shtet ka komisarët e vet, — u përgjigj specialisti, që mendoi se i erdhi zogu në dorë.

— Nuk ngatërroj as kombësitë, as vendlindjet e

student, koha e provimeve. Mësonte në shtëpi dhe më të shumtën natën. Njëherë nëna, e frikësuar, heshturazi kishte hyrë në dhomën e tij dhe, pa u vënë re, ishte ulur mbi divan dhe vështronte e çuditur të birin që mërmëriste me vete.

U ul ngadalë, sikur të ruhej mos trembte kujtimin e nënës që i qe fanitur para syve.

«U bënë kohë që s'të kam parë, më fal. Po do të vij shumë shpejt. Sa më ka marrë malli!»

Hapi dritaren. Vezullimi i dritave dhe sidomos ndriçimi i flakës së furnaltës pushtoi dhomën.

Pa orën. Vonë ishte, po do të punonte. E ndiente veten të fortë dhe të sigurt. Ndeshja e fundit po bëhej me një makineri tepër të vështirë, pa asnjë orientues dhe me specialistët e huaj që përpiqeshin ta pengonin me gjithfarë mënyrash. Por ai nuk po tërhiqej. Kishte bërë një punë të madhe përgatitore dhe kishte dalë para shokëve me një mendim të pjekur, të saktë. Ata qenë treguar entuziastë dhe e kishin ndihmuar. Mendimi i tij nuk mbeti një rrjedhë e vogël, e pafuqishme, që e thith dheu rrugës, por erdhi u mbush si një përrua i vërtetë, që nuk shteronte kurrë, ditën edhe natën, si tani, madje edhe ato pak orë pushimi që bënte, i bënte nën melodinë e atij vërshimi.

Ngriti kokën dhe lëshoi lapsin nga dora. Po hidhte në projekt barabanin e madh, që do të fillonte të zbatohej menjëherë pas ardhjes së spesorit nga laboratorit. Si do të bëhej montimi i tij? Njëherësh. Po sikur të kishte devijime?

«Ta diskutojmë nesër me shokët, — mendoj. — Aty le të vendosim. Vetëm ky na ka mbetur. Pas-taj vemë mbi të firmën.» Ai hodhi lehtë firmën e

tij dhe po atë çast e ndjeu veten të turpëruar. E prishi shpejt e shpejt atë, sikur të ruhej mos e shihte njeri. «Kjo makineri do të mbajë vetëm një firmë, — tha, — Kombinati Metalurgjik, ja firma e saj.» Pastaj qeshi gjithë shend dhe shkroi: KOMETAL.

## IX

Drejtori u kthye nga Fierza dy javë më vonë nga dita që kishte nisur puna për makinerinë e re. Ai ishte montator i vjetër hidrocentralesh dhe e kishin thirrur atje urgjentisht për disa pengesa që po hasnin. Nga kombinati, me telefon, i kishin njoftuar diçka rreth punës së re, po se si kishte shkuar filli më tutje, ai nuk dinte gjë. Ndaj tërë rrugën, derisa mbërriti, e bëri me këtë merak. Shumë mendime i vinin në kokë dhe herë-herë diçka mërmeriste me vete. Shoferi, i çuditur, e vështronte me cepin e syrit të djathtë.

— Ç'ka ndodhur në uzinë? — e pyeti ai.

— Si? — bëri drejtori.

— Mos ka ndodhur ndonjë fatkeqësi në uzinë?  
— pyeti përsëri shoferi.

— Ë... — jo, — bëri drejtori. — Djemtë na kanë nisur një punë të mirë, por edhe të vështirë... por kam frikë se ata... — Ai donte të thoshte diçka për specialistët e huaj, por ndërroi mendje. Dy javë në Fierzë e kishte parë ballë për ballë armiqësinë, arrogancën dhe hipokrizinë e tyre.

— «Një hale janë, — mendoj ai, — si ata, si këta që janë në kombinat.»

mbyllte, sepse ndërkohë u dëgjuan disa goditje me tërsëllimë. Pak më tutje, te sheshi i magazinës, Daja kishte hipur mbi kumbull. Me njëren dorë mbahej, ndërsa me tjetrën shtrëngonte sëpatën dhe goditte dy degët e thara. Teknologu kushedi ç'fantazonte dhe shkrihej së qeshuri me lëvizjet që bënte tjetri. Daja, kur për një çast pa dritaren çelur, zbriti dhe i vajti teknologut në zyrë.

— Të kam ardhur edhe një herë tjetër, — i tha, — po s'të kam gjetur. Desha të të pyes për analizën.

Teknologu e vështroi i çuditur. Ç'kërkonte ky? Vendosi t'i tregonte vendin këtij plakui.

«Si plak, — mendoi ai, — i lirojmë vendin në kafene, si punëtor e mësojmë të respektojë normat fillestare.»

— Ç'kërkon ti? — i tha teknologu.

— Për analizën erdha, — përsëriti Daja.

— Aa, për analizën! Po ç'je ti?

— Punëtor jam, — tha Daja.

— Atëherë, shko shiko punën tënde! Ti kujton...

— Edhe kjo puna ime është, — këmbënguli ai.

— Ti kujton... — vazhdoi tjetri mendimin e prerë, — ti kujton se të gjitha punët janë të tuat, edhe që të më përplasësh mua lart e poshtë puna jote është... ë!? Shko, more, shiko hallin tënd, ç'të duhet ty në rri apo s'rri unë nëpër dritare.

— Vëri mend punës, — tha Daja, — pa rri ku të duash.

— Çfarë të kam unë ty, ë, — tha i revoltuar teknologu, — s'po kuptoj, po kush është këtu...

Ai s'e mbaroi dot fjalën, por s'ishte nevoja, se

Daja e kuptoi fare mirë se ku i dilte tymi. Atë çast u hap dera.

— Urdhëro, shoku Li, — tha teknologu.

Daja u ngrit dhe doli jashtë. Ai kishte kohë që s'kishte qejf as t'i shikonte specialistët e huaj.

— Si doli analiza? — pyeti teknologu.

— Keq, e kontrollova vetë, — tha i huaji.

— Po si do t'ia bëjmë?

— Pllaka që duhet, ka përzierje speciale çeliku. Zor se mund të gjejmë këtu, po në Shangai mund të mbushësh edhe një vapor...

— Atëherë të kërkojmë, — tha teknologu.

— Posi... dhe do të na vijë shumë shpejt... — ia ktheu tjetri.

— A s'po vjen të dalim?

— Shkoni, më duhet ta dërgoj përgjigjen edhe me shkrim, — i tha ai duke qeshur.

— Të gjitha të dhënat i ke këtu, — tha i huaji, duke lënë një letër mbi tryezë. — Mirupafshim, — përshëndeti në gjuhën e tij, edhe pse e dinte shqip këtë fjalë.

Matanë dritares sëpata e Dajës nisi prapë këngën. Ai u nervozua dhe shpejtoi të mbyllte dritaren. Poshtë, në trotuar, po kalonte Frida. Përparesja e bardhë i rrinte e ngushtë dhe i nxirrte mirë në pah format e bukura të trupit.

— Femër e shkëlqyer! — tha teknologu në zjarrllëk dhe goditi lehtë xhamin. Ajo ngriti kokën dhe i buzëqeshi. Ai i bëri shenjë me dorë. Frida ndërroi rrugë dhe ngjiti shkallët. Trokiti dhe hyri brenda.

— Ulu, — i tha ai dhe, kur i dha dorën, s'e ndjeu veten mirë. Nuk u shtir, por, si gjithnjë, para

bukurisë së saj e humbiste fare. Tani as që po fliste dot. Goja i ishte tharë. Për të marrë veten, nisi të shfletonte kot. Ja, tani Fridën e kishte aty pranë. Kishte qenë një dëshirë e vjetër kjo, por fakti që ajo kishte qenë vinçiere dhe s'do të mund t'u vente pas ëndrrave të tij, sikur e ngushëllonte dhe fajin ia kishte hedhur fatit të vajzës, që s'kishte pasur një punë për të qenë. Por, kur mori vesh dashurinë e saj me Gjergjin, e kuptoi se e kishte dashur shumë, madje kjo ndjenjë e fjetur i qe kthyer në vuajtje dhe, me t'u dhënë rasti, e mori Fridën në laborator... pastaj le të vendoste koha. Ai kishte besim se ajo që ishte vetë aq e bukur, do të dinte ta çmonte bukurinë edhe te të tjerët. Hapi i parë qe hedhur me sukses. Laboratori e kishte ndjellë Fridën si lulja bletën.

— Unë kot po shfletoj, — tha ai.

— Duket, — tha vajza me buzëqeshje.

Intimiteti që u krijua prej përgjigjes dhe buzëqeshjes së saj ishte në dobi të tij dhe atëherë, prej vrullit të ndjenjave, i shpërtheu një mendim i përsëritur disa herë.

— Frida, sa e bukur je!

Ajo e priti fare e qetë këtë. Për gjërat që dihen, interesi është i paktë, por, edhe pse nuk e shfaqti, asaj i pëlqeu ky pohim dhe për një çast iu duk krejt i ri, ose si një meritë e harruar, që dikush është përpjekur t'ia mohonte.

— Nuk ke vajtur ndonjëherë në uzinë? — pyeti ai.

— Unë? E pse? — bëri ajo. Sytë e saj të bukur e thyen shikimin e tij zhbirues.



— Po Gjergjin nuk e ke takuar? — Ai këtë radhë e quajti veten idiot. Ç'ishtë kjo pyetje! Po pas pak iu duk se veptoi mirë, sikur hoqi një barrë prej shpatullave. Do të bëhej një ditë një pyetje e tillë dhe s'ka më mirë kur shqetësimi i së nesërmes merr fund një ditë më parë.

— Ai të vijë të më takojë, — tha ajo.

«Ja sa mirë bëra që pyeta», mendoi ai.

— Atë mos e prit, ai të braktis kur të duash. Këtë cilësi e ka në karakter. E kam provuar vetë... Kjo e çarë nisi menjëherë pas emërimit tim në laborator. I pëlqen vetëm vetja dhe interesohet vetëm për vete. Ja, të pyes ty, pse s'donte që ti të vije këtu?

— Të mendosh që është dhe me shkollë të lartë, inxhinier, — tha ajo.

Ai qeshi dhe e vështoi ëmbël.

— Ju diç na dini ne, po këtu në kombinat u bënë kaq shumë inxhinierë, sa kanë nisur të thonë edhe anekdota. Tipa si ai i shkaktojnë këto. Kuadri ta ruajë veten. S'është puna se i ke bërë të gjitha po të vishesh, apo të flasësh si punëtorët. Thjesh-tësia qëndron në të tjera gjëra.

— Ai e tepron, — tha Frida, — ka muaj të tërë që s'dëgjoj gjë tjetër prej tij veçse fjalë për uzinën, tamam si një tifoz.

Teknologu i buzëqeshi dhe për një çast s'ia ndau vështrimin. Ai e ndjeu veten më të sigurt.

«Dashuria e tyre, — mendoi ai, — qenka thyer si xham.»

— Vajza të bukura, kështu si ti, edhe pas një fatkeqësie, e kanë përsëri veten në dorë, — tha ai.

Të dy qeshën. Pastaj Frida u bë gati për të dalë:

— Do të dal edhe unë, — tha ai, — dua të çoj përgjigjen e analizës, mund t'i lajmëroj dhe në telefon, por kaq do Gjergji të të quajë burokrat.

Vuri buzën në gaz dhe e shoqëroi vajzën. I hodhi dorën lehtë mbi sup. Atëherë ra një heshtje e thellë, sikur të dy, befasisht, dëgjuan fillimin e një melodie të shumëpritur.

## X

Një grup punëtorësh të furrnaltës, me ta edhe Metani, një ditë pas ardhjes së analizës prej laboratorit, vendosën të venin në uzinë. Metani s'kishte më shumë se një javë që, me propozim të sekretarit të komitetit të Partisë, kishte filluar detyrën e përgjegjësit të furrnaltës. Fatkeqësia që i kishte rënë uzinës, aty dukej më hapur. Dora e përgjegjësit të ri që ndier sidomos në shfrytëzimin me nikoqirllëk të lëndës së parë. Kjo bëri që furrnalta të punonte pa ndërprerje dhe punëtorët ta ndienin veten më të qetë.

«Por kjo s'është e tëra, — mendonte ai. — Mirë, mirë, por ama lëndës së parë po i vjen fundi. Makineria një në uzinë s'na ushqen dot me atë ritëm. Ç'bëhet atje? Si i kanë punët shokët? Dëgjova se paska ardhur drejtori. T'ia themi edhe atij gjendjen në furrnaltë. Nuk mund të vejë gjatë kështu.»

Herët në mëngjes ai kishte zbritur vetë në vaskën e madhe. Aty mineral nuk kishte më shu-

më se mbi kupën e gjurit. Do të shkonin në uzinë për të parë hallet e tyre dhe, po të ishte nevoja, së bashku me ta të përvishte llërët.

Hynë në sallën e makinerive.

«Drejt ta marrë, — u kujtua, — nga nxitimi nuk veshja as rrobat e punës.»

Shpejt e shpejt nisën të ngjitnin shkallët për në drejtori. Drejtori, mbështetur me mjekrën e gjerrë mbi pëllëmbë, vështronte Gjergjin, që diç po thoshte. Pranë dritares ishte ulur Daja. Ai e lëshonte tymin e duhanit sikur të përzipte diçka të keqe nga goja. Metanit i ra në sy gjendja e ndërë. Mbi tryezë vuri re përgjigjen e analizës. As nuk ishte nevoja ta lexonte atë, rezultatit mund ta shihje në fytyrën e madhe plot rrudha të drejtorit.

— Fillove ti, — e ndërpreu Metani.

Daja u ngrit më këmbë. Flakëriu jashtë cigaren dhe doli.

— Djallo punë, diçka mund të luhet në laborator. Nejse, do ta ndjek vetë, — tha drejtori.

Gjergji doli dhe menjëherë pas tij hyri Viktori.

— Njëshi defekt, — tha ai.

Drejtori u ngrit rrëmbimthi.

— Po tani. sapo e vumë në punë, të shkretën!

Viktori mblodhi supet. Metani hoqi xhakëtën dhe shkoi te gardëroba. Ashtu bënë edhe shokët e tij. Çarja ishte e gjerë, sa të futje në të trupin e një njeriu.

## XI

KOMETAL... përsëriti disa herë specialisti i huaj, i cili vërtitej rreth pajisjeve të reja që kishin mbaruar. Ai e kishte të qartë se ç'shpërnin ato shkronja.

KOMETAL. Fjala sikur i ngeci nëpër dhëmbë. Qëlloi hekurin dy-tri herë me grusht, si një i marrë që do të provojë se dora apo hekuri është më i fortë.

«Këto pajisje nuk do të montohen kurrë. Ku do të gjejnë pllakë për barabanin! Atëherë le të rrinë kështu si skelete. Skelete prej hekuri, më zi se ata të Tibetit.»

U vërtit dhe një herë duke nënqeshur tërë ligësi. Ndaloj për një çast dhe pastaj shau e mallkoi në gjuhën e vet.

## XII

Uzina të ngjallte ndjesinë e një dimri të acar-të. Makineria një po mbahej me zor të madh. Ajo nga larg të kallte frikën. Ishte mbushur tërë mballoma saldimi dhe të krijonte përshtypjen e një hunde të shëmtuar në një fytyrë të bukur. Përgjigjja e dytë e analizës, qysh nga dita që Daja kishte çuar mostrën, po mbushte javën, por ende s'po vinte.

— Kjo s'do të thotë se ne do të heqim dorë nga puna që kemi nisur, — kishte thënë drejtori gjatë diskutimit të tij në pesëminutëshin e mëngje-

sit. — Do të gjejmë patjetër pllakë çeliku për barabanin. Por tani me forcë dhe me kurajë t'i vihem Njëshit.»

Gjergji hyri në dhomën e vet. U ul mbi shtrat dhe, i mbështetur pas murit, u qetësua për disa çaste. Nisi të kundronte. I tërhoqi vëmendje rregulli dhe pastërtia. Iu kujtua se për ditë me radhë e kishte gjetur dhomën ja, si sot dhe jo ashtu siç e linte ai, plot letra të zhubrosura të shpërndara andej-këtej. Kush e rregullonte? Këtu dukej një dorë e kujdesshme vajze.

«Patjetër Vera», mendoi ai.

Mbi tryezë ishte skica, e pakapur me dorë qysh prej ardhjes së përgjigjes negative prej laboratorit. Disa herë ishte përpjekur t'i jepte dorën e fundit, por aty për aty shkëputej dhe vështronte si i hutuar, si një njeri që i bëhet se po e thërresin që larg, po s'dihet se nga. «Zëri i uzinës që po shuhet, patjetër ai. Memecëria e hekurave qenka e tmerrshme.» — Ai psherëtiu thellë.

Ndërkaq u hap dera dhe hyri Drita. Kur e pa në atë gjendje, ajo u step.

— Më fal, inxhinier, — tha, — nuk do t'ju shqetësoj, por erdha...

— Nuk më shqetësoni, — iu përgjigj buzagaz, — po hajdeni...

— Megjithatë, — tha ajo e qeshur, — kam besim se do t'jua largoj mërzitjen, — dhe i vuri mbi tryezë një letër nga Gjirokastra, nga nëna.

— Nga nëna! — u gëzua ai dhe nisi të lexonte në këmbë.

— Të paska marrë malli, — tha vajza duke e vështruar me kureshtje. Inxhinieri po pushtohej prej një përmallimi të madh. Vajza nuk ia kishte njohur këtë cilësi. Kishte kohë pa u takuar me nënën dhe malli i saj s'kishte si shpërblehej ndryshe, veçse duke i vajtur vetë. Kështu i shkruante ajo.

— Kam nënën më të mirë në botë, — bëri shaka ai.

Ajo qeshi. Atë çast hyri Vera.

— Mirë se erdhe! — i tha ai.

— Qenke i gëzuar, — tha ajo, — cili është shkakku, — dhe ngacmoi Dritën.

— Të fala prej nënës, — i tha ajo.

— Të falem nderit. Ç'kërkon nëna, — ngacmoi përsëri Vera, — apo si gjithnjë: nuse.

— Me sa duket, — u përgjigj ai, — beqaria do të vazhdojë edhe për shumë kohë.

Qeshën të tre.

— Më fal, Vera, që nuk të kam falënderuar, — tha ai.

— E pse!? — u habit ajo!

— Për dhomën... — tha ai.

— Unë, unë! — u habit ajo. — Moj, — iu drejtua Dritës, — mos ia rregullon ti?

Drita uli kokën e turpëruar.

— Po nejtë, s'ka rëndësi, — tha shpejt Vera, — mjafton që ty të të krijohen kushte të mira pune.

Gjergji tundi kokën buzagaz. Hyri Viktori me disa shokë.

— Inxhinier, — tha ai, — sot më duket se vjen përgjigjja e dytë. Drejtori u nis urgjentisht për në Vlorë, kishte marrë vesh se mund të gjente atje.

— Ashtu! — tha Gjergji. — Atëherë së shpejti diçka do të kemi në dorë. Meqë u mblodhëm, mendoj t'i japim dorën e fundit projektit të barabanit... ta kemi gati. Kemi vendosur ta montojmë pjesë-pjesë... të thërresim dhe Metanin.

— Mbaj gojën! — thirri Viktori.

Ai që kishte zëvendësuar Nazmiun i shqeu sytë nga habia. Si i fliste ky punëtor inxhinierit me këtë ton? «Kushedi ç'do t'i ketë punuar Nazmiut të shkretë», mendoi ai.

— Po pse? — pyeti Gjergji.

— Shoku Metan duhet thënë, mos harro se ai tani është përgjegjës, — bëri shaka Viktori.

Qeshën të gjithë, edhe ai që kishte zëvendësuar Nazmiun, ndonëse me vonesë.

Pas pak ata u larguan. Gjergji mori në telefon laboratorin. I thanë se të gjithë ishin në mbledhje. Vazhdoi të hidhte dy skica të tjera në projektin-bazë dhe u shkëput prej tij vetëm atëherë kur u ndezën dritat e para.

Ndërkaq edhe mbledhja kishte mbaruar. Gjergji mendoi të shkonte vetë atje.

Kur mbërriti te sheshi para laboratorit, shumë njerëz po shpejtonin të arrinin urbanin. Ai kërkoi me sy teknologun. E pa te dera duke biseduar me dy vajza. Njëra prej tyre ishte Frida. Ajo u nda prej tyre dhe kaloi pranë Gjergjit si pa e vënë re. Ai ishte i sigurt që ajo e kishte parë. U mat

t'i thërriste, por ndërroi mendje dhe i erdhi inat për dobësinë.

— Mirëmbërma! — e përshëndeti teknologu, që shkëlqente i tëri prej kënaqësisë. Kishte mbajtur, për dy orë rresht, një leksion për ruajtjen e substancave kimike nga lagështia:

— A e more përgjigjen e analizës? — pyeti ai.

— Jo, — tha Gjergji.

— Si jo! Erdhi e mori ai plaku i magazinës dhe, të lutem shumë, mos ma dërgo më atë njeri, përndryshe do t'i tregoj vendin! S'më la gjë pa thënë, bile arriti sa të fyente edhe specialistin e huaj.

— Si doli analiza? — pyeti Gjergji.

— Negative, — tha tjetri dhe u mat të ikte. Pak më tutje, me çantën mbi sup, e priste një vajzë, të cilën Gjergji nuk e shqoi aty për aty.

— Kush e kontrollloi? — pyeti Gjergji.

— Eu! — bëri teknologu. — Këtu ka njerëz kompetentë, ç'mendon ti, se vetëm në uzinën tuaj ka njerëz të zotë?

— Kush e kontrollloi analizën? — këmbënguli Gjergji, që s'po e mbante më veten.

Tjetri u përpoq të ikte. Gjergji e ndaloi.

— Të pyeta!

Teknologu bëri më tutje dhe nënqeshi.

— S'kam nge të merrem...

— Ç'flet, more derëzi, — e ndërpreu ai. — Njerëzit po copëtohen ditën dhe natën, ndërsa ti as që do t'ia dish.



— Epo, s'jam si ti, ti i ke hallet e kombinatit mbi shpinë, — ironizoi teknologu.

— Hallet e kombinatit i kanë ata që derdhin djersë.

— Veç ti, — vazhdoi tjetri në të tijën.

— Vëri gishtin kokës, — tha Gjergji, — dhe hap sytë...

— Deri këtu arrite? — kërceu tjetri. — Deri tani s'ke lënë vend pa raportuar për mua, por do të di dhe unë si të veproj. Do t'i sqaroj mirë këto.

— Do të ta përsërit? Shiko se të është rritur mendja, — tha Gjergji, — por do ta thyesh kokën.

— E, Frida, e dëgjon? Po këtë gjuhë përdori dhe ai plaku, — tha teknologu kur i vajti asaj pranë.

Gjergji përsëri nuk ia shqoi dot fytyrën; pa vetëm çantën që ajo e hodhi mbi sup. Pastaj ai u mbështet te një shtyllë aty pranë.

Njoftimi që mori i dukej i pabesueshëm.

«Ky të jetë fundi i tërë asaj pune? — mendoi. — Mbase ka gjetur drejtori në Vlorë.» Por ky supozim iu tret po aq shpejt sa i lindi. Drejtori do të kishte lajmëruar patjetër.

«Si do t'ia bëjmë?» — Pyeti ai disa herë me radhë veten. Hija e rëndë e uzinës e ndiqte çap pas çapi. Doli në rrugë. Ecja e tij i ngjante ecjes së një njeriu nëpër një kënetë plot baltë.

Kurrë s'e kishte ndier veten kaq ngushtë. Mendoi të shkante në uzinë. Aty do të ishin punëtorët e turnit, por, kur mendoi se ç'lajm do t'u jepte, ktheu

mendje. Uzina i shëmbëlleu me një masë hekurash pa formë, pa vlerë.

Nga e djathta prej klubit që rrinte hapur gjatë natës për nevoja të punëtorëve të ndërtimit, vinin zëra të vakët. Gjergji mendoi të pinte një kafe. Vapë ishte. Ai e parandjeu se ajo natë për të dó të ishte e gjatë, pa gjumë dhe e mërzhitshme.

— Gëzuar, inxhinier! — u dëgjua një zë, sapo ai u ul në një tryezë karshi banakut.

Ai ktheu kokën. Tri tryeza më tutje pa Nazmiun, që kishte përpara pesë gota birre të zbrazura, ndërsa me një tjetër, të porsafilluar, po uronte Gjergjin.

— Gëzuar, të thashë... qysh... — tha ai.

«Ja ku i pikoka çatia Nazmiut», — mendoi Gjergji dhe iu kujtua biseda për «hallet e mëdha» të tij. Nazmiu diçka foli, por u dëgjua vetëm një *qysh* dhe pas saj një lemjë e gjatë. Atij i ishte trashur pak gjuha.

— Kam pirë, — dërdëllisi ai, — po me paratë e mia. A të kërkova gjë ty, inxhinier... qysh... po ty, po ty? — i mori ai me radhë gjithë ç'ishin në lokal. Dikush ia shkrepiti gazetën. Nazmiu iu hakërrua. Pas pak u qetësua dhe, kur Gjergji u bë gati të dilte, ai nisi përsëri të fliste.

— Inxhinier unë kam para, kam më shumë nga ju të gjithë. Pesëqind lekë kisha kur filloi kombinati, një mijë kam sot.

— Ç'ka barku e nxjerr bardhaku, — foli këtë radhë banakieri.

— Mbushi një gotë inxhinierit, — i tha Nazmiu.  
— Të falem nderit, — tha Gjergji, — unë ngutem.

— Jo, nuk është e vërtetë, ti s'pranon të pish me mua. Ju më keni marrë inat.

— Natën e mirë! — i tha Gjergji dhe bëri të ikte, po Nazmiu iu qep nga pas.

— Inxhinier, unë të dua ty... më bëj ç'të duash, se ai Viktori qysh... Viktori... — prej gojës së tij kuterboi një erë e rëndë dhe aq e fortë alkooli, saqë, po t'i vije shkrepësen, rrezik se merrte flakë. Megjithatë ai sikur e përmbloodhi veten dhe Gjergji e ndjeu këtë në shtrëngimin e duarve. — Inxhinier, më kanë thënë se jam dezertor... — Gjergjit i erdhi zor prej atyre që po dëgjonin e shikonin, po ç'të bënte! Të merrej me Nazmiun, pikërisht atë natë, kur kishte nevojë për një shok!

— Shko fli, Nazmi.

— S'jam dezertor...

— Askush s'e thotë këtë, — e qetësoi Gjergji.

— Viktori është për...

— Viktori është shoku yt dhe imi, — vazhdoi po me atë mirësi Gjergji dhe mallkoi veten që hyri në lokal.

— Më ka sharë, s'më ka lënë gjë pa thënë.

Zëri i zbutur i Nazmiut e qetësoi Gjergjin dhe ky e tërhoqi mënjanë.

— Po të jetë kështu, ka gabuar, — tha Gjergji.  
— Po ti ja ku e ke uzinën, kush të pengoi?

Nazmiu s'qëndroi më në këmbë dhe u ul në karrigen më të afërt.

— Hajde të të çoj në dhomë, — iu lut Gjergji.

Po tjetri s'foli dhe nuk pranoi të ngrihej, po mbështeti kokën mbi tryezë.

— Natën e mirë, Nazmi! — tha Gjergji dhe doli.

Ishte freskët dhe shpejtoi për në dhomë. Aty çdo gjë ishte siç e kishte lënë. Tejetej ishte hapur projekti përfundimtar i makinerisë së re, i zbatuar në pjesën më të madhe, me përjashtim të barabanit.

«Pa pllakën e çelikut, kjo mund të rrijë këtu një jetë të tërë.»

U ngrit dhe vajti e u shtri përmbys mbi shtrat. Ishte lodhur shumë, ishte mërzhitur. Koka i zhurmonte.

Ndërkohë u hap dera. Hyri Metani. Në dorë mbante një kokë të pjekur dhe dy shishe birra. Hoqi projektin prej tryezës dhe i thirri Gjergjit.

— Çohu, çohu, o pesimisti më i madh i botës!

Gjergji u ngrit dhe, pa e marrë veten mirë, i zgjati dorën. Tjetri e tërhoqi vrullshëm dhe e mbështolli në gjoks, duke lëshuar edhe një të qeshur me gurgullimë.

«Ky diçka di, — mendoi ai, — ndoshta drejtori do të ketë gjetur çelikon...»

— E mora vesh se t'u mblodhën rripat, — tha Metani, — më tha Viktori, që barabani më paska kërkuar mua. Kërkon ndihmën time...

— Kurrë s'e kam mohuar atë, — tha Gjergji, që s'po e kuptonte shakanë e shokut.

— Po, — pohoi Metani, — po këtë radhë mos e prit.

— Pse?! — bëri Gjergji dhe i shkoi mendja se mos kishte bërë ndonjë ngatërresë Viktori, apo ndonjë tjetër.

— Edhe më pyet! Nuk kam mundësi.

— Përse s'paske...

— Sepse ka dallgë Oqeani Indian, — Metani shpërtheu në gaz. Edhe Gjergji nisi të qeshte. «Pengesat vijnë prej dallgëve të Oqeanit Indian.» Këto fjalë të Metanit tashmë ishin bërë proverbiale.

— Gëzuar! — uroi Metani. — Merr mish, është i ngrohtë. Ç'ke, të shoh të mërzitur.

— Analiza erdhi përsëri negative.

— E mora vesh. Daja dje, gjithë mbasditen, bëri gurgulenë. Nuk erdhi këtu?

— Jo.

— Kërkonte drejtorin, po besoj se nuk e ka takuar, se s'ka shumë që është kthyer.

— Erdhi drejtori? — pyeti Gjergji me një frymë. — Gjeti gjë?

— Nuk kishte gjetur.

— Si t'ia bëjmë? S'po më ndahet e keqja.

— E keqja i rëntë hasmit, — tha Metani. — Do të gjejmë. Drejtori ka një shqetësim për në laborator. Ndoshta atje... Ia shfaqëm edhe sekretarit të komitetit këtë mendim.

— Ku e takuat?

— Mbeti te ne. Furrnalta, tha, duhet të punojë për të mirën tonë dhe për inat të armiqve.

— Fol më hapur, dreqi ta marrë, — tha Gjergji, që lëvizi prej vendit.

«Thashë që ky di diçka, — mendoi ai, — ky gëzim i sotëm i tij më duket i pashoq.»

— Prandaj erdha, më shumë, — vazhdoi Metani, — sekretari bëri një bisedë të gjatë me ne dhe me disa shokë të ndërtimit. Ia qamë hallet tona, sidomos ata të ndërtimit, që janë plot me to, deri në fyt. Mungojnë pajisje të tëra...

— Kujt i thua, mua? — tha Gjergji.

— Edhe ato që kanë ardhur, janë defektoze... copë: ata po na sabotojnë. Partia i di të gjitha, na tha, po një gjë ka rëndësi të madhe: ne që jemi këtu, jemi tamam ashtu siç na do ajo, të fortë dhe të zotë. Kombinatin e kemi ne në dorë dhe kjo është kryesorja... Shkoi vapa me gushtin, — shtoi Metani. Tani s'jemi në gjashtëdhjetën... Hajde, gëzuar!

— Gëzuar, — uroi dhe Gjergji.

— Gati harrova, — tha Metani, — më tha të të përgëzoj për punën që ke nisur.

— Kur ta mbaroj, — buzëqeshi Gjergji.

— Kur ta mbarojmë, thuaj, — ndreqi me shaka Metani. — Ktheje edhe atë pak birrë që ka mbetur. U bë vonë, unë po iki, ndërsa ti fli.

— Bëre mirë që erdhe. Do të punoj edhe pak.

Metani u ngrit. Gjergji e shoqëroi deri te dera dhe e la hapur atë, derisa ai doli në rrugën me dritë.

Gjergji e ndjeu veten të lehtësuar dhe u kthye përsëri pranë tryezës. E pastroi dhe hapi mbi të fletën e projektit.

Tani ishte pushtuar prej ethes së punës dhe ndihej tepër i ngazëllyer. Kështu punoi deri në të aguar.

### XIII

Në orët e para të ditës moti u prish dhe nisi një shi i fuqishëm. Rrëketë u krijuan shpejt. Nëpër rrugët e kantierit nuk shihje njerëz. Rralle të zinte syri ndonjë që nxitonte me një thes të grisur çimentoje hedhur supeve ose mbi kokë. Koha e rëndë dhe e mugët e kishte larguar përkohësisht zhurmën e punës dhe i jepte ambientit përgjumje. Vetëm dikush, atje larg, nuk donte t'ia dinte as prej shiut dhe stivoste materiale. Nga veprimet se si e bënte këtë punë, dukej se i kishte ardhur në majë të hundës. Një copë e madhe letre, e mbetur prej thesit të qullur, i rrinte akoma pas shpatullave.

Ishte Daja. Me të marrë vesh përgjigjen negative të analizës, u kishte këputur ca të mira teknologut dhe specialistit të huaj, pastaj, me një frymë, kishte shkuar drejt e te drejtori. E kishte kërkuar në uzinë, në zyrë dhe më në fund e kishte marrë vesh se qe nisur për në Vlorë. Ajo natë për të kishte qenë nga netët më të këqija që mbante mend.

«Unë kam thënë se kam çelik të atillë, dhe po kështu them. Nuk më ka lënë akoma mendja, as më ka rrjedhur!» — Ja, këto mendime përsëriste edhe tani, ndërsa numëronte për të dhjetën herë e po stivoste pllakat prej llamarine çeliku. «Në mos mostra e parë, e dyta patjetër ishte ajo që kërkohej. S'keni besim tek unë? Po kujt, kujt i besoni... ah, ah... atij, atij buzëqumështit, — tha për teknologun. — Ai s'e ka mendjen

në punë, tërë ditën e ditës krihet e pispillohet pas penxhereve të zyrës...» Doli me të shpejtë prej she-shit. Shiu u dendësua, por ai ecte sikur të kishte diellin mbi kokë. Ngjiti shkallët dhe në krye të korridorit trokiti në derën e zyrës së drejtorit. Nuk erdhi asnjë përgjigje. I ra përsëri fort. Nga dyert e tjera u zgjatën disa koka të çuditura, me ndonjë buzëqeshje të ngrirë në buzë. Ajo më e afërta, gati e trembi. Ishte koka e specialistit të huaj, që sa-kaq e mbylli derën me forcë.

Zbriti shkallët. Shiu vazhdonte të binte. Te kthesa e parë kaloi një veturë e bardhë. Ai e vështroi kalimthi. Profili i njërit prej burrave që ishin brenda, iu duk si i sekretarit të komitetit. Ngriti dorën dhe e përshëndeti. Pa bërë as disa hapa rrugë, vetura që e kishte marrë kthesën, iu vu prapa dhe i ndaloi mu pranë këmbëve. U hap dera e pasme. Kur hipi brenda, pa në krahë të tij drejtorin. Përpara ishte ulur sekretari.

— Për tek ti ishim nisur, apo s'të besohet? — Ai qeshi lehtë dhe vazhdoi. — E di që më ke marrë inat.

— Unë! — bëri Daja. — Hëm, ti je djali im.

— Po mua? — pyeti drejtori, që atë çast ngacmoi te supi sekretarin.

— Ty po, — tha punëtori. — Ne të dy kemi nga një mal me thinja mbi kokë.

— Ti je zemëruar me ne, — tha sekretari, — se ne po tërheqim materialet, se po shkelim një urdhër të...

— Ai për mua s'është urdhër, — e ndërpreu



punëtori, — ai është ligj. Dhe askush s'bën mirë që shkel ligjin.

— Neve na duhen ato materiale, — foli sekretari i menduar. — na duhen. Prandaj e kishim krijuar edhe rezervën, që ta përdornim kur të na e lypte nevoja. E pra, sot në një gjendje të tillë jemi. — Punëtori i magazinës vështroi drejtorin, po prej syve të tij, që u mbyllën atë çast, nuk mundi të zbulonte asgjë, përveç një tronditjeje te cepi i vetullës.

Ndërkohë vetura ndaloi, u hapën dyert dhe ata zbritën.

— Ngjitungi, — u tha sekretari duke shpejtuar.

Para sallës së mbledhjeve ishin grumbulluar shumë njerëz. Punëtori i magazinës dalloi midis tyre Gjergjin, disi të veçuar, dhe i vajti pranë:

— Pse bëhet kjo mbledhje? — pyeti.

Gjergji mblodhi supet. Në fakt ai diçka para-ndiente. Mos vallë për atë që i kishte folur Meta-ni një natë më parë? Një grup burrash tymosnin duhan pranë dritares së hapur. Tymi rrëmbehej prej erës dhe humbte nëpër shi.

Kishte pasur edhe mbledhje të tjera operative, të gjata deri në një orë, më të shkurtra, madje edhe pa u ulur fare, më këmbë.

Në sallë u futën edhe një grup shokësh, të ardhur drejt e nga frontet e punës. Ata ishin lagur. Dikush shkundte kokën, një tjetër rrihte kapelën pas gjunjëve e të gjithë avullonin, duke krijuar një mjegull nëpër sallë. Pastaj ata u ulën në heshtje,

duke u imponuar edhe të tjerëve qëndrimin e tyre. Heshtje e thellë. Pas pak të gjithë, vetvetiu, kthyen kokat prapa. Po hynte sekretari i komitetit dhe pas tij disa të tjerë. Ata zunë vend qetë-qetë në presidium. Gjergji vështroi me kureshtje. I pari, nga e majta, u ul sekretari, pastaj një i dërguar i Komitetit të Partisë të Rrethit, Metani, dy të tjerët ishin vetëm të njohur për të; ai, fytyrëholli me mollëza të kërcyera, ishte Hero i Punës Socialiste, montator i vjetër dhe asistent inxhinier. Ndërsa tjetri, i thinjur këndshëm, vetëm te tëmthat, me sy të mprehtë dhe depërtues, në vend të dorës së majtë kishte një protezë. Ishte mjeshtër Mihali, i aksidentuar në vitet 60-të, në një nga veprat e Planit të Tretë Pesëvjeçar.

Sekretari, pa u ulur mirë akoma, u ngrit. Dukej i tronditur dhe i rreptë. Flokët gështenjë e të rrallë i kishte hedhur anash.

— Shokë, — tha ai. Zëri erdhi i ngadaltë, po shpejt nisi të ngrihej, të arrinte lartësinë e tij të zakonit e të bëhej më i fuqishëm.

Ai foli në fillim për situatën ndërkombëtare, duke përmendur çështjet më kryesore. Nga dëshira për të prekur sa më shpejt thelbin e çështjes, me mundim të madh përpiquej të ruante emocionet. Herë pas here dora kalonte mbi ballin e ndritur. Ai foli për rolin e Partisë sonë në ruajtjen me besnikëri të pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për kontributin e saj në zhvillimin e revolucionit në vendin tonë dhe kudo në botë.

— ... Revolucionit, — vazhdoi ai, — është një çështje e shtruar për zgjidhje... Partia këtë ua

ka bërë të qartë të gjithëve. Marksizëm-leninizmi na mëson se rruga e fitores së revolucionit është ajo e luftës, e betejave klasore dhe jo ajo e kompromiseve, bisedimeve dhe lajkave, siç predikojnë revizionistët, reaksionarët e të gjitha ngjyrave, duke përfshirë këtu edhe teoricienët e «botës së tretë»...

Salla u shtrëngua si në darë.

— Midis Partisë sonë dhe PK të Kinës ka pasur divergjenca dhe mosmarrëveshje për çështje parimore, të cilat Partia jonë ka dashur t'i zgjidhë në rrugë të drejtë, por, kur ka hasur në këmbënguljen e tyre, i ka luftuar dhe do t'i luftojë vazhdimisht, pa mëshirë...

Salla dëgjonte e përqendruar. Punëtori i magazinës kishte hedhur krahun mbi supin e Gjergjit.

— Partia jonë s'është si ajo lulja e diellit, që ta kthejë kokën një herë nga lindja dhe një herë nga perëndimi, — vazhdoi sekretari. — Partia jonë s'pranon diktat nga askush. Ata duan të na imponojnë mendimet e tyre. S'ka parti-mëmë e parti-bijë. Në qoftë se ndokush nuk e di këtë, le të mësojnë prej viteve 60-të.

Salla shpërtheu në duartrokitje.

— Vëllezër, — tha sekretari. Ai disa herë u ishte drejtuar kështu. Rradhët e punëtorëve ngjisheshin më fort.

— Këtu gjërat janë paraqitur thjeshtë si çështje teknike, vonesa, moszbatim kontratash.... po secili prej nesh s'e ka pasur të vështirë të kuptonte të vërtetën. Kjo është një meritë tjetër e

Partisë, e mësimeve të saj, që na kanë hapur sytë. Kombinatin do ta mbarojmë vetë, me forcat tona, dhe këtë e kemi pasur parasysh qysh me vënien e gurit të parë në themelet e kësaj vepre... Prova janë dhënë, edhe më të mëdha do të jepen. Vëllezër, në gjirin tonë kemi...

Ai përmendi një sërë shokësh që, edhe pse ishin penguar prej të huajve, kishin thyer norma në procese pune të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Pastaj ai tha se kemi midis nesh shokë të viteve të vështira, të Luftës, të viteve të para të rindërtimit, të viteve 60-të, edhe më të rinj, që vetë koha do t'i thërrasë me emrin e saj.

Gjergji vështroi Metanin që kishte mbështetur bërrylat dhe vështronte diku larg. Heroi i Punës Socialiste diçka bisedonte me atë shokun e komitetit. Mjeshtër Mihali, me shikimin e tij depërtues, sikur mundahej t'i maste pulsën gjithë sallës. Pastaj vështroi nga radhët. Njëri, i thinjur borë, tjetri vetëm te tëmthata, një tjetër pak i kërrusur, i zeshkët dhe eshtak, ai pranë tij, kuqo nga fytyra dhe nga flokët, më tutje një shpatullgjerë, i shëndoshë dhe i gjatë, thua se ishte vëlla me Metanin...

Ndërkaq sekretari kishte mbaruar fjalën dhe filluan të diskutonin shokë nga salla. Ata u solidarizuan me të. U përmend disa herë shprehja tashmë proverbiale e Metanit, për vonesën e materialeve për shkak të «dallgëve të Oqeanit Indian». Kjo shkaktonte një buzëqeshje të lehtë. Mjeshtër Mihali tha se kur kishte qenë dikur në Shangai, kishte marrë vesh se kryeinxhinieri i një kombi-

nati ishte njëherësh edhe pronar i tij dhe veshja e tij me dok merrej si shenjë e proletarizimit, si pasojë e «punës së madhe edukative» që ishte bërë me të për ndërrimin e lëkurës së borgjezit.

— Mund të ketë bllokadë, — tha i dërguari i Komitetit të Partisë të Rrethit, — unë, Metani dhe shumë shokë të tjerë i njohim mirë ato. Po fjalën e kam për shokë më të rinj se ne, shumë më të rinj që, siç e tha me të drejtë sekretari, koha do t'i thërrasë me emrin e vet, shokë të viteve 70-të.

Gjergji vështroi nëpër sallë. E dinte se një pjesë e madhe aty ishin moshatarë me të, por s'mundi të dallonte asnjë. E gjithë salla i shëmbëlleu me një bllok të vetëm, të palëkundshëm.

Mbledhja mbaroi vonë. Të gjithë nisën të dilnin grupe-grupe. Punëtori i magazinës u shkëput prej Gjergjit e vajti të takonte sekretarin. Ai e pushtoi një herë fort, dy herë dhe kush ishte aty pranë, vuri re në sytë e punëtorit të vjetër një pikë lot. Ky qe një çast i prekshëm për të gjithë. Dikush nisi një këngë, pastaj e pasuan dhe të tjerë. Sipër, në korridor, u formua një kor i vërtetë, gjëmues:

*Enver Hoxha e mprehu shpatën,  
Edhe një herë për situatën...*

Për situatën e re, shpata ishte mprehur edhe një herë. Vetëtima e saj shpërndahej kudo, rreth e rreth dhe larg, shumë larg, qindra dhe qindra kilometra larg.

Kombinati tejtejt gjëmonte.

Jashtë Gjergjin e takoi sekretari.

— Duhet të na dalë me sukses makineria e re, — i tha ai, — patjetër me sukses. Tani kjo punë fiton vlera të dyfishta.

Gjergji i tha për rezultatin negativ të analizës.

— E kam marrë vesh, — tha sekretari, — do të gjejmë çelik të atillë, por më parë t'i mbushim mendjen vetes se s'kemi këtu. Drejtori e mori përsipër ta zgjidhë këtë hall dhe do ta nisë nga laboratori njëherë...

— Presim të zgjidhet sa më shpejt, — tha Gjergji.

— A arriti puna deri këtu, oburra, Gjergji, sukcesi është më i nevojshëm se kurrë.. Bukur e kishit menduar firmën e re, KOMETAL, — Sekretari i shtrëngoi dorën dhe u ndanë.

Ishte vonë. Në sheshin e madh binte ndriçimi i furnnaltës dhe po ato reflekse, rozë e shkëlqyer, dukej sikur përkëdhelnin edhe qiellin.

— Ç'shikon ashtu? — pyeti Metani Gjergjin, që kishte disa minuta që e priste, — furnnaltën shikon...

— U mësuam me dritën e saj, dhe jo vetëm ne, por edhe qielli sikur u mësua me të, — tha buzagaz.

Metani i futi krahun dhe e mori atë natë në shtëpinë e vet.

#### XIV

Mëngjesi i së nesërme u gdhi me një qiell të kulluar. Vetëm tutje në horizont davaritëshin disa bishtra resh të holla. Prej uzinave ngrihej zëri i

makinerive dhe melodia e ëmbël e motorëve elektrinë. Tymi i bardhë i oxhaqeve ngrihej përpjetë drejt. Prej uzinës mekanike dëgjohej një zhurmë e rëndë dhe pranë saj toka dridhej. Daja vështronte i çuditur herë uzinën, herë gjunjët e tij, që dridheshin sikur të përshkoheshin prej një rryme të dobët elektrike.

— Çudi pra! — tha ai për të disatën herë. Pas pak aty u dha një veturë. Që aty brenda drejtori ia bëri me shénjë të hipte. Gjatë rrugës nuk biseduan asgjë. Në darkë drejtori kishte qenë i ftuar në shtëpinë e Dajës dhe kishin biseduar gjatë dhe për shumë gjëra, po ajo që u përsërit disa herë ishte shqetësimi për përgjigjen e analizës.

— Megjithatë dua ta ndjek një analizë, — kishte thënë drejtori dhe me kaq bisedës i kishte vënë kapak.

Tani ata po shkonin në laborator.

— Mbaje, — i tha shoferit drejtori.

Vetura frenoi me zhurmë. Teknologu, që e dëgjoji uturimën e makinës, shpejtoi pranë dritares.

Ai po vështronte me kureshtje dhe u prek kur pa se drejtori kaloi pranë lulishtes pa e përfillur fare bukurinë e saj.

«Asgjë nuk i hyn në sy plakut», mendoi ai.

Pas pak trokiti dera. Ai shpejtoi ta hapte, por s'qe nevoja, drejtori hyri vrullshëm, duke e mbyllur derën pas vetes. Në atë kohë, Daja sapo mbërriti sipër në korridor. U mat të hynte, por ndërroi mendje dhe nisi të bënte ecejake.

Nuk shkoi gjatë dhe filluan të dëgjoreshin hapa të shpejtë dhe zhurmë dyersh. Të gjithë

ishin vënë në lëvizje. Spesorit po i bënin përsëri analizën.

Drejtori bënte ecejake, i heshtur, kokulur. Orët kalonin. Zhurma e lehtë e presave elektrike të cimbište nervat. Daja u ngrit befasisht më këmbë. Kishte parë specialistin e huaj që punonte në laborator. Daja i vajti pas. Sepcialisti u përpoq të hynte në sallën tre, por, kur pa drejtorin atje, pranë derës, ndërroi mendje. Daja nuk ia ndau sytë.

Më në fund erdhi dhe përgjigjja.

— Analizat herët e tjera janë bërë pa kujdes,  
— tha drejtori.

Zëri e tregonte pak të lodhur, por të vendosur. Grupi i laboratorit u pushtua prej ankthit.

— Duhet ta dini të gjithë, — vazhdoi ai, — na keni penguar shumë...

Askush nuk po lëvizte. Zëri i tij, që erdhi e u rëndua edhe më, i tronditi të gjithë, po njëra prej vajzave nuk duroi dot e tha:

— Pse, shoku drejtor?! Po këto rezultate kanë dalë edhe herët e tjera.

— Ashtu! — bëri ai i çuditur. Rrudhat e ballit i ranë palë-palë mbi vetulla.

— Kush e ka bërë relacionin? — pyeti të parin teknologun.

Teknologu vështroi përçark me mëdyshje.

— Përgjegjësja, — tha ai.

— Po, — pohoi ajo, — unë, por e kam bërë... ja, kështu, siç doli tani. — Vajti me ngut te një raft dhe pruri një kopje të kartelës. Ajo përputhej plotësisht me përfundimin e tanishëm. Drejtori heshti për një çast, pastaj ngadalë tha:



— Ti, djalë, ke firmosur ç'të ka ardhur, ç'të kanë prurë... kush e ka bërë verifikimin, ti, apo dikush tjetër?

Teknologu sikur mbante në gojë një arrë gungë.

— Të pyeta! — tha drejtori.

— Specialisti i huaj, — tha më në fund ai.

— Po ti, — shpërtheu drejtori, — apo vetëm vulën në dorë? Nuk zbrisje dot që ta bëje vetëm këtë punë? Ç'është ky besim kaq i madh! Vetëm një syleshi, një njeriu të papjekur mund t'i ndodhë kështu... — Teknologu e tërhoqi zvarrë dorën që mbante mbi tryezë. Bëri të dilte jashtë, po para tij doli drejtori.

Mbasdreke një makinë hyri me tërsëllimë në repartin mekanik. Gjergji, që sapo kishte hyrë brenda, ktheu kokën shpejt. Nga kabina zbriti drejtori, ndërsa sipër, në karroceri, Daja hapi spondin e krahut të djathtë e nisi të shkarkonte me kujdes të madh pllaka çeliku.

— U gjet? — pyet Gjergji.

— Aty ishin, — u përgjigj punëtori i vjetër, — unë s'ngulja këmbë kot... Po ai, ai qumështaku... Qumështak nga mendja, se kështu është sa një plep...

Drejtori u dha nga krahu tjetër.

— E, Gjergji! — tha dhe qeshi.

— Në rregull, — u përgjigj Gjergji, që ishte gati ta përqafonte.

Ai që kishte zëvendësuar Nazmiun, si gjithnjë, vështronte Viktorin që gati kërcente përpjetë prej gëzimit.

— Kam thënë, kam thënë se ata...

— Kur mund ta mbaroni? — pyeti drejtori.  
Gjergji vështroi njëherë nga shokët e shfrytëzimit.

— Në fund të javës, — tha.

— Me krahë të lehtë, — uroi drejtori, — këtu do të jemi.

U largua përsëri po me atë makinë, duke marrë edhe Dajën me vete. Pas pak erdhën Metani me Viktorin. Mbas tyre ishte edhe Nazmiu.

— O, Nazmi! — thirri Gjergji, kur pa se ai po ngurronte të afrohej.

— Mezi i pajtova me Viktorin, — tha Metani, që i dha një shenjë kuptimplote.

— Po ç'thotë puna e re? — pyeti Gjergji.

— Kërkon të vijë përsëri në uzinë, — i ra shkurt Metani. Ata e kishin parë Nazimun të vërtitej rreth uzinës. Një nga punëtorët u kishte thënë se Nazmiu kishte që në mëngjes që bënte këtë vepër.

— Kush e përzuri, — tha Gjergji.

— Thotë që e kemi inat... — shtoi Viktori për shaka.

— Epo mjaft, — tha Metani, — Viktor, ç'i nget urët.

— Ku e dija unë, — tha Nazmiu.

— Çfarë të dije?! — tha Gjergji.

— Ata paskan qenë të poshtër...

— Sytë s'janë vetëm për të parë ç'ka xhepi, Nazmi, — i tha ai që e kishte zëvendësuar.

Ndërkohë, me të shpejtë po zbritnin shkallët Vera dhe Drita. Edhe ato ishin të gëzuara.

— Të gjithë jemi këtu, — tha Metani, — të fillojmë, s'kemi ç'presim.

Pas pak reparti mekanik uturoi nga zhurma e punës.

## XV

Java po mbaronte me erë të fortë. Ajo nisi herët në mëngjes, duke ngritur përpjetë pluhurin që rrëmbente prej shesheve, rrugëve dhe krijonte me të shtjellje fluturuese.

Specialisti i huaj u vërtit njëherë rreth makinerisë së re. Ajo, ashtu hijerëndë dhe pa lëvizur, të kujtonte një bedenë kalaje, nga maja e së cilës sheh si në pëllëmbë të dorës fushën e paanë dhe lëvizjet e armikut nëpër të.

Shikimi i tij i rreptë dhe nervoz sikur donte të shponte tejepërtej trupin e saj të metaltë. Më keq akoma ai e ndjeu veten kur sytë iu mbërthyen te shkronjat, tani të njohura, **KOMETAL**. E përsëriti disa herë atë fjalë dhe zëri i tij, nëpër dhëmbë, të sillte ndër mend belbëzimin e memecit. «E ngritën, e ngritën!», — tha ai me vete dhe rrëmbimthi, sikur ta kishte goditur njeri papritur, ktheu kokën nga furnalta.

Flaka e saj sikur përpiquej të zbuste erën dhe t'i falte agimit qetësinë. Por kjo s'kishte lidhje me të. Ai s'ndihej mirë. Para syve iu përhiqe fytyra e egërsuar e shefit, stilografët në xhepin e xhaketës së tij... Tibeti...

«S'jam mirë, tha, tërë natën mbytem në djersë. Fryn erë, po vera është e nxehtë zjarr! Verë e

shëndetshme, — ironizoi ai. — Duhet të bëj diçka, që t'ua lë në dorë...» — Vera, që kishte kohë që ndiqte lëvizjet e tij, shkoi me vrap të lajmëronte inxhinierin.

Punëtorët kishin punuar gjithë natën dhe në agim makineria e re kishte mbaruar. Tani, të kënaqur, ishin ulur në klub e po hanin mëngjesin. Të gjithë ishin aty, me përjashtim të Viktorit, që po i bënte një riparim të lehtë makinerisë së vjetër. Ajo do të punonte akoma, deri atëherë sa të niste këngën e reja. Dhe kënga e saj pritej të dëgjohej së shpejti. Gjergji nuk mund të rrinte dot ulur, edhe pse Metani, herë me shaka, herë seriozisht e këshillonte të ruante emocionet.

Ndërkaq hyri Vera. Ajo ia bëri me shenjë dhe Gjergji i vajti pas. Në sallën e makinerive u ndeshën me specialistin e huaj, që, tërë nerva, shtrëngonte në dorë një pllakë të vogël.

— Kush e ka prerë këtë? — pyeti ai.

— Ç'është ajo... ë, e Njëshit... — tha Gjergji.

Atë çast u dha edhe Viktori.

— A nuk të thashë që e preva unë? — iu drejtua ai.

— E pse e preve? — u hakërrua specialisti i huaj.

— Sepse s'mban më.

— Po pse pikërisht këtë, — tha i zemëruar, duke treguar me gisht shkronjat mbi të.

— Kjo ka dalë jashtë përdorimit, — i tha Gjergji.

— Kjo është shumë e fortë, — këmbënguli ai.

Viktori qeshi, u mat t'ia merrte pllakën, por ai u spraps.

— Qenka e fortë, ë? — ironizoi Viktori. — Ajo është bërë si letër cigareje, po ç'ta zgjatim...

— Kjo është prerë me qëllim, do ta shikojmë...

— Mbrapa diellit shkofsh! — ia pati Viktori.

— E dëgjon si flet, — iu drejtua ai Gjergjit.

— Kurrë s'jam marrë vesh me të. Përdor disa fjalë që... s'i kuptoj.

— Shprehje popullore, — tha Viktori.

— Keni shumë të tilla, shumë, hiqini...

— Janë të popullit, — iu përgjig Gjergji, — s'hiqen dot... ndërsa ju mbase e keni më të lehtë, i keni të «filozofëve» tuaj...

— Ç'janë këto, «të filozofëve tuaj»?! — tha ai me mendimin se e fitoi betejën. — Me ju nuk fli-tet. Është e kotë. Ju na konsideroni ne njësoj si... si sovjetikët.

— Mjerë ju! — tha Gjergji dhe i foli Viktorit të vazhdonte punën.

Së largu u dukën njerëz, që po vinin drejt tij. «Vijnë për inaugurimin», mendoi ai. Një valë e tërë emocionesh i vërshoi nëpër trup. Shpejtoi për në dhomë të vishte xhaketën. Prej dritares së hapur pa Dritën që rregullonte diçka, pastaj ajo vështroi për një copë herë fotografinë në cep të pasqyrës. Në anën tjetër ai kishte vënë letrën e nënës.

— Çfarë! — bëri ajo e habitur, sikur të kishte lënë një bisedë përgjysmë, kur Gjergji hapi derën. Ngjyra e kuqe e buzëve i mori edhe fytyrën.

— Hajde, — i tha ai dhe i zgjati dorën, — a nuk po vjen, do të inaugurojmë makinerinë e re. — Për një çast këmbyen me njëri-tjetrin një vështrim të ëmbël.

Rreth makinerisë së re ishin mbledhur shumë njerëz. Midis tyre Gjergji pa mjeshtër të vjetër dhe moshatarë të tij. Kishin ardhur edhe sekretari, drejtori e në të djathtë të tij ishte edhe mjeshtër Mihali.

— Metani!

— Këtu jam! — u përgjigj ai.

— Si thua?

— Çfarë! Ki besim. Ka për të dalë mirë.

— Gjergji, Gjergji! — thirri. Ndërkohë sekretari dukej se dikë kërkonte me sy.

Gjergji i shkoi pranë. Të dy iu afruan sinjalit të kuq.

— Shkrepja, — i tha ai.

Gjergji ngurroi një çast. Ra një heshtje e thellë. Të gjithë ishin të emocionuar. Gjergji vështroi edhe një herë nga drejtori.

— Shkrepja! — kumboi si urdhër një zë.

Gjergjit iu bë sikur zëri tha «Zjarr!» dhe vuri gishtin mbi sinjalin e kuq. Makineria e re filloi rrotullimin. Ai vështroi furrnaltën, pastaj edhe kon- turet e tjetres që po hidhte shtat dhe iu bë sikur rreshti i tyre ishte pa mbarim dhe mbi to ndehej gjoksi i kaltër i qiellit që në mbrëmjet e vona për- skuqej prej flakës. Sytë e thellë e të bukur i shkël- qyen si çeliku i ndezur.

## PASQYRË E LËNDËS

Tregimi i një shokut tÿm .....	3
«Kodra» .....	12
Tingujt e metalit .....	25
Kapedani pa emër .....	32
Një ditë e Gori Jankut .....	42
E qeshura... ..	54
Leka Hysi .....	61
Linja të largëta .....	74
Erërat sillnin një kujtim .....	83
Beltarët .....	95
Dimri që shkoi .....	104
Djersa dhe gjaku .....	126
Nën qiellin e furnaltave .....	165